



CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS

**“PROBLEMATIKA E NJOHJEVE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS DHE
SFIDAT E ANËTARËSIMIT NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE: 2008-
2021”**

Kandidati

MA. Dorajet Imeri

Mentori

Prof. Dr. Abdulla Azizi

Tetovë, Janar 2023

DEKLARATA E NDERSHMËRISË

Unë, Dorajet Imeri, student i doktoratës në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, me përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj se ky punim doktrate është rezultat i punës sime hulumtuese dhe asnjë pjesë e tij nuk është marrë nga autorë të tjerë, në përjashtim të pjesëve që janë të regjistruara me referencat përkatëse.

E nënshkruar: 

Nr. ID-së 128358

Kandidat: Dorajet Imeri

Unë, Elhame Arifi, me profesion lektore, nën përgjegjësi morale dhe materiale, me datë 17.01.2023, jap këtë:

DEKLARATË

Me të cilën deklaroj se kam lekturuar temën me titull: "Problematika e njohjeve të Pavarësisë së Kosovës dhe sfidat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare: 2008-2021", të kandidatit Dorajet Imeri.

Prishtinë, 17.01.2023

LEKTOR

EMRI DHE MBIEMRI

Elhame Arifi

+38345379365

lekturim@hotmail.com

Nënës, Bacit dhe Pranverës

ABSTRAKT

“Problematika e njohjeve të Pavarësisë së Kosovës dhe sfidat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare: 2008-2021”

Procesi i krijimit të shtetit të Kosovës u cilësua si mjaft kompleks dhe me shumë sfida të cilat u bartën më pas në procesin e njohjeve të shtetësisë. Sfida e parë me të cilën do të ballafaqohej Kosova ishte fakti se procesi negociues me Serbinë nuk u përmbyll me marrëveshje, prandaj njohja e pavarësisë së saj deri diku do të varej edhe nga raporti i ri që Kosova do të kishte me Serbinë. Procesi i njohjeve kishte një dinamikë jostabile, fillimisht trendi i njohjeve ishte shumë shpresëdhënës, por u ngadalësua ndërkohë për shkak të shumë veprimeve të organizuara politike serbe, synimi i të cilave ishte pengimi i njohjeve të pavarësisë së Kosovë dhe rrjedhimit edhe të pamundësimit të fuqizimit të subjektivitetit të shtetit të ri. Pengesat ishin të shtrira në disa nivele dhe forma, fillimisht si angazhim vetanak i diplomacisë serbe e në disa raste edhe i sinkronizuar me partnerët ndërkombëtarë, sidomos Rusia e cila ishte si garanci që Kosova nuk do të anëtarësohej, sidomos në OKB. Me vijimin e zhvillimit të procesit, vihen në pah edhe dobësitë dhe paqëndrueshmëritë strukturore të Kosovës, e cila nuk kishte arritur të konsolidonte politikën e jashtme. Trajtimi i rastit të Kosovës në GJND dhe Bisedimet e Brukselit, janë shfrytëzuar nga Serbia për të paraqitur rastin e Kosovës së pambyllur dhe në këtë mënyrë të përmbyllet i gjithë procesi politik i shtetit të Kosovës.

Fjalët kyçe: *Pavarësia, Kosova, pengesat, subjektiviteti, organizatat ndërkombëtare.*

ABSTRACT

"The problem of recognition of the Independence of Kosovo and the challenges of membership in international organizations: 2008-2021"

The process of establishing the state of Kosovo was described as quite complex, and with many challenges, which were then transferred to the process of recognition of statehood. The first challenge that Kosovo would face was the fact that the negotiation process with Serbia was not concluded with an agreement, therefore the recognition of its independence would depend to some extent on the new relationship that Kosovo would have with Serbia. The process of recognition had an unstable dynamic, initially the trend of recognition was very hopeful, but it slowed down in the meantime due to many organized Serbian political actions, the aim of which was to hinder the recognition of Kosovo's independence and, consequently, the impossibility of strengthening the subjectivities of the new state. The obstacles were spread on several levels and forms, initially as an independent commitment of Serbian diplomacy and in some cases synchronized with international partners, especially Russia, which was adamant that Kosovo would not become a member, especially in the UN. With the continuation of the development of the process, the weaknesses and structural instabilities of Kosovo, which had failed to consolidate its foreign policy, are highlighted. The handling of the case of Kosovo in the ICJ and the Brussels talks have been used by Serbia to present the case of Kosovo as unfinished and in this way the entire political process of the state of Kosovo has been concluded.

Key words: *Independence, Kosovo, obstacles, subjectivity, international organizations.*

АПСТРАКТНО

„Проблемот на признавањето на независноста на Косово и предизвиците за членство во меѓународните организации: 2008-2021 година“

Процесот на формирање на државата Косово беше опишан како доста сложен и со многу предизвици, кои потоа беа префрлени на процесот на признавање на државноста. Првиот предизвик со кој ќе се соочи Косово беше фактот што преговарачкиот процес со Србија не беше склучен со договор, па затоа признавањето на неговата независност донекаде ќе зависеше од новиот однос што Косово ќе го има со Србија. Процесот на признавање имаше нестабилна динамика, првично трендот на признавање беше многу надежен, но во меѓувреме забави поради многуте организирани српски политички акции, чија цел беше да го попречат признавањето на независноста на Косово и, следствено, на неможност за зајакнување на субјективностите на новата држава. Пречките беа раширени на повеќе нивоа и форми, првично како самостојна определба на српската дипломатија, а во некои случаи и синхронизирани со меѓународните партнери, особено со Русија, која беше категорична дека Косово нема да стане членка, особено во ОН. Со продолжувањето на развојот на процесот, се истакнуваат слабостите и структурните нестабилности на Косово, кое не успеа да ја консолидира својата надворешна политика. Ракувањето со случајот на Косово во МСП и бриселските разговори Србија ги искористи за да го прикаже случајот со Косово како недовршен и на тој начин е заокружен целиот политички процес на државата Косово.

Клучни зборови: *Независност, Косово, пречки, субјективност, Меѓународни организации.*

FALËNDERIM

Punimi i dedikohet nënës, Bacit, dhe Pranverës, të cilët më qëndruan afër për të gjitha, për të qenë ata shtytësit e mi kryesorë drejt sukseseve, por padyshim edhe arsyeja e arritjes së tyre, por ky punim është edhe falënderim për vëllain dhe motrat për përkrahjen e tyre të pakursyer, si dhe gjithë familjen time. Punimi është një kontribut modest për Kosovën, dhe si i tillë do të plotësohet e përpunohet.

Falënderoj përzemërsisht mentorin tim, Prof. Dr. Abdulla Azizi, për udhëheqjen e tij shkencore, sikundër falënderoj komisionin profesional në përbërje: Prof. Dr. Afrim Hoti, Prof. Dr. Bekim Nuhija, Prof. Dr. Zemri Elezi dhe Prof. Dr. Agron Rustemi për mbështetjen e tyre shkencore dhe profesionale.

Komisioni vlerësues

Mentor

- Prof. Dr. Abdulla Azizi

Komisioni vlerësues:

- Prof. Dr. Afrim Hoti
- Prof. Dr. Bekim Nuhija
- Prof. Dr. Zemri Elezi
- Prof. Dr. Agron Rustemi

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E NDERSHMËRISË	2
ABSTRAKT	5
ABSTRACT	6
ΑΠΙΣΤΡΑΚΤΗΟ	7
FALËNDERIM	8
LISTA E FIGURAVE.....	11
LISTA E DIAGRAMEVE	12
LISTA E SHKURTESAVE	13
PARATHËNIA	14
HYRJA	17
1. Lënda e hulumtimit.....	17
2. Qëllimet e hulumtimit.....	30
3. Hipotezat.....	33
4. Metodologjia e hulumtimit.....	35
5. Rëndësia e punimit	37
KAPITULLI I.....	38
ANALIZË HISTORIKE E PËRPJEKJEVE TË KOSOVËS PËR SIGURIMIN E SHTETIT DHE NJOHJES SË TIJ	38
I.1. Kontesti historik i krijimit të shtetit të Kosovës.....	43
I.2. Konferenca për Jugosllavinë - Komisioni Badinter – Vetëvendosja e mohuar për Kosovën	54
I.3. Mes ndërkombëtarizimit dhe njohjes së Kosovës - Marrëveshja e Dajtonit.....	58
I.4. Konferenca e Dejtonit, “përpyqja e hershme” e vonuar për Kosovën	61
I.5. Intensifikimi i krimeve në Kosovë dhe “ <i>shkëputja e suksesshme përmirësuese</i> ”	65
KAPITULLI II	69
NJOHJA E SHTETIT – SFONDI TEORIK	69
II.1. Rendi ndërkombëtar dhe njohja e shtetit	75
II.2. Sovraniteti dhe njohja e shtetit	79
II.3. Konferenca e Montevideos – Kriteret e shtetësisë	83
II.4. Teoria konstitutive e njohjes së shtetit.....	86

II.5. Teoria deklarative e njohjes së shtetit.....	90
KAPITULLI III	92
PERIUDHA PARA PAVARËSISË DHE NDIKIMI I SAJ NË PROCESIN E NJOHJES.....	92
III.1. Krijimi i shtetit të Kosovës dhe sfidat e para të sigurimit të njohjeve.....	116
III.2. Njohja e shtetit të Kosovës si gjeopolitikë	123
III.3. Faktorët gjeostrukturore dhe ndikimi në njohjen e shtetit.....	133
III.4. Gjeostruktura dhe procesi i njohjes	138
KAPITULLI IV	143
PROCESI I NJOHJEVE, POLITIKA E JASHTME DHE DIPLOMACIA	143
IV.1. Sfidat e para të Kosovës për sigurimin e njohjeve	148
IV.2. Njohjet për Kosovën nga momenti i deklarimit deri në vendimin e GJND-së.....	154
IV.3. Pengesat strukturore dhe jostrukturore në procesin e njohjeve.....	160
IV.4. Sfidat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare	169
PËRFUNDIMET.....	172
BURIMET DHE LITERATURA.....	178

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Agjenda e Gabriel Almond për shndërrimin e një episodi historik në një episod analitik, adaptuar nga Charles Tilly	40
Figura 2. Zhvillimet politike në Jugosllavi sipas perspektivës kosovare	53
Figura 3. Shpërndarja etnike në Ballkanin Perëndimor, 2008. Qendra Hartografike e CIA-s/ Biblioteka e Kongresit	63
Figura 4. Përleshjet mes grupe protestuesish, shqiptarë e serbë. 18 mars 2004 / CBS NEWS	97
Figura 5. Momenti i Deklarimit të Pavarësisë së Kosovës	113
Figura 6. Territoret “problemore” të dhe rreth Rusisë - John O’Loughlin, 2007 University of Colorado.....	127
Figura 7. Shtetësia në teori dhe praktikë.....	132
Figura 8. Shpërndarja e kompetencave nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës te organet e brendshme të politikës së jashtme.....	148
Figura 9. Procesi i njohjeve dhe ngjarjet përcaktuese.....	152
Figura 10. Shtetet e Ballkanit dhe Hungaria	157
Figura 11. Vizualizimi i procesit dhe i dinamikës së njohjeve të shtetit të Kosovës në raport me vendimin e GJND-së	161

LISTA E DIAGRAMEVE

Diagrami 1. Gjeografia e njohjes.....	129
Diagrami 2. Njohjet e pavarësisë së Kosovës në muajin e parë të shtetësisë.....	150
Diagrami 3. Trendi i njohjeve të pavarësisë.....	151
Diagrami 4. Njohjet e pavarësisë së Kosovës në vitin e parë të shtetësisë.....	155
Diagrami 5. Numri i shteteve që e njohin shtetin e Kosovës në vitin 2008 dhe 2009-2021 .	159
Diagrami 6. Pozicionimi i shteteve lidhur me vendimin e OKB-së për dërgimin e rastit të Kosovës në GJND.....	162
Diagrami 7. Njohjet e para dhe njohjet në 13 vitet vijuese.....	163
Diagrami 8. Pasqyra totale e njohjeve të pavarësisë 2008-2021	165
Diagrami 9. Njohjet e pavarësisë në pesë vitet e para të shtetësisë.....	166

LISTA E SHKURTESAVE

AAK	-	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
DN	-	E Drejta Ndërkombëtare
KS	-	Këshilli i Sigurimit
LDK	-	Lidhja Demokratike e Kosovës
MN	-	Marrëdhëniet Ndërkombëtare
OKB	-	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ON	-	Organizatat Ndërkombëtare
PDK	-	Partia Demokratike e Kosovës
SN	-	Sistemi Ndërkombëtar
UÇK	-	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNMIK	-	United Nations Mission in Kosovo (Kombet e Bashkuara Misioni në Kosovë)
VV	-	Vetëvendosje!
KiV	-	Këshilli i Evropës

PARATHËNIA

Krijimi i shtetit të Kosovës paraqet një përpjekje të gjatë dhe të strukturuar që brenda saj ka përfshirë një numër rrethanash dhe aktorësh lokalë e ndërkombëtarë, duke qenë temë e trajtimit në institucionet më të rëndësishme globale, temë e vendimmarrjes për secilin lider politik të shteteve të fuqishme, të cilët u gjetën të shtrënguar nga situatat që prodhonin kriza me ndikim në raportet mes shteteve dhe rendit ndërkombëtar përgjithësisht.

Para 30 vitesh, Kosova në perspektivën e atyre që vendosnin në arenën ndërkombëtare, ishte një problem i vogël në Jugosllavi, e cila në rastin më të mirë duhej të trajtohej si rast i brendshëm i saj. Shpërthimi i konfliktit atëbotë, ndonëse si diçka i pritshëm, gjeti shtetet e fuqishme botërore para sfidave të reja se si të dilnin nga situata e krijuar, pasojat e të cilës mund të ishin të pallogaritshme në rast të mos gjetjes së zgjidhjes së duhur politike.

Jugosllavia kishte qëndruar për vite me radhë e plasaritur nga qarjet që ishin produkt i rrethanave paraprake historike, që kishin krijuar dallimet strukturore, etnike, politike e kulturore. E dominuar qartësisht nga serbët, por *e mbuluar* me mjeshtri me politikat gjithëpërfshirëse që qëndronin të palëkundura shkaku i faktorëve të jashtëm, u gjet para rrënimit ditën kur në Fushë-Kosovë, lideri i ri serb, Slobodan Millosheviq, po bënte hapat kryesorë drejt marrjes së pushtetit federal.

Ai arriti pa shumë mund t'i bindte elitën politike serbe se duhen ndryshime politike për të rikthyer atë që serbët e kishin humbur dikur, dominimin. Kjo ishte përligje e një plani të tmerrshëm politik që synimin real e kishte zgjerimin territorial të Serbisë, që do të vinte si rrjedhojë e ndryshimeve të mëdha të jashtme, por edhe të brendshme, këto të fundit do të ishin të kontrollueshme, prandaj fillimi i tyre nisi me ndryshime kushtetuese.

Ndryshimet kushtetuese do të “riparonin lëshimet politike” që kishin ndodhur paraprakisht, por këto veprime do të prodhonin dy efekte, *e para* se do të vendoste nën kontroll gjithë Jugosllavinë, e në veçanti Kosovën e Vojvodinën, duke i rrënuar çdo element konstituiv që kishin fituar në vitin e largët 1974 dhe e dyta, sigurisht shumë e pritshme, ngritja e revoltës nga sllovenët, kroatët, shqiptarët e boshnjakët, për shtetet e tyre, më e pritshmja ishte Kosova.

E gjetur para një shtate të jashtëzakonshme politike, kur serbizimi i saj kishte marrë hov, Kosova u orvat për të reaguar politikisht, fillimisht me ndryshime kushtetuese që

reflektonin ripozicionimin politik të Kosovës e deri te krijimi i shtetit të Kosovës, të deklaruar me referendum, shtet i cili nuk u njoh nga askush, pos Shqipërisë e cila gjendej edhe vetë në situatë ekzistencialiste, pasi sapo kishte dalë nga diktatura.

Pa përkrahje, e izoluar dhe e vetme, Kosova kishte mundësi të zgjidhte dy rrugë, luftën ose nënshtrimin. Elita politike e kohës, kishte gjetur rrugën e mesme, jo tipike për kontekstin ballkanik, rrugën e sistemit paralel të funksionimit, që mund të thuhet se kishte shumë efekte pozitive për kohën, duke krijuar mendësinë e reagimit kolektiv, punës vullnetare e përgatitjes për hapat e ardhshëm, që thënë të drejtën me zgjatjen e kësaj faze u bënë përherë e më të pakët.

Në Kosovë, *meqë nuk ka luftë, nuk ka krime*, kjo ishte pikëpamja e të huajve që humbën rastin të ndalnin atë që kishte ndodhur para syve të tyre, pak kohë më parë gjatë luftës në Bosnje e Hercegovinë dhe Kroaci. Krimet nuk ishin të munguara, por ato u intensifikuan deri sa më 28 nëntor 1997, shtyri daljen publike të UÇK-së, si formacion ushtarak që qëllim kishte çlirimin e Kosovës.

Krimet serbe të intensifikuara kishin paraqitur në mënyrë të vazhdueshme shqetësime për bashkësinë ndërkombëtare e cila kishte nisur të shihte se duhej reagim i strukturuar i saj, si në Rambuje e Paris (1999), për t'i dhënë fund asaj që po ndodhte në Kosovë. Serbia që atëherë e deri 25 vite pas, ka mbajtur qëndrimin e njëjtë, nuk ka rënë dakord asnjëherë me Kosovën sa i takon çështjeve politike.

Vitet pasuese u dinamizuan në përpjekje e proces, Kosova ishte vendosur nën administrimin ndërkombëtar, pasi paraprakisht ishte nënshkruar Marrëveshja e Kumanovës, që e detyronte Serbinë të largohej nga Kosova, ndërsa përmes UNMIK-ut dhe KFOR-it, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, po jetësonte Rezolutën 1244.

Pa strategji dalëse, kjo rezolutë nuk parashihte se si të zgjidhej statusi politik i Kosovës, sido që të jetë, parashihte krijimin e institucioneve të Kosovës, të cilat më pas dolën të jenë vendimtare për plotësimin e standardeve, për miratimin e ligjeve që dilnin nga procesi politik i negociatave, por edhe për të përmirësuar sado pak pasojat e lëna nga “Trazirat e Marsit” 2004, të cilat determinuan procesin politik vijues.

Krijimi i shtetit të Kosovës mbledh jo vetëm këto ngjarje, bashkon e ballafaqon secilën fuqi botërore, të cilat ishin përfshirë në procesin politik të krijimit të saj, por edhe të njohjes. Shteti i ri i deklaruar kishte nevojë për përkrahësit e vjetër, tash për të siguruar njohje, që

dëshmon se i gjithë procesi pa dallim kohe, ishte një fërkim i madh forcash gjeopolitike e strukture në botë.

Pos kësaj, Kosova duke e pasur të vështirë rrugën e njohjes ka provuar që përmes diplomacisë multilaterale të pozicionohet favorizueshëm në arenën ndërkombëtare, sfida ka mbetur anëtarësimi në organizata, pasi shumë nga to kërkojnë që anëtarët e rinj si Kosova të jenë pjesë e OKB-së, e kjo del të jetë sfida kryesore e vendit. Mundësi e pengesë në të njëjtën kohë janë Bisedimet e Brukselit, për të cilën flitet më gjerësisht në pjesën tematike të punimit.

Ky punim ka këtë synim, të shohë argumentin(et) politik(e) të Kosovës në procesin e saj të njohjes, të elaborojë, krahasojë e vlerësojë faktorët, rrethanat, aktorët, sfidat e mundësitë që ka pasur entiteti politik i deklaruar shtet, në procesin e tij të konsolidimit. Ky punim zhvillohet në një trajektore paralele me procesin, prandaj pozitiv mbetet fakti se objekti i trajtimit është fare i qartë, i bashkëgjetur me gjithë procesin e analizimit të tij. Kjo paraqet edhe sfida në të njëjtën kohë, pasi shumë nga aktorët dhe proceset, sa kohë janë në fuqi e bëjnë të vështirë realizimin e hulumtimit.

Prishtinë, 2022

HYRJA

1. Lënda e hulumtimit

Teza me titull *“Problematika e njohjeve të Pavarësisë së Kosovës dhe sfidat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare: 2008 - 2021”*, paraqet një përpjeke të strukturuar për të ofruar një pasqyrë të angazhimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, duke u specifikuar në politikën e saj të jashtme, me ç’rast sillet në mënyrë të detajuar *procesin e njohjes së pavarësisë, sfidat që ka hasur Kosova gjatë këtij procesi, zhvillimin e saj, por edhe ngecjet dhe karakteristikat dalluese*.

Punimi i tillë që realizohet në njëfarë paraleli kohor me procesin, tregon se shtetet e porsakrijuara, sikur Kosova, njërën nga proceset më të rëndësishme të konsolidimit të tyre ndërkombëtar, i kanë njohjet dhe anëtarësimin në mekanizmat ndërkombëtarë, përmes të cilave synojnë forcimin e pozitës ndërkombëtare dhe të subjektivitetit politik.

Njohjet ndërkombëtare për një shtet janë me shumë rëndësi, sidomos në konsolidimin e tyre, por ky proces është mjaft kompleks, pasi janë *polemikat doktrinare* (Wheatley, 2014), ato që vështirësojnë të dihet se kur një shtet i ri është shfaqur në arenën ndërkombëtare, sa kohë që, edhe për vetë këtë koncept ka qëndrime të ndryshme, të cilat për studiuesit janë sfida të vazhdueshme që vijnë sidomos si produkt i zbrazëtimeve teorike në trajtimin e tij.

Sido që të jetë, shtetet ekzistojnë edhe kur teoritë politike nuk arrijnë t’i shpjegojnë si duhet rastet e njohjeve të shtetit, ndërsa studimet e fundit konstatojnë se njohja nuk ka përmbajtje normative në vetvete, ose shihen si mjete ligjore për zgjedhjet politike (Worster, 2009: 116).

Shtetet e porsakrijuara, sikur Kosova, synojnë të kompletojnë shpejt njohjen, për konsolidim politik të jashtëm, sepse krijimi i shtetit, padyshim se është procesi që ka hasur përherë në *rezistencë të konsiderueshme*, duke qenë se krijimi i tij prek territoret, por edhe mund të ketë ndikim në sistemin ndërkombëtar (Visoka et al., 2020: 1).

Kur flitet për krijimin dhe njohjen e shtetit, lidhur me to janë krijuar shumë debate, sidomos për shkak të shumësisë së *llojeve të krijimit të shteteve* (Finck, 2016: 52), por edhe për shkak të nevojës për të siguruar njohjen, që mbetet njëri nga objektivat kryesore të tyre.

Edhe te rasti i Kosovës, për të cilën flitet në këtë temë, njohja e pavarësisë është parë dhe vazhdon të mbetet, njëri nga prioritetet kryesore që ka pasur politika e jashtme e Kosovës

(MPJ, 2021), pasi përmes saj ka synuar të dëshmojë se Kosova si shtet është një fakt i pamohueshëm (Ahmeti, 2022), ndërkaq, njohja nga të gjitha shtetet fqinje, njohja nga të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë, përjashtuar Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën (për shkak të natyrës së vendimmarrjes në shtetin federal), njohja nga shumica e vendeve të BE-së dhe shumica e vendeve perëndimore, veçse e ka përforcuar këtë synim.

Duke qenë se arritja e njohjes dhe anëtarësimi në organizata, shihet si mundësi e forcimit të subjektivitetit, Kosova është fokusuar në sigurimin e tyre, por shpesh ka mbetur në nivele të projekteve sporadike, dhe pa ndonjë agjendë të mirëstrukturuar. Kosova, ka deklaruar vazhdimisht se është një fakt i pamohueshëm, por në anën tjetër ka synuar që ta përmbyllë njohjen, duke u sfiduar në disa nivele, kryesisht nga Serbia e cila, në mbështetje nga Rusia e disa vende të tjera, kanë penguar Kosovën në sigurimin e njohjeve dhe anëtarësimin në organizata.

Bota duket e ndarë sa i takon njohjes së Kosovës, ajo ka siguruar pranimin nga shtetet që janë marrë me procesin e saj të krijimit si shtet dhe të cilat e kanë njohur problematikën dhe e dinë kontestin (Hoxhaj, 2021), por ka edhe të tjera, që për arsye politike, gjeopolitike e gjeostrukturore, nuk e njohin atë.

Ky klasifikim i njohjeve si peshë politike dhe klasifikimi i shteteve njohëse/mosnjohëse, tregon se njohja varet nga shumë faktorë, si ata gjeopolitikë, rendi ndërkombëtar dhe ndikimi i fuqive të mëdha në një sistem shumëpolar vendimmarrës (Newman & Visoka, 2021), prandaj fokusimi duhet të bëhet në *ndikimet e pavarësisë në arenën ndërkombëtare*, por edhe te *roli dhe ndikimi i forcave gjeopolitike* të përfshira në atë proces, para se të flitet për llojin e shpalljes së pavarësisë (Blaufarb, 2007: 742).

Rëndësia e njohjes për një shtet është shumë e madhe, kurse nëse fokusi bie në elaborimin e fjalës *njohje* në kuptimin filozofik, Hegeli paraqet një qëndrim të qartë për këtë koncept, për të, *gjeja* ekziston vetëm duke u *njohur*.¹ Ndërkaq teoricieni Charles Taylor, në veprën e tij, *Politika e njohjes*, konsideron se njohja, siç thotë ai, është një *'nevojë jetike njerëzore'* dhe varet nga qëndrimet e të tjerëve (1994: 26). Ky qëndrim është i afërt me *Teorinë Konstituive*, pasi si e tillë, kjo teori ka proklamuar njohjen si të domosdoshme, madje edhe përcaktuese për shtetin që sapo është deklaruar, ndërsa edhe studiuesit kur flasin për

¹ Hirvonen, O., & Laitinen, A. (2016). Recognition and democracy – An introduction. Thesis Eleven, 134 (1), 3–12. <https://doi.org/10.1177/0725513616646022>

njohjen dhe rëndësinë e saj, e kanë cilësuar atë me një rol të theksuar konstitutiv (Baldwin, 2009: 311), përmes të cilës shtetet ekzistuese konstatojnë ekzistencën e shtetit të ri.

Shkollarët janë në mes të dilemave se si të shpjegohet problematika e njohjes së Kosovës, pasi procesi politik nëpër të cilën ajo ka kaluar, e ka vështirësuar qasjen doktrinare në procesin e njohjes, pasi mënyra e shpalljes së pavarësisë, ka përcaktuar edhe formën dhe procesin e njohjes, por çka vërehet, mbetet fakti se si njohja ashtu edhe mosnjohja si koncepte dhe norma, (jo vetëm te rasti i Kosovës), mbesin akoma të paqarta (Gustafsson, 2016).

Sido që të jetë, mos polemikave dhe dallimeve si teorike e politike, procesi i njohjeve të pavarësisë së Kosovës, ka kaluar në disa faza, ndërsa vërehet se në fazën fillestare, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ka pasur njohjet më të shumta dhe nga shtetet më me ndikim, ndërsa prioriteti i saj kryesor, ishte sigurimi i 100 njohjeve.

Shtetet që e njohën Kosovën, fillimisht, ishin shtetet që e kishin mbështetur atë edhe në procesin e krijimit të saj si shtet (Hoxhaj, 2021), ose nëse e shohim nga perspektiva pozitiviste, argumentimet kryesore për shtetet që e njohën Kosovën, ishin se ajo kishte përjetuar shkelje të të drejtave të njeriut nga aparatura e Millosheviqit, ishte nën administrimin ndërkombëtar për një kohë, gjatë të cilës kishte treguar angazhim të shtuar dhe kishte marrë obligime ndërkombëtare për pozitën e pakicave, ndërsa ishte shprehur e gatshme të pranonte Pakon e Ahtisaarit, që në fakt paraqet pranimin e pavarësisë së mbikëqyrur (Bolton & Visoka, 2010).

Në anën tjetër, procesi i njohjeve të pavarësisë së Kosovës kishte shënuar një rënie graduale, gjatë zhvillimit të tij, shtetet që ende nuk e kishin njohur Kosovën, mbetën në mes të disa dilemave kryesore, Kosova si fakt i pakthyeshëm, miqësi e kamotshme me Jugosllavinë, interesa strategjike të ndryshëm me ata të Kosovës dhe aleatëve të saj, ose të varur nga proceset që rrjedhën pas shpallës së pavarësisë, ndërkaq argumentimet dalin të jenë nga më të ndryshmet, për të *“legjitimuar mosnjohjen”*, sidomos kontestimi i njohjes për shkak të sovranitetit dhe integritetit territorial të Serbisë dhe precedentit që mund të krijojë në rastet e ngjashme (Bolton & Visoka, 2010). Pra, njohja e pavarësisë së Kosovës, ishte arena e re e përplasjeve të vjetra mes fuqive të mëdha, të cilat shfrytëzuan ndikimin e tyre për lobim te shtetet e treta.

Shtetet që nuk e njohën Kosovën, e shfrytëzuan këtë moment për të nisur përkrahjen e lëvizjeve separatiste në disa vende, ndërsa në anën tjetër, arsyetimi i mosnjohjes ishte

pikërisht mbi faktin e krijimit të precedentit, ndërsa përmes tyre kontrollon (de)stabilitetin e atyre vendeve (Riegl, 2018: 58), sikur që kishte bërë Rusia² ndaj disa rajoneve afër saj, të cilat do t'i shtynte drejt njohjes, duke e përdorur shpalljen e pavarësisë së Kosovës si përligje të veprimeve të saj.³

Krijimi i shtetit të Kosovës ka vendosur para sfidave të mëdha, jo vetëm liderët politikë, shtetet, ose organizatat, por edhe teoricienët dhe shkollarët e së drejtës e të marrëdhënieve ndërkombëtare, prandaj është shumë i vyeshëm kontesti historik i analizimit të krijimit të shtetit të ri ballkanik.

Kontesti historik i shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, sigurisht se ka shumë dimensione për vërtetim, nisur nga procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, vijon me procesin ndërkombëtar për Kosovën që kulmon me Konferencën e Rambujesë e thirrur pas Masakrës së Reçakut, dështimi për të prodhuar një marrëveshje e deri te fillimi i bombardimeve të NATO-s, që çoi në fundin e luftës, miratimit të Rezolutës 1244, këtu fillon ajo që studiuesit Christian Pippan e Wolfram Karl (2012) e konsiderojnë si ndërkombëtarizimi i zgjidhjes së statusit ndërkombëtar të Kosovës, vijon me Administrimin Ndërkombëtar, procesin e (para)statusit, Bisedimet e Vjenës për Statusin, Pakon e Ahtisaarit, shpalljen e pavarësisë, kontestimin ndërkombëtar në GjND, vendimin e saj kapital për Kosovën, hapjen e Bisedimeve të Brukselit dhe vijimin e procesit. Ndërsa si alternativa të zgjidhjes së problemit, për atë kohë sa ndodhte ai, sidomos në periudhën e para dhe gjatë luftës studiuesit e konsideronin autonominë, ndarjen ose pavarësinë si zgjidhjet e mundshme për Kosovën, ndërsa për arritjen e tyre, varej nga angazhimi proporcional, qoftë negociatat, imponimin ndërkombëtar e deri te lufta e shkallës së gjerë (Malcolm, 1998).

Ky proces i gjatë e historik ka krijuar atë që studiuesit e cilësojnë si *grup unik faktesh të raporteve mes dy vendeve* e që e bëjnë të dallueshme Kosovën me rastet e tjera separatiste, ose së paku ky është pretendimi i shteteve që e mbështesin shtetin e ri në arenën ndërkombëtare (Reynolds, 2008: Fierstein, 2009).

² Studiuesja Julianne Smith, duke u thirrur në shkrimin e gazetares Megan Slack, me titull "*Kosovo a frustration for Russia*," të publikuar në gazetën LA Times, pak pas pavarësimit të Kosovës, tregonte se Rusia do të përdorë politikisht njohjen e Kosovës nga vendet perëndimore, si një nxitje për veprimet e saj ndaj rajoneve të diskutueshme ish-sovjetike.

³ "Për muaj të tërë para pavarësisë së Kosovës, Rusia tashmë po parashikonte se çfarë do të bënte për sigurinë ndërkombëtare efektet e një shpalljeje të njëanshme të pavarësisë - madje duke shkuar atëherë larg sa të kërcënonte me hakmarrje duke njohur pavarësinë e rajoneve separatiste të Gjeorgjisë, nëse pavarësia e Kosovës do të ishte njohur vërtet" (Smith, 2008: 759-773).

Kësisoj, problematikën e Kosovës, nëse shihet në gjenezë, vërehet se është e vështirë të piketohet si një rast që fillon me një ngjarje ekskluzivisht, por gjithsesi, krijimi i shtetit të Kosovës lidhet kryekëput me procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, proces që konsiderohet si fundi i shpërbërjes së saj (Warbrick, 2008: 675).

Kur trajtohet problematika e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të, listohen disa ngjarje kryesore që ndodhën brenda kontekstit politik që prodhoi shtetin e Kosovës, fillimisht me pozitën e saj në kuadër të Jugosllavisë, me ndryshimet politike e kushtetuese që vijuan pas ardhjes në pushtet të Slobodan Millosheviqit, me shpalljen dhe njohjen e shteteve të tjera që dolën nga Jugosllavia (Borgen, 2008: 1).

Kështu Kosova po e përmbyll një proces politik që ka filluar gati 20 vite para se ajo të deklaronte pavarësinë, por megjithatë, parë nga perspektiva historike, shpallja e pavarësisë së Kosovës, erdhi si rrjedhojë e dështimit për të arritur një marrëveshje të pranuar për palët (Kosovë - Serbi), të përfshira paraprakisht në procesin e Bisedimeve të Vjenës, të njohura si Bisedimet e Statusit, nëse flitet për procesin politik që do të prodhonte status politik.

Pavarësisht se Kosova, mori obligime ndërkombëtare për një shkallë të lartë të vetëqeverisjes për serbët lokalë, përmes Pakos së Ahtisaarit, Serbia refuzoi ta pranonte këtë dokument, përmes të cilit Kosova do të pavarësohej, si epilog i bisedimeve, pavarësi e cila do të mbikëqyrej për një kohë. Në anën tjetër, pritshmëria për një marrëveshje potenciale mes palëve të përfshira në Bisedimet e Vjenës, pothuajse nuk ekzistonte, ato që nga fillimi mbanin qëndrime tërësisht të ndryshme, Beogradi, qëndronte në pikën se sistemi klasik ndërkombëtar për ruajtjen e tërësisë territoriale, nuk guxonte të prekej, pasi mund të kishte ndikime në rajonet e ngjashme (Weller, 2008: 659).

Serbia, gjithmonë duke u mbështetur nga Rusia, nuk i ka parë negociatat si mundësi e gjetjes së një zgjidhjeje, por për të penguar realisht mundësinë e krijimit të shtetit të Kosovës, duke e zgjatur procesin dhe duke i krijuar mundësi Rusisë për imponime brenda zonave gjeostrategjike të NATO-s dhe SHBA-së, shumë vite pas humbjes së ndikimit real që kishte.

Pengesa e parë për njohjen e pavarësisë së Kosovës ishte pamundësia për ta kaluar Pakon e Ahtisaarit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, pavarësisht se u mendua kjo organizatë së paku do ta miratonte propozimin e Ahtisaarit, edhe nëse përfundimisht nuk do të ishte i gatshëm të prononcohej në favor të pavarësisë, thotë studiuesi Weller, por në këtë formë njohja e pavarësisë së Kosovës, do ta merrte një *jo*, ende pa filluar procesi, ose në të

kundërtën, miratimi do të thoshte pranim i asaj që propozonte Ahtisaari, që për Serbinë dhe partnerët e saj nuk ishte e pranueshme.

Reagimet e shteteve në lidhje me procesin e njohjeve të pavarësisë së Kosovës, sigurisht se do të kishin efekte të ndryshme në proces, kjo do të shërbejë edhe si një tregues se njohja ose mosnjohja në esencë janë politike, sa kohë që të njëjtat duke qenë se varen nga deklarimi i shtetit, ato do të mund të përdoren e justifikohen politikisht. Studiuesit⁴ i kanë kushtuar vëmendje këtij problemi, duke vënë në pah konceptin *politika e njohjes* dhe për ta i gjithë procesi prodhon kontradikta në lidhje me rrjedhën e procesit të sigurimit të njohjeve nga entiteti politik i deklaruar shtet. Për të sjellja e shteteve dhe e organizatave (si vullnet e ballafaqim i shteteve) prodhojnë politikën e njohjes (Almqvist, 2009: 1).

Në këtë mënyrë Kosova nuk arriti të shpallet e të njihet shtet nga OKB-ja si tërësi, ashtu siç kishte ndodhur me Izraelin, 60 vite përpara. Kjo shpallje e pavarësisë u pa edhe beteja në mes atyre që e shohin si të pranueshme shpalljen e pavarësisë, kundrejt atyre që e konsiderojnë rastin e tillë si shkelësin e sovranitetit (Newman & Visoka, 2018: 267). Pra njohja, dëshmohej se është shprehje e vullnetit politik për të pranuar ose jo faktin e ri, pra njohja shfaqet si akt *kryekëput politik*.

Kosova ishte de facto e ndarë nga Serbia përmes një 'ndërrhyrjeje humanitare' të NATO-s në vitin 1999, shpalljen e pavarësisë të së cilës, disa studiues e shohin edhe si '*shkëputje të suksesshme përmirësuese*',⁵ duke i dhënë fund një procesi të gjatë të shtypjes sistematike, prandaj shkëputja shihet si zgjidhja e fundit që i jep fund kësaj situate (Vidmar, 2010: 37–56).

Shkëputja përmirësuese (korrigjuese) si e tillë nuk mund të aplikohet në rastet e krijuara në shkelje të rëndë të normave të së drejtës ndërkombëtare, vënë në dukje studiueset Lina Laurinavičiūtė dhe Laurynas Biekša (2015: 67), të cilat duke u thirrur në burimet e studiuesit Jure Vidmar (2010: 38), tregojnë se kahja e zhvillimit progresiv të së drejtës ndërkombëtare, favorizon një shkëputje që vjen vetëm *si pasojë e dhunës sistematike kundrejt një grupi të caktuar etnik*.

⁴ "Dështimi i Këshillit të Sigurimit është rezultati i asaj që mund të përkufizohet si 'politika e njohjes', dmth një shumëllojshmëri reagimesh të ndryshme dhe kontradiktore të shteteve të treta në përgjigje të Deklaratës së Kosovës, të cilat riprodhojnë qëndrimet kryesore në mosmarrëveshjen fillestare dhe jo zgjidhjen e saj" (Almqvist, 2009: 1).

⁵ Anton Bebler, Daniel H. Meester, etj., shpalljen e pavarësisë të së cilës, disa studiues e shohin edhe si '*shkëputje të suksesshme përmirësuese*'.

Edhe studiuesi tjetër, kur trajton ndarjen ose shkëputjen përmirësuese, nisët nga fakti se qytetarët e atij vendi janë gjetur para situatave ku nuk kanë pasur zgjidhje tjetër, prandaj shpallja e pavarësisë shihet si e vetmja zgjidhje politike për atë popull, që sistematikisht i është mohuar e drejta e saj për vetëvendosje të brendshme, dhe i cili sistematikisht ka qenë i shtypur nga regjimi represiv (Meester, 2011).

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës i ka të specifikuara disa elemente me rëndësi që duhet të trajtohen këtu, si *“Duke rikujtuar vitet e konfliktit dhe dhunës në Kosovë që shqetësuan ndërgjegjen e të gjithë popujve të civilizuar”* dhe *“Duke rikujtuar vitet e negociatave të sponsorizuara ndërkombëtarisht ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mbi çështjen e statusit tonë të ardhshëm politik”* (Deklarata e Pavarësisë, Kuvendi i Kosovës, 2008), paraqesin dy nga pikat më me rëndësi për trajtimin e konceptit shkëputje e suksesshme përmirësuese, pasi plotëson dy nga kriteret themelore që sfidojnë (keq)përdorimin e parimit të sovranitetit, duke qenë caku i dhunimit sistematik mbi baza etnike (Malcolm, 1998), por duke provuar që pa trysni nga jashtë të prodhojnë zgjidhje përmes negociatave.

Sido që të jetë me paraqitjen e Deklaratës së Pavarësisë dhe shprehjen e gatishmërisë për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera, Kosova formalisht plotësoi kriterin e katërt të Konferencës së Montevideos,⁶ që flet për kushtet që një shtet duhet t’i ketë për t’u njohur si i tillë në arenën ndërkombëtare.

Edhe Tim Judah, në librin e tij me titull, *“Kosova: Çfarë duhet të dinë të gjithë”*, tregon se vendi gjendej në mesin e dy grupeve të madha shtetesh me ndikim, njërin anë perëndimi me SHBA-në dhe shtetet e Evropës dhe në anën tjetër Rusia, duke qenë njëra nga temat e mëdha të mosmarrëveshjeve mes të liderëve të tyre, ndërsa thekson faktin se nëse Kosova do të ishte në ndonjë vend tjetër si në Kaukaz, ose Azi e Afrikë, nuk do të ishte as temë e as çështje (Judah, 2008: XIII).

Pra ndarja është e qartë Shtetet e Bashkuara dhe shumica e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) e njohin Kosovën. Serbia, Rusia, Kina dhe vende të tjera të ndryshme (duke përfshirë pesë vende anëtare të BE-së) nuk e bëjnë këtë, thuhet në studimin e

⁶ Më 26 dhjetor 1933, në Montevideo të Uruguait, u mbajt Konventa, e njohur gjerësisht si Konventa e Montevideos, përmes së cilës përcaktoheshin të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve (ndër-amerikane), ku në nenin e parë të saj paraqiten kriteret themelore që shteti duhet t’i plotësojë, ose siç thuhet shteti si person i së drejtës ndërkombëtare duhet të zotërojë këto kualifikime: a) një popullsi të përhershme; b) një territor të përcaktuar; c) qeveria; dhe d) aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera.

përgatitur për Kongresin Amerikan nga analistja e çështjeve evropiane, Sarah E. Garding (2021: 1).

Kosova duhej që të siguronte njohjet sa më parë që të mundej, ndërsa duke e ditur se ky proces do të ishte i vështirë e i ngadalshëm, por edhe me disa probleme të brendshme politike, nuk kishte arritur të krijonte një strategji të duhur dhe të efektshme. Jugosllavia e dikurshme kishte ngritur lidhje të mira diplomatike me shumë vende, lidhje këto që u trashëguan suksesshëm nga Serbia, duke i mirëmbajtur ato me tregti e bashkëpunim ekonomik.

Kosova mbështetjen kryesore e kishte te SHBA-ja, e cila për shumë kë vlerësohet edhe vendi kryesor i përfshirë në gjithë procesin, thotë ndër të tjerash studiuesi Garding:

“Shtetet e Bashkuara gëzojnë popullaritet të gjerë në Kosovë për shkak të mbështetjes së tyre gjatë epokës së Millosheviqit, udhëheqja e ndërhyrjes së NATO-s në vitin 1999 në luftën e Kosovës, duke mbështetur pavarësinë e Kosovës në vitin 2008, dhe mbështetje diplomatike pasuese për Kosovën”
(Garding, 2021: 13).

Ky veprim paraqet njërin nga hapat e parë që kishte ndërmarrë Serbia në lidhje me pengimin e njohjes së pavarësisë së Kosovës. Por si i tillë do të përcillej edhe me veprime të tjera strategjike për ta penguar njohjen. Kjo nuk u tregua e suksesshme, prandaj Serbia synimin e ri e pati *delegjitimimin* e pavarësisë së Kosovës përmes ngritjes së rastit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, nga ku do t’i arrinte disa suksese të shpejta, e para e zvogëlon ritmin e njohjeve deri në atë pikë ku edhe mund të ndalet tërësisht dhe e dyta e rikontestonte statusin politik të Kosovës.

Serbia kishte vendosur që t’i drejtohej GjND-së, me pyetjen *“A është shpallja e njëanshme e pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, por paraprakisht kishte paraqitur rastin në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, e cila kishte miratuar Rezolutën 63/3 (Kombet e Bashkuara, 2008: Rezoluta 63/3), duke u nisur nga fakti se shtetet anëtare të OKB-së kishin qëndrime të ndryshme në lidhje me aktin e shpalljes së pavarësisë (Kombet e Bashkuara, 2008: Rezoluta 63/3), ndërsa pritej që konform Nenit 96 të Kartës së OKB-së (Kombet e Bashkuara, Karta e OKB-së, Neni 96), ku thuhet që Asambleja e Përgjithshme ose Këshilli i*

Sigurimit mund t'i kërkojnë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të japë një opinion këshillues për çdo çështje ligjore. Neni 65 i Statutit të Gjykatës, në lidhje me autorizimin që ka gjykata për të trajtuar çështjet që ngritën, pika 1, thotë: “Gjykata mund të japë një opinion këshillues për çdo çështje ligjore me kërkesë të cilitdo organ që mund të autorizohet nga ose në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara për të bërë një kërkesë të tillë” (GJND, Neni 65).

Fillimisht gjykata e trajtoi çështjen nëse si e tillë bie në juridiksionin e saj, ndërsa me 22 korrik 2010 nxjerr opinionin se Kosova nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Gjykata paraqiti disa gjetje të detajuara që u bënë bazë e mirë për proceset vijuese. Miratimi i kërkesës së saj, e futi Kosovën praktikisht në një kontest ndërkombëtar, që ndikoi në njohjen e pavarësisë, duke e përzgatur procesin.

Më vonë, mendimi i gjykatës ndonëse ishte kapital për Kosovën, duke e cilësuar shpalljen e pavarësisë së saj, si të pranueshëm për të drejtën ndërkombëtare, nuk u përdor mjaftueshëm nga Kosova, pasi menjëherë filloi një proces i ri, që lidhet pashkëputshëm me mendimin e GJND-së, ai i Bisedimeve të Brukselit, të cilat krijuan njëfarë dykuptimësie nga palët.

Studiuesja polake, Marzena Żakowska, duke e trajtuar reflektimin e Serbisë, ndaj vendimit të GJND-së për Kosovën shkruan se autoritetet serbe në Kuvendin e Republikës së Serbisë kishin miratuar një rezolutë, që e paraqiste qëndrimin se ky shtet kurrë nuk do ta njohë Kosovë, ndërsa, vijon të tregojë se si Serbia kishte kryer këto veprime vetëm sa për ta penguar shtetin e Kosovës të njihej e të konsolidohej.

“Autoritetet serbe, duke vazhduar protestën kundër shpalljes së sovranitetit nga Kosova, bënë një sërë përpjekjesh diplomatike që synonin kufizimin e numrit të vendeve që njohin pavarësinë e Kosovës dhe bllokimin e zbatimit të politikave të brendshme shtetërore nga ana e Kosovës” (Żakowska, 2016: 6).

Vendimi i GJND-së, nuk e mbylli procesin, por ai ishte një moment i ri në raportet Kosovë-Serbi, raporte të cilat do të varen nga një proces tjetër delikat që po hynin vendet, atë të normalizimit të raporteve të tyre, bisedime të cilat u përdorën për të paraqitur arritjet e tyre (Gashi, 2017: 545), njohje nga Kosova, ose hapje të statusit nga Serbia.

Fillimi i bisedimeve për çështjet që kanë mbetur të hapura mes Kosovës dhe Serbisë, proces që filloi më 2011, e që vazhdon edhe sot, e la Kosovën në tregimin e njëjtë, me numër njohjeve të ngadalësuar, më anëtarësime në organizata ndërkombëtare më pak se paraprakisht, ndërsa imazhi i Kosovës u dëmtua ndjeshëm, sidomos nga pretendimet e eurodeputetit Dick Marti, i cili kishte hartuar një raport, sipas të cilit pretendohet se në Kosovë, UÇK-ja ka kryer krime kundër njerëzimit, deri në trafikim të organeve, ndërsa për të vërtetuar pretendimet e tilla, Kosova përmes Kuvendit u detyrua të krijonte dhoma të specializuara të Gjykatës Speciale, ndërsa në vitin 2020, filloi arrestimi i të dyshuarve, që ishin krerët më të lartë të shtetit të Kosovës, presidenti i vendit, dy kryetarë të Kuvendit, deputetë, zyrtarë të tjerë të institucioneve dhe mekanizmave institucionalë.

Sido që të jetë Bashkimi Evropian si lehtësues i këtyre bisedimeve, ka vazhduar në mënyrë konsistente të mbështetë procesin (Tannam, 2013: 946–964), duke e paraqitur atë si një nga çështjet më me interes që ka BE-ja ndaj Ballkanit, sidomos pas vendimit të GJND-së për Kosovën, edhe pse asnjë nga shtetet që nuk e kishin njohur Kosovën deri në atë kohë, nuk e bënë atë veprim as pas tij.

Në pamundësi të arritjes së njohjeve nga shtetet, por edhe paralelisht me këtë proces, Kosova u anëtarësua në një numër të madh organizatash rajonale, kontinentale, por edhe globale, duke e forcuar ndjeshëm pozitën e saj politike ndërkombëtare, ndërsa synimi kryesor është anëtarësimi në OKB, rruga drejt së cilës është sa e paqartë, aq edhe e pamundur, marrë parasysh qëndrimin e njohur të Ruisë, e cila pozicionin politik në raport me Kosovën e lidh me raportet që do të krijohen në mes Kosovës dhe Serbisë në një fazë pas përfundimit të bisedimeve që vijnë.

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare ishte prioriteti tjetër i Kosovës, pasi ON dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë kanë ndikim të jashtëzakonshëm (Emini & Marleku, 2016: 172-181), sidomos në ushtrimin e diplomacisë multilaterale, forcimin e pozicionit politik ndërkombëtar, marrë parasysh faktin se në ON, marrin pjesë edhe shtetet që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

OKB-ja ka qenë e përfshirë në gjithë procesin politik të Kosovës, ka ushtruar administrimin e saj për një kohë, duke e menaxhuar paqen dhe sigurinë, ndërsa ka investuar në krijimin e institucioneve të Kosovës, përmes zgjedhjeve demokratike, ka menaxhuar procesin e krijimit të shtetit të Kosovës, prandaj studiuesi David I. Efverhan e cilëson si kundër produktive ndalimin e një entiteti të tillë politik që t'i bashkohet organizatës, ndërsa

mos anëtarësimin e shih si rrezikim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare (Efevwerhan, 2012: 93-130).

Profesorët Newman dhe Visoka, kur e shohin këtë angazhim të Kosovës për të siguruar njohjet, e në anën tjetër thonë se Kosova është shtet, dëshmojnë për zbrazëtirën teorike që ka ky proces, ndërsa e elaborojnë rëndësinë e njohjes dhe anëtarësimit në ON, kështu:

“Përvoja e Kosovës qëndron në mes të teorive deklarative dhe konstituive të njohjes, ku njëkohësisht lidhshipi politik promovon ekzistencën e shtetit të Kosovës pavarësisht nga njohja dhe punon në konstituimin e legjitimitetit ndërkombëtar dhe anëtarësimin në shoqërinë ndërkombëtare përmes njohjes diplomatike dhe anëtarësimit në organizata rajonale dhe ndërkombëtare”
(Newman & Visoka, 2018: 367–387).

Synimet kryesore të Kosovës në raport me anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe mekanizma të tjerë si BE-ja, ka shumë sfida, sidomos sfidë dalin të jenë statutet e organizatave të cilat specifikojnë se vetëm shtetet e pavarura mund të anëtarësohen, prandaj, do të shohim se si ka rrjedhur, cilat janë dobitë e prekshme dhe të efektshme nga anëtarësimi në organizata, në cilat organizata Kosova është pranuar edhe pse në statut specifikohet se vetëm anëtarët e OKB-së kanë të drejtë, si ka ndodhur që Kosova nuk është pranuar si anëtare e organizatave për shkak të votës kundër që shtetet njohëse i kanë dhënë Kosovës në atë proces të mos anëtarësimit.

Do të shohim se cili është raporti në mes OKB-së dhe Kosovës, cilat janë rrugët që Kosova ka drejt anëtarësimit në të dhe a është i favorshëm një anëtarësim në raport me një kompromis të ri që Kosova do ta bënte në raport me Serbinë. Si ka rrjedhur raporti në mes Kosovës dhe BE-së, edhe pse BE-ja nuk është organizatë, anëtarësimi në të është parë si i dyti prioritet nga tre kryesorët, krahas OKB-së dhe NATO-s.

Teza me titull “Problematika e njohjeve ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës dhe sfidat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare: 2008 – 2021”, paraqet temën që trajton në mënyrë të detajuar ndërvlarshmërinë e procesit politik më kompleks në marrëdhënie ndërkombëtare dhe në të drejtën ndërkombëtare, që është njohja e shtetit të ri të krijuar përmes një akti politik. Si proces i tillë, njohja ose pranimi i një subjekti të ri në marrëdhënie

ndërkombëtare është parë nga këndvështrime të ndryshme teorike, me ç'rast që nga Westfalia e këtij ka përcaktuar edhe rendin ndërkombëtar.

Meqë politika i ka paraprirë normimit juridik, njohja e shtetit të porsashpallur, është parë më shumë si konfirmim i një fakti të ri, duke lënë anash çështjen e ligjshmërisë së tij, pra fokusi bie te efektshmëria, më shumë se sa te legjitimiteti. Çfarë i duhet një entiteti të plotësojë për t'u konsideruar shtet, ka qenë dhe mbetet dilema themelore teorike, që ka përcaktuar kriterin e pranimit ose jo të një shteti.

Sido që të jetë shkollarët bien dakord se fokusimi te krijimi i faktit dhe te ligjshmëria, si faktorë të vetëm të krijimit të shtetit dhe të bollshme për njohje, nuk është i mjaftueshëm, prandaj konstatimet dalin të mbestin si tentativa për gjurmime vijuese në gjetjen e një shumësie komplementare standardesh, të cilat, përsëri nuk do të jenë një listë e gjatë kriteresh të njëjta për secilin rast.

Krijimi i shtetit të Kosovës përmes një procesi ndërkombëtar, pa një epilog të pranueshëm për palët, e vendosi atë në një rrugë të vetme, pa alternativa dhe mundësi të tjera, pos shpalljes së pavarësisë. Ky paraqet aktin e shpalljes, që sipas teorisë deklarative, është edhe momenti i krijimit të shtetit. Pranimi i deklaratës ose jo, nuk ka efekt konstitutiv për shtetin, por vetëm në forcimin e pozicionit të tij. Ai është fakt (i diskutueshëm në brendi të temës).

Ndarja e kapitujve

Punimi është i ndarë në katër kapituj të cilët pasqyrojnë zhvillimet evolutive të vetë procesit, duke nisur fillimisht me *Kapitullin I*, i cili merret me pjesën historike të ngjarjeve paraprake, të cilat do të shërbejnë për të njohur zhvillimet që kanë ndodhur, me ç'rast identifikohen faktorët dhe aktorët që kanë përcaktuar edhe fatin e gjithë procesit, duke prodhuar mjaftueshëm të dhëna dhe argumente politike *pro dhe kundër*, të cilat më pas janë përdorur nga Kosova, por edhe nga kundërshtarët e saj, në procesin e njohjes së pavarësisë së republikës së re të deklaruar më 2008.

Ky kapitull përmbledh zhvillimet politike kryesore që e karakterizojnë procesin, i cili nis me rrënimin e sistemit politik e kushtetues të Kosovës e deri te intensifikimi i krimeve kundër shqiptarëve që ngriti reagimin e bashkësisë ndërkombëtare e cila kishte ndërhyrë ushtarakisht, ndërhyrje e cila do të hapte debate të pashtershme për bazën ligjore të saj, për

efektet në rendin ndërkombëtar dhe në veçanti në përdorimin politik të saj dhe shtetit që doli nga ky proces, si një rast që do të krijonte precedent për rastet e ngjashme në botë.

Ky kapitull përdorë analizën historike, e cila duket më se e vyeshme në krijimin e një pasqyre të qartë analitike dhe e cila përkthen një fazë të tërë të zhvillimeve historike në një përmbajtje politike, duke vënë në dritë raportet shkak-pasojë në këto raporte, të cilat natyrisht se kanë krijuar mjaftueshëm ngjarje të diskutueshme politike e analitike, ndërsa përfundon me disa gjetje konkrete të ndikimit që ka pasur kjo fazë në procesin e mëtejshëm politik.

Kapitulli II, i kushtohet tërësisht trajtimit të konceptit njohje, si koncept kryesor i analizës së temës, me ç'rast trajtohen disa elemente me rëndësi fundamentale në të kuptuarit e vetë aktit të njohjes, rrethanave kur ndodh ajo, ndikimin që ka rendi ndërkombëtar, marrëdhëniet dhe e drejta ndërkombëtare, në veçanti debati i pashtershëm e i vjetërsuar teorik e analitik mes dy shkollave ose teorike kryesore të së drejtës, asaj konstitutive dhe deklarative, duke vënë në pah përparësitë e njëra-tjetrës, sigurisht edhe duke treguar pamjaftueshmërinë e tyre në përmbledhjen kuptimplotë të njohjes, rrethanave kur bëhet ajo dhe ndikimit që ka ajo në një rend politik të varur nga vullneti i shteteve sovrane.

Ky kapitull, përmend po ashtu edhe kushtet themelore që duhet t'i ketë një entitet politik për t'u deklaruar shtet, sikundër tregon se te rasti i Kosovës, por edhe te rastet e tjera, Kriteret e Montevideos janë thjesht të pamjaftueshme për të treguar se çfarë kërkohet si kriter sot në deklarimin e shtetit. Duke ofruar në përmbledhje gjetjesh nga sfondi teorik e analitik, përmbyllet ky kapitull.

Kapitulli III, flet për pjesën e zhvillimeve politike shtetformuese, që të gjitha prej tyre janë në raport me deklarimin e shtetit si një përmbyllje e natyrshme e ngjarjeve që kanë rrjedhur. Rezoluta 1244 paraqet nisjen e kësaj pjese, vijon me ngjarjet kryesore politike që kanë ndodhur pastaj, sidomos "Trazirat e Marsit" 2004, nevojën e intensifikimit të procesit drejt statusit, me plotësimin e standardeve dhe hapja e negociatave të cilat kulmojnë me pranimin e Pakos së Ahtisaarit nga ana e Kosovës, e cila bazuar në të, shpall edhe shtetin e pavarur.

Ky kapitull është padyshim edhe një nga pjesët me të rëndësishme të punimit, pasi flitet për gjithë procesin, dinamika e të cilit ka pasur vetëm një qëllim, gjetjen e statusit të ri politik të Kosovës, e i cili për shkak të qëndrimeve të Serbisë e të Rusisë, u minua si i tillë, duke e lënë shtetin e Kosovës në një betejë të vazhdueshme, fillimisht në krijimin e shtetit, e tash

në betejën e sigurimit të njohjeve, për çka që të dyja kanë vepruar sistematikisht kundër çdo arritjeje të shtetit të ri.

Në kapitullin IV, trajtohet procesi i njohjeve, me theks të veçantë sfidat që ka pasur Kosova në këtë proces, sidomos trajtohet njohja si gjeopolitikë dhe si gjeostrukturë, ku që të dyja paraqesin njohjen si reagim politik. Duke qenë se njohja e Kosovës ka marrë këtë raport, si ballafaqimi i fuqive të mëdha në procesin e sigurimit të njohjeve, fokusi bie te arritjet, sfidat dhe dështimet që ka pasur Kosova, por edhe partnerët e saj ndërkombëtarë.

Punimi ka përfundimin në të cilin paraqiten gjetjet kryesore të një procesi që është në vijim.

2. Qëllimet e hulumtimit

Por çfarë është rasti i Kosovës, cilat janë karakteristikat e njohjes së pavarësisë së saj, do të trajtohen në punim, qëllimet të cilat janë:

- *Njohja* - identifikimi i teorisë komplementare, gjetja e zbrazëtisë teorike;
- *Shkëputja korrigjuese*;
- *Teoria deklarative (e pamjaftueshme), teorianë konstitutive (dhe fosilet e saj)*;
- *“Çnjohja?”*, fenomen i ri, praktikë, ose drejt një teorie të re;
- *Kriteret e Montevideos* dhe e ardhmja e kriterit të katërt, pra aftësia për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare dhe rëndësia e saj në njohjen e shtetit të ri.

Njohja e shtetit të ri, pas shpalljes së tij si shtet, është varur nga vullneti i shteteve të tjera për ta pranuar ose jo faktin e ri të krijuar në terren që është produkt derivativ i rrethanave të ndryshme, kryesisht suksedimit.

- *Kontesti analitik i njohjeve të shtetit të Kosovës*
- *Valët e njohjeve:*
 - 2008 - 2010 – Nga shpallja deri në vendimin e GJND-së për Kosovën;
 - 2010 - 2011 – Nga vendimi i GJND-së deri në fillimin praktik të bisedimeve të Brukselit;
 - 2011 - 2013 – Nga fillimi i Bisedimeve të Brukselit deri në Marrëveshjen e Prillit 2013;
 - 2013 – 2015 - Nga Marrëveshja e Parë deri në Marrëveshjen e Dytë të Brukselit;

- 2015 – 2020 - Nga Marrëveshja e Dytë e Brukselit deri në Marrëveshjen e Zotimeve të Uashingtonit.
- Procesi i njohjeve
 - *shtrirja gjeografike e shteteve* - trajtohen në mënyrë të detajuar shtrirja gjeografike e shteteve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, duke i krahasuar me Tajvanin dhe me Palestinën;
 - *lobimi* - identifikohen faktorët, mekanizmat, rrethanat, objektivat e aplikuara që kanë ndikuar në procesin e njohjeve;
 - *qasja* - identifikohen dhe vlerësohen qasjet diplomatike që ka aplikuar Kosova ose partnerët e saj, në sigurimin e njohjeve;
 - *strategjitë* - vlerësohen, përshkruhen dhe analizohen të gjitha strategjitë politike që ka aplikuar Kosova në procesin e sigurimit të njohjeve;
 - *partnerët lokalë, kontinentalë dhe globalë*, identifikojmë partnerët e të gjitha niveleve, duke u nisur nga shtetet, mekanizmat e tjerë nënshtetëror, organizatat, individët;
 - *njohjet potenciale* - identifikojmë njohjet potenciale që mund të vijnë, duke u bazuar në hapat konkretë që kanë bërë shtetet që në të shumtën e rasteve flasim për një njohje de facto për Kosovën; dhe
 - *e ardhmja e njohjeve* – trajtohet duke parë ndikimin që kanë Bisedimet e Brukselit për kompletimin e njohjeve dhe varshmërinë që krijojnë këto bisedime në raport me të gjithë procesin;
 - *pengesat në procesin e njohjeve*;
 - *lobimi serb* – Serbia që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, ka vënë në dispozicion të gjitha mekanizmat politikë e para politikë për të ndaluar rritjen e numrit të njohjeve, këtë e ka bërë në mënyrë të organizuar dhe sistematike, ndërsa synimi është që të identifikojmë në detaje të gjithë aktivitetin;
 - *politika e jashtme e dobët e Kosovës* – Kosova, në mungesë të kapaciteteve kuadrore dhe infrastrukturore, rrjetit diplomatik e konsullor, lobues e mbështetës, politizim të strukturës diplomatike, kanë bërë që procesi i njohjeve të varet edhe nga kjo pengesë;
 - *mungesa e strategjisë funksionale* – shteti i Kosovës, ka krijuar kohë pas kohe strategji për sigurimin e njohjeve, por implementimi i tyre, bazuar në numrin e njohjeve nuk ka treguar rezultat.

- Mekanizmat ligjorë dhe institucionalë
 - analizohet dhe vlerësohet angazhimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme;
 - funksionimi dhe bashkërendimi i politikës së jashtme në mes organeve të brendshme dhe të jashtme të politikës së jashtme, si presidenti, kryeministri, ministri i punëve të jashtme, ambasadorët, konsujt;
 - ligjet;
 - rregulloret;
 - struktura organizative;
 - diplomacia parlamentare.
- Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare
 - anëtarësimet: Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, rajonale të përgjithshme dhe të specializuara;
 - përfitimi dhe forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës përmes organizatave ndërkombëtare;
 - sfidat dhe rruga drejt anëtarësimit në: OKB, NATO, UNESCO dhe INTERPOL;
 - ndikimi i bisedimeve me Serbinë në procesin e anëtarësimit në organizata; Diplomacia multilaterale.

Dy konceptet kyçe:

- Njohja

Njohja e shtetit të Kosovës varet nga një numër i madh faktorësh, varet nga rrethanat politike e po ashtu edhe nga pozicionimi i shteteve të fuqishme lobuese, kundështarëve të njohjes dhe të shteteve që nuk mbajnë ndonjë qëndrim të qartë në lidhje me njohjen. Si proces ka një dinamikë interesante, me një fillim të vrullshëm, por për shkak të rrethanave, pengesave dhe vetë konsumimit si proces, njohjet gradualisht fillojnë të ndalen, deri në një moment kur nuk ka asnjë njohje brenda vitit.

- Anëtarësimi në organizata

Anëtarësimi në OKB, varet nga vota ruse, anëtarësimi në NATO është proces i gjatë, mosnjohja nga një numër shtetesh të këtij mekanizmi e bëjnë anëtarësimin sa të paqartë, aq edhe të pamundur. Anëtarësimi i Kosovës në BE është më kompleks nga të gjitha

anëtarësimet në mekanizma ndërkombëtarë. Anëtarësimi në organizata deri diku varet nga epilogu i bisedimeve me Serbinë, ose nga mënyra e vendimmarrjes në ato organizata.

3. Hipotezat

Punimi duke qenë i zhvilluar paralelisht me proceset politike që kanë pasur ndikim në procesin e njohjeve kanë ofruar një pasqyrë të plotë të të gjitha rrjedhave dhe ndikimeve shkakësore që ato kanë pasur në njohjen, ose mosnjohjen si të tillë. Nisur nga kjo, ky punim provon t'i identifikojë, fillimisht aktorët, duke vijuar me ngjarjet, faktorët, por edhe rrethanat që kanë çuar në njohje e anëtarësim në ON, ose e kundërta. Të parë nga fakti se veprimet politike të shteteve drejt njohjes së një shteti të sapo deklaruar, thuhet më lart, prekin rendin ndërkombëtar, konsiderohet e rëndësishme të shihet roli që kanë pasur shtetet e fuqishme të përfshira në proces. Kjo prodhon hipotezën e parë:

- *Njohjet e pavarësisë së Kosovës në fazën e saj fillestare janë produkt i ndikimit të diplomacisë perëndimore, më saktë shteteve të Kuintit.*

Krijimi i shtetit të Kosovës, është produkt i shumë ngjarjeve, ndërsa si i tillë kap një periudhë kohore së paku 20-vjeçare, ndërsa njohja e pavarësisë është proces që vijon edhe pas 14 vitesh shpalljeje. Ky vonim në kompletimin e njohjeve, ka shumë shpjegime të karakterit politik, por të cilat një element të përbashkët kanë kundërshtimin e ashpër nga Serbia, e cila kishte përkrahje të pareshtur nga Rusia, por edhe aleatë të tjerë strategjikë, duke prodhuar një hipotezë përmes së cilës, synohet të shpjegohet *procesi i njohjeve* si akt politik i cili varet nga *proceset politike rrethanore*, të cilat krijojnë situata të (pa)favorshme për palët, të cilat përdoren politikisht nga shtetet, i porsa shpalluri dhe shteti pararendës.

- *Procesi i njohjeve të pavarësisë së Kosovës është penguar strategjikisht dhe sistematikisht nga Serbia, përmes Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Bisedimeve të Brukselit dhe Gjykatës Speciale, me synim ndalimin e rrjedhës së njohjeve dhe dobësimin e pozitën politike ndërkombëtare deri në delegjitimim të tërësishëm.*

Meqë Serbia kishte paralajmëruar se nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovë, duke mos e pranuar pakon e Ahtisaarit, shtetit të porsakrijuar nuk i kishte mbetur gjë tjetër, pos të përgatitej për betejën e re me Serbinë, siç thuhet më lart, tash për sigurimin e njohjeve.

Kosova nuk kishte ide se si do të kompletonte njohjet e si të anëtarësohej në OKB, prandaj shteti i ri duhet ta ndiqte një kurs të ri në një arenë ku ajo sapo hynte. Lobimi, nuk ishte diçka e re për Kosovën, por ngjarjet politike, kishin marrë kah tjetër për shkak të ndryshimeve politike botërore, prandaj ngrihet hipoteza:

- *Kosova nuk pati një strategji lobuese të qartë dhe të efektshme për t'i kompletuar njohjet.*

Kjo hipotezë shpjegon raportin në mes të njohjeve dhe aplikimit të *strategjisë lobuese*, pasi shtetet përmes aplikimit të këtyre masave synojnë të forcojnë pozitën politike, duke krijuar lidhje bilaterale.

Kosova, në mungesë të njohjeve, por edhe paralelisht me të synim kryesor ka pasur anëtarësimin në organizata ndërkombëtare përmes të cilave ka synuar të forcojë subjektivitetin e saj ndërkombëtar, prandaj nisur nga kjo ajo ka shënuar disa përparime, sidomos sukses mund të llogaritet anëtarësimi në FMN, BB, BERZH, por edhe në disa organizata e nisma të tjera rajonale, kontinentale e globale, prandaj hulumtimi ka synim të shohë edhe raportin që ka anëtarësimi në ON, në konsolidimin e shtetësisë së Kosovës. Kësisoj, ngrihet hipoteza:

- *Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare ka ndikim më të madh në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës se sa njohjet individuale nga shtetet.*

Kjo hipotezë shpjegon se në periudhën e tanishme kur shtetet si rasti i Kosovës nuk mund të sigurojnë njohje individuale, synojnë që subjektivitetin ta forcojnë përmes anëtarësimit në organizata, si mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë pas shteteve. Në to, shtetet bëhen subjekte të barabarta edhe me shtetet që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Kosova që nga shpallja e saj si shtet, por edhe përpara, synimin e ka pasur që të anëtarësohet në OKB, BE dhe NATO, si tri institucionet kryesore të politikës, sigurisë e përparimit. Por ky proces ka mbetur peng i njohjes nga Serbia, e cila ka pasur partnerë strategjikë që e kanë ndihmuar në ngadalësimin e konsolidimit të Kosovës, duke bërë që procesi i Bisedimeve të Brukselit, të përcaktojë përmbylljen e shtetësisë së Kosovës, në një marrëveshje finale. Përmes këtij punimi, synohet të vihet në dritë ndikimi që kanë këto bisedime në procesin e njohjeve dhe konsolidimit të Kosovës, prandaj:

- *Anëtarësimi i Kosovës në OKB, në NATO dhe BE është parë si procesi më i rëndësishëm përmes së cilës synohet të përmbillet subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës, proces i cili varet nga Bisedimet e Brukselit, në mes Kosovës dhe Serbisë.*

Kjo hipotezë elaboron ndërvashmërinë që ka anëtarësimi në mekanizma ndërkombëtarë nga Bisedimet e Kosovës dhe Serbisë, që zhvillohen në Bruksel.

4. Metodologjia e hulumtimit

Teza me titull “Problematika e njohjeve ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës dhe sfidat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare; 2008 – 2021”, paraqet një angazhim për të identifikuar një proces i cili ishte shumëdimensional, me shumë të panjohura dhe me dinamikë e ecuri të llojllojshme, prandaj kërkon një laramani të metodave, teknikave dhe qasjeve, synimi i të cilave është nxjerrja, të nxirret përfundim sa më i saktë, i besueshëm, i vlefshëm dhe i matshëm. Nisur nga kjo, tema kërkon aplikimin dhe kombinimin e të dy llojeve të metodave, si atë kualitative, por edhe atë kuantitative, me ç’rast do të kryqëzohen të dhënat.

Nisur nga problematika që aplikohet, në këtë tezë do të përdoret *Qasja Funksionaliste* në Shkencën Politike, duke u nisur në modelin e aplikuar në Davide Easton, ndërsa përmes metodës së induksionit, do të përdoren dhe elaborohen përfundimet sistematike, të nxjerra nga faktet e ndara dhe kualifikuara për të nxjerrë një përfundim të përgjithshëm që është produkt i analizimit të detajuar të të dhënave që aplikohen.

Natyra e këtij hulumtimi kërkon aplikimin e këtyre metodave:

- *Analizë e përmbajtjes,*
 - Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
 - Ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës;
 - Rregulloreve;
 - Strategjive të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
 - Udhëzuesve.

- Përmes kësaj metode, vlerësohen, sintetizohen të gjitha normat, aktet dhe rregulloret, strategjitë të cilat i ka aplikuar Kosova për të siguruar njohjet dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare.

- *Intervistë e strukturuar, me:*

- Ministrat e Punëve të Jashtme
- Ambasadorë

- *Përmes kësaj metode synohet që të identifikohen, vlerësohen dhe analizohen, problemet kryesore me të cilat është përballur politika e jashtme e Kosovës në periudhën referuese, duke u nisur nga qëndrimet njohëse dhe vlerësuese që kanë bartësit e institucioneve.*

- *Intervistë e pastrukturuar, me:*

- Njohësit e Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- Studiuesit e Politikës së Jashtme.
- Ish-diplomatë;
- Ekspertë të marketingut ndërkombëtar
- Ekspertë të studimeve të Politikës së Jashtme
- Diplomatë;

- Nga aplikimi i kësaj metode, synohet që të pasqyrohet se cilat janë perspektivat analitike, nga njohësit dhe studiuesit e fushës përkatëse të problematikës së lartcekur.

- *Analiza statestikore*

- *Përmes kësaj metode synohet që të identifikohen, vlerësohen dhe analizohen, dinamika numerike e njohjeve të pavarësisë së Kosovës, duke e parë gjeografinë e njohjeve, sfidat respektive dhe impaktin që kanë ato në këtë proces.*

Studimi i tillë ofron një sfond të gjerë të dhënash dhe interpretim të duhur analitik dhe vlerësues, për një proces shumë të rëndësishëm për shtetin e Kosovës. Procesi i njohjeve dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, ishin sfidat kryesore më të cilat u përball shteti i porsashpallur.

5. Rëndësia e punimit

.... lidhen me disa elemente, si:

- Hulumtimi sjell një prapavijë historike si pararendëse e proceseve politike, duke aplikuar një qasje të drejtë historike, meqë distanca kohore e mundëson këtë.
- Shtrohen për trajtim, baza e qëndrueshme teorike, identifikohet teoria komplementare duke e bërë hulumtimin më të kornizuar dhe të bazuar.
- Analizimin e procesit duke i vënë në pah të gjitha elementet e tij, duke e mbuluar një zbrazëti të theksuar të hulumtimit të tillë, kaq të gjerë e kaq gjithëpërfshirës.
- Punimi paraqet një bazë të qartë teorike, por duke u bazuar në rastin e Kosovës, provon të avancojë ato, ose në rastin tjetër të dëshmojë se si ka rrjedhur i gjithë procesi, duke identifikuar fazat, pengesat, ecurinë, arritjet dhe pritjet.
- Do të sfidojmë teorinë deklarative, do të shohim a mjafton të jesh shtet vetëm me shpallje, ose çfarë kërkohet tjetër, prandaj konsiderojmë se do të mbulojmë këtë zbrazëti.
- Hulumtimi me aplikimin e gjerë të metodave, qasjeve dhe instrumenteve hulumtuese, nxjerr një ekstrakt të mjaftueshëm dhe gjithëpërfshirës për të nxjerrë përfundime të qëndrueshme, për të krijuar një hap me tej në vlerësimin dhe analizimin e të dhënave.
- Përbashkimi i dy fushave kryesore të politikës së jashtme të shtetit, si njohja dhe anëtarësimi në organizata, krijon mundësinë për të gjeneruar të dhëna të detajuara krahasuese, njohëse e vlerësuese.
- Hulumtimi ka për synim pos të krijojë një pasqyrë të qartë, mund të përdoret edhe si analizë edhe për qendrat politikëbërëse ose institucionet vendore e ndërkombëtare.

KAPITULLI I

ANALIZË HISTORIKE E PËRPIEKJEVE TË KOSOVËS PËR SIGURIMIN E SHTETIT DHE NJOHJES SË TIJ

Krijimi i shteteve ka qenë dhe mbetet sfida kryesore e rendit ndërkombëtar, pasi si i tillë vetë rendi është varur nga shtetet të cilat janë aktoret kryesore vendimmarrëse në Marrëdhënie Ndërkombëtare (në disa vende MN). Shtetet kanë attribute pa të cilat nuk mund të ekzistojnë, si popullata, territori, qeverisja ose sovraniteti, por edhe aftësia për të marrë obligime ndërkombëtare (Konventa e Montevideos).

Krijimi i shtetit lidhet pashkëputshëm me njohjen e tij, por njohja nuk përcakton ekzistencën e shtetit. Kjo është dilema, e cila trajtohet në këtë punim, pra se si njohja e shtetit rrumbullakon shtetësinë, e në anën tjetër njohja ose mosnjohja tregojnë se nuk ka një linjë të qartë që duhet të ndiqet në funksionim të së drejtës. Krijimi i shtetit është i lidhur me historinë, por marrëdhëniet ndërkombëtare nuk janë sinonim me të, as e drejta ndërkombëtare. Krijimi i shtetit lidhjet me ekonominë, strukturat sociale e demografike, me gjeografinë e gjeopolitikën, por të gjitha këto janë thjesht faktorë të jashtëm, ose pararendës të rrethanave politike që shpien në krijimin e shtetit ose zhdukjes së tij.

Edhe krijimi i shtetit të Kosovës nuk mund të shpjegohet ndaras nga procesi historik i tij, pasi të dhënat që i ofron ky proces, ndihmojnë mjaftueshëm për të identifikuar faktorët dhe rrethanat nëpër të cilat ka kaluar entiteti politik, deri në deklarimin e shtetit, por mbi të gjitha mund të përdoren edhe si argumente politike në procesin e sigurimit të njohjeve.

Siç është thënë më lart, nuk mund të identifikohet një pikëprerje nga ku mund të nisët “*historia*” e krijimit të shtetit të Kosovës, por gjithsesi, kërkohet të trajtohen nga prizmi i perspektivës kauzale e gjithë rrjedha e historisë së saj së paku tridhjetë vjeçare, prandaj konstatimi i përgjithshëm është se *fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë* (nga tash RFJS) mund të merret si pikënisja e rrjedhës politike që prodhoi mjaftueshëm ngjarje politike të cilat ndikuan në krijimin dhe njohjen e shtetit të Kosovës.⁷

Shpërbërja e RSFJ-së, kishte ndikuar jo pak në proceset politike kontinentale, por edhe te qëndrimi i shteteve evropiane të cilat u detyruan të gjenin zgjidhje politike ndaj problemit

⁷ Argumentimet e këtij konstatimi gjenden në pjesën vijuese.

të krijuar rishtazi, problem i cili mund të kishte efekte edhe ndaj rajonit i cili shpesh u gjet i tensionuar nga ndikimi i zhvillimeve politike që po ndodhnin në Jugosllavi. Shpallja e shteteve që po dilnin nga RSFJ-ja kishin krijuar fakte të reja në Evropë dhe se përgjigjja ndaj tyre duhet të ishte e organizuar, edhe pse njohjet veçse kishin filluar individualisht.

Ky kapitull trajton ndikimin e këtyre ngjarjeve në procesin e njohjeve dhe kushtet që janë përcaktuar për njohje, ndërsa ndalet te secila ngjarje për të kërkuar hollësi në lidhje me pozitën e Kosovës në këtë proces dhe argumentet historike që i përdor shteti i ri, në përpjekjen e saj për kompletimin e njohjeve.

Këtu trajtohen disa elemente:

- Shpërbërja e Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në raport me njohjen – *Njohja si proces i shpërbërjes së shtetit pararendës;*
- Pozita e Kosovës në raport me njohjen, sipas Komisionit të Arbitrazhit – Njohje si posedim de facto i kontrollit të territorit;
- Marrëveshja e Dejtonit dhe pamundësia e Kosovës që të siguronte njohje - *Njohja si vendim i Konferencës Ndërkombëtare;*
- Shpërthimi i luftës dhe njohja e kryengritësve si palë ndërluftuese;
- Administrimi ndërkombëtar dhe krijimi i shtetit përmes *shkëputjes korrigjuese.*

Ky kapitull, duke i shoshitur argumentimet teorike e politike, në lidhje me procesin historik të krijimit të shtetit të Kosovës, trajton ndikimin që kanë faktorët politikë, si shtetet e organizatat ndërkombëtare dhe ballafaqimi mes tyre në procesin e njohjeve të shtetit të ri, rendi ndërkombëtar dhe avantazhet që ai mund të krijojë gjatë rrjedhave politike, pa të cilat në moment tjetër, shumë gjëra do të ishin të paarritura, sikundër që trajton edhe vendimmarrjen kolektive ndërkombëtare, si vendimet e konferencave e të forumeve politike që krijuan mundësi për krijimin dhe njohjen e shteteve, po ashtu edhe evoluimin e të drejtave të njeriut dhe në fund shembullin që mund të ofrojë një rast i pashembullt sikur ajo që kosovarët dhe mbështetësit e tyre e paraqesin te rasti i Republikës së Kosovës.

Trajtimi nga perspektiva historike e procesit politik të krijimit të shtetit të Kosovës shërben për të njohur më mirë ndikimet që kanë pasur aktorët dhe faktorët në procesin politik vijues, tash për sigurimin e njohjeve.

Në trajtimet politologjike, i është kushtuar vëmendje sidomos identifikimit të metodës më komplementare historike që do të mund të aplikohet në trajtimin e problematikave me karakter politik, ndërsa theksohet fakti se në analizën politike të rrethanave historike kanë rëndësi dy elemente, si: *shtrimi i çështjes* dhe *ndërvarësia faktike*. Studiuesit Michael Howlett dhe Jeremy Rayner, nisur nga fakti se politika paraqet një proces tepër dinamik, thonë se është me rëndësi të dihen trajektoret politike të zhvillimeve, ndërsa procesin politik e sheh kështu:

“...renditja e procesit është, në fakt, një qasje sintetike më premtuese, duke inkorporuar elemente të modeleve narrative dhe stokastike të varura nga rruga në një mënyrë që lidhet me politikën me një sërë studimesh empirike mbresëlënëse pas saj” (Hewlett & Rayner, 2006: 18).

Analiza historike e proceseve politike më shpesh ndjek marrëdhëniet shkak-pasojë, thotë Charles Tilly (2001: 567), prandaj është e nevojshme të ndërtohet skema e analizës, të cilën Gabriel Almondi e ka paraqitur kështu:




Figura 1. Agjenda e Gabriel Almond për shndërrimin e një episodi historik në një episod analitik, adaptuar nga Charles Tilly

Më lart është paraqitur pikëpamja që ofron teoricieni Gabriel Almond, i cili kur skicon transformimin e rrethanës historike në analizë politike ndalet te ndikimi që ka ambienti –

rrethanat politike në procesin politik, së këndejmi, konstatimi fillestar për rastin që trajtohet, është se fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë kishte krijuar kushtet për ndryshimin e pozitës politike të Kosovës, si produkt përfundimtar i gjithë procesit politik.

Meqenëse flitet për një proces efektet e të cilit vërehen edhe tash, mund të konstatohet se duhet të vihet në shërbime edhe historia, ose pikëpamjet interpretuese historike, *për faktin se historia, si disiplinë shembullore e bazuar në prova, është po aq e rëndësishme sa edhe qasjet e tjera për politikëbërjen e bazuar në dëshmi* (Berridge, 2018: 369).

Janë identifikuar tri mundësi se si studimet nga perspektiva historike mund të shërbejnë për t'i dhënë më shumë vlerë dhe besueshmëri hulumtimit (McCurley, 1979: 206-207). Sipas McCurley, studimet ndër të tjerash duhet të kenë *mundësinë për interpretim*, bazuar në faktorët kohë/hapësirë, pasi vendimmarrësit dhe politikëbërësit, nuk kanë nevojë vetëm për të dhëna numerike ose të kalkulueshme, kjo prodhon pikën e dytë, që njihet si *elementi vlerë* në analizën politike/historike (McCurley, 1979: 206-207).

Qasja historike në analizën politike trajton vlerat, jo numrat, prandaj, gjërat duhet të shihen jo vetëm nga numrat, ose vetëm nga interpretimet, *kjo nuk do të thotë se historianët mund t'u ofrojnë politikëbërësve "Foton e Madhe" të pakapshme, por sugjeron që historianët mund të luajnë një rol integral dhe të vlerësuar gjatë procesit të përpunimit të kontekstit të çështjeve të politikave* (McCurley, 1979: 206-207).

Argumentimi historik i proceseve politike, është trajtuar nga shumë studiues, si Theodor Schieder, i cili duke e ngritur lart qëndrimin që kishte mbajtur studiuesi Arnold Gehlen, lidhur me përcaktimin e ndërgjegjes historike si aftësinë për të njohur cilësinë epokale të një ngjarjeje që po ndodh tani, por e cila ka ndikime në mënyrën se si shihet e ardhmja (Schieder, 1978: 1-18), duke treguar se historia duhet të shërbejë si përcaktuesja e proceseve të tanishme.

Nisur nga kjo, ky kapitull fokusohet në trajtimin e problematikës së njohjes së Kosovës, nga perspektiva historike, duke i aplikuar instrumentet e paraqitura më lart në analizë, ndërsa në anën tjetër, duke u nisur nga premisa shkak/pasojë, synon të tregojë për ndikimet që kanë pasur ngjarjet paraprake, jo vetëm për t'i njohur ato si vlerë/fakt, as për t'i pasur si një pasqyrë të madhe, por për të njohur realisht se si rrjedha e ngjarjeve politike ka ndikuar në mënyrë komulative në gjithë procesin e krijimit dhe njohjes së Kosovës si shtet.

Ky kapitull, duke identifikuar shkaktarët, sjell të dhëna koherente për këto elemente:

- Fillesat e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe ndikimi i tyre në pozitën politike të Kosovës;
- Reagimin e shqiptarëve të Kosovës në procesin e ri të përcaktimit të statusit të vendit të tyre;
- Ndërkombëtarizimi i problemit të Jugosllavisë dhe perspektiva globale e kontestit;
- Reagimet e bashkësisë ndërkombëtare në raport me krizën dhe mbajtja e konferencave ndërkombëtare për gjetjen e zgjidhjes;
- Konferenca e Hagës, Komisioni i Arbitrazhit të Badinterit, kushtet dhe kriteret e tyre dhe pozita e Kosovës në raport me sigurimin e njohjeve;
- Konferenca e Dejtonit, kushtet dhe kriteret e saj dhe pozita e Kosovës në raport me sigurimin e njohjeve;
- Thellimi i krizës dhe dhunimi i të drejtave të njeriut që shpie në luftë dhe njohja e kryengritësve si palë ndërluftuese në Konferencën e Rambujesë.

Pas trajtimit të fakteve dhe të dhënave të dala nga procesi, synohet t'i jepet përgjigje pyetjes hulumtuese: "Si ka ndikuar procesi politik i shpërbërjes së Jugosllavisë në krijimin e fakteve që çuan në njohjen e pavarësisë së Kosovës?". Hulumtimi nisët nga premisa se *shpërbërja e Jugosllavisë, Komisioni i Badinterit dhe Konferenca e Dejtonit duke mos e trajtuar Kosovën, tregohet se nuk ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e argumentit për njohjen e shtetit të Kosovës.*

I.1. Kontesti historik i krijimit të shtetit të Kosovës

“Lufta e Kosovës për pavarësi filloi pas heqjes së autonomisë së

Kosovës nga Millosheviqi në vitin 1989”

(Abazi, 2015).

Ardhja në pushtet e Millosheviqit dhe suprimimi i autonomisë së Kosovës, shihet si momenti i fillimit të përpjekjeve të shqiptarëve për të ridefinuar statusin e tyre politik, konform ndryshimeve të mëdha që po përjetonte Jugosllavia, ku në këtë kohë *pavarësia u pa si statusi i tyre i ardhshëm* politik (Borgen, 2008). Në këtë linjë është edhe studiuesi Colin Warbrick (2008: 675), i cili e cilëson krijimin e shtetit të Kosovës si *produkt të shpërbërjes së Jugosllavisë*, prandaj fillimi i këtij procesi, paraqet edhe fillimin e krijimit të shteti të ri, proces i cili u var nga një numër faktorësh politikë.

Ndryshe nga studiuesit Borgan e Warbrick, studiuesi Veton Zejnullahu, (2014: 265) (duke u thirrur në burimet e studiuesit Lisen Bashkurti, 2006: 3), trajton problemin e Jugosllavisë nga një perspektivë tjetër, ku konsideron se ishin udhëheqësit politikë, ata të cilët përmes përdorimit të retorikës nacionaliste, krijojnë ndasi ndëretnike duke nxitur frikë e mosbesim mes tyre, duke e ofruar si plotësim të skemës së analizës *elementin e vetive të udhëheqjes*, të paraqitur më lart. Ardhja në pushtet e rrymave nacionaliste serbe, dhe përpjekjet për krijimin e Serbisë së Madhe, krijoi shumë faktorë pasues që ndikuan në prodhimin e shumë ngjarjeve politike që përcaktuan edhe pozitën e shqiptarëve dhe më vonë edhe statusin e tyre politik.

Pos liderëve politikë, natyra e sistemit politik të Jugosllavisë, por edhe dallueshmëria e madhe mes përbërësve të Jugosllavisë, ishin ato që krijuan paqëndrueshmërinë më të madhe brenda sistemit, ndërsa synimi i serbëve për të dominuar shtetin jugosllav, që do të kapitalizohej pas ndryshimeve kushtetuese, çuan në shpërthimin e konfliktit (Salla, 1995: 427).

Dallimet e theksuara strukturore në Jugosllavi, dhe në veçanti ato të karakterit etnik, kanë prodhuar jo pak shkaktarë të transformimeve edhe të gjendjeve nga para konflikti në luftë dhe më pas në pasoja të (pa)riparueshme në procesin e konsolidimeve të shoqërive.

Këtu Kosova bënte përjashtimin e madh në strukturën e përgjithshme, me dallime të tilla, si: kulturore, fetare, sociale e etnike në Jugosllavi, prandaj edhe qasja e shtetit jugosllav

ndaj ish-krahinës e bënte të pritshme revoltimin e shqiptarëve të Kosovës, sikundër e pritshme ishte edhe shpërbërja e komplet Jugosllavisë, në një proces vijues ku ata, pra shqiptarët gjetën rrugë tjetër të rezistencës.

Transformimet e mëdha që ndodhën në Jugosllavi, treguan se mundësitë për të gjetur zgjidhje politike kreative, ishin të pakta, për shkakun e ngjarjeve historike që ndodhën paraprakisht, prandaj nisur nga kjo, studiuesja Lingli Zhang, thotë se nëse një shtet nuk mund të trajtojë siç duhet marrëdhëniet e brendshme të grupeve etnike, konfliktet e brendshme vicioze do të çojnë në rritjen e mëtejme të forcave centrifugale, por edhe rritjen e kostos sociale për ruajtjen e rendit shoqëror, burimeve financiare, njerëzore dhe materiale (Zhang, 2008: 11), duke e ofruar *elementin e ndërvarësisë strukturore – funksion në tabelën e madhe të analizës* që e ofron Almond paraprakisht.

Studiuesi Dennison Rusinow kur flitet për rastin e Jugosllavisë, thekson faktin se janë kulturat dhe interesat e ndryshëm, por edhe personalitet politike elementet që çuan në shpërbërjen e saj (Rusinow, 1991: 143).

Edhe autorja Nancy Namisi Siboe, identifikon një mori faktorësh që patën ndikim në këtë proces, si ato etnike, nacionaliste, fetare, ekonomike, territoriale dhe politike, ndërsa revokimi i autonomisë dhe diskriminimi masiv ndaj shqiptarëve të Kosovës, sidomos në sferën publike, pat ndikim të jashtëzakonshëm në masivizimin e konfliktit (Siboe, 2020: 1-10).

Ndryshimet kushtetuese në Jugosllavi, dhanë efekte politike, sidomos në sferën sociale e ekonomike, të cilën studiuesi Howard Clark (2000), i cilëson si *serbizimi i Kosovës*, që u manifestua sidomos te policia një etnike (e sapospastruar), e cila kishte filluar masa të mëdha represive. Serbët në Jugosllavi aplikuan një praktikë të njohur si *kontrollim i sistemit*, sidomos të dy institucioneve kyçe të tij, si *qeveria e ushtria* (Yağci, 2019: 246), përmes së cilës synohej të ruhej dominimi dhe rrjedhimisht edhe të parandalohesh shpërbërja, në atë kohë kur *shpërbërja e saj po afrohej, sidomos kur Sllovenia dhe Kroacia fajësuan Serbinë për dominim të padrejtë të qeverisë, ushtrisë dhe financave jugosllave, ndërsa Serbia në anën tjetër, po i akuzonte këto dy vende se po bënin separatizëm* (Zejnnullahu, 2014: 265, Bashkurti 2006: 3).

Ndryshimet e mëdha politike që po ndodhnin në Jugosllavi dhe sidomos suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës, për disa qarqe politike të atëhershme jugosllave, u panë si një veprim të cilin nuk duhet të kundërshtohet, sepse kjo do t'i plotësonte ambiciet maksimale serbe, të paraqitura rishtazi me Millosheviqin (Qeriqi, 2020: 95) dhe nuk do të kishte konsekuenca politike për vendet e tjera përbrenda shtetit jugosllav. Ky konstatim mund

të konsiderohet i qëndrueshëm, për faktin se të pakta ishin reagimet e faktorëve të tjerë vendimmarrës, aq më tepër kur dihet se të pakta kanë qenë edhe informatat në lidhje me gjendjen e përgjithshme në Kosovë.

Studimet e deritanishme theksojnë faktin se politika serbe e kohës, duke e parë ndryshimin e madh politik që po ndodhte në Jugosllavi, u nxitën të vepronin që sa më parë të krijojnë rrethanat e reja, përmes ndërmarrjes së veprimeve të tilla që do të ndikonin në pozitën politike të Kosovës dhe të ardhmes së saj, ku edhe do të niste së jetësuar plani i Serbisë së Madhe, thotë studiuesi Pesic, i cili argumentimin e vijon, duke thënë:

“Gjatë viteve 1988–89, inteligjenca e Serbisë dhe klika e partisë komuniste serbe të Slobodan Millosheviqit bashkuan forcat për të inkurajuar një revolucion kombëtar për të krijuar një "Serbi të bashkuar" duke prekur pakënaqësinë sociale dhe kombëtare në republikë. Ideologjia nacionaliste e të qenit i kërcënuar dhe i urryer nxiti këtë lëvizje masive serbe” (Pesic, 1996: V).

Një Kosovë me autonomi të theksuar dhe ndryshimi i kushtetutës që do të shpinte vendin drejt një konfederate, do të thoshte një minim i pozitës së Serbisë në Jugosllavi (Guzina, 2000: 28-29), duke vënë në dukje se Jugosllavia ka funksionuar në shërbim të *çështjes kombëtare serbe*, ndërsa decentralizimi i pushtetit që çonte në shpërbërje, do të thoshte edhe *pasiguri kombëtare pikërisht për serbët*.

Viti 1980 dhe plasaritjet që shkaktuan demonstratat e atij viti me thirrjet *Kosova Republikë*, u shoqëruan edhe me ide të tjera, që e sfiduan shtetin jugosllav, si *"Sllovenia, vendi im"*, *"shpirti boshnjak"*, *"Të gjithë serbët në një tokë serbe"* ose *"identiteti vojvodinian"* (Guzina, 2000: 28), shërben si dëshmi se Jugosllavia ishte ndërtuar asistojë që shpërbërja e saj do të ishte në shërbim të të gjitha ideve nacionaliste.

“Kriza e fundviteve të ‘80 ngriti tensionet dhe inkurajoi urrejtje midis fraksioneve nacionaliste, duke rezultuar në luftëra brutale dhe poshtëruese” (Radeljic, 2010: 115).

Të gjitha etnitë në Jugosllavi tashmë e kishin të qartë, vendi sapo kishte hyrë në fazën e cila do të ishte përcaktuese për të gjithë ata, prandaj veprimet që do të ndërmerrnin në atë kohë, do të ishin përcaktuese për rrjedhat e ngjarjeve të mëpasshme.

Studiuesi Blerim Reka, konsideron që sfondi historik dhe politik i problemit të Kosovës mund të shpjegohet me problemin e vetëvendosjes së jashtme, ndërkaq duke u thirrur në burime të tjera⁸ shton se *Kosova ka lëvizur në mënyrë të pashmangshme nga vetëvendosja drejt sovranitetit që nga viti 1990*, (Reka, 2003: 34), ndërkaq vë në dukje qëndrimin që kishte mbajtur Josef DioGuardi, në një mbledhje të Komitetit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Dhomës së Përfaqësuesve, në maj të vitit 2003, ku ndër të tjerash ai kishte thënë:

“Nën Slllobodan Millosheviqin, qeveria jugosllave shpërbeu strukturat politike të Kosovës, zëvendësoi shqiptarët etnikë me serbë në shumicën e vendeve të punës, u mundësoi firmave në pronësi serbe të merrnin kompanitë në pronësi shqiptare dhe ua ndaloi shqiptarëve blerjen ose përmirësimin e pronave në tokat e tyre” (DioGuardi, 2003, Komiteti për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Dhoma e Përfaqësuesve)

*Serbizimi i Kosovës*⁹ trajtohet edhe nga studiuesi Steven Woehrel, i cili flet për qasjen që ka aplikuar shteti serb ndaj Kosovës, me ç’rast identifikon se mbi 100,000 shqiptarë etnikë, ishin detyruar t’i lëshonin pozitat e tyre në institucionet e vendit, si në ato qeveritare, por edhe në institucionet e tjera shoqërore e të sigurisë, medime, shkolla e spitale, të cilët u zëvendësuan nga serbët, duke shkaktuar diferencim kulturor e etnik. Këto masa u intensifikuan më vonë, duke kulmuar deri në konflikt të armatosur (Woehrel, 1999: 5).

Suprimimi i Autonomisë së Kosovës, sigurisht në mënyrë të dhunshme nga ana e Beogradit, nuk kishte lënë mundësi tjetër në Kosovë, pos afrimit të asaj që kishte nisur në vitin 1980, pra shpallja e Kosovës, një entitet i pavarur dhe i barabartë me republikat e tjera (Abazi, 2008: 68) në kuadër të Federatës/Konfederatës Jugosllave.

Kuvendi i Kosovës, i mbledhur në një mbledhje të jashtëzakonshme para dyerve të tij, me 2 korrik 1990, nën kërcënimin e madh të forcave serbe dhe duke i parë zhvillimet politike në vend dhe nevojën për afirmimin e pozitës politike të Kosovës në Jugosllavi, provuan që përmes kësaj deklarate të paraqesin Kosovën si të barabartë dhe për këtë çështje kërkuar njohje dhe miratim të plotë në opinionin e gjerë.

⁸ Shih: Blerim Reka dhe http://commdocs.house.gov/committees/intlrel/hfa87200.000/hfa87200_0f.htm

⁹ Koncept i përdoruar nga Haward Clarc te *“Rezistenca Civile”*.

“Ky kuvend duke e shpallur nga ana e tij dhe në nivel të tij Kosovën si njësi të barabartë në Jugosllavi, në bazë të principeve të demokracisë autentike mbi respektimin e vullnetit të njerëzve dhe të kolektiviteteve njerëzore dhe kombëtare, pret konfirmimin e këtij akti konstitutiv të tij në Kushtetutën e Jugosllavisë me mbështetje të plotë të opinionit demokratik në Jugosllavi dhe të opinionit ndërkombëtar” (Pika 2, Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut 1990).

Ishte e qartë se që atëherë Kosova kishte nevojë për njohje, prandaj pikërisht Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut 1990, mund të cilësohet si akti i parë formal e juridik i cili kërkonte njohjen e Kosovës, kësaj radhe në rangun e Republikës, në kuadër të Jugosllavisë. Kjo deklaratë, kishte nevojë të materializohej prandaj me 7 shtator 1990, bëhen edhe ndryshimet e nevojshme kushtetuese, që afirmonin Kosovën si Republikë në mesin e entiteteve politike që e ndërtonin Jugosllavinë. Nenet që u ndryshuan preknin pozitën politike dhe kushtetuese, sidomos Neni I, II dhe IV (Bajrami, 2011: 59).

Rrjedha e proceseve politike ishte shumë dinamike, ndryshimet politike që ndodhën gjatë dy viteve paraprake ishin dëshmi se Jugosllavia kishte hyrë në një rrugë e cila e shpinte drejt shpërbërjes, prandaj aktet e mësipërme të ndërmarra, u panë si mundësi e krijimit të faktit të ri të krijuar në terren. Por rezultati i tyre real ishte jo i matshëm. Republikat e tjera jugosllave, sapo kishin nisur shpalljen e pavarësisë, Sllovenia përmes marrëveshjes së Brionëve të arritur më shtatë korrik 1991, doli nga lufta, madje u njoh shpejt, ndërsa konflikti u intensifikua në Kroaci (Poirier, 1998: 55-56), ndërsa Kosova nuk kishte arritur të siguronte njohjen e ndryshimeve të saj kushtetuese, prandaj ndërmarrja e hapave që çonin drejt shpalljes së pavarësisë u panë si mjetet e vetme të mbetura. “Duke e ndier se autonomia brenda Jugosllavisë nuk ishte më një opsion i zbatueshëm, shqiptarët etnikë mbajtën një referendum për pavarësinë e Kosovës në shtator” (Woehrel, 1999: 5).

Duke e parë se Sllovenia ishte pavarësuar dhe se pozita politike e paraqitur në ndryshimet kushtetuese për Kosovën nuk dhanë efektin e pritur e të dëshiruar, ishte parë e udhës të organizohej një referendum përmes të cilit do të shprehej vullneti i qytetarëve të Kosovës për shtetin e tyre. Rezultati i tij prej 87.1% në favor të shtetit të pavarur dhe sovran, ishte treguesi i qartë i shprehjes së vullnetit politik në mënyrën demokratike e edhe të ripërsëritur disa herë.

Referendumi përcaktoi kursin që duhej ta ndiqte Kosova, pasi nga ky moment, qëllimi i përbashkët i lëvizjes shqiptare – i pohuar nga “vullneti popullor” – u bë pavarësia. Pesë ditë pas referendumit, Shqipëria njohu pavarësinë e Kosovës. Dhjetë ditë më vonë Republika e Kosovës i kërkoi BE-së njohjen (Dusan et al., 2012: 286).

Rezultati i Referendumit dhe shpallja e pavarësisë një muaj më vonë, nuk dha efekte politike, intensiteti i dhunës u rrit, ndërsa luftimet filluan të shpërndahen edhe në Bosnjë e Hercegovinë, e cila pak muaj më vonë kishte shpallur shtetin e pavarur. Shteti i shpallur, por i panjohur i Kosovës, orvatej të dilte pa pasoja nga kontrolli i Beogradit, ndërsa serbët lokalë në Bosnjë e Kroaci, iu ishin bashkuar armatës jugosllave, duke i zgjeruar territoret e kontrolluara prej tyre.

Ky fakt, vuri përballë dy elemente kryesore, të cilat edhe sot e kësaj dite e përcjellin bashkësinë ndërkombëtare përgjatë tridhjetë viteve të fundit në raport me njohjet e shteteve të dala nga shpërbërja e Jugosllavisë.

“Gjermania dhe Austria mbështetën përpjekjet e republikave të Sllovenisë dhe Kroacisë për t’u bërë të pavarura, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe qeveritë në Londër, Paris dhe Uashington dëshironin të shihnin ruajtjen e unitetit të Jugosllavisë” (Calic, 2019: 299).

Pozicionimet e tilla politike, duhet të shihen në prizma të ndryshme, por ajo që vërehet është fakti se ka munguar një standard i së drejtës ndërkombëtare, ndërsa parimet e sovranitetit dhe të vetëvendosjes, po ballafaqoheshin mes tyre. Në anën tjetër, pozicionimet pro dhe kundër njohjeve të pavarësive të republikave ish-jugosllave, dëshmojnë për njohjen si veprim gjeostrategjik, ndërsa shtetet që nuk i njihnin së paku në fillim republikat e reja, kishin parasysh aleancat e vjetra e reagimet potenciale të vendeve të tjera, pra përmes mos njohjes ka penguar njohjet e shteteve të reja. Prandaj është e nevojshme të identifikohen qëndrimet e shteteve evropiane në raport me procesin e krijimit dhe njohjes së shteteve që kanë dalë nga Jugosllavia.

Franca: historikisht është perceptuar si shtet partner me Jugosllavinë, ndërsa raportet me të janë konsideruar edhe si forma e kontrollimit të dominimit anglez në Ballkan, por gjatë rrjedhave politike të shekullit të kaluar, Franca e sidomos De Goli, nuk e kanë konsideruar të rangut të tyre shtetin jugosllav, ndërsa tek në vitet e 80-ta, të atij shekulli, diplomacia franceze

u mor intensivisht me të, pasi për Francën, destabiliteti në Jugosllavi, do të mund të përsëriste atë që kishte ndodhur në vitin 1914, me fillimin e Luftës së Parë Botërore, prandaj një Jugosllavi e bashkuar mund të menaxhojë më mirë edhe në planin e krijimit të Komunitetet Evropian (tash BE), sesa menaxhimi i gjashtë grupeve të ndryshme etnike (Jones, 2015: 335-340).

Ngjarjet që rrodhën në atë periudhë, si rënia e Bashkimit Sovjetik, por edhe rënia e Murit të Berlinit, e gjetën Francën para dilemave themelore në ripozicionimin e saj, pasi Bashkimi i Gjermanisë do ta ndryshonte raportin e forcave në Evropë, *ndërsa nuk mund të shfrytëzonte më bipolaritetin që kishte krijuar kaq shumë hapësirë për një politikë të pavarur midis Shteteve të Bashkuara dhe BRSS-së*, kështu që ky moment do të përcaktonte kursin e politikës së jashtme franceze (Macleod, 1997: 243-264).

Pra, Franca manovronte lirshëm midis dy superfuqive, duke provuar ta maksimizonte pavarësinë kombëtare, aktivizimin dhe 'madhështinë', dhe të kishte një rol udhëheqës në Komunitetin Evropian, ndërsa duke i aplikuar këto veprime, të kishte një sferë ndikimi jashtë Evropës, thotë studiuesja Pia Christina Wood, e cila shton se pozicionimi i saj ndaj problematikës jugosllave gjeti atë të përballej mes pavarësisë nga ndikimi amerikan dhe nevojës për përfshirje reale në procesin politik, i cili prirej nga SHBA-ja, duke e lënë shtetin francez pa shumë opsione, ndërsa në fund, ajo mbeti vetëm vëzhguese e rrjedhave politike (Wood, 1994: 129).

Vërehet qartë se qëndrimi i Francës ishte i paorientuar, ajo nuk kishte përgjigje për zhvillimet e reja politike, madje ajo e kundërshtoi njohjen e tyre, së bashku me Spanjën dhe Greqinë (Hill, Ch., Smith, K. E. 2002: 374). Franca nuk kishte ndonjë interes të qartë në Jugosllavi, por donte ta përdorte atë si instrument.

Franca duke e parë pozitën e saj të ngushtuar tashmë me bashkimin e Gjermanisë e cila arriti që shpejt të merrte primatin në komunitetin evropian, synonte që përmes një bashkërendimi politik në Evropë, të shmangte mbivendosjen amerikane e cila shihej në sfond, pasi ajo së fundi ishte angazhuar në Krizën e Gjirit, ndërsa studiuesi Grbin, lidhur me qëndrimin francez ndaj krizës jugosllave, thekson:

“Franca në veçanti, u përpoq të promovonte rolin e institucioneve evropiane si Bashkimi Evropian Perëndimor në zgjidhjen e krizës, si pjesë e një përpjekjeje

të përgjithshme për të krijuar një politikë të qëndrueshme evropiane të jashtme dhe të sigurisë, të pavarur nga Shtetet e Bashkuara” (Grbin, 2004: 2).

Gjermania: sapo e dalë e bashkuar nga një proces i gjatë historik, nuk kishte se si të vepronte ndryshe, por duke qenë përkrahëse e parimit të vetëvendosjes. Bashkimi i Gjermanisë i kishte prishur balancat e Evropës, ndërsa ajo kishte nevojë të imponohej në proceset politike edhe për të dëshmuar se “rendi i ri evropian” ka marrë trajtë tjetër. Beteja e parë e madhe për Gjermaninë në arenën politike ndërkombëtare ishte Jugosllavia, problem i cili nuk zgjidhej vetëm me mjete politike, ose “evropiane” siç njihen ndryshe, prandaj studiuesi Marten H. A. van Heuven, konsideron:

“Megjithatë, qasja gjermane përmbante një dobësi thelbësore, në atë që vendi nuk ishte gati të përdorte forcën për të mbështetur politikën e tij” (Van Heuven, 1993: 52).

Gjermania nuk mund të përdorte armët në Jugosllavi, pasi gjërat do të kishin konotacione të jashtëzakonshme, në lidhje me pretendimet e saj reale tash si e bashkuar, ajo do të tregonte hegjemoni në vendin ku pikërisht konflikti me të kishte nisur një luftë botërore, prandaj studiuesit si britaniku Timothy Garton Ash, konsideron se veprimi i Gjermanisë nuk duhet të shihet si një raport lidhjeje të moçme mes kroatëve e Hitlerit, por pikërisht e kundërta, duke thënë:

“Serbia e Millosheviqit u ishte paraqitur si Gjermania e re naziste dhe këtë herë ata (gjermanët) donin të ishin në anën e duhur” (Garton Ash, 1993: 396).

Pozicioni i Gjermanisë ishte tepër i ndjeshëm, opinion publik dhe partitë opozitare atje, duke kujtuar kontestin historik të vendit, kërkonin me çdo kusht që qeveria federale të ndiqte një kurs politik të tillë që i mbante të balancuara idealet e reja gjermane, por edhe peshën e saj në raport me investimet që kishte bërë për kaq vite si pjesë e BE-së, kështu profesor amerikan Michael Smith konstaton:

“Gjermania duhet të ecë në një vijë të hollë midis mbrojtjes aktive të interesave kombëtarë që rrjedhin nga pozicioni i saj strategjik në qendër të Evropës dhe përshtatjes së shqetësimeve të anëtarëve të tjerë të BE-së” (Smith, 1995: 2).

Ka diçka të përbashkët mes Gjermanisë edhe Francës në lidhje me qëndrimin e tyre në raport me njohjen e shteteve që dalin nga Jugosllavia, të dyja e përdorën atë si një vegël, francezët për t'u dukur si faktor evropian i pakapërcyeshëm që rregullon dinamikën e proceseve, ndërsa Gjermania për t'u dukur superfuqi evropiane (Schloer, 1996: 16), për çka edhe e arriti.

Përmes njohjes, Gjermania e përshpejtoi procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, thotë studiuesi Beverly Crawford (1996: 482). Gjermanët po festonin për kombin e tyre të bashkuar, ndërsa po në atë kohë serbët kishin si kurrë më parë nevojë për një shtet ku të gjithë serbët do të jetonin në të, që praktikisht do të nënkuptonte zgjerimin territorial të Serbisë. Studiuesja Marie-Janine Calic, e sheh problemin e Serbisë pikërisht mbi elementin e bashkimit kombëtar duke thënë:

“Në Serbi, një konsensus u zhvillua në të gjitha palët: objektivi për t'u mbrojtur mbi të gjithë të tjerët në këtë situatë historike ishte uniteti kombëtar i popullit serb” (Calic, 2019: 291).

Gjermania dukshëm ishte shteti kryesor që i priu fillimit të njohjeve të shteteve që po dilnin nga shpërbërja e Jugosllavisë. Pavarësisht se institucionet evropiane për kohën orvateshin të gjenin një zgjidhje kompromisi, që më shumë tingëllon si pajtim që si palë të veprojnë të sinkronizuara, se sa interesa të ndryshme. Kancelari gjerman, Kohl, kishte vendosur që njohja gjermane të bëhej edhe pa mbështetjen e KE-së, ndërsa kishte arritur të fitonte përkrahjen edhe të Italisë, Belgjikës, Danimarkës dhe ndoshta Holandës, kundër akoma ishin Franca e Britania, e kjo e fundit, iu bind shpejt qëndrimit gjerman në kompensim për projektin e Mاستrihtit, duke e lënë Francën të fundit që iu bashkohet shteteve që i njihnin shtetet e dala nga procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë (Smith, 1995: 13).

Këto ndryshime të theksuara në qëndrimet mes shteteve kryesore vendimmarrëse në Evropë, tregonte se nuk pritej një qëndrim i unifikuar politik e diplomatik, e mos të pritet edhe një ushtarak në një vatër krize si ajo e Jugosllavisë. KE, nuk arriti të tregohet e suksesshme, thotë studiuesi Davide Anderson, duke shtuar:

“KE-së i mungonin instrumentet e duhura për menaxhimin e krizës dhe me përpjekjet e saj diplomatike dhe paqeruajtëse që rezultuan të pasuksesshme,

KE filloi të dorëzonte mbi detyrat e saj ndaj OKB-së në muajt e fundit të vitit 1991” (Anderson, 1995: 20).

Britania e Madhe: po ashtu ishte nga shtetet të cilat ishte shumë e përfshirë në procesin e krijimit dhe njohjes së shteteve që dilnin nga shpërbërja e Jugosllavisë. Pozicioni i saj politik ishte i atillë që favorizohej nga disa elemente, të tilla si, rënia e Bashkimit Sovjetik, rrjedhimit, devaluimi i saj i përkohshëm në raport me nevojën amerikane, prandaj bashkëpunimi i saj rajonal me shtetet evropiane do ta mbanin atë në nivelin e kërkuar, atë të fuqisë.

Sigurisht disa gjëra kishin ndryshuar, armët bërthamore, nuk bënë më punë, ndërsa pikërisht duke u nisur nga fakti se Gjermania ishte forcuar ndjeshëm përmes bashkimit, ajo kishte vendosur ta ndiqte një qasje tjetër duke e parë krijimin e shteteve të reja nga Jugosllavia, si diçka që nuk duhet të ndodhë, për aq kohë sa të gjitha nga to mbajnë përgjegjësi për konfliktin që sapo kishin nisur, madje politikanë e perceptuan ngjarjen si diçka të zakonshme në mesin e fiseve ballkanike, një term që kishte kuptimin e grupeve të caktuara të këqija po aq sa njëri-tjetri, ndërsa si veprim më shumë shihej si përpjekje për të mos u përfshirë në një konflikt kaq të kushtueshëm ekonomik e politik, thotë studiuesi Dejan Marolov (2012), i cili vijon duke argumentuar qëndrimet që ka mbajtur Britania e Madhe e Franca në lidhje me njohjen e shteteve të reja.


“Politika e jashtme franceze ndaj Jugosllavisë ishte shumë më afër politikës së Britanisë së Madhe sesa politikës gjermane. Kështu Franca në një farë mënyre ende e shihte Serbinë si aleatë të saj nga Ballkani dhe për këtë arsye kundërshtonte çdo pozicion me të cilin ata ishin të vetmit përgjegjës për luftën. Ngjashëm si Britania e Madhe Franca gjithashtu zgjodhi të kishte një pikëpamje pasive me të cilën Perëndimi nuk duhet të ndërhynte shumë në Jugosllavi. Kjo do të nënkuptonte një fitore të shpejtë të forcave serbe ndaj pjesës tjetër të Jugosllavisë. Franca nuk e shikonte favorizuese ndaj krijimit të një Kroacie dhe Slloveni të pavarur” (Marolov, 2012: 2).

Komuniteti Evropian, fillimisht nuk e kishte mbështetur krijimin e shteteve të reja, madje deklaruan se kanë gatishmërinë për stimuj ekonomikë të mëdhenj për Jugosllavinë, nëse ajo nuk shpërbëhet, por kjo ishte e vonë, Sllovenia kishte organizuar referendumin, duke

i shtyrë forcat jugosllave për një sulm të shpejtë ndaj tyre, çka e ngriti Gjermaninë, por edhe disa shtete ta ndërronin qasjen e tyre ndaj vendimit paraprak të ndërmarrë në KE, kështu Gjermania paralajmëroi të bënte njohjen e shteteve të reja, ndërsa u rishfaq partneriteti i heshtur franko-britanik i cili orvatej ta përcaktonte politikën e BE-së ndërsa i përdorte shembujt e ngjashëm të Spanjës, Greqisë, për të siguruar përkrahjen, sikundër edhe të Holandës, për ta lënë si të vetëm shtetin gjerman, Gjermania, Danimarka, e Irlanda, ishin në krahun tjetër (Marolov, 2012: 2-3).

Sido që të jetë, vlimi i Jugosllavisë kishte përmasa shumë të gjera, nisi me Slloveninë e Kroacinë të cilat u ndanë në vitin 1991, ndërsa Sllovenia u pranua si shtet në mungesë të kauzës politike për ta përligjur luftën, ndërsa fokusi ra mbi Kroacinë, e cila veçse kishte një ngritje të konfliktit në mes serbëve lokalë dhe kroatëve, ndërsa ndërhyrja e Armatës Jugosllave, dukshëm favorizonte serbët. Shembulli i tyre (sllovenëve dhe kroatëve), u ndjek nga Kosova, e cila kishte organizuar referendumin për pavarësinë e Kosovës, ndërsa në prill të vitit 1992, Bosnja mbajti referendumin përmes të cilit, shpalli shtetin e pavarur që u njoh nga SHBA-ja dhe Komuniteti Evropian (Woehrel, 1999: 5).

Studiuesja Enika Abazi e cila flet për çështjen e Kosovës dhe ndikimin e saj në diplomacinë ndërkombëtare, procesin e krijimit të shtetit të Kosovës dhe sfidën e arritjes së njohjes së saj e paraqet të lidhur me tri momente kryesore, si:



Transformimi i procesit të krijimit të shtetit të Kosovës - Perspektiva historike
 Figura 2. Zhvillimet politike në Jugosllavi sipas perspektivës kosovare

Konferenca mbi Jugosllavinë dhe Komisioni Badinter, i cili negocioi shpërbërjen e Jugosllavisë:

- Marrëveshja në Dayton që i dha fund luftës së Bosnjës;
- Bisedimet në Rambouillet midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës me ndërmjetësinë e diplomacisë ndërkombëtare për gjetjen e një zgjidhjeje për statusin e Kosovës (Abazi, 2012: 187-188);
- Kosova ka qenë e ndikuar në njërën ose formën tjetër nga këto ngjarje politike me rëndësi në krijimin e rregullave mbi të cilat i është dhënë kah procesit të shpërbërjes dhe krijimit të shteteve të reja, por edhe të njohjes së tyre. Sido që të jetë edhe ky element ka mundësi të skematizohet, ndërsa segmenti i shpërbërjes së Jugosllavisë do të mund të paraqitet.

Kjo paraqet një risi në analizë, pasi problematika e Kosovës nuk mund të shpjegohet mjaftueshëm vetëm nga një perspektivë, por nga një shumësi rrethanash, të cilat siç dëshmojnë, prekin disa ndryshore në analizë, si sistemin politik, dallimet strukturore, dallimet historike, dhunën sistematike, duke e bërë më komplekse për të trajtuar problemin e Kosovës.

I.2. Konferenca për Jugosllavinë - Komisioni Badinter – Vetëvendosja e mohuar për Kosovën

Shtetet evropiane duke mos pasur mundësi tjetër për t'iu qasur problemit, kishin thirrur një Konferencë Ndërkombëtare për Paqen në Jugosllavi synimi i së cilës ishte gjetja e një zgjidhjeje të përhershme dhe paqësore për krizën brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Craven, 1996: 333), konferencë e cila kishte autoritet për të negociuar zgjidhjet e mundshme në kuadrin e shpërbërjes së saj (Abazi, 2012: 192).

Mes dilemave të shumta në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së problemit jugosllav, mes qëndrimeve të ndryshme në lidhje me ecurinë e proceseve vijuese dhe ndikimeve nga jashtë, paraqiten dilema se si të operohej me tej me procesin, ndërsa dilema e parë ishte se *kishim të bënim me shpërbërje dhe jo shkëputje të një territori të caktuar*.

Komisioni i Badinterit, kishte para vetes disa obligime të cilat duhej t'i plotësonte për të sqaruar aktet përmes së cilave po shpërbëhej Jugosllavia, prandaj *Komisioni konsideron se ajo duhet të përcaktojë parimet e së drejtës ndërkombëtare publike, të cilat shërbejnë për të përcaktuar kushtet në të cilat një entitet përbën një shtet; se në këtë drejtim, ekzistenca ose*

zhdukja e shtetit është çështje faktike; se efektet e njohjes nga shtetet e tjera janë thjesht deklarative (Komisioni i Badinterit, Pika 1, a).

Kjo pikë paraqet dy elemente me rendësi, se krijimi i shtetit është çështje fakti, por fryma e saj ka më shumë karakter të efektshmërisë, ndërsa opinioni vijohet me argumentimin se shteti është ushtrues i sovranitetit (Komisioni i Badinterit, Pika 1, b).

Komiteti Evropian kishte precizuar kushtet që shtetet e krijuara duhet t'i plotësojnë për t'u njohur si të tilla, ndërsa Akti Final i Helsinkit dhe i Kartës së Parisit ishin dokumentet bazë, ndërkaq Komisioni i Arbitrazhit të Badinterit, përmes vendimit të tij, të bazuar në dy dokumentet e nxjerra nga Konferenca e Hagës, si Deklarata dhe Udhëzuesi për Njohjen Ndërkombëtare, *e kufizuan parimin e vetëvendosjes duke vendosur rregulla që favorizonin vetëm Republikat si shtete pasuese të Jugosllavisë, duke lënë jashtë këtij diskutimi problemin e kombësive dhe grupeve të veçanta etnike* (Abazi, 2012: 193).

Kësisoj Komisioni i Badinterit, nuk kishte pjesë të trajtimit ato territore që konsideroheshin si entitete politike, por jo republika, ndërsa lidhur me këtë Serbia veçse kishte bërë shtrimin e çështjes në këtë komision duke pyetur se *"A është popullsia serbe në Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë, si një nga popujt përbërës të Jugosllavisë, a ka të drejtën e vetëvendosjes?"* (Shih Komisioni i Badinterit, opinion nr. 2). Komisioni duke u bazuar në një numër dokumentesh e qëndrimesh të tubuara me parë, konsideron se, *pavarësisht nga rrethanat, e drejta për vetëvendosje nuk duhet të përfshijë ndryshime në kufijtë ekzistues në kohën e pavarësisë (uti possidetis juris), përveç rasteve kur shtetet në fjalë bien dakord ndryshe.*

Nëse ndarja e republikave nga RSFJ ishte e lejueshme për shkak se Federata po shpërbëhej, mbi çfarë baza ligjore mund të kundërshtohet ligjërisht shkëputja e mëtejshme nga ato republika? Pse vetëvendosja e një njësie ishte më e shenjtë se ajo e nën njësie tjetër?, janë disa nga pyetjet fundamentale që janë ngritur nga studiuesi Michla Pomerance, i cili verifikon bazën e ligjshmërisë së mohimit të së drejtës së Kosovës për shkëputje, duke shtuar mohimi i vetëvendosjes për nën njësitë nuk ishte vërtet i qëndrueshëm në baza ligjore, as domosdoshmërisht, as në baza praktike, prandaj ai vë në dukje se vendosja e parimit të uti possidetis vlen për ndarjet e brendshme administrative, ndërsa kritikon faktin se vendimmarrësit nuk duhet të vizatojnë vija të brendshme, duke pasur parasysh mundësinë e shkëputjeve të tjera (Pomerance, 1998: 56). Dhe nëse arsyetimi pas këmbënguljes për zbatimin universal të *uti possidetis* ishte besimi se në këtë mënyrë do të shmangej kaosi dhe

fragmentimi më i madh, ky supozim do të dukej se ishte hedhur poshtë nga evolucioni i konfliktit në Jugosllavi, këmbëngul Pomerance.

“Zbatimi i ngurtë i parimit uti possidetis në kufijtë midis republikave ekzistuese thjesht mund të ketë hapur rrugën drejt konflikteve dhe zjarreve më të mëdha dhe më intensive. Stabiliteti në rreze të gjatë mund të ketë qenë shkak i një shtrirjeje të gabuar të një parimi që në fillim ishte me vlefshmëri ligjore të dyshimtë” (Pomerance, 1998: 57).

Qëndrim të ngjashëm ka edhe studiuesi Novitet Nezaj, ndërsa për rastin e Kosovës, bazuar në vendimin e komisionit thotë se kërkesa e Kosovës për njohje nuk u pranua as nga Komisioni i Arbitrazhit të Badinterit. Mbeti e paqartë nëse Kosova kishte apo jo të drejtë për pavarësi” (Nezaj, 2015: 4).

Në një studim tjetër të realizuar nga Instituti KIPRED, në vitin 2007, kur elaborohet problematika e mosnjohjes së Kosovës nga Komisioni i Badinterit, shprehimisht thuhet se shpeshherë është konstatuar se Komisioni i Badinterit nuk u ka njohur krahinave të drejtën në pavarësi. Duke mos pasur shprehimisht detyrën për të gjykuar se a kanë të drejtë në ndarje krahinat, Robert Badinter thekson se nuk ka pasur mundësi që të vendosë për një gjë të tillë. Si rezultat, nuk mund të nxirret përfundimi se Kosova shprehimisht është lënë brenda Serbisë. *Gjatë kësaj kohe Kosova ishte nën pushtim të paligjshëm dhe nuk përfaqësohej nga një udhëheqësi legjitime.* Në këtë drejtim, nuk mund të kishte kërkesë zyrtare që t’i jetë dorëzuar Badinterit në emër të Kosovës. Duke qenë faktikisht nën pushtim, nuk mund të merrej asfare pëlqimi i Kosovës për të ardhmen e vet. Përfundimisht, duhet dhënë interpretimin se më 1991 nuk është marrë vendim për Kosovën dhe se vendimi që atëbotë është marrë për njësitë e tjera mbetet i hapur për Kosovën sot e kësaj dite” (KIPRED, 2007).

Komuniteti Ndërkombëtar nuk e kishte fokusin te Kosova, ndërsa Komisioni i Badinterit në opinionin e tij të parë (29 nëntor 1991) ku konstaton se Jugosllavia është në proces të shpërbërjes, ashtu edhe në opinionin e fundit (prill 1992), ku konstaton se Jugosllavia nuk ekziston më, nuk e përmend Kosovën, pavarësisht, se Kosova kishte lobuar në disa vende ku e kishte diasporën më të organizuar. Ishte bashkësia ndërkombëtare dhe shtetet kryesore pjesëmarrëse në proces, ato që refuzuan mbështetjen për njohjen e Kosovës, ndërsa statusi i saj do të ishte një autonomi e zgjeruar. Edhe qeveria e Kosovës e formuar pas

Kuvendit të Kaçanikut, kishte kërkuar njohjen, si e drejtë e vetëvendosjes, por u refuzua kategorikisht (Dusan et al., 2012: 287).

Kjo pjesë e përmbyll fazën e parë të procesit historik të krijimit të shtetit të Kosovës, duke konstatuar se vendi *nuk kishte arritur të fitonte njohjen*, pavarësisht se kishte organizuar një mori veprimesh politike e kushtetuese, Komisioni i Arbitrazhit të Badinterit, *nuk parashihte të drejtën për shkëputje për Kosovë, ose së paku nuk ka pasur mundësi që të vendosë për një gjë të tillë*.

“Çështja e Kosovës mbeti nën kujdestarinë e Republikës së Serbisë, e cila duhej të kujdesej për interesat e shtetit dhe të sigurisë të të gjithë shtetasve të saj, në pajtim me detyrimet ndërkombëtare të respektimit të të drejtave të njeriut dhe pakicave kombëtare. Një zgjidhje e tillë i mohoi Kosovës të drejtën e vetëvendosjes” (Abazi, 2012: 195).

Problematika e Kosovës lidhur me sigurimin e njohjes së saj, mund të konstatohet se është varur nga një numër i madh faktorësh, si qëndrimet e shteteve dhe në veçanti të BE-së lidhur me shpërbërjen e Jugosllavisë në fillim, e pastaj edhe me modalitet se si të njihen dhe çfarë kriteresh duhen aplikuar në procesin e njohjeve. Kosova nuk paraqiste një shqetësim urgjent për faktorët e përfshirë në proces, fokusi ndaj saj nuk ishte asnjëherë i madh, përveç disa lëvdatave të kohëpaskohshme për rezistencën e saj pasive të udhëhequr nga Rugova, në kohën e trazimeve të mëdha që po ndodhnin në Jugosllavi.

“Rugova i kishte bërë thirrje BE-së për njohjen e pavarësisë në dhjetor të vitit 1991 kur BE-ja po diskutonte çështjen e njohjes së Sllovenisë dhe Kroacisë. Komisioni i Badinterit, i cili raportoi në fillim të vitit 1992, propozoi që republikat e Jugosllavisë duhet të kenë të drejtën për t'u bërë të pavarura me kusht që të përmbushen disa parakushte” (Oxford University Press, 2000: 56).

Vlen të theksohet fakti se procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë kishte vënë në pah një mori ngjarjesh për analizë e trajtim, si pozicionet politike të shteteve të fuqishme, si Franca, Gjermania, Britania e Madhe, të cilat e shihnin procesin si pjesë ku ato mund t'i rritin ndikimin politik, ose fuqinë politike të tyre në proceset politike vendimmarrëse, ndryshe nga kjo, fakti

i shpërbërjes së Jugosllavisë ishte edhe reflektim i proceseve politike ndërkombëtare si rënia e Murit të Berlinit dhe Bashkimit Sovjetik.

Pavarësisht shkallës së brutalitetet dhe dhunës që kishte ndodhur në Jugosllavi gjatë procesit të zbërjes së saj, e njëjta kishte ndodhur edhe në Kosovë, ndërsa shkollari Janez Drnovsek, e cilëson atë si diçka që ka mundur të shmanget (2000: 56-73), sidomos pas asaj që kishte ndodhur paraprakisht në republikat ish-jugosllave, edhe pse i gjithë procesi kishte filluar pikërisht aty, pra me Kosovën.

1.3. Mes ndërkombëtarizimit dhe njohjes së Kosovës - Marrëveshja e Dajtonit

Pamundësia e Kosovës për të krijuar ndryshime në pozitën e saj politike përmes komisionit të Badinterit, nuk e ndali atë në përpjekjen për krijimin e shtetësisë dhe betejën për njohje. Kosova gradualisht kishte hyrë në një fazë e cila para se të fitonte njohjen, bota duhet ta njihte problemin e Kosovës, duke qenë se si rast më shumë u pa si një problem i brendshëm. Kësisoj, Kosova potencialisht do të duhet të fillonte një fushatë lobuese në kancelaritë perëndimore në kërkim të përkrahjes së çështjes së saj. Kjo paraqet edhe fillimin e procesit të ndërkombëtarizimit të problematikës së Kosovës, ndërsa kjo temë filloi të hapej në disa nivele, si individuale të vendimmarrësit e institucioneve me rëndësi, por edhe në protesta e demonstrata. *Kosova si problem kishte filluar të njihej.*

Në Kosovë, institucionet e kohës, kishin zgjedhur një strategji politike e cila e shmangte konfliktin, ndërsa padëgjueshmëria politike shfaqej përmes mirëmbajtjes së Republikës së Kosovës, përmes një sistemi paralel. Politologu Alfred Merlaku, e cilëson se këtë qasje që aplikonte Kosova *si një lëvizje paqësore të rezistencës duke krijuar një sistem paralel të organizimit institucional* (2012: 86), kurse historiania Carole Rogel, e cila kur flet për Kosovën potencon faktin se *aty (në Kosovë) filloi gjithçka*, në lidhje me shpërbërjen e Jugosllavisë, por për ironi, Kosova nuk u nda nga ish – shteti jugosllav, ndërsa sipas saj:

“Ironikisht, kur Jugosllavia filloi të shpërbëhej në vitin 1991, dhe pasi ishte luftë për katër vite, Kosova mbeti relativisht e qetë. Vetëm pas paqes së Dejtonit, në fund të vitit 1995, shqiptarët e Kosovës zgjodhën një politikë militante” (Rogel, 2003: 167).

Ndryshe nga shumë studiues të cilët flasin për mundësitë e zgjidhjes së problemit të Kosovës para dhe gjatë Konferencës së Dejtonit, Petar Russell konsideron se problematika e Kosovës ishte e njohur për qarqet vendimmarrëse, por si e tillë, duke mos pasur vlim të saj, ajo disi mbeti anash, ndërsa fokusi iu dha luftërave në vendet si Kroacia dhe Bosnja.

“Problemet në Kosovë ishin të njohura dhe të kahershme, pavarësisht eklipsit të tyre nga lufta e hapur në Kroaci dhe Bosnjë” (Russell, 2009: 487).

Ka dy alternativa, e para se Kosova ka dashur që për shkak të gjendjes së saj ekonomike, sociale e politike të mos bëjë veprime të tilla ushtarake, ndërsa të presë ndikimin që do të ketë shpërbërja e Jugosllavisë, duke provuar të krijohet një zgjidhje e atillë që do të mund të impononte Diplomacia Parandaluese. Ndërsa e dyta, që Kosova duke hyrë në luftë, do të mund të zgjidhte problemin e saj që në Konferencën e Dejtonit.

Studiuesi Christopher Greenwood, konstaton se edhe pas pavarësimit të ish-republikave jugosllave, Kosova kishte mbetur akoma e qetë, edhe pse ishte paralajmëruar, siç thotë ai, *përdorimi i tepruar i forcës në Kosovë gjatë kësaj periudhe dhe përpjekjet e OSBE-së për të mbajtur një prani atje, ndërsa statusi i Kosovës si pjesë e Serbisë (dhe rrjedhimisht e RFJ-së) nuk u vu në dyshim nga bota e jashtme* (2002: 146).

Serbia nuk ishte e interesuar që problemi i Kosovës të vihej në pah edhe pse e kishte të qartë se kosovarët kishin krijuar një sistem paralel të disa agjencive shtetërore. Studiuesi Zlatko Isakovic (1999), thekson faktin se *leadershipi politik i Serbisë kishte interesime që të krijonte një status quo në Kosovë, duke e përjashtuar atë nga çdo mundësi eventuale për kryengritje, ndërsa përmes kësaj forme, do të mund të ruante kontrollin në gjithë territorin, duke i aplikuar disa mekanizma shtetërorë, si centralizimi shtetëror, presione politike dhe propagandistike dhe shtypje të politikave divergjente*. Kjo paraqet një përputhje metodash për arritjen e qëllimit të ndryshëm, pra kosovarët donin (së paku për momentin), shmangie të konfliktit, sikundër edhe serbët, deri në një situatë kur gjërat marrin një epilog tjetër.

Kosova kishte pritshmëri se njohja e saj si shtet do të vinte si produkt i një marrëveshjeje ndërkombëtare, sidomos pas asaj që po ndodhte në Bosnje e Hercegovinë, thotë studiuesja Nathalie Duclos, e cila vë në dukje faktin se Kosova synonte pavarësinë përmes strategjisë së mosdhunës dhe si pjesë e zgjidhjes së një konflikti edhe më të madh.

“Gjatë këtyre viteve, ekzistonte mundësia që çështja e Kosovës të zgjidhej si pjesë e një marrëveshjeje për t'i dhënë fund konfliktit në Bosnjë, dhe kjo ndihmoi në legjitimimin e një strategjie të mosdhunës, e cila bazohej në shpresën se bashkësia ndërkombëtare do të ndërhynte” (Duclos, 2020: 23).

Rezistenca civile në Kosovë kishte krijuar një qëndrim pozitiv ose siç e quan Thorsten Gromes (2019: 4), *një admirim të madh*, por e cila nuk ishte përcjellë me përkrahje të theksuar ndërkombëtare, e cila do të vërehej në fazën në vazhdim. Sido që të jetë, kjo gjendje në Kosovë kishte krijuar jo pak ndikim pozitiv te masat e gjera, të cilat kishin përcjellë ndjesinë e organizimit kolektiv, thonë studiuesit.

“Rezistenca jo e dhunshme e Kosovës unifikoi me sukses masat kundër regjimit me një risi të veçantë të ndërtimit të solidaritetit duke reduktuar dhunën. Në veçanti, ai reduktoi vrasjet në gjakmarrje” (Marsavelski, 2018: 218–236).

Tema kryesore që Kosova kishte para vetës, ishte ndërkombëtarizmi i çështjes së saj, e cila për studiuesin e njohur Howard Clark (2013: 288-291), ishte arritur suksesshëm nga shqiptarët e Kosovës, pasi ata kishin shënuar disa rezultate, sidomos në lidhje me organizimin e diasporës, për të ndikuar te vendimmarrësit, ndërsa potencohet fakti se Adem Demaçi, një disident i njohur shqiptar i Kosovës, i burgosur politik për gati 30 vite kishte marrë çmimin Saharov për Paqe.

“Nga viti 1990 deri në vitin 1999, qeveritë perëndimore ishin të vendosura se Kosova nuk do të fitonte më shumë se një autonomi të zgjeruar brenda Serbisë... Në nëntor 1995, Marrëveshja e Dejtonit i dha fund luftës në Bosnje, duke shënuar gjithashtu fillimin e fundit të monopolit të Rugovës mbi lidershipin politik në Kosovë” (Clark, 2013: 288-289).

Kosova nuk arriti të merrte pjesë në Konferencën e Dejtonit, ndërsa ndikimi i saj nga studiuesit shihet si i shumëfishtë, lidhur me zgjidhjen e çështjes së Kosovës, por sidoqoftë, duhet të shihet si epilogu i pritshëm i një procesi i cili kishte dhënë disa efekte, kishte krijuar kohezion social, kishte filluar ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, ndërsa edhe dështimi duhet të shihet si mundësi që Kosova atë energji që e kishte akumuluar ta kthente në një rezistencë civile aktive përmes studentëve të UP-së, të cilët i prinë ndryshimit gradual të formës se si Kosova po i qasej problemit të saj politik.

Por të gjitha këto veprime nuk krijuan asnjë peshë në arenën ndërkombëtare, ndërsa studiuesit e lidhin me faktin se kjo më shumë është produkt i një perceptimi që kishte krijuar bashkësia ndërkombëtare në raport me pozitën e Kosovës, ajo për ta nuk paraqiste një urgjencë, as sa i takon statusit, por as sa i takon situatës. Dhuna në Kosovë nuk ishte në nivele të tilla që mund të krahasohej me Bosnjën, ose Kroacinë, ndërsa sistemi paralel, jepte indikacione se situata mund të menaxhohej.

I.4. Konferenca e Dejtonit, “përpyjekja e hershme” e vonuar për Kosovën

Pozita politike e Kosovës në periudhën kohore 1990-1995, është shënuar me intensifikim të dhunës së ushtruar nga aparatura shtetërore serbe, si një masë politike për kontrollim të tërësishëm të Kosovës. Fokusi ndërkombëtar i koncentruar vetëm në zgjidhjen e problemit të Bosnje Hercegovinës e la Kosovën tërësisht anash në mundësinë për të gjetur një zgjidhje politike të statusit të saj. Konferenca e Dejtonit që po i jepte fund luftës në Bonje e Hercegovinë, nuk e përfshiu edhe Kosovën, edhe pse pritshmëria ishte se ajo do të mund të merrte pjesë në të, ndërsa konstatimi fillestar është se problemi i Kosovës u mënjana shkak i luftërave në Kroaci e Bonje e Hercegovinë. Mos përfshirja e Kosovës në Dejton prodhon dy pyetje, e para: a ka pasur Kosova realisht mundësi të fitonte njohje ndërkombëtare pa luftë dhe e dyta: a ka mundur që bashkësia ndërkombëtare ta trajtonte edhe Kosovën, pikërisht duke e parë atë që po ndodhte në Kroaci e BH.

Studiuesit i kanë kushtuar vëmendje kësaj teme, pasi për ta Dejtoni është mundësi e humbur për bashkësinë ndërkombëtare, e cila do të mund të aplikonte *diplomacinë parandaluese* në rastin e Kosovës. I këtij mendimi është studiuesi Peter Russell, i cili konsideron se Kosova nuk gëzoi vëmendjen e duhur në atë periudhë, duke shtuar:

“Nëse ka pasur ndonjëherë një mundësi të humbur për të tentuar diplomacinë parandaluese për Kosovën, ishte në Dejton” (Russell, 2009: 487).

Mospjesëmarrja e Kosovës në Dejton duhet të shihet në tri rrafshe: se Kosova nuk paraqiste urgjencë për bashkësinë ndërkombëtare; se Kosova nuk kishte arritur të siguronte mbështetjen e mjaftueshme që do t’i mund t’i siguronte asaj njohje dhe e treta Kosova ishte një problem i brendshëm politik i Jugosllavisë e cila në rastin më të mirë mund të trajtohet në perspektivën e shkeljes së të drejtave të njeriut.

Marrëveshja e Dejtonit dhe mospjesëmarrja e Kosovës në të, është trajtuar mjaft shumë, madje nga këndvështrime të ndryshme, pos prej Peter Russellit, të paraqitur më lart, edhe prej studiuesve dhe shkollarëve të tjerë si: Richard Caplan, Pierre Melandri, Davide Phillips, Hürner, Enika Abazi, Tim Juda e të tjerë, të cilët i kanë kushtuar vëmendje kësaj ngjarjeje dhe të gjithë e shohin si mundësi e humbur për bashkësinë ndërkombëtare, që prodhoi shumë efekte pasuese.

Studiuesi Richard Caplan, konstaton dy pika tepër me rëndësi, ai thotë se Kosova me Dejtonin po e humbte edhe mundësinë e dytë, pasi fillimisht kishte humbur shansin në Komisionin e Arbitrazhit të Badinterit, ku ajo nuk arriti të siguronte njohjen, ndërsa në Dejton, u thelluan edhe më shumë zhgënjimet te shqiptarët e Kosovës, të cilët nuk morën përkrahjen e duhur, pavarësisht angazhimit paqësor, ndërsa komuniteti ndërkombëtar, sidomos ai evropian nuk do të mund t'i siguronte Kosovës më shumë sesa ruajtjen e të drejtave të njeriut (Caplan, 1998: 748 – 750).

Studiuesi francez Pierre Mélandri, e sheh në dy rrafshë problemin e Dejtonit, dhe sipas tij, aty pra në Dejton, nuk ishte problem vetëm Kosova, por ekzistenca e NATO-s që po i shqetësonte amerikanët, duke dëshmuar se kishte një qarje në mes shteteve në lidhje me përgjigjen që ata duhet të kenë në rast të një intervenimi, ndërsa Kosova as që përmendej, prandaj fokusi ishte te përfundimi i Luftës së Bosnjës, ndërsa në anën tjetër, negociatat po tregonin diçka, “Serbia e Madhe” e Sllobodan Millosheviqit, po binte si projekt me nënshkrimin e marrëveshjes, prandaj çfarë lëshimesh të tjera do të mund të kërkoreshin nga ai, thotë studiuesi Mélandri (Mélandri, 2000: 6).

Në një teori hipotetike të lojës, kush do të fitonte dhe kush do të humbte nëse Kosova do të merrte pjesë në Dejton ku do ta siguronte njohjen, ka katër grupe pjesëmarrësish në një “dilemë të të burgosurish”, Bosnja e Kroacia, janë në një grup, Serbia paraqet grupin e dytë, amerikanët grupin e tretë dhe Kosova grupin e katërt. Në rast se Kosova do të siguronte njohjen, kjo do të rëndonte skajshmërisht Serbinë, e cila apriori pritej të kundërshtonte çdo pjesëmarrje të Kosovës në konferencë. Bosnja e Kroacia, parimisht duhet t'i mbrojnë qëndrimet e tyre, prandaj pjesëmarrja e Kosovës do të ulte pozitën negociuese të tyre.



Figura 3. Shpërndarja etnike në Ballkanin Perëndimor, 2008. Qendra Hartografike e CIA-s/
Biblioteka e Kongresit

Ka pasur një përpjekje që të përfshihet edhe Kosova, por diplomati amerikan, Richard Holbrooke, e kuptonte se çdo përfshirje e Kosovës, do ta minonte mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje, madje ai u përpoq që ta takonte Millosheviqin me lobuesit shqiptaro-amerikanë, që kërkonin më shumë të drejta për Kosovën, refuzimi i tij ishte kategorik (Holbrooke, 2011: 234). Kishte diçka që ishte një shqetësim më i madh, kishte të bënte me gjeopolitikën dhe mundësinë që vatra e krizës të zgjerohej. Holbrooke, ishte i vetëdijshëm se përshkallëzimi i konfliktit mund të kishte pasoja të pallogaritshme dhe do të prekte pothuajse secilin shtet të Ballkanit, mozaiku ndërfaqet dhe ndëretnik i të cilit është si fuqi baroti (Mélandri, 2000: 4-5).

Serbia, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Dejtonit, arriti fillimisht të siguronte disa përparësi, ajo përligji një entitet politik kryesisht serb i "Republika Srpska", i cili do të gëzonte një shkallë të gjerë autonomie, edhe pse mbetej brenda territorit të Bosnje-Hercegovinës, ndërsa suksesi i dytë ishte përjashtimi i Kosovës nga Dejtoni, pasi ajo nuk u konsiderua si pjesë e kontestit i cili po mbyllej me këtë marrëveshje ndërkombëtare (Weller, 1999: 214-15).

Aplikimi i qasjes jo të dhunshme përmes rezistencës civile pasive, nuk dha rezultat të matshëm, madje ajo edhe u keqpërdor nga Serbia e cila e paraqiste Kosovën si vendin ku sido që të jetë, ka respektim të të drejtave. Marrëveshja e Dejtonit dhe përjashtimi i rrugës që Kosova të mund të arrinte pavarësinë, krijoi dy momente të rëndësishme, defaktorizoi

Rugovën dhe tregoi se e vetmja formë e arritjes së objektivave të shqiptarëve të Kosovës, ishte revoltimi. Revoltimi i Kosovës, si për ironi do t'i prekte dy vija të kuqe, njëren të paraqitur nga Millosheviqi, i cili thirrej në historinë, serbët e manastiret, përmes së cilës synonte të legjitimonte luftën, ndërsa në anën tjetër, është linja e kuqe e paraqitur nga Bushi I, i cili i kishte bërë me dije Serbisë se dhunimi i të drejtave të njeriut në Kosovë, do ta merrte ndëshkimin amerikan (Weller, 1999: 217).

Gjërat nuk ndryshuan shumë, së paku jo në të mirë të Kosovës, përpjekjet e saj për të fituar njohjen dhe në anën tjetër, fuqizimi i Millosheviqit, i cili u ndie i pakërcënuar së paku në periudhën e pas marrëveshjes së Dejtonit, bëri që ai të intensifikonte veprimet kundrejt shqiptarëve të Kosovës. Studiuesi Hürner, R. G. e sheh edhe veprimin e fundit që bie mbi përpjekjet e rezistencës civile pasive të Rugovës të të japin rezultat, por në të njëjtën kohë do të deklaronin fundin real të kësaj qasjeje. Sipas tij ishte marrëveshja për rihapjen e sistemit arsimor, e cila do të përdorej për të legjitimuar pozitat politike të të dy liderëve, por gjërat vijuan ndryshe:

“Me 1 shtator të vitit 1996, me bashkëpunimin diskret, por efikas të "Comunita di San Egidio" romake, u nënshkrua një marrëveshje midis Ibrahim Rugovës (në Prishtinë) dhe Slobodan Millosheviqit (në Beograd) për rihapjen e sistemit arsimor, kuptoj sipas kurrikulës shqipe dhe në gjuhën shqipe. Në mes të dhjetorit 1996, duhet thënë se kjo marrëveshje pothuajse nuk është zbatuar fare dhe se kriza politike në zhvillim në Beograd nuk do ta bëjë Millosheviqin më të pranueshëm” (Hürner, 1997: 73).

Në Kosovë po zhvillohej një betejë tjetër, beteja ishte mes historisë dhe demografisë, që të dyja shiheshin si mundësi, por edhe pengesë. Serbia synonte që përmes mitit të ruante kauzën e saj në Kosovë, Millosheviqi ishte vënë në krye të projektit të Serbisë së Madhe, ku ruhen “vëllezërit e tij serbë që ishin viktima në Kosovë”, ndërsa Kosova, duke e pasur në favor sidomos demografinë, synonte fitimin e pavarësisë përmes bashkësisë ndërkombëtare (Mélendri, 2000: 5).

Synimi serb ishte pikërisht prishja e kësaj balance të pafavorshme për ta. Masat represive, largimi nga puna, ndalja e shkollimit dhe helmimi i nxënësve në një kohë më herët, janë disa nga veprimet konkrete që Serbia kishte ndërmarrë në Kosovë. Madje, shumë

studiues konsiderojnë se ishin pikërisht veprimet politike të Rugovës, të cilat deri në një masë i mundësuan Serbisë t'i kryente të gjitha ato veprime, sidomos dhunën që u përcoll me largim masiv të shqiptarëve për në mërgim. Në anën tjetër, shumë serbë duke u larguar nga vatrat e krizës në Jugosllavi erdhën në Kosovë, edhe pse nuk qëndruan gjatë, qëllimi përmes tyre ishte i qartë, ndryshimi i demografisë së Kosovës (Dusan et al., 2012: 90).¹⁰

I.5. Intensifikimi i krimeve në Kosovë dhe “shkëputja e suksesshme përmirësuese”

Marrëveshja e Dejtonit ndonëse i dha fund luftës në Bosnje e Hercegovinë, duke mos e përfshirë Kosovën si pjesë të asaj marrëveshjeje, i dha disa indikacione të cilat edhe krijuan shumë efekte, si brenda Kosovës, ashtu edhe jashtë saj, sidomos në lidhje me intensifikimin e dhunës në Kosovë, e cila e qiti në një situatë skajshmërisht të pafavorshme rezistencën pasive civile të Kosovës, por edhe bashkësinë ndërkombëtare e cila në mënyrë sistematike e kishte neglizhuar Kosovën, ndërsa studiuesja e njohur, Miranda Vickers, përjashtimin e Kosovës nga mundësia për të marrë pjesë në Dejton, ku do të prodhonte zgjidhje politike, thotë se e dëmtoi si argument fitoren e pavarësisë përmes aplikimit të qasjes pacifiste (Vickers, 1998: 266).

Nëse shihet problematika nga një teori e lojës se kush çka fitoi, vërehet se marrëveshja mund të lexohet nga disa vështrime. E para se serbët morën gjysmën e Bosnjës dhe Hercegovinës, madje përmes një marrëveshjeje ndërkombëtare, duke iu siguruar një shkallë e lartë e të drejtave politike, çka ishte krejt e kundërta me shqiptarët e Kosovës, vë në dukje studiuesi Christopher Carson, i cili argumentimin e vijon duke treguar se si Serbia arriti të siguronte mosnjohjen e Kosovës, duke kërcënuar me mosarritjen e marrëveshjes (2013: 76), ndërsa ngutja për të arritur marrëveshje që i jepte fund luftës, e ndihmonte atë (Serbinë) në krijimin e një marrëveshjeje të çfarëdoshme që do ta minonte paqen dhe sigurinë e BeH edhe në periudhën vijuese, por e cila siç e thekson studiuesi gjerman Alexander Kleibrink, si e tillë *Marrëveshja e Dejtonit, nuk mund të ishte ndryshe, pos në radhë të parë një marrëveshje paqeje, ndërsa përfundimi i luftës dhe arritja e një kompromisi politik që ishte i pranueshëm për të gjitha palët e përfshira* (2008: 74), ishte qëllimi kryesor i saj, vijon argumentin ai.

¹⁰ Confronting the Yugoslav Controversies: A Scholars' Initiative. (2013). United States: United States Institute of Peace Press.

Serbia ka vazhduar ta përdorë “kërcënimin e paqes” në BeH, për të minuar edhe më tej pozitën politike të Kosovës dhe çdo përpjekje të saj për avancim në status politik të ri, ndërsa kjo qasje nuk është se nuk i është shpërblyer asaj, së paku në fillim.

Duke qenë se situata politike e statusit nuk u zgjodh me Dejtonin, Kosova kishte hyrë në një fazë të re të status qoa-s, pasi dështuan dy elemente, e para rezistenca civile dhe e dyta, bashkësia ndërkombëtare, e cila duke mos trajtuar rastin e Kosovës, e përlligjte veprimin politik të Millosheviqit, i cili sapo kishte marrë një kredit politik në marrëveshjen e Dejtonit, ndërsa largimi i embargos ekonomike, të vendosur paraprakisht i dha frymë edhe ekonomike vendit. Madje Shtetet e Bashkuara përmes presidentit Clinton, kishte revokuar sanksionet ekonomike ndaj Jugosllavisë, duke synuar që përmes saj të arrinte disa qëllime, si avancimin e pozitës së Kosovës dhe ruajta e gjendjes së Bosnjës.

Në një hulumtim të realizuar nga Shërbimi Kërkimor i Kongresit, specifikohen qëllimet e lehtësimeve ekonomike që po i aplikonte SHBA-ja ndaj Jugosllavisë, dhe raporti i tyre me pozitën e Kosovës, duke i dhënë mundësinë që presidenti amerikan të vendosë më tej për aplikimin ose jo të kësaj mase:

“Akti i vitit fiskal 1997 mbështet certifikimin mbi: progresin thelbësor drejt "realizimit të një identiteti të veçantë për Kosovën dhe të drejtës së popullit të Kosovës për të vetëqeverisur; ose krijimin e një protektorati ndërkombëtar për Kosovën"; përmirësime thelbësore në situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, duke përfshirë qasjen në rajon për vëzhguesit ndërkombëtarë; dhe aftësinë e qeverisë së zgjedhur të Kosovës për t'u takuar dhe zhvilluar biznes. Presidenti mund të heqë dorë nga kërkesa, megjithatë, për të përmbushur nevojat emergjente humanitare ose "për të arritur një zgjidhje të negociuar të konfliktit në Bosnje dhe Hercegovinë” (Rennack, D./ CPC, 1996: 6-7).

Projekti serb mbi Kosovë dhe për Kosovën, nuk u ndal, Serbia kishte intensifikuar dhunimin e të drejtave të njeriut në vend. Status quo, po e karakterizonte gjendjen e Kosovës, ndërsa Dejtoni duke i riafirmuar paprekshmëritë e kufijve i dha njëfarë sigurie Serbisë në veprimet e saj, ndërkaq kishte shkelje brutale të shqiptarëve të Kosovës (Dick, 2001: 1), tash bashkësia ndërkombëtare ishte përsëri në provë, pasi ata ndaj Kosovës kishin dështuar në mënyrë serike, vijon të thellohet në analizë raporti i përgatitur nga Qendra Kërkimore e Studimeve të Konfliktit, e cila gjendjen politike e sheh të lidhur me ngjarjet dhe reagimin e dështuar ndaj krizës, si:

- Të bllokuar nga mosveprimi i tyre fillestar;
- Veprimi i paefektshëm në periudhën deri në shtator 1995; dhe
- Të përhumbur nga dështimi i tyre për të parandaluar apo përgjigjur masakrës së Srebrenicës, SHBA-të dhe NATO-ja nuk mundën të përmbushnin sërish rolin e kalimtarëve pasivë (Dick, 2001:1).

Kosova, edhe njëherë kishte mbetur jashtë mundësisë për të arritur një status politik të pranueshëm ndërkombëtarësh. Në fakt edhe qasja e Kosovës nuk prodhonte tjera pritshmëri, nëse shihet nga perspektiva e tanishme, pra duket se synimi për arritjen e një statusi politik të zgjidhur e të njohur, si produkt i një marrëveshjeje finale mes palëve, nuk mund të cilësohet si veprimi më i mirë politik, në kohën kur kishte pak mundësi për një zgjidhje politike të atillë. Studiuesit i kanë kushtuar shumë vëmendje përjashtimit të Kosovës nga mundësia për të arritur një status politik përmes një konference ndërkombëtare, e cila apriori nuk ishte ditur se do të ndodhë, duke treguar se qasja politike pacifiste në rastin më të mirë, nuk ka pasur strategji dalëse, ndërsa fakti se pothuajse shumica e studiuesve e qesin Kosovën si rastin e humbur nga bashkësia ndërkombëtare për t'i dhënë fund konfliktit në Ballkan, tregohet se synimi ka qenë që edhe Kosova të përfshihet në të, së paku e disa aktorëve politikë. Studiuesi Kimberly Hudson, e konsideron këtë fakt si diçka të mirëqenë, pasi statusi i zgjidhur për Kosovën, minon arritjen e paqen, duke dëshmuar se Serbia këtë veprim e ka bërë për të përcaktuar rrjedhën e proceseve vijuese, duke e argumentuar si vijon:

“Kosova nuk u “shtrua” në Konferencën e Londrës apo në Dejton, sepse pjesëmarrja e Kosovës me vendet e tjera mund të kishte qenë një prishës i marrëveshjes. Çështja e Kosovës u vendos në prapavijë për të shmangur ndezjen e Millosheviqit dhe prishjen e mundësive për zgjidhjen e krizave të tjera në konferencat e Londrës dhe Dejtonit” (Hudson, 2009: 136).

Kosova nuk kishte prodhuar mjaftueshëm veprime politike të cilat do t'i ndihmonin asaj të avanconte drejt njohjes së statusit politik përmes një konference ndërkombëtare, prandaj pos argumentit se Serbia nuk do ta pranonte një marrëveshje politike ku Kosova ishte pjesë, e treguan edhe diplomatët evropianë, qëndrimet e të cilëve lidhen drejt me faktet e krijuara në terren, Rugova – Millosheviq, kishin qëndrime të ndryshme, i pari kërkonte

pavarësinë, ndërsa Millosheviq, maksimumin e statusit politik të Kosovës e shihte një autonomi.

Është interesant fakti se Millosheviq e kishte diktuar se edhe Kosova do të mund të ishte pjesë e Dejtonit dhe do të mund të kishte presion për të, ndërsa duke dashur të përcaktojë kursin e zhvillimeve politike në vigjilje të konferencës, kishte parashikuar se “ka një numër idesh për Kosovën”, të cilat do të mund të paraqiteshin pas arritjes së marrëveshjes së Dejtonit, thotë studiuesi Luis Sell (2003: 171), por të cilat marrëveshje nuk u paraqitën asnjëherë pas Dejtonit. Duke qenë se marrëveshja u arrit pa e përfshirë Kosovën në të, Serbia parimisht *nuk kishte marrë asnjë obligim ndërkombëtar mbi Kosovën dhe statusin e saj politik*, duke arritur të *përfshinte de facto pavarësinë e Kosovës nga konsiderata e madhe ndërkombëtare* (Ramet et al., eds. 2015: 96.), ndërsa leva e mirëmbajtjes së marrëveshjes së Dejtonit në raport me Bosnje e Hercegovinën, e la të lirë për një kohë kreun serb. Ky moment e rilegjtimoi Millosheviqin, ndërkaq shqiptarët e Kosovës e panë edhe si një miratim të qëllimeve të tij në rajon (Campbell, 1999: 154).

KAPITULLI II

NJOHJA E SHTETIT – SFONDI TEORIK

Rrafshi teorik që trajton dhe përshkruan njohjen e shtetit, ka përjetuar një ballafaqim të vazhdueshëm në mes të dy shkollave ose teorive të ndryshme, sa edhe sot vazhdojnë të kenë po të njëjtin ballafaqim, pa prodhuar një sqarim të duhur dhe të plotë të problemit. *Shkolla (teoria) konstitutive*, e cila ishte dominuese në periudhën e shekullit XIX, konstaton se entiteti politik i duhet *njohja për të ekzistuar si shtet*, por që nuk ofron ndonjë shpjegim të mëtejshëm, nëse njohja është *njohje e shtetit si ekzistencë*, ose *njohje diplomatike që vjen nga lidhja e këtyre raporteve*.

Autoritetet në entitetin politik, në anën tjetër, kur shpallin shtetin e tyre, nuk presin që të gjitha shtetet do ta njohin atë (*apo jo?*). Ka të ngjarë se krijimi i shteteve, sidomos gjatë shekullit XX, për shkak të zhvillimeve të marrëdhënieve ndërkombëtare, proceseve globale, ose të krijimit të mekanizmave të tjerë mbishtetërorë, ka bërë që njohja të mos përcaktojë ekzistencën e shtetit të porsakrijuar, pasi mundësia e njohjeve nga shtetet e tjera është e madhe (e nga të gjitha shtetet, shumë e vogël), ndërsa shumë mekanizma të tjerë politikë ndërkombëtarë, i japin atij mundësinë për të krijuar lidhje të tjera diplomatike.

Sistemi ndërkombëtar në anën tjetër, është mjaft i strukturuar, ndërsa janë pikërisht shtetet ato që e mirëmbajnë këtë sistem, që e modifikojnë dhe e ndryshojnë atë. Së këndejmi edhe njohja e shtetit varet nga kjo sjellje e shteteve që e prodhon këtë rend ndërkombëtar, i cili duhet të bazohet në vlera dhe parime. Studiuesit Anthony Murphy dhe Vlad Stăncescu, kur flasin për njohjen e shtetit, faktorët përcaktues dhe rrethanorë për njohjen e shtetit, argumentojnë kështu:

“Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, mjetet me të cilat shtetet veprojnë dhe ndërveprojnë duhet të udhëhiqen nga parime të tilla si sovraniteti dhe barazia. Në realitet, disa shtete vendosin të veprojnë në një mënyrë të diktuar nga dinamika gjeopolitike, domethënë fuqia ose ndikimi i mbajtur dhe nëpërmjet të cilit mund të zbatohen interesat e tyre në nivel rajonal ose global”
(Murphy & Stăncescu, 2017: 6).

Pra njohja nuk është vetëm konstatim i një fakti e as një vullnet i një numri të madh shtetesh si tërësi në raport me entitetin politik të deklaruar si shtet, por si sjellje individuale e shteteve ekzistuese ndaj tij, qasje që e rikthyen fokusin në konceptin e *njohjes si politikë*, duke e reduktuar veprimin politik nga veprimi i bazuar në parime e në vlera, një veprim kryekëput politik e strategjik i shteteve në nivele të ndryshme.

Duke qenë se ka një numër të madh rastesh se si krijohen shtetet e reja, ku mund të ketë cenim të rendit ndërkombëtar, natyrshëm edhe diskutimi për njohjen shfaqet si diskutim përmbajtjesor, duke qenë se studiuesit i kanë kushtuar jo pak rëndësi kësaj teme, si shkencëtari i njohur Jure Vidamar, i cili e trajton këtë problem, ku thotë se ... *shkëputja e njëanshme dhe paligjshmëria territoriale krijojnë rrethana të ndryshme ligjore në të cilat rregullat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare nënkuptojnë dhe madje presupozojnë se njohja (kolektive) mund të ketë efekte përbërëse* (2012: 361).

Shqetësimi që ka ngritur Vidmar, është qenësor në analizën që duhet t'i bëhet njohjes dhe e cila në formën e një tangjenteje e prek edhe *shkollën deklarative*, pasi siç thekson Vidmar duke e vijuar argumentimin e tij, *interpretimi i natyrës juridike të njohjes dhe mosnjohjes nuk duhet të fillojë me premisën se njohja gjithmonë pranon vetëm faktin e shfaqjes së një shteti të ri* (2012: 361), ndërsa nuk ka *elemente të diskrecionit*.

Njohja e shtetit ndonëse është trajtuar shumë, ajo nuk ka një shpjegim të kënaqshëm dhe përmbledhës, ndërsa *teoria konstitutive* dhe ajo *deklarative*, kanë vijuar të sjellin të dhëna nga praktikat kundërrthënëse dhe jo kuptimplota. Konstatimi fillestar është se krijimi i shtetit dhe format se si arrihet ajo, nuk mund të normohen, ose normimi mund të ndodhë vetëm pas krijimit të rastit, mbi modelin *fakt – normë; normë – fakt; fakt -normë*.

Në paragrafin vijues të paraqitur nga James Crawford, vërehen zbrazëtirat teorike që shfaqen në trajtimin krahasues mes dy teorive dominuese në të drejtën ndërkombëtare, kur flitet për njohjen. Studiuesi Crawford, ka vënë në pah se shteti është fakt, por jo i çfarëdoshëm. Fakti këtu presupozon ekzistimin e një *baze të caktuar juridike*, ndërsa në anën tjetër, konstitutivja, nuk bën dallimin mes njohjes dhe njohjes diplomatike, duke i dhënë rëndësi të dytës, ndërsa konsideron se njohja ka *elemente të diskrecionit*.

“Asnjëra nga teoritë e njohjes nuk e shpjegon në mënyrë të kënaqshme praktikën moderne. Teoria deklarative supozon se entitetet territoriale, për shkak të ekzistencës së tyre të thjeshtë, mund të klasifikohen lehtësisht si me një status të caktuar ligjor: kështu, në një farë mënyre, ajo ngatërron 'faktin' me 'ligjin'. Sepse, edhe nëse efektiviteti është parimi

dominues, ai duhet të jetë gjithsesi një parim ligjor. Një shtet nuk është një fakt në kuptimin që një 'karrige' është një fakt; është një fakt në kuptimin në të cilin mund të thuhet se një traktat është një fakt: domethënë, një status juridik që i bashkëngjitet një gjendjeje të caktuar në bazë të rregullave ose praktikave të caktuara.... Nga ana tjetër, teoria konstituive, ndonëse tërheq vëmendjen për nevojën e njohjes ose identifikimit të subjekteve të së drejtës ndërkombëtare dhe lë të hapur mundësinë e marrjes parasysh të parimeve ligjore përkatëse të pabazuara në fakte, identifikon gabimisht njohjen me njohjen diplomatike, dhe nuk merr në konsideratë mundësinë që identifikimi i subjekteve të reja mund të arrihet në përputhje me rregullat ose parimet e përgjithshme dhe jo në baza ad hoc, ose diskrecionale” (Crawford, 2006: 5).

Se njohja e shtetit paraqet një sfidë të madhe si në aspektin politik, ashtu edhe në atë analitik, tregon një zbërthim që studiuesja Pamela Price (1979: 123-124), i ka kushtuar njohjes që SHBA-ja i bën Kinës, si rast studimor dhe sipas saj, shteti amerikan nuk e kishte njohur për një kohë Kinën (edhe pse ajo kishte shpallur shtetin dhe ishte pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë) duke treguar për ndikimin e njohjes, sipas pikëpamjes konstituive në të drejtën për vetëvendosje, ndërsa konstaton se përmes presidentit Karter, e kishin ndryshuar qëndrimin në favor të njohjes, ku arsyetimi i mosnjohjes (deri në kohën e Karterit) ishte tërësisht *subjektiv*, gjithmonë sipas pikëpamjes amerikane, pasi ata (amerikanët) përmes politikës së mosnjohjes kanë dashur ta *frenojnë shtrirjen e komunizmit*, kurse vetë akti i njohjes, ka treguar se SHBA-ja ka përvijuar parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare. Analiza që Pamela Price i bën rastit në fjalë, tregon se njohja duhet të shihet në disa rrafshe:

- *vështrimit politik* - si veprim politik (frenues),
- *sipas shkollës deklarative*, njohja cilësohet *objektivisht*, (pasi Kina kishte përmbushur katër kriteret themelore të paraqitura në Konventën e Montevideos), ndërsa
- *sipas shkollës konstitutive*, zgjerimi i njohjes është një akt plotësisht *diskrecional*.

Nga kjo që u tha më lart, mund të nxirren konstatime interesante që tregojnë se njohja dhe mosnjohja e shtetit, janë tërësisht politike, ndërsa argumentimet shkollare janë tepër pasive dhe të papesha në analizën politike të thelluar, pasi asnjëra dhe as tjera nuk e trajtojnë në mënyrë shteruese aktin e njohjes dhe duke e lënë njohjen në përgjegjësi të sjelljeve të shteteve.

Studiuesi Rowan Nicholson, kur argumenton sjelljen e shtetit në të drejtën ndërkombëtare në raport me njohjen, në librin me titull *“Statehood and the State-like in International Law”*, ai konsideron se shteti sillet konform përcaktimeve të tij, të cilat janë marrë për bazë edhe nga obligimet e tjera ndërkombëtare. Kësisoj, i njëjti veprim, pra edhe njohja, edhe pse e thirrur në premisën dhe parimet e njëjta, mund të cilësohet ndryshe. Nicholson argumentimin e vijon duke u thirrur në qëndrimin e paraqitur nga Ronald Dworkin, i cili konstaton se e drejta është një sistem formal i normave pa zbrazëtira dhe prandaj nuk mund të ketë dykuptimësi në të.

“Përveç kësaj, duke qenë se sjellja në të drejtën ndërkombëtare kuptohet gjithmonë si sjellje e kryer nga një subjekt i caktuar dhe ndaj një subjekti të caktuar, i njëjti veprim mund të jetë i paligjshëm ndaj një subjekti, por i ligjshëm ndaj një tjetri. Një veprim që shkel një traktat, për shembull, është përgjithësisht i paligjshëm vetëm ndaj palëve të tjera të traktatit; mund të jetë ende i ligjshëm ndaj një subjekti tjetër që nuk është palë në traktat. Por, për çdo pyetje specifike në lidhje me zbatimin e normave të sjelljes, dallimi është i ngurtë. Ose sjellja e veçantë është e paligjshme ndaj një subjekti të caktuar ose duhet të jetë e ligjshme ndaj atij subjekti të caktuar” (Nicholson, 2019: 30).

Sido që të jetë, kriteret e shtetësisë, ndonëse nuk kanë ndryshuar pavarësisht ndryshimeve të mëdha në proceset globale, ka pasur vetëm fillim të aplikimit, ose së paku janë përmendur në procesin e njohjeve edhe disa kriterë të reja, sidomos pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ku demokratizimi i shoqërive ka kërkuar edhe njohjen e shteteve me vlera demokratike, duke u përcaktuar edhe si kriter i ri në këtë proces. Studiuesi Jure Vidmar (2013), në librin e tij me titull *“Democratic Statehood in International Law”*, ka përmendur faktin se ka një përzierje të theksuar në mes vetëvendosjes dhe demokracisë, të cilat janë aplikuar në vend të njëra-tjetrës, sigurisht pa të drejtë. Argumentimi kryesor i Vidmar këtu është se shteti nuk krijohet vetëm si rezultat i përmbushjes së kriterëve të shtetësisë, por kjo nuk nënkupton se demokracia është kriter shtetësie, ndërsa krijimi i shtetit dhe njohja e tij më shumë cilësohet si proces i prodhuar nga një e drejtë, ku pastaj mund të përcaktohet kriteri i demokracisë, por deri atëherë, *një sistem politik demokratik është po aq i rëndësishëm apo i parëndësishëm sa kriteret e shtetësisë, përfundon argumentin Vidmar* (2013).

Studiuesit konsiderojnë se nuk kërkohen vetëm fakte, si kritere të shtetësisë, por edhe vlera të cilat shtetet që krijohen duhet t'i kenë. Studiuesja Amy Eckert, trajton këtë problematikë duke e cilësuar se si shtetet njohëse shohin edhe *çfarë shteti po njohin*, në kuptimin e vlerave që bart ai, duke shtuar:

“Proceset e krijimit të shtetit pas Luftës së Ftohtë duket se u japin rëndësi të paktën të barabartë, nëse jo më të madhe, vlerave të shteteve njohëse, duke përfshirë mbështetjen për të drejtat e njeriut dhe demokracinë. Këto vlera, aq vendimtare për periudhën bashkëkohore, nuk kanë vend në teoritë e mëparshme të krijimit të shtetit” (Eckert, 2002: 20).

Ky kapitull ka këtë synim, bën trajtimin teorik të njohjes, duke u nisur nga faktorët politikë, sidomos rendi ndërkombëtar dhe efekti i tij në transformimin teorik të njohjes, duke u pasuar nga teoria konstitutive dhe teoria deklarative, për t'u pasuar me njohjen e shtetit në periudha moderne, sidomos llojet e njohjeve të shteteve që kanë dalë nga procese të shkëputjes, duke aspiruar që të shohë se si e drejta ndërkombëtare akoma nuk ka gjetur një shpjegim të qartë dhe përmbledhës për këto raste.

Çështjen e njohjeve në perspektiva të ndryshme teorike e kanë trajtuar mjaft shumë, studiuesit: Gëzim Visoka, John Doyle, Edward Newman, Thomas D. Grant, Roland Portmann, John Dugard, Richard Caplan, Krystyna Marek, James Crawford, Hersch Lauterpacht, Michael Schoiswohl, C. Daase, A. Geis, Caroline Fehl, Michelle Murray, Mikulas Fabry, Eiki Berg, Archie W. Simpson, Duncan French, Stefan Talmon, të cilët flasin për njohjet, rendin ndërkombëtar dhe implikimet e tij në këtë proces, por edhe për mosnjohjen dhe strukturat gjeopolitike, me ndikim në njohje.

Thomas Grant, në librin me titull *“The Recognition of States Law and Practice in Debate and Evolution”* konsideron si të varfër shpjegimin doktrinar lidhur me krijimin dhe njohjen e shtetit, ndërsa sipas tij fokusimi i problematikës së njohjes vetëm te pikëpamjet e ngurta teorike konstitutive dhe deklarative e kanë varfëruar argumentimin faktik, duke iu shmangur argumenteve bazike, dhe sipas tij:

“Doktrinat nuk marrin parasysh në mënyrë adekuate karakterin e përbërë të shtetit, duke injoruar se shtetësia ndoshta përshkruhet më së miri si një grup të drejtash, detyrimesh dhe funksionesh” (Grant, 1999).

Posedimi faktik i të drejtave dhe ushtrimi efektiv i funksioneve të shtetit, i jep entitet politik të deklaruar shtetit, personaliteteve ndërkombëtare, por fitimi i tyre, lidhet me procesin e njohjeve, pikëpamje të cilën e ka ofruar Roland Portmann, duke konstatuar se posedimi i së drejtës dhe përgjegjësisë së shteteve, vjen vetëm pas njohjes, prandaj sipas tij, shtetet ushtrojnë kapacitet të plotë si person ndërkombëtar bashkë me procesin e njohjeve (Portmann, 2010: 82).

Njohja, si konstatim i një fakti, sido që të jetë, nuk paraqet ndonjë problem, kur është fjala te praktika e ushtrimit të deklarimit nga shteti, por te natyra e pasojave të saja ligjore që prodhon më pas ky deklarim dhe njohja e tij, ndërsa shumica e qëndrimeve teorike e të së drejtës sot, nisen nga parimi se shteti është shuma e funksionimeve që mund të maten në mënyrë empirike (Abushov et al. (ed), 2014: 48).

Shpesh, në trajtimet e deritanishme, kur flitet për njohjen e shteteve që dalin nga procesi i shkëputjes, janë diskutuar ndaras konceptet fakte, e drejta dhe politika, por John Dugard, konsideron se këto koncepte janë të lidhura pashkëputshëm me njëra-tjetrën dhe sipas tij:

“...kur ekzistojnë parime juridike konkurruese në një situatë të caktuar faktike, që është shpesh rasti me shkëputjen, ku parimet e integritetit territorial dhe vetëvendosjes konkurrojnë, vendimmarrësi duhet t'i japë përparësi njërit parim mbi tjetrin në lidhje me politikën që përfshin konsiderata të drejtësisë që mund të përcaktohet vetëm në bazë të fakteve të secilit rast” (Dugard, 2013: 34).

Qëndrimi që mban Dugard, tregon një gjë fundamentale në procesin e përcaktimit të vetë shembullit të shtetit që do të njihet, ndërsa argumentimi se ka (vetëm) disa raste të veçanta, nga të tjerat, është jo fort i qëndrueshëm, pasi çdo rast ka veçoritë e tij.

Sido që të jetë, shpërbërja e Jugosllavisë dhe proceset që vijuan me krijimin dhe njohjen e disa shteteve dhe shembujt që u përdorën për të njohur shtete të tjera, të deklaruar rishtazi, tregoi se rendi ndërkombëtar ka pësuar njëfarë ndryshimi dhe se njohja do të mbetet peng i së drejtës dhe real politikës (Ryngaert & Sobrie, 2011: 467).

Pavarësisht kësaj, këta shembuj akoma nuk kanë treguar mirëfilli se do të mund të ndiqen si diçka e vlefshme e që janë ngulitur suksesshëm në rendin ndërkombëtar, për shkak se shumë shtete të fuqishme duke e njohur ndikimin që ka njohja, nuk janë lëshuar edhe në

njohje të tjera (Fabry, 2012: 661), së paku jo në zona ku ndikimi nuk ka qenë i bollshëm duke u mjaftuar me tendosje tensionesh në disa vatra krizash. Njohja ka mbetur peng i rendeve ndërkombëtare, qëndrimeve të fuqive botërore, që imponohen si faktorë politikë gjeopolitikë e strategjikë, por veprimeve sovraane të shteteve të pavarura.

Në këtë kapitull trajtohet baza teorike e njohjes së shtetit dhe rolit që kanë organizatat ndërkombëtare në forcimin e subjektivitetit të entitetit të deklaruar si shtet, duke aplikuar analizën e përmbajtjes dhe krahasimin. Teoritë politike që flasin dhe kornizojnë njohjen në një tërësi anë dhe teoritë që elaborojnë ndikimin që ka pjesëmarrja e shtetit në forume multilaterale kanë gjetur zbatim të madh në analizën politike në veçanti ato të teorisë deklarative e konstitutive.

Ky kapitull do të jetë i vyeshëm për të parë realisht se ku gjendet njohja e Kosovës dhe sfidat që ka shteti i deklaruar në forcimin e subjektivitetit të saj, duke u ndaluar në specifikat që ofron rendi ndërkombëtar, por edhe vetë koncepti i sovranitetit ndërkombëtar në procesin e sigurimit të njohjeve.

II.1. Rendi ndërkombëtar dhe njohja e shtetit

Procesi i krijimit të shteteve të reja, ka kaluar nëpër faza të ndryshme të cilat kanë përcaktuar dhe janë përcaktuar nga rendi ndërkombëtar i kohëve. Nisur nga kjo, krijimi i shtetit, parimisht ka paraqitur raportin ndaj faktit të krijuar në terren, fakt me të cilin sistemi ndërkombëtar është dashur të ballafaqohet e adaptohet. Krijimi i shtetit është procesi më i komplikuar në marrëdhëniet ndërkombëtare, pasi flitet për aktorin kryesor të tyre, ndërsa *parimi i sovranitetit*, si pushteti i pushteteve, ka qenë pengesa kryesore e krijimit të shteteve të reja.

Krijimi i shtetit ka përcaktuar edhe sjelljen e shteteve në raport me faktin e ri të krijuar, duke prodhuar së paku dy rende:

- a) *rendin paswestfalian*, i cili krijoi kornizën e marrëdhënieve moderne ndërkombëtare dhe konceptin e sovranitetit shtetëror (Patton, 2019), zhvillimin e normës së integritetit territorial (Radin et al., 2016), por i cili shihet edhe si momenti kritik i justifikimit të kolonializmit (Bauder & Mueller, 2021); dhe
- b) *rendin e bazuar në parimin e vetëvendosjes*, të shfaqur sidomos me Wilsonin dhe i cili përbëhet nga dy premisa, *të jashtmen për pavarësi* e shtetësi dhe *të brendshmen*,

përmes së cilës shteti zgjedh sistemin politik të tij (Mustafa, 1971), parim i cili nuk ka arritur ende të vendoset si duhet, ndërsa këto sisteme kanë pasur ballafaqime të vazhdueshme që nga koha e shfaqjes së tyre, duke përcaktuar edhe pozitën e shteteve të reja, në një sistem të vjetër ndërkombëtar.

Krijimi i shtetit, sikundër edhe njohja e tyre, vjen për shkak të shumë rrethanave, por kryesisht vijnë nga ajo se si ato (shtetet) paraprakisht janë ndërtuar, duke prodhuar kështu dallime të tilla si në etni, kulturë, territor, fe dhe marrëdhënie qendrore – periferi (OECD, 2011) dhe të cilat reflektojnë në (de)stabilitetin e shtetit deri në shpërbërjen e tij.

Crawford (2010), ka identifikuar se deri në gjysmën e shekullit të kaluar kishte diku 50 shtete, ndërsa sot janë jo me pak se 195 të tilla, ndërsa ai këtë e lidh me një mori procesesh, si vetëvendosjen, shkëputjen, trashëgiminë, njohjen, dekolonizimin dhe disa fusha të tjera. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e numrit të shteteve janë dekolonializmi, përmes të cilit vetëm në Afrikë janë krijuar 50 shtete, thotë studiuesja Farina Mir (2015, 844), ndërsa një valë tjetër e krijimit të shteteve haset me shpërbërjen e BRSS-së, por edhe të Jugosllavisë, në fillim të viteve 1990. Nisur nga kjo, qartë tregohet fakti se krijimi i shtetit dhe njohja e tij, ndonëse paraqet procedurë standarde, nuk ndodhet mbi baza të njëjta, aq më tepër nuk mjaftojnë teoritë e moçme për të kryer analiza mirëfilli lidhur me procedurat e krijimit dhe njohjes së shtetit të ri.

Studiuesi T. V. Sathiyamurthy, është i mendimit se krijimi i shteteve të reja varen nga dy faktorë, *të brendshëm dhe të jashtëm*, që ai i quan *kriza*, ndërsa vë në dukje faktin se shtetet e reja do të hasin në vështirësi të cilat lidhen me mundësinë që ato të mund të hyjnë në një rend ndërkombëtar i cili është i ndërtuar nga shtetet të cilat duke e ruajtur veten, e shtrëngojnë edhe sistemin, ndërkaq ndërvarja mes shteteve është aq e madhe sa *shtetet e reja fillojnë ekzistencën e tyre të pavarur në një atmosferë të rritjes së aktivitetit ndërkombëtar të rritur prej këtyre ndërvarësive* (1971: 2523).

Njohja e shtetit dhe imponimi i tij në arenën ndërkombëtare është parë nga perspektiva të ndryshme nga studiuesit, por edhe teoritë e ndryshme politike e analitike, pasi implikimi që ka pasur krijimi i shtetit është shumë i madh, sidomos kjo vërehet nga shtytja që rendi ndërkombëtar krijon, prandaj është me rëndësi që shteti të njihet, ose jo.

Njohja e shtetit i shtyn ato që të anëtarësohen në mekanizmat ndërkombëtarë (Mazarr et al., 2016: 40). Kjo prodhon një ndërvarshmëri të madhe mes shtetit dhe arenës

ndërkombëtare, ku shteti si aktor ndikon dhe ndikohet te/nga rendi ndërkombëtar, sikundër edhe anasjelltas. Njohja dhe sidomos anëtarësimi i tij në mekanizma ndërkombëtarë, bëhet për disa arsye ndër të cilat më të rëndësishmet janë: *prestigji, reputacioni, ndikimi social dhe legjitimiteti i brendshëm dhe ai ndërkombëtar* (Mazarr et al., 2016: 40), të cilat shtetet synojnë t'i arrijnë përmes njohjes ndërkombëtare.

Zhvillimet politike që kanë ndodhur në së paku pesëqind vitet e fundit, flasin për sisteme politike të paqëndrueshme të cilat janë varur nga faktorët shtete, të cilat përmes transformimeve graduale kanë krijuar rende, ndërsa krijimi i shteteve dhe njohja e tyre, kanë qenë pikërisht pengje të këtyre rendeve politike të cilat kanë vlejtur për një periudhë të caktuar kohore, deri te kulmimi i ngjarjes tjetër që ka përmbysur, ose ridizajnuar rendin ndërkombëtar.

Rendi ndërkombëtar është i rëndësishëm ekzistencialiste për shoqërinë njerëzore thotë studiuesi Stephen A. Kocs, dhe sipas tij, pa një rend ndërkombëtar, bota do t'i nënshtrohej një kaosi, frike e pasigurie, prandaj konsideron që rënia e rendeve ndërkombëtare e ka shtyrë botën drejt luftërave botërore, duke vijuar:

“Një sistem ndërkombëtar përcakton të drejtat dhe detyrimet e aktorëve që e përbëjnë atë dhe specifikon kufizimet që ata pritët të respektojnë në sjelljen e tyre ndaj njëri-tjetrit. Pasi të krijohet, një sistem ndërkombëtar normalisht mbetet në fuqi për aq kohë sa aktorët e fuqishëm ruajnë aftësinë dhe vullnetin për ta mbështetur atë” (Kocs, 2016: 3).

Rendet ndërkombëtare kanë ndikuar në krijimin e shteteve, por studiuesit si Michael J. Mazarr, Miranda Priebe, Andrew Radin e Astrid Stuth Cevallos e shohin atë nga një prizëm tjetër, nga ai i konkurrencës mes fuqive dhe japin konsideratat se rendi ndërkombëtar nuk është uniform, pasi si i tillë, ai ndërtohet nga *grupe të ndryshme vlerash dhe parimesh*, ndërsa duke qenë se ky rend përbëhet nga fuqitë e mëdha, ballafaqimet e këtyre shteteve kanë implikime edhe në atë se si do të ndërtohet vetë ai (2016: 10).

Studiuesi George Lawson (2016: 2), nuk e sheh si pengesë atë që e paraqesin studiuesit e sipërpërmendur lidhur me rendet ndërkombëtare, madje për të kjo është edhe e pritshme dhe diçka që ka ndodhur gjatë gjithë historisë, për të sistemet janë të fragmentuara, por kjo i shtyn shtetet si nën njësi të rendeve ndërkombëtare që të bashkëpunojnë duke prodhuar

bashkërendime që nisin nga njohja mes njëra-tjetrës. Kjo nënkupton se rendi ndërkombëtar fillon me njohjen e shteteve mes vete, sepse aty fillon edhe i gjithë procesi vijues i bashkëpunimeve, por edhe mosnjohja në anën tjetër.

Literatura e deritanishme shkencore e akademike që e ka trajtuar këtë problematikë, e ka parë ngushtë rrethanën e krijimit dhe njohjes së shtetit, ndërsa diskutimi është sjellë kryesisht mes dy teorive kryesore, por edhe njohja si akt nuk është se është trajtuar mjaftueshëm, madje njohja kryesisht ka qenë në shërbim të ruajtjes së rendit ekzistues, thotë studiuesi Visoka, i cili argumentimin e vijon duke thënë:

“Njohuritë kryesore mbi njohjen e shtetit synojnë të ruajnë interesat e fuqive ekzistuese në kurriz të të drejtave dhe lirive të popujve të nënshtruar, të cilët e shohin krijimin e një shteti të ri si një vend të shenjtë për emancipimin kolektiv dhe shpëtimin nga abuzimet e të drejtave të njeriut nga shteti bazë” (Visoka, 2022: 150).

Visoka, (2022: 150), po ashtu shprehet skeptik nëse edhe në të ardhmen e parashikueshme mund të ketë ndonjë ndryshim, e gjithë kjo në favor të ruajtjes së rendit ekzistues, sigurisht në dëm të krijimit të mundësisë dhe lehtësisë për të siguruar njohje. Sido që të jetë, ai përsëri shprehet se e tashmja dhe e ardhmja e rendit ndërkombëtar, mund të sjellë disa ndryshime, sidomos trajtimet analitike do të kenë për bazë ndalimin e promovimit të dhunës si mjet përmes së cilës mund të sigurohet njohja, ndërsa konstaton se fokusi duhet të bie në trajtimin e shkëputjes korrigjuese, duke e argumentuar kështu:

“Ai (hulumtimet) duhet të tregojë ndjeshmëri ndaj rasteve të vetëvendosjes korrigjuese dhe të zbulojë strukturat e padrejtësisë, por jo të inkurajojë prodhimin e kushteve korrigjuese me pasoja të dëmshme njerëzore dhe materiale për njerëzit e nënshtruar në radhë të parë dhe gjithashtu për rajonet fqinje dhe më gjerë” (Visoka, 2022: 150).

Konstatimi fillestar sa i takon rendit ndërkombëtar dhe efektit të tij në procesin e njohjes është se, ky proces, është varur nga rrethanat e krijuara, më saktë qëndrimet që kanë mbajtur shtetet ndaj entitetit politik të krijuar rishtazi. Shtetet nuk është se kanë përfillur shumë rendin ndërkombëtar, por kryesisht janë fshehur prapa tij, më synim të mbajtjes së

qëndrimit të pandryshueshëm ndaj entitetit të ri politik të deklaruar si shtete. Mekanizmat ndërkombëtarë kanë filluar të japin impaktin e tyre në procesin e ndërkombëtarizimit të problematikave, por kjo ka krijuar edhe disa kundër efekte, pasi ka ndezur edhe rastet e ngjashme, në kërkim të avancimit të të drejtave të tyre.

Artikujt e shumtë shkencorë me pikëpamje të ndryshme analitike e teorike kanë qëndrime të ndryshme ndaj problematikës, por kanë edhe pika të përbashkëta që tregojnë se rendi ndërkombëtar është pa një strukturë hierarkie, shtetet imponohen aty si faktorë force dhe imponojnë politika, transformimi gradual është se ka të ngjarë dhuna nuk do të përdoret si mekanizëm përmes të cilit transferohet edhe njohja dhe krijimi i shtetit.

II.2. Sovraniteti dhe njohja e shtetit

Parimi i sovranitetit paraqet parimin bazë të marrëdhënieve ndërkombëtare i cili është vendosur si një nga mekanizmat më të mirë të ruajtjes së rendit mes shteteve. Si koncept është shumë i njohur dhe lidhet me kontrollin që një autoritet i caktuar ushtron ndaj një territori ose popullsie, sigurisht pa ndikime nga jashtë ose ndikime të brendshme, por në aspektin e njohjes së shtetësisë dhe të funksionimit të tij të tanishëm, është mjaft i diskutueshëm.

Koncepti sovranitet është mjaft i zbatueshëm dhe përdoret për të ofruar perspektiva të ndryshme të relacioneve brenda dhe ndërshtetërore, të cilat nisin me Jean Bodin, i cili në veprën e tij me titull “Gjashtë Libra të Komonuelthit”, thotë: *“Sovranitet është ai pushtet absolut dhe i përhershëm që i është dhënë një Komonwealthi”* (1756: 25). Por, gjërat kanë ndryshuar dhe sot flitet për një sovranitet të zbehur, meqë ka një numër aktorësh funksionalë nëpër botë, por edhe shtete që kanë jo pak ndikim sidomos te shtetet e dobëta. Pikëpamjet e reja thonë se sovraniteti i shtetit është sfiduar vazhdimisht nga shtetet e fuqishme të cilat kanë shtrirë ndikimin e tyre, këtë vlerësim e ka Stephen D. Krasner, i cili ndër të tjerash, thotë:

“Politikat e shumë shteteve më të dobëta janë depërtuar vazhdimisht dhe kombet më të forta nuk kanë qenë immune ndaj ndikimit të jashtëm” (Krasner, 2001: 20).

Lidhur me relacionin mes njohjes së shtetit dhe parimit të sovranitetit, ka bërë që të trajtohet pozita e shtetit nga prizmi i ballafaqimit të argumenteve kundërthënëse, pasi të qenit sovran ka nënkuptuar vënien në jetë të një parimi juridik e historik, ose si mundësia e mekanizmit përmes të cilit shtetet kanë vepruar në pajtim me linjat e politikave shtetërore,

por në anën tjetër të jesh sovran nënkupton edhe marrjen e përgjegjësisë që dalin nga krijimi i raporteve diplomatike, duke sfiduar kaq shpejt atë që sapo u tha më lart, thotë David Williams, i cili duke u thirrur në qëndrimet e shkollarëve si: Robert Keohane, Joseph Nye, Robert Gilpin Mark Zacher, James Rosenau, konsideron se:

“...ndërvarësia ekonomike, ndryshimi teknologjik dhe përhapja e aktorëve joshtetërorë e kanë komprometuar ose gërryer sovranitetin shtetëror”
(Williams, et al., 2003: 6).

Njohja e shtetit varet nga plotësimi i kriterëve të shtetësisë, por edhe nga veprimet e shteteve të tjera, në raport me shtetin e sapo deklaruar. Këtu krijohet kundërthënia e madhe se shtetet janë sovraane në raport me njohjen e një entiteti politik të sapo deklaruar, pasi ato, nuk mund të mos e njohin një shtet që plotëson këto kriterë.

Studiuesi i njohur britanik, Hersch Lauterpacht kur flet për njohjen e shtetit, ai konstaton që *ky veprim lidhet me deklarimin se entiteti politik ka përmbushur kriteret e shtetësisë*, duke e ushtruar funksionin deklarativ. Shteti ekzistues është i *detyruar* të njohë entitetin politik që i plotëson kriteret e shtetësisë, por kjo është e diskutueshme, pasi shtetet sillen si aktorët e vetëm të së drejtës ndërkombëtare, sigurisht në mungesë të një organi më të lartë vendimmarrës, prandaj ato e administrojnë atë rend pa një strukturë hierarkike (1944: 385).

Sido që të jetë, kjo nuk nënkupton se shtetet kanë të drejtë të veprojnë bazuar vetëm në interesat e tyre, kundrejt ligjit ndërkombëtar, thotë Lauterpacht. Këtu njohja ka marrë një dimension tjetër, atë konstitutiv për shtetet që ekzistojnë në raport me entitetin që është deklaruar si shtet, thotë ai, ndërsa vijon qëndrimin kështu:

“Edhe pse njohja është kështu deklaruese e një fakti ekzistues, një deklaratë e tillë, e bërë në përmbushjen e paanshme të një detyre ligjore, është konstitutive ndërmjet shtetit njohës dhe komunitetit të ri të të drejtave dhe detyrave ndërkombëtare që lidhen me shtetësinë e plotë” (Lauterpacht, 1944: 385).

Argumentimi i mësipërm jep një konstatim fundamental si për shtetin ekzistues, entitetin politik që synon shtetësinë, për marrëdhëniet ndërkombëtare, por edhe për të drejtën ndërkombëtare, pasi shtetet ekzistuese nuk mund të sillen si përcaktuese nominale e

ekzistencës së një entiteti të ri politik, në anën tjetër as entitetet politike nuk mund të pretendojnë shtetësi të suksesshme në një rast të mospërmbushjes së kriterëve të shtetësisë, kështu që rendi ndërkombëtar mbetet i qëndrueshëm e marrëdhëniet ndërkombëtare kanë qartësi.

Krijimi i shteti është thënë më herët se është procesi më i komplikuar në të drejtën ndërkombëtare, pasi prek territorin, sovranitetin dhe qëndrueshmërinë e tij, prandaj për këtë arsye shfaqet ballafaqimi mes dy forcave, atyre që thirren në *ruajtjen e sovranitetit* dhe atyre që e shohin atë si *pengesë për grupet etnike që kanë synim të fitojnë sovranitetin*. I këtij mendimi është studiuesi Oliver Richmond (2002: 381), i cili konstaton se shtetet ekzistuese e shohin *mbijetesën e sovranitetit si jetik për rendin ndërkombëtar*, a në fakt, synimi është ruajtja e tërësisë territoriale dhe pamundësia e shpërndarjes së një pjese të territorit nga grupet e caktuara etnike, të cilat e shohin si pengesë rendin ekzistues për të fituar sovranitetin, mbi premisën e vetëvendosjes.

Në këtë aspekt, e drejta e vetëvendosjes sot, është padyshim, pika më e ndjeshme e sistemit ndërkombëtar, thotë studiuesja Patricia Carley e cila vendos theksin te *dështimi i dokumenteve bazë të aplikueshme për përcaktimin e saktë se kush ka të drejtë të kërkojë vetëvendosje, qoftë një grup, një popull, ose një komb* (1996: V), gjithmonë duke llogaritur se si dhe kur janë vendosur kufijtë ekzistues, prandaj kjo i ka shtyrë shumë grupe etnike të synojnë pavarësimin e tyre, gjithmonë duke llogaritur në luftimin e dhunën sistematike të ushtruar nga qeveria qendrore, që thirret në ruajtjen e sovranitetit.

Kështu, parimi i sovranitetit ka krijuar pabarazi në mes dhe brenda shteteve e rendit ndërkombëtar, ka qenë i ndërtuar pikërisht mbi këtë parim, ndërsa është shënuar një ndryshim gradual, sidomos pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, duke bërë që sovraniteti gradualisht të tkurret, të dobësohet dhe të transformohet, e me këtë edhe avancimi i institucioneve dhe strukturave të reja ndërkombëtare. Shpesh në mënyrë të përgjithshme ky transferim është konsideruar pozitiv, madje edhe i mirëqenë, por shkollari Benedict Kingsbury, e ndan mendimin e tij nga qëndrimi pararendës, duke e cilësuar si të dëmshëm, madje intensifikues të pabarazive zbehjen e sovranitetit, ndërsa shton:

“...hedhja e sovranitetit në favor të një qasjeje funksionale do të intensifikojë pabarazinë, do të dobësojë kufizimet ndaj ndërhyrjeve shtrënguese, do të zvogëlojë rolet kritike të shtetit si një vend identiteti dhe një zonë autonome të

politikës Koncepti normativ tradicional i sovranitetit është i sforcuar, por në mungesë të mjeteve më të mira për të menaxhuar pabarazinë, ai mbetet i preferueshëm ndaj cilësdo prej alternativave të ofruara” (Kingsbury, 1998: 599).

Njohja e shtetit, është veprim sovran, është akt politik dhe përcaktues i qëndrimit që shteti ekzistues ka ndaj rrethanës së re të krijuar, por ky qëndrim sa kohë është i karakterit politik, natyrshëm tregon për shfaqjen edhe të interesit që ka shteti ekzistues ndaj aktorit të ri që po krijohet, prandaj ky deklaram tregon se njohja e shtetit, ose edhe mosnjohja e tij, është larg të qenit i standardizuar dhe parimor, sikundër edhe ndryshimi i qëndrimit politik.

Studiuesi George Kyris, e trajton këtë koncept duke e shtruar pyetjen se si *sovraniteti qëndron statik* (nëse mund të qëndrojë i tillë), sa kohë që aktorët kryesorë dhe veprimet e tyre janë tepër dinamike, duke shtuar se *sovraniteti si dinamik*, ku kushtet shoqëruese, si njohja, luhaten në cilësi dhe sasi me kalimin e kohës duke shtuar diskutimet ekzistuese që përqendrohen në ndryshime në të kuptuarit real të parimit dhe konceptimit të sovranitetit (2022: 287).

Krijimi i një numri të madh shtetesh, të cilat nuk e kanë të kompletuar njohjen dhe kanë dallime të mëdha mes tyre si raste në bërje, e vënë në diskutim pikërisht sovranitetin dhe që ka ndikuar në *shkallë të ndryshme të njohjes*, që do të thotë se shumë entitete politike (të shpallura shtete) kanë fituar diçka nga njohjet, por jo të gjithën, si rasti i Kosovës që ka njohje të gjerë, por jo të përgjithshme, rasti i Palestinës, që paraqitet si njohja e një të drejte, në krahasim me praninë e shtetësisë, si dhe ndryshimi i njohjes me kalimin e kohës, që dëshmojnë për luhatje të konsiderueshme në njohjen e tyre, si rasti i Tajvanit (Kyris, 2022: 287). Autori Kyris jep përfundimin se sovraniteti paraqitet si dinamik në situatën e *sovranitetit të pjesshëm në vetvete* (p.sh. në ata të cilëve u mungon njohja e përgjithshme) dhe rastet në të cilat sovraniteti ndryshon brenda një njësie dhe me kalimin e kohës, për shembull, nëpërmjet rritjes ose humbjes së njohjes, ... si Tajvani apo Kosova (2022: 305).

Kjo tregon se ka një tablo komplekse nëse synohet të trajtohet sovranitetit në kuptimin e dikurshëm, prandaj autorët si Kyris, synojnë që sovranitetin ta zbërthejnë në disa nivele, nga perspektiva e tanishme dhe sipas tij, duhet të ndërtohet një pikëpamje e re, ajo e *sovranitetit si jo absolut*, e cila do të ishte më funksionale dhe e cila do të duhej të fokusohet në variacionet e sovranitetit në njësi të ndryshme, si:

- në rastet se si disa shtete shihen si më sovrane se të tjerat në kontekstin e marrëdhënieve hierarkike;
- në rastet e ndarjes së sovranitetit ndërmjet aktorëve të ndryshëm (p.sh.: ndërmjet qeverive shtetërore dhe aktorëve të jashtëm, siç është administrata tranzitore e OKB-së);
- në rastet e vendeve që kanë një shkallë të sovranitetit në të njëjtën njësi si sovraniteti i pjesshëm (si rasti me Kosovën, Palestinën apo Saharën Perëndimore) (Kiris: 2022: 287).

II.3. Konferenca e Montevideos – Kriteret e shtetësisë

Shteti është subjekti kryesor i së drejtës ndërkombëtare, thonë grupi i teoricienëve klasikë, si grupi më i madh që trajton subjektet e së drejtës (Gruda: 2013: 8), por shteti është edhe aktori kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare (Goldstein, 2003: 24). Shteti duke ushtruar funksionin e tij si aktori kryesor, ka ndjekur vazhdimisht interesat e tij në një sistem ndërkombëtar pa struktura të forta politike globale. Krijimi i shtetit në këto kushte, ka qenë shpesh peng, por edhe burim i kësaj situate, ku krijimi dhe zhdukja e tij, kanë pasur ndikime nga më të ndryshmet, deri te niveli me i lartë botëror.

Shtetet për t'u krijuar e njohur, duhet patjetër, të prishin një ose shumë shtete paraprake, por të cilat është dashur të kenë disa kriteret të cilat flasin për një gjendje faktike. Kriteret e shtetësisë që entitetet politike është dashur t'i përmbushin kanë qenë pjesë e një diskutimi të madh, jo në lidhje me ato si të tilla, por me atë se çfarë ato përfaqësojnë. Diskutimet e mësipërme që trajtojnë zbërthimin teorik të shtetit dhe shtetësisë, njohjes dhe ndikimit të njohjes, më të drejtë janë dukur si të vjetra dhe jo produktive për të përcaktuar ekzistencën e entitetit politik të deklaruar shtet.

Është thënë se shtetet janë krijuar vazhdimisht, edhe para vitit 1933, kur në Montevideo (Urugai) është mbajtur konferenca e shteteve amerikane (Gruda, 2013: 69), për të përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësitë e shteteve. Sipas kësaj Konvente, në Nenin e parë të saj thuhet: *Shteti si person i së drejtës ndërkombëtare duhet të zotërojë këto kualifikime: a. një popullsi e përhershme; b. një territor të përcaktuar; c. qeveria; dhe d. aftësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera* (Konventa e Montevideos, 1933).

Të gjitha kriteret e mësipërme flasin për fakte, prandaj shteti si person ndërkombëtar do të shfaqet në momentin e përmbushjes së këtyre fakteve, të cilat më pas duhet të njihen nga shtetet e tjera, pasi shteti është çështje fakti, dhe jo ligji, dhe lidhet me efektshmëri, para se të lidhet me ligjshmërinë (Crawford, 2007: 3-4).

Në linjë me këtë që e paraqet Crawford, se shteti është fakt dhe se njohja ose mosnjohja, nuk paraqesin ndonjë kriter diskrecial, tregon edhe Neni i tretë i Konventës ku thuhet:

“Ekzistenca politike e shtetit është e pavarur nga njohja nga shtetet e tjera. Edhe përpara njohjes, shteti ka të drejtë të mbrojë integritetin dhe pavarësinë e tij, të sigurojë ruajtjen dhe prosperitetin e tij, dhe rrjedhimisht të organizohet ashtu siç e sheh të arsyeshme, të nxjerrë ligje mbi interesat e tij, të administrojë shërbimet e tij dhe të përcaktojë juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave të saj. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk ka kufizim tjetër përveç ushtrimit të të drejtave të shteteve të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare” (Konventa e Montevideos, 1933).

Ky nen i kësaj konvente flet për dy gjëra me rëndësi, e para është për pavarësinë e jashtme, e cila fitohet në momentin e krijimit të shtetit si fakt dhe e dyta ka të bëjë me pavarësinë për të zgjedhur sistemin politik dhe ndarjen e pushteteve të brendshme.

Konventa vazhdon t’i kushtojë vëmendje edhe në nenet vijuese ku në Nenin 6 të saj specifikon faktin se njohja e shtetit thjesht ka kuptimin e asaj që shteti njohës përmes njohjes ka pranuar personalitetin e tij e bashkë me të edhe të drejtat dhe përgjegjësitë që dalin nga e drejta ndërkombëtare, dhe si e tillë, njohja nuk mund të jetë e kushtëzuar ose e revokueshme (Konventa e Montevideos, 1933, Neni 6). Pos tjerash, Konventa ka paraparë edhe format se si mund të realizohet njohja dhe sipas Nenit 7, shtetet mund të njohin shtetin e ri në dy forma, e shprehur ose e heshtur, e nënkuptuar që është si rezultat i veprimeve që kryen shteti ndaj shtetit të sapo deklaruar.

Studiuesit kanë vënë re se mënyra se si janë caktuar kriteret e shtetësisë në Konventën e Montevideos është shumë joserioze, pasi këto kritere duken tepër abstrakte dhe joserioze sa për të caktuar standardet mbi të cilat do të krijohet shteti i ri. Derek Wong, duke u thirrur në qëndrimet e autorëve si Crawford e Grant, vjen në përfundim se kushtet e shtetësisë jo përherë paraqesin kushte të domosdoshme për të përcaktuar një përkufizim funksional për entitetin politik të deklaruar shtet, ose si elemente që për periudhën e tanishme janë jo të domosdoshme, përveç se edhe të pamjaftueshme (2013: 9).

Konventa e Montevideos, ka të ngjarë se ka dështuar të prodhojë një rregullsi të qëndrueshme sa i takon të drejtës ndërkombëtare lidhur me kriteret që e shtynë një entitet politik të deklarojë shtetin (Panayi, 2018: 1). Shtetet kur janë krijuar, në të shumtën e rasteve nuk kanë pasur një territor të definuar saktë dhe se pretendimi në zotërimin e një territori, sa kohë që i njëjti efektshmërisht nuk e kontrollon atë, tregon se ky kriter nuk është i qëndrueshëm.

Plotësimi i këtyre kriterëve të shtetësisë, sigurisht se mbetet i rëndësishëm, por edhe pas plotësimit të tyre, shteti mund të mos njihet, prandaj plotësimi i katër kriterëve nuk është matësi më i mirë i shtetësisë. Por ka diçka që është themelore në këtë aspekt, çështja është se nuk është mbajtur ndonjë konventë tjetër që do të përcaktonte kriteret e reja, të aplikueshme, prandaj deri atëherë shtetet do të priren të shohin plotësimin e kriterëve të shtetësisë bazuar në perspektivat e tyre.

Studiuesit tregojnë se ka një debat në lidhje me mungesën e këtyre kriterëve, duke vënë në pah nevojën për shtimin e të rejave, për të kompletuar standardet që do të tregonin për ligjshmërinë e krijimit të shtetit, bazuar në to. Këtë konsideratë e ka Chike Okosa, i cili konstaton se vetë përkufizimi i natyrës së shtetit, roli i njohjes ose jo, janë disa elemente që e bëjnë entitetin politik të deklaruar shtet vështirë të pranueshëm si i tillë, duke shtuar:

“Një përkufizim i qartë se çfarë do të thotë të jesh shtet nuk është kodifikuar në të drejtën ndërkombëtare. Kjo është ndoshta për shkak të natyrës së tij tejet subjektive; shtetësia është në fund të fundit një temë e ngarkuar politikisht dhe e ndjeshme, e që është subjekt i njëanshmërisë” (Okosa, 2018: 115).

Argumentimet e përgjithshme nga autorë të ndryshëm të së drejtë, si Grant, Vidmar, Crawford, Brownlie etj., konstatojnë se nuk mund të përgjithësohen kriteret e shtetësisë dhe se perspektivat e krijimit të shteteve të reja, sikundër edhe njohja e tyre, nuk janë standarde ngushtë të aplikueshme.

Vlen të përmendet qëndrimi që mban Brownlie, në lidhje me katër kriteret e shtetësisë, të cilat ai, në rastin më të mirë, thotë se mund të përdoren si bazë për diskutim të mëtejshëm, dhe se jo të gjitha këto kritere janë të nevojshme, por në disa raste duhet të përdoren edhe kritere të reja për të prodhuar përkufizim funksional (Brownlie, 2012: 423).

Pretendimet se shteti mjafton të jetë fakt e i mbështetur në katër kërkesat e shtetësisë del të jetë e pamjaftueshme, pasi ka kritere të reja që burojnë po ashtu nga e drejta ndërkombëtare, lidhen me ligjshmërinë e krijimit të shtetit, të tilla si: *shteti nuk mund të krijohet nëpërmjet përdorimit të forcës ilegale, duke shkelur të drejtën e vetëvendosjes ose ndjekjen e politikave raciste* (Okosa, 2018: 115).

II.4. Teoria konstitutive e njohjes së shtetit

Krijimi i shtetit është thënë se ka paraqitur në vazhdimësi një sfidë të madhe për rendin ndërkombëtar, pasi si i tillë, krijimi i tij ka prekur jo pak aspekte politike e territoriale, të cilat kanë implikuar pasoja si në rendin ndërkombëtar, ashtu edhe në të drejtën ndërkombëtare, për faktin se *është pikërisht natyra e paqartë e doktrinës së njohjes në të drejtën ndërkombëtare që ka ndikuar në debatin akademik* (Marrison, 1967: 857).

Kësisoj, njohja e shtetit ka këtë konstatim, sepse edhe njohja si akt, gjendet edhe sot, në mes të dilemave të mëdha teorike. Shteti ekziston vetëm duke u njohur, apo njohja konstaton një gjendje të re të krijuar në terren, është pyetja që duhet të shtrohet sa kohë flitet për shtetin dhe njohjen e tij.

Njohja e shtetit është trajtuar zellshëm në teoritë politike dhe si të tilla ato janë shërbyer edhe me qëndrime filozofike, si ato të Hegelit, që si përkrahës i sovranitetit absolut dhe pozitivizmit ortodoks, e lidh ekzistencën e shtetit me njohjen dhe sipas tij *shtetet hyjnë në marrëdhënie juridike me njëra-tjetrën në përputhje me vullnetin e tyre në bazë të aktit të njohjes* (Lauterpacht, 2012: 38).

Teoria konstitutive paraqet teorinë e parë që flet për rolin që ka njohja në konsolidimin e shtetësinë. Teoria konstitutive nisat nga fakti se shteti ekziston vetëm duke u njohur (Brierly: 1963), pra njohja është përcaktuese për shtetin. Një vëmendje të shtuar kësaj teme, i kanë kushtuar studiues të njohur si: Hans Kelsen, Lassa Oppenheim, William Slomanson, Malcolm Show, James Crawford etj.

Njohja e shtetit ka kuptim politik e juridik, me pasoja të brendshme e të jashtme, thotë studiuesi Fred Morrison (1961: 857), duke u thirrur në burimet e Kelsenit. Lassa Oppenheim, shkencëtari i njohur gjerman, konsideron se shteti është dhe bëhet person ndërkombëtar vetëm dhe ekskluzivisht përmes njohjes, prandaj shtetet që synojnë të ekzistojnë duhet të sigurojnë njohjen (Oppenheim, 1905: 109).

Teoricieni William Slomanson, konsideron se teoria konstitutive ngushtësisht e lidh njohjen e shtetit me konfirmimin e tij *de jure* si person juridik ndërkombëtar (2007: 76). Shkollari tjetër i njohur, Malcolm N. Shaw thotë se teoria konstituive e njohjes nuk është vërtet e pranueshme (2017: 206-207), por sido që të jetë, thotë ai, kjo teori i kushton vëmendjen kryesore aktit të njohjes duke shtuar:

“Teoria konstitutive pohon se është akti i njohjes nga shtetet e tjera që krijon një shtet të ri dhe e pajis atë me personalitet juridike dhe jo procesi me të cilin ai fitoi në të vërtetë pavarësinë” (Shaw, 2017: 330).

Studiuesi James Crawford, e ndërlidh problemin e njohjes dhe i kushton rëndësi asaj, gjithmonë duke u nisur nga perspektiva e teorisë konstitutive, ku thotë se rendi ndërkombëtar paraqet një sistem kur shtetet janë aktorët të cilët me veprimet e tyre politike e ruajnë rendin ndërkombëtar, prandaj edhe njohja e shtetit varet nga shtetet e tjera, të cilat përcaktojnë se kush mund të jetë subjekt i këtij rendi, përmes veprimeve individuale ose kolektive, duke krijuar atë që Crawford e cilëson si *efekti juridik përfundimtar* (2006: 20). Njohja bëhet pjesë e shtetësisë, thotë studiuesi Grant, ndërsa argumenton faktin se ajo nënkuptohet edhe si *diskrecion nga ana e shteteve ekzistuese për të krijuar shtete të reja* (1999: 1).

Sipas kësaj teorie, ekzistenca e shtetit varet nga njohja e tij që vjen nga aktorët shtete pararendëse, të cilat konfirmojnë përmbushjen faktike të kriterëve të shtetësisë, duke bërë që ato të veprojnë konform vullnetit të tyre politik. I këtij mendimi është edhe studiuesi Daniel Högger, i cili vë në pah dy elemente të kësaj teorie, fillimisht varshmërinë e ekzistimit të shtetit nga njohja që vjen nga shtetet e tjera dhe vullnetin politik të shteteve ekzistuese, të cilat veprojnë përherë politikisht, duke shtuar:

“Vetëm pasi shtetet e tjera të kenë konfirmuar se të gjitha kërkesat janë përmbushur, një shtet përfundimisht vjen në ekzistencë. Rrjedhimisht, subjekti që kërkon trajtim si shtet nga shtete të tjera ekzistuese varet nga vullneti i shteteve të tjera ekzistuese për ta njohur atë” (Högger, 2015: 25).

Nisur nga kjo, studiuesi Högger, tregon për klasifikimin ose krijimin e një grupi shtetesh të cilat nuk kanë një personalitet ndërkombëtar të plotësuar dhe i ndan shtetet në dy grupe,

ku grupin e dytë e përbëjnë “entitet” të cilat nuk kanë arritur të sigurojnë njohjen nga shtetet e tjera, pra mund të konstatohet se statusi shtet arrihet me njohjen (2015: 26).

Një entitet politik për të synuar shtetësinë, duhet të kompletojë disa elemente, si territorin, qeverisja mbi një popullatë të caktuar, por edhe aftësinë dhe gatishmërinë për të respektuar obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare, por këto nuk janë të mjaftueshme për teorinë konstitutive, thotë studiuesi Thomas Grant (2019:2), i cili konsideron se këto *kritere janë kot në mungesë të njohjes* dhe shton se *njohja perfeksionon shtetësinë*.

Por ka edhe prej atyre që konsiderojnë se entiteti politik duhet të sigurojë njohjen, ata pretendojnë se ajo nuk është kriteri themelor për shtetësinë, por pavarësisht kësaj entitetet politike vazhdojnë të kërkojnë me këmbëngulje njohjen, sigurisht edhe pranimin në organizata ndërkombëtare. Këtë qëndrim e paraqet studiuesi Visoka (2021: 143), i cili thotë se *pa dyshim, njohja është një kusht i domosdoshëm i shtetësisë sovrane bashkëkohore, por jo përbërës i shtetësisë në vetvete*. Shtetet e kërkojnë njohjen, por ajo nuk lidhet vetëm me kriteret që janë përcaktuar për arritjen e shtetësisë, ndërsa procesi më shumë lidhet edhe me kritere të tjera, që u përmenden më lart.

Njohja ka gjetur vend në shumë trajtime që janë bërë, në perspektiva të ndryshme, qoftë që lidhen me efektin e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare, ose në krijimin e paqes, por edhe në sistemin ndërkombëtar dhe në teorinë politike. Autori Jens Bartelson (2016), e përmend njohjen duke e konsideruar atë në tri kuptime, si:

- *Së pari, përdoret zakonisht për të shpjeguar se si shtetet dhe identitetet e tyre formohen nga ndërveprimi, dhe se si sistemi modern ndërkombëtar është shfaqur si pasojë e grumbulluar e modeleve të tilla të ndërveprimit. Në këtë kontekst, koncepti i njohjes përdoret për të shpjeguar se si shtetet individualizohen dhe diferencohen nga njëri-tjetri, si sistemi ndërkombëtar shtresohet në vija të statusit, si dhe pse konfliktet mbi statusin janë të mundshme apo edhe të pashmangshme* (Bartelson, 2016).

Sipas këtij kuptimi, njohja paraqitet si domosdoshmëri për entitetet politike, si sjellje individuale e shteteve ekzistuese ndaj rastit të ri të krijuar dhe si sjellje individuale që kapërcen vijat e së drejtës ndërkombëtare.

- *Së dyti, megjithëse koncepti i njohjes ka pasur prej kohësh një vlerë të gjerë brenda teorisë juridike ndërkombëtare, ku përdoret për të llogaritur atë që i bën shtetet persona juridikë dhe anëtarë të barabartë të shoqërisë ndërkombëtare, studimet e fundit kanë bërë shumë për ta komplikuar këtë pikëpamje duke vënë në dukje se si praktikat e përfshirjes shpesh kanë ecur paralelisht me praktikat e përjashtimit dhe se si kjo ka çuar në një shtresim informal të shoqërisë ndërkombëtare (Bartelson, 2016).*

Kjo pikë, e paraqitur nga Bartelson, ka kuptimin e një dykuptimësie të standardeve të aplikuara në rastin e njohjes, ku janë paraparë shumë raste ose rrethana që kanë promovuar ose përjashtuar njëra-tjetrën.

- *Së treti, koncepti është përdorur së fundmi për të sugjeruar se si mund të zbuten apo edhe të shmangen pasojat e padëshiruara të anarkisë ndërkombëtare përmes njohjes reciproke ndërmjet komuniteteve politike (Bartelson, 2016).*

Sipas kësaj pike, njohja i afron shtetet me entitetet politike, duke i barazuar ato si bartës të së drejtave dhe detyrimeve në të Drejtën Ndërkombëtare, ku si subjekte të barabarta, ato mund të funksionojnë si duhet, duke respektuar të drejtat dhe detyrat e tyre themelore. Shtetet nuk e njohin entitetin politik, duke vonuar deklarimin për njohje, siç kanë bërë në shumë raste, madje ato ndihen të lira dhe veprojnë kështu, pavarësisht ndikimeve që mund të kenë këto veprime në raportet ndërkombëtare.

Brownlie, konstaton se sipas teorisë konstitutive, *një shtet nuk ekziston as ligjërisht pa njohje formale*, duke thënë se personaliteti i një shteti, në kuptimin e ekzistencës, varet nga qëndrimi politik që do të kenë shtetet e tjera ndaj entitetit politik që pretendon shtetësi, madje pavarësisht nëse shteti pretendues ka arritur t'i plotësojë këto kritere (1973: 89-108).

Njohja e shtetit, ka qenë sfida më e madhe me të cilën janë përballur shtetet në raport mes vete dhe në politikat e tyre, kjo ka reflektuar edhe në kornizën teorike dhe në vetë të drejtën ndërkombëtare, sa konsiderohet se ky fenomen është ngatërruar dhe keqpërdorur, është përdorur politikisht, si mekanizëm presioni, është paraqitur si enigmë e pazgjidhshme politike dhe e së drejtës, por edhe arenë e trajtimeve teorike e ballafaqimeve mes shkollarësh e teorish, sikur një miniaturë e ballafaqimeve mes shteteve (Brown, 1950: 617).

Nga ajo çka u tha më lart, mund të konstatohet se njohja është mekanizëm i domosdoshëm për shtetet e sapo krijuara, është e paplotësuar dhe ka shumë kuptime, në

aspektin teorik dhe në fund është një mundësi për të prodhuar paqe e siguri në rendin ndërkombëtar.

II.5. Teoria deklarative e njohjes së shtetit

Shteti është aktori kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare, ndërsa krijimi dhe njohja e tij janë proceset më të ndjeshme politike, për aq kohë sa ato prekin interesat e shteteve, raportet gjeopolitike, sistemin dhe rendet ndërkombëtare. Kështu dëshmohet se ky proces më shumë varet nga marrëdhëniet ndërkombëtare dhe se shteti nuk është produkt i së drejtës, por i rrethanave jashtë tij (Bokor-Szegő, 1998: 268), ndërsa njohja e një shteti të deklaruar si i pavarur (sipas teorisë deklarative) është një akt politik, që paraqet thjesht konfirmimin e një subjekti të ri ndërkombëtar (Crawford, 2006: 22), që ka hasur në jo pak polemika me përkrahësit e teorisë konstitutive.

Sot e kësaj dite, ka njëfarë debati të madh, ndoshta edhe të vjetruar mes teorisë deklarative e asaj konstitutive, në lidhje me njohjen dhe efektin e saj, por, sido që të jetë, ky debat do të vazhdojë të jetë po aq i rëndësishëm, edhe për shkakun se deklarimi i njohjes së pavarësisë, *sjell pasoja të ndryshme juridike* (Talmon, 2004: 101).

Në një plan tjetër analitik, teoritë mund të ndihmojnë në krijimin e bazës konceptuale në lidhje me proceset politike, ndoshta për të prodhuar një kornizë koherente, përmes së cilës do të mund të shpjegohen veprimet e shteteve që ndërmerren në marrëdhëniet ndërkombëtare. Por studiuesit e shohin si shumë ambicioze përpjekjet për të kornizuar aspiratat dhe pritshmërinë e shteteve përbrenda një modeli të vetëm, pasi shtetet, sikur njeriu, veprojnë në mënyrë jokonsistente (Schoiswohl, 2004: 32).

Njohja sa i takon kornizave teorike paraqet një ballafaqim mes “njohjes si çështje e një fakti”, ose “njohjes si çështje e një ligji”, sikundër edhe ekzistenca e shtetit, varet po ashtu nga i njëjti raport, pra shteti lidhet me efektin e veprimit, që paraqet faktin e ri të krijuar në terren. Ligjshmëria e shtetit si krijim i një subjekti të së drejtës, nuk është i parëndësishëm, por duket se ka mbetur nën hijen e efektivitetit, prandaj njohja e shtetit, sipas kësaj teorie nuk paraqet asgjë më shumë se sa një konstatim të faktit.

Kjo pikëpamje, ndonëse e re, ka hasur në një ballafaqim të vazhdueshëm me teorinë konstitutive e cila, njohjen nuk e lidh me konstatimin e një fakti, por me konstituimin e tij, pasi një shtet nuk mund të ekzistojë për sa kohë nuk i plotëson kriteret e shtetësisë, bazuar

në të drejtën ndërkombëtare, prandaj nuk mund të njihet. Pra, shteti nuk vihet në dilemë për shkakun se nuk është njohur, por për shkakun se nuk janë krijuar bazat e shtetësisë që kërkojnë njohje.

Njohja e shtetit duhet të shihet nga plani i veprimit politik dhe i kufizimit të caktuar nga e drejta ndërkombëtare. Duke qenë se për njohjen e shtetit duhet të ketë paraprakisht përmbushje të kriterëve të shtetësisë. Përmbushja e këtyre kriterëve mbetet e diskutueshme sa kohë që nuk ka një autoritet më të lartë e të fundit që do të përcaktonte ekzistencën meritore të shtetit, si produkt të kompletimit të suksesshëm të këtyre kriterëve.

Çfarë do të thotë të njohësh një shtet, ose një entitet politik të shpallur rishtazi, në një realitet kur veprimi i caktuar politik nga shtetet ekzistuese do të prodhojë efekt juridik? Këto janë disa nga dilemat që janë trajtuar nga studiuesit e njohur si Lauterpacht, i cili konsideron se duke e njohur një shtet, në fakt është konstatuar se kriteret e shtetësisë janë përmbushur suksesshëm, pra konstatohet një fakt. Përmbushja e kriterëve për shtetësi, i obligon shtetet ekzistuese të bëjnë njohjen, sepse është krijuar fakti i pamohueshëm konform rendit dhe të drejtës ndërkombëtare. Pra, shtetet këtu janë autoriteti kryesor i munguar i rendit ndërkombëtar dhe ushtruesit efektiv të subjektit kryesor në të drejtën ndërkombëtare (Lauterpacht, 1944: 385).

Përvoja e Kosovës qëndron në mes të teorive deklarative dhe konstituive të njohjes, ku njëkohësisht lidhshipi politik promovon ekzistencën e shtetit të Kosovës pavarësisht nga njohja dhe punon në konstituimin e legjitimitetit ndërkombëtar dhe anëtarësimin në shoqërinë ndërkombëtare përmes njohjes diplomatike dhe anëtarësimit në organizata rajonale dhe ndërkombëtare (Newman & Visoka, 2018: 371).

Sipas teorisë deklarative, një entitet politik do të njihet si shtet që në rastin kur janë plotësuar kriteret e shtetësisë, si posedimi i popullatës rezidente, territorit, qeverisë dhe aftësisë për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare, të precizuar në Konventën e Montevideos, prandaj shtetet e tjera thjesht kanë pranuar një fakt të kryer. Duke qenë se kjo teori, fokusin e ka te fakti e jo te ligji, disi duket e mangët në trajtimin gjithëpërfshirës të fenomenit.

KAPITULLI III

PERIUDHA PARA PAVARËSISË DHE NDIKIMI I SAJ NË PROCESIN E NJOHJES

Krijimi i shtetit të Kosovës kishte kaluar nëpër disa faza të cilat kur mblidhen krijojnë një shumësi faktesh (Borgen, 2008: 1), të cilat ky vend do të mund t'i përdorë në procesin lobues për sigurimin e njohjes si veprim që do të ofronte paqe dhe siguri për rajonin (Abazi, 2008: 67), pasi gjetja e një statusi politik të qëndrueshëm për Kosovën, sigurisht se shihet si një faktor i rëndësishëm për stabilitetin në rajonin e Ballkanit dhe se përmes saj do të parandaloheshin veprime të caktuara terroriste e ndalim i krimit të organizuar (Toshev & Cheikhameguyaz, 2005: 273).

Sido që të jetë, Kosova nuk kishte arritur të fitonte njohjen e pavarësisë as pas përfundimit të Bisedimeve të Vjenës, rrjedhimisht as përmes OKB-së si mbështetëse e tyre, ndërsa konsiderohet se mbajtja e qëndrimeve ekstreme në negociata ishte parë që në fillim si sfida kryesore që do ta përcjellë procesin dhe përfundimin e tyre (Weller, 2008: 659-681).

Sido që të jetë, procesi paraprak kishte kaluar mes dilemave themelore të pozicionit të shteteve kryesore të botës, që kishte vazhduar po të njëjtin qëndrim edhe gjatë periudhës së para statusit duke e dobësuar shumë besueshmërinë ndaj tyre, por edhe duke e ulur pritshmërinë se ato do të mund të prodhonin status politik për Kosovën.

Bashkësia ndërkombëtare ishte në një pozicion politik jo të favorshëm në Kosovë, por edhe ndaj Kosovës (Buja, 2001: 435), pasi proceset politike kishin rrjedhur asisoj që do të mund të kishin asi efekte të cilat edhe e sfiduan gjithë projektin, ndërsa legjitimiteti politik i misionit ndërkombëtar, sidomos ai i UNMIK-ut, kishte filluar gradualisht të zbehet, përjashtimisht kohës kur ky mision udhëhiqej nga Soren Jesen Petersen (Selaci: 2020: 162).

Procesi politik i krijimit të shtetit të Kosovës, si produkt i të gjitha zhvillimeve paraprake, ishte dëshmuar se mund të dilte jashtë kontrollit, prandaj edhe argumentimet e Grupit të Kontaktit ishin se *“koha në Kosovë po skadonte”* (Weller: 2011: 319). Kësisoj, procesi politik kishte kaluar nëpër disa momente kryesore që kishin ndikim reciprok, sidomos Rezoluta 1244 deri te Pakoja e Ahtisaarit.

a) Rezoluta 1244 e KS-OKB-së

Krijimi i shtetit të Kosovës dhe procesi i njohjeve të saj, ka kaluar nëpër disa faza të cilat shpesh janë paraqitur si mundësi dhe si pengesë në të njëjtën kohë. E tillë është Rezoluta 1244 e KS-OKB-së për Kosovën. Kjo rezolutë ishte ardhur në shprehje pas ndërhyrjes së NATO-s, dhe përmes së cilës Kosova do të vendosej në një administrim ndërkombëtar (Weller, 2011, 299), dhe e cila nga ky administrim, po i përcaktonte asaj kornizën politike nga ku do të zgjidhej statusi politik (Borgen, 2008: 1).

Por kjo rezolutë ka mbetur “në fuqi”, pasi KS i OKB-së, nuk ka mundur të gjejë zgjidhje politike për efektet që janë krijuar nga Negociatat e Vjenës dhe Pakoja e Ahtisaarit, përmes së cilës përcaktohej statusi politik i vendit. Kësisoj, kjo rezolutë ka vazhduar të mbetet si një pykë, e cila është përdorur si baza, fillimisht për të krijuar institucionet politike të Kosovës, që do të shpallnin pavarësinë, por edhe si rezoluta e cila do të mbetej e vlefshme për Serbinë edhe pas deklarimit të Kosovës si shtet. Kjo gjendje politike tregon se ka një rast unik kur ekzistojnë dy sisteme juridike konkurruese, ku secila nga to pretendon se ka legjitimitet dhe supremaci në Kosovë (Muharremi, R. 2014: 719).

Serbia e ka parë Rezolutën si mundësi e mbajtjes së Kosovës, pasi ajo kërkon që statusi politik të dalë nga marrëveshja politike e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, duke iu referuar preambulës së rezolutës *“që konfirmon përkushtimin e të gjitha shteteve anëtare ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë”* (Borgen, 2008: 2).

Rezoluta sido që të jetë kishte efekt pozitiv, sidomos sa i takon krijimit të institucioneve vetëqeverisëse të Kosovës, thekson Vidmar, i cili duke analizuar Rezolutën 1244, konstaton kjo rezolutë promovon zgjidhjen përfundimtare të statusit dhe kjo rezolutë përmes Kornizës Kushtetuese bën mbikëqyren e institucioneve të Kosovës të cilat do të dilnin nga zgjedhjet demokratike, duke u bërë efektshmërisht institucionet që përmes marrjes së kompetencave, bartëset e vullnetit politik të qytetarëve të Kosovës, kësisoj mbajtja e zgjedhjeve, krijimi i institucioneve dhe fillimi i jetës institucionale nga IPVQ-ja, e mënjanoi praktikisht kontrollimin efektiv të Kosovës pasi ato kishin kompetenca mbi territorin e Kosovës të cilat mund të jenë të krahasueshme me ato të autoriteteve të shteteve sovrane; pavarësisht se të njëjtat institucione mbikëqyreshin nga autoriteti i UNMIK-ut (Vidmar, 2021: 797).

Mandati i institucioneve që dëlnin nga rezoluta ishin të pashembullta, për OKB-në në historinë e saj, jo vetëm për shkakun e administrimit që po i bënin një territori të tillë, por edhe për shkakun se ato ishin faktori kryesor lokal në procesin politik të zgjidhjes së konfliktit, thotë Alexandros Yannis, i cili argumentin e vijon:

“Roli i administratës ndërkombëtare ishte të zëvendësonte autoritetet jugosllave në territorin e Kosovës dhe të merrte përgjegjësinë e plotë të përkohshme administrative. Detyrat kryesore të UNMIK-ut ishin: (1) krijimi i një administrate të përkohshme civile funksionale, duke përfshirë ruajtjen e rendit dhe ligjit; (2) të promovojë vendosjen e autonomisë dhe vetëqeverisjes substanciale, duke përfshirë mbajtjen e zgjedhjeve; dhe (3) për të lehtësuar një proces politik për të përcaktuar statusin e ardhshëm të Kosovës” (Yannis, 2004: 67).

Rezoluta 1244 është e shkruar me një gjuhë të balancuar dhe kompromisi, duke krijuar dykuptimësi në pjesën më të madhe të saj dhe si dokument duket tepër tranzitor, por pa një strategji dalëse, duke u thirrur edhe në Marrëveshjen e Rambujesë, e cila kishte po ashtu dykuptimësi, pasi si e tillë ajo krijonte kornizat e një marrëveshjeje që cilësohej si gjithëpërfshirëse për ushtrimin e të drejtës së vetëvendosjes nga shqiptarët e Kosovës, por pa e përmendur këtë term, por kishte referencat e qarta për integritetin territorial të RFJ-së (Vidmar, 2021: 793).

Sfida kryesore që kishte rezoluta ishte se ajo për dallim nga Marrëveshja e Rambujesë nuk parashihte kornizën kohore të përfundimit të veprimit të saj, për të marrë një vendim lidhur me statusin, ajo ishte më pak rigoroze dhe kishte mundësi të interpretimit, por sido që të jetë ajo i jepte më shumë kompetenca misionit dhe vendorëve, duke e minuar ndikimin e Beogradit mbi Kosovë (Balcer, 2003: 50).

Sido që të jetë, statusi final për Kosovën nuk varej nga gatishmëria politike e institucioneve të saj për të treguar kapacitete politike qeverisëse, sikundër nuk i takon as bashkësisë ndërkombëtare të tregojë se zhvillimi i institucioneve funksionale e përshpejton statusin politik të vendit, institucione këto që ishin më të denja se në shumë vende të botës, por dominimi i tyre nga UNMIK-u, do të dëshmohej si i dëmshëm, do të prodhoheshin tensione sociale, politike e paqëndrueshmëri ekonomike (Williams, et al., 2003: 2).

Perspektiva e shqiptarëve ndaj Rezolutës 1244 ishte jo shumë shpresëdhënëse, por sido që të jetë ajo u pa edhe si mundësia e pezullimit efektiv të sovranitetit të Serbisë mbi Kosovën, në anën tjetër, shqiptarët ishin të sigurt se ajo nuk do t'i shpinte ata drejt objektivave të tyre politike, ndërsa një zgjidhje e caktuar që bie nën pavarësi do të ishte e papranueshme, pasi kjo zgjidhje do t'i jepte mundësi Serbisë për t'u rikthyer në Kosovë (Lehne, 2009: 1).

Kjo gjendje sikur krijoi tensione fillimisht ndaj ndërkombëtarëve, institucioneve vendore dhe "të gjithëve", që po e mbanin Kosovën si peng në mungesë të strategjisë dalëse, për çka mund t'i ketë kushtuar edhe në pozicionimin e saj në negociatë, por edhe pas saj, në procesin e lobimit për njohje.

b) "Trazirat e Marsit" 2004

Vonimi i gjetjes së një zgjidhjeje politike për statusin e Kosovës duhet të shihet nga disa perspektiva, e para lidhet me paqartësinë orientuese të institucionet e Kosovës që njiheshin si IPVQ, edhe pse ato treguan përkushtim dhe profesionalizëm, pasi procesi u pa si mundësi e krijimit të statusit politik dhe bashkë me të edhe ngritja e institucioneve (Geci, 2008: 25), por të cilat në mungesë të kompetencave kryesisht kishin rol marginal, rol që mbulohej nga bashkësia ndërkombëtare, me theks të veçantë UNMIK-u.

Duhet të trajnohet edhe roli që kishin zhvillimet globale, sikundër edhe roli që kishte Serbia, e cila duke ndjekur qasjen doktrinare, kishte dashur të aplikonte, pra pamundësi për të prodhuar zgjidhje politike të qëndrueshme, rrënim i procesit të konsolidimit të shoqërisë kosovare, duke u thirrur në Rezolutën 1244, që serbët e lexonin si mekanizmi përmes të cilit e ruanin integritetin territorial mbi Kosovën (Borgen, 2008: 1-5), por edhe për të dobësuar pozicionin politik të liderëve kosovarë në bisedime që do të ndodhnin më vonë, duke mos i trajtuar ata si të barabartë (Balcer, 2003: 51-55), por shqiptarët e Kosovës, nuk do të lejonin asnjë zgjidhje politike tjetër pos pavarësisë dhe çdo alternativë politike, do të ishte fatal jo vetëm për Kosovën, por edhe për gjithë Ballkanin, dëshmi ishin "*Trazirat e Marsit*" 2004 (Weller, 2011: 319).

Pavarësia për Kosovën, nuk kishte alternativë së paku jo për ata që e kishin ndjekur rrjedhën e procesit politik të saj, për këtë këmbëngulte sidomos SHBA-ja, e statusin e ardhshëm politik të Kosovës e shihte si reflektim të ngjarjeve politike paraprake dhe sipas institucioneve amerikane:

“Në dritën e konflikteve të viteve 1990, pavarësia është e vetmja mundësi e mundshme për të promovuar stabilitetin në rajon” (US – Departament of state: 2008).

Krijimi i shtetit të Kosovës kishte kaluar përmes shumë të panjohurash strukturore dhe politike, që lidhen me gjetjen e rrugës së qëndrueshme politike që do të prodhonte statusin politik të pritur, aq me tepër kur “Trazirat e Marsit” treguan se situata politike e Kosovës nuk mund të vonohej, prandaj edhe gjetja e një zgjidhjeje të caktuar politike kishte mbetur alternativa e vetme, para se i gjithë procesi do të dështonte.

Fakti se procesi u vonua tregonte se kishte pasur disa probleme ose pengesa strukturore e politike që nuk lejonin rrjedhën e tij, së paku nuk parashihej një strategji dalëse për institucionet e kohës, sidomos ato ndërkombëtare, por në anën tjetër tregonte se statusi si përmbajtje do të varej nga ngjarjet që ajo krijoi.

“Trazirat e Marsit” kishin ngjallur reagime të shteteve që ishin përfshirë në disa forma në Kosovë, të atyre që e përkrahën dhe e atyre që kundërshtonin atë si proces dhe si projekt, duke treguar po ashtu se ky ballafaqim do të ndiqej edhe në procesin vijues, fillimisht gjatë negociatave e me vonë edhe në atë të njohjes.

Studiuesi Daniel Serwer nga Instituti për Paqe i Shteteve të Bashkuara, në vërtetimin që i bën “Trazirave të Marsit”, identifikon se kjo ngjarje kishte pasur shumë efekte, pro dhe kundër rrjedhës së proceseve dhe rreshtimeve që do të rishfaqen, sipas tij kjo ngjarje kishte bërë që:

“...diskutimi është polarizuar mes atyre që mbrojnë pavarësinë e menjëhershme të Kosovës dhe atyre që duan ta mbyllin këtë mundësi. Të parët argumentojnë se trazirat demonstrojnë se Kosova nuk mund të mbahet në harresë për shumë më gjatë dhe se protektorati ndërkombëtar duhet t'i lërë vendin vetëvendosjes. Këta të fundit argumentojnë se sjellja e keqe nuk duhet të shpërblehet, se multietniciteti në Kosovë ka dështuar dhe se e vetmja perspektivë për mbajtjen e popullatës serbe në Kosovë vjen nga ndarja fizike e serbëve nga shqiptarët dhe ruajtja e sovranitetit serb” (Serwer, 2004).

Kjo gjendje politike imponoi gjetjen e një strategjie dalëse e cila në fakt më shumë duket si mekanizmi i menaxhimit të krizës së shkaktuar, se sa një plan real për të prodhuar zgjidhje, fjala është për “standardet para statusit”, që parimisht do të thoshte hyrje në një

fazë të re e cila nuk do të ishte shumë shpresëdhënëse, për shkak se kërkesat e paraqitura si standarde do të varehin nga kapacitetet e limituara të IPVQ-së, ndërsa ndasia e madhe ndëretnike ishte rikonfirmuar rishtazi.



Figura 4. Përleshjet mes grupe protestuesish, shqiptarë e serbë. 18 mars 2004 / CBS NEWS

Instituti për Paqe i Shteteve të Bashkuara (2004), kishte paraparë se kjo ngjarje, kishte pasur ndikim edhe te rikonfigurimi i skenave politike në Kosovë e Serbi, në dy rrafshje, e para në Serbi kjo ngjarje mund të ketë ndikuar në ardhjen në pushtet të forcave nacionaliste, ndërsa në Kosovë, kjo ngjarje do të përcillej me standardet para statusit, që do të thoshte një status-qoa të ri, që kërkonte bashkëveprim të forcave politike në vend, duke lënë jashtë nacionalistët shqiptarë që do të rreshtoheshin më pas në kuadër të një lëvizjeje politike e njohur si “Vetëvendosje” dhe e cila kërkonte që statusi politik i saj të ishte shprehje e vullnetit politik të qytetarëve të Kosovës.

c) “Standardet para statusit” – “Standardet për statusin”

Për të dalë nga situata e paqartë politike e juridike për shkak të obstrukcioneve që bënte Rezoluta 1244, nga shefi i misionit të UNMIK-ut, Michael Steiner, u paraqit ideja e strategjisë “Standardet para statusit” si formulë politike përmes së cilës Kosova do të mund të fliste për statusin politik të saj, vetëm pasi të ishin plotësuar kërkesat që dilnin nga ato

(Balcer, 2003: 51). Këto standarde kishin një efekt të madh për të siguruar mbështetje në procesin vijues, pasi komuniteti ndërkombëtar i kushton shumë vëmendje standardeve të tilla, përmes së cilave entitetet politike arrijnë që përmes përvetësimit të këtyre standardeve si norma demokratike, të fitojnë mbështetje ndërkombëtare deri te vetëvendosja (Gardner, 2011: 45).

Për Kosovën standardet para statusit kishin shumë rëndësi, sepse me to konfirmonte te partnerët e saj gatishmërinë për të marrë obligime ndërkombëtare, ishte tregues se “Trazirat e Marsit” ishin një moment i keq i rrugëtimit të Kosovës dhe se pasojat e saja do të rikuperohen edhe me investimin e institucioneve të vendit, të cilat synonin me këmbëngulje të rindërtohej imazhi i ri i shoqërisë që do të ndërtohej, ndërsa në atë kohë kryetari i PDK-së dhe ish-lideri i UÇK-së, Hashim Thaçi, kishte kërkuar të fillohej një debat me serbët lokalë, projekt i cili nuk u zbatua, thotë studiuesi Borgan, duke vijuar:

“...Koncepti shumë etnik i Kosovës është i lidhur me çështjen e bisedimeve të drejtpërdrejta ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për çështje rreptësisht teknike, të cilat UNMIK-u shpreson se do të ndihmojnë në ndërtimin e besimit të ndërsjellë. Megjithatë, të dyja palët i qasen këtyre bisedimeve me kujdes për shkak të dallimeve radikale në pikëpamjet e tyre për çështjen kyçe të statusit të ardhshëm të Kosovës” (Borgan, 2003: 53).

Plotësimi i standardeve për statusin kishin rëndësi të madhe për gjithë procesin, pasi përmes tyre Kosova do të kapërcente status-qoa-n që sapo kishte hyrë, me besimin se e ardhmja e shpejtë do ta gjente atë në një fazë të re politike, sigurisht me afër statusit. “Trazirat e Marsit” kishin treguar se situata politike nuk lejonte më fleksibilitet politik, UNMIK-u e kishte humbur rolin e tij në Kosovë dhe se shkalla e plotësimit të standardeve para statusit nuk ishte më shumë relevante (Ker-Lindsay & Economides, 2012: 78-79).

Me një rezolutë në fuqi, por e cila nuk parashihte mundësinë e gjetjes së statusit, me një ndasi të madhe politike mes serbëve dhe shqiptarëve në raport me statusin politik të Kosovës, me institucione ndërkombëtare pa strategji dalëse e me një legjitimitet politik të dobësuar, standardet para statusit do të mund të shiheshin si mundësi për të çuar përpara procesin politik pavarësisht shkallës së plotësimit të tyre.

“...Rezoluta 1244 e KS të OKB-së nuk e zgjidhi statusin e kontestuar të Kosovës, por bëri thirrje që statusi të shqyrtohej në një kohë të papërcaktuar pas krijimit të një qeverie autonome. Pothuajse të gjithë shqiptarët etnikë duan pavarësinë e Kosovës; serbët thonë se Kosova mbetet pjesë integrale e Serbisë. Në mesin e vitit 2005, OKB-ja filloi një rishikim gjithëpërfshirës të standardeve të Kosovës, ose standardeve të progresit” (Kim & Woehrel, 2007: 1).

Standardet para statusit, si dokument strategjik kishte të bënte me tetë kushte kryesore që Kosova do të duhet t’i përmbushte si: ekzistenca e institucioneve demokratike efektive, përfaqësuese dhe funksionale; zbatimi i shtetit të së drejtës; liria e lëvizjes; kthimet e qëndrueshme të refugjatëve dhe personave të zhvendosur dhe respektimi i të drejtave të komuniteteve; krijimi i një baze të shëndoshë për një ekonomi tregu; zbatimi i drejtë i të drejtave pronësore; dialogu i normalizuar me Beogradin; dhe transformimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në përputhje me mandatin e saj, por ky dokument kishte një rol edhe për një aspekt që pak trajtohet, atë të evropianizimit të Kosovës, e njohur si “e ardhmja evropiane e Kosovës” pasi në fakt këto standarde ishin të nivelit evropian duke dëshmuar dy gjëra, se Kosova është çështje e Evropës (Hoxhaj, 2021) dhe se në të ardhmen shtetet kryesore që e njohin atë janë nga Evropa (Atakara, 2022: 75).

Këshilli i Sigurimit, e ka mbështetur vazhdimisht atë që ata e quajnë politika “Standardet para Statusit”, përmes së cilës ky mekanizëm jetëson rezolutën 1244, ndërsa konsideron se fokusi kryesor që duhet të arrihet përmes plotësimit të tyre është ndërtimi i një shoqërie multietnike, me qëndrueshmëri politike dhe demokratike (S/PRST/2004/13).

ç) Raporti i Kaii Eide

Plotësimi i standardeve do të duhet të formalizohej përmes një raporti gjithëpërfshirës për t’i hapur rrugë procesit të bisedimeve politike, prandaj për këtë çështje Sekretari i OKB-së, Kofi Annan, kërkoi nga diplomati norvegjez Kaii Eide, përpilimin e një raporti për shkallën e plotësimit të standardeve (23 majit 2005 (S/2005/335)) të cilin norvegjezi Eide e paraqiti si te Këshilli i Sigurimit me 25 tetor 2005 përmes Raportit S/2005/635.

Ambasadori Eide, kishte vë në dukje fillimisht rolin që kishte UNMIK-u, duke thënë se ky rol gradualisht duhet të reduktohet në raport me forcimin e institucioneve të Kosovës, të cilat duhet të barten përgjegjësitë. Sipas tij, i menjëhershëm duhet të jetë fillimi i gjetjes së zgjidhjes politike për statusin e Kosovës, mes Prishtinës dhe Beogradit, ndërsa raporti i tij u

miratua, disa gjetje ishin me shumë rëndësi, sidomos sa i takon pozitës së pakicave (Kim & Woehrel, 2007: 10).

Serbia, “Trazirat e Marsit” i ka parë si mundësi që gjatë procesit që do të vijonte, të rritet shkalla e decentralizimit të pushtetit për serbët lokalë, kjo edhe mund të ketë pasur përkrahje sidomos nga shtetet që hezitonin ta përkrahnin projektin e Kosovës, të cilat edhe u shtynë nga kjo ngjarje që të besojnë se politika e standardeve për statusin është e dështuar dhe se mundësia për bashkëjetesë është vënë në pikëpyetje, prandaj institucionet serbe kërkuan që të krijohet njëfarë ndarje etnike në Kosovë me qëllimin që serbëve t’i jepet autonomia në vetëqeverisje (Kim & Woehrel, 2007: 10). Serbët madje edhe e kishin bërë këtë, duke themeluar “Bashkësinë e komunave serbe të Kosovës dhe Metohisë” (Balcer, 2003: 55), përmes së cilës paraqisnin politikën e re serbe për Kosovën duke ndërmarrë këto veprime:

1. *Paraqitjen e idesë për ndarje;*
2. *Ristrukturim të pakicës serbe në Kosovë;*
3. *Krijimin e faktorëve etnikë në terren;*
4. *Krijimi i lidhjes strukturore Serbi – “Bashkësinë e komunave serbe të Kosovës dhe Metohisë”, për t’i arritur këto objektiva:*
 1. *Ndarjen etnike – me qëllim të rrënimit të shoqërisë multietnike, të lirë e demokratike;*
 2. *Ndarje administrative territoriale – mbi baza etnike;*
 3. *Ndarjen e Kosovës.¹¹*

Në anën tjetër, standardet para statusit parashihnin tekstualisht ndërtimin e një shoqërie multietnike, me bazë demokratike e me një sistem të qëndrueshëm politik (S/PRST/2004/13), çka ishte pikërisht e kundërta e asaj që kishte ndodhur në marsin e 2004, ku dështuan institucionet, u rishfaqën ndarjet e mëdha etnike të cilat me pas do të mund të “sanoreshin” vetëm përmes decentralizimit me bazë etnike përmes Pakos së Ahtisaarit.

Sido që të jetë, raporti siç thuhet edhe te Deklarata e Presidentit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, vë në dukje disa elemente me rëndësi, si nevojën e madhe për vazhdimin e plotësimit të standardeve, nevojën për një shkallë të lartë të decentralizimit, kërkesën për institucionet e Kosovës për angazhim të shtuar në proces dhe në fund mirëpret angazhimin e

¹¹ Disa nga këto ide, janë paraqitur nga Daniel Serwer, në raportin e tij “Kosovo: Status with Standards” të botuar me 15 prill 2004, për më shumë: <https://www.usip.org/publications/2004/04/kosovo-status-standards>

Grupit të Kontaktit për rolin e tij aktiv në procesin vijues drejt statusit final të Kosovës (S/PRST/2005/51).

Qëndrimin e kishte mbajtur Eide, ishte i qartë, sipas tij standardet duhet të shihen si mundësi e kalimit në fazën e ardhshme politike dhe se mosarritjet eventuale në këtë proces nuk duhet të shihen si pengim për statusin, pasi nuk ka moment më të mirë se sa tash për të arritur gjetjen e statusit politik, konstatonte ambasadori norvegjez, Eide, dhe se përmes tij (negociatave) do të ishte shumë e mundshme që të arrihet plotësimi i tyre, duke shtuar:

“Nuk do të ketë asnjë moment të mirë për të trajtuar statusin e ardhshëm të Kosovës...Megjithatë, një vlerësim i përgjithshëm çon në përfundimin se ka ardhur koha për të filluar këtë proces... Kërkohet urgjentisht progres i mëtijshëm në zbatimin e standardeve. Nuk ka gjasa që shtyrja e procesit të statusit të ardhshëm të çojë në rezultate të mëtijshme dhe të prekshme” (UN Doc. S/2005/635, 7).

Ishte e qartë se Kosova kishte hyrë në fazën e re politike dhe do të duhej fillimisht të kornizohej dialogu dhe të gjente udhëheqësin e negociatave mes Kosovës dhe Serbisë.

d) Grupi i Kontaktit – Korniza politike për statusin

Duke qenë se nuk kishte mekanizma të tjerë politikë, OKB-ja përmes Këshillit të Sigurimit mirëpriti angazhimin e Grupit të Kontaktit, i cili kishte qenë aktiv edhe në disa procese të tjera në botë, e sidomos në Bonje e Hercegovinë. Sa i takon problematikës së Kosovës, Grupi i Kontaktit kishte paraqitur qëndrimin se anëtarët pajtohen që të ketë një rishikim zyrtar të statusit të Kosovës kah mesi i vitit 2005, varësisht nga arritja e standardeve, por edhe nga gatishmëria e palëve të interesuara që të prodhohet statusi politik për vendin (Woehrel & Kim, 2004: 7).

Ky mekanizëm politik do të kishte rol sidomos në vendosjen e kornizave politike nga ku do të dilte statusi i ardhshëm politik i Kosovës. Grupi i Kontaktit i përbërë nga Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Federata Ruse (Contact Group: 2005), menjëherë paraqiti udhërrëfyesin që duhej të ndiqej nga palët për të arritur deri te statusi politik, të deklaruar nga Grupi i Kontaktit për të ardhmen e Kosovës, ku ndër të tjera thuhet:

“Parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit të nëntorit 2005 e bëjnë të qartë se nuk duhet të ketë: të mos ketë kthim të Kosovës në situatën e para 1999-ës, të mos ketë ndarje të Kosovës dhe të mos ketë bashkim të Kosovës me ndonjë ose një pjesë të një shteti tjetër” (Archive of US Department of State, 2006).

Kornizimi politik i statusit ishte parë me sy skeptik nga të gjitha palët, si Kosova ashtu edhe Serbia, të cilat sido që të jetë nuk do të arrinin maksimumin e tyre në negociata dhe se qëndrimet e tyre politike do të jenë pak të rëndësishme, për përparimin e negociatave, por mjaft domethënëse në keqpërdorimin e tyre.

Angazhimi i Grupit të Kontaktit tregonte se OKB-ja nuk do të mund të luante rol aktiv së paku jo në prodhimin ose gjetjen e një statusi politik për shkak të polaritetit të madh që përfaqësonte ai, madje kjo sikur edhe nuk ju pëlqente disa vendeve evropiane të cilat sikur u ndien të përjashtuar nga mospërfshirja e tyre në proces. I këtij mendimi është Stefan Lehne, i cili Grupin e Kontaktit sido që të jetë e sheh si një qasje koherente për kohën por edhe e balancuar, ndërsa edhe pse GK-ja, funksiononte si “grup”, shtetet mbanin qëndrimet e tyre të njohura, që vareshin nga historia e angazhimit të tyre në shpërbërjen e Jugosllavisë, në procesin e çlirimit të Kosovës dhe të rindërtimit të saj, deri te statusi politik, duke vijuar të argumentonte:

“Ajo përfshinte SHBA-në, e cila duke pasur parasysh rolin e saj gjatë luftës së 1999-ës u perceptua nga Prishtina si mbrojtëse e interesave të shqiptarëve të Kosovës, por edhe Rusia, me simpatitë e saj të qarta dhe të hapura për Beogradin. Ai përfshinte shumicën e anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si dhe vendet dhe organizatat, të cilat në mënyrë operative bartën barrën më të rëndë për stabilitetin e Kosovës dhe të rajonit” (Lehne, 2009: 3).

Britania e Madhe - Roli i mbretërisë ishullore, ishe i shumëfishtë, si në raportet me Kosovën, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu edhe përmes diplomacisë multilaterale, ku ishte njëri nga shtetet që mbronin vizionin e krijimit të shtetit të Kosovës, duke qenë përkrahëse e madhe në tri momente kyçe, te standardet për statusin, te kornizimi i statusit dhe te përkrahja e Propozimit të Ahtisaarit (Doyle, 2013: 6-8).

Shteti britanik kishte treguar angazhimin më të madh dhe të vendosur në arenën ndërkombëtare për herë të parë në Kosovë që nga lufta e dytë botërore, përmes administratës Bleir, pavarësisht shkallës së ballafaqimeve të brendshme sa i takon edhe përdorimit të forcës, të cilat ata e lidhin me mbrojtjen e të drejtave humanitare në rastin e Kosovës (Keohane, 2007: 78).

Kur trajtohet rolin i britanikëve, sidomos gjatë luftës së Kosovës, tregohet se ata ishin madje projektuesit e një fushate lobimi për ndërgjegjësimin e audiencës sidomos të NATO-s, madje kishin paralajmëruar se nuk përjashtonin edhe sulmet ushtarake tokësore ndaj Serbisë, si formë e bindjes së saj për ndalimin e veprime agresive në Kosovë, por edhe për të shtyrë partnerët e NATO-s, të mos duken të luhatshëm në operacionin e Kosovës (Dixon, 2003: 83).

Britania e Madhe, te rasti i Kosovës mund të thuhet lirisht se ka qenë përcaktuese për të gjitha proceset politike që ka kaluar vendi, duke qenë e koordinuar me amerikanët, por edhe me partnerët e tjerë evropianë, duhet të përmendet sidomos angazhimi në kuadrin e NATO-s, ishte shtytësja kryesore (bashkë me SHBA-në) e agjendës së statusit të Kosovës, duke mos u fshehur prapa qëndrimi se pavarësia duhet të jetë rezultati përfundimtar i gjithë procesit, por britanikët ndihmuan edhe në fazën vijuese, atë të sigurimit të njohjeve të reja (Ker-Lindsay, 2015: 24-25).

Franca - Pothuajse perceptimet e para të rolit të Francës përherë lidhen me raportet që ajo ka kultivuar me Serbinë, që duken shumë të zmadhuara, pasi shteti francez politikën e saj të jashtme nuk e lidh me shtete të veçanta, por me raportin që ndërton ndaj shteteve të fuqishme, ndërsa synon që duke qëndruar si e tërhequr të përcaktojë zhvillimin e politikave kontinentale, së paku.

Te rasti i Kosovës, Franca ka kërkuar përherë zgjidhje të pranueshme për palët, diçka që në rrjedhën politike të kohës ka qenë e paarritshme. Kjo e ka minuar pak pozitën franceze, pasi mbajta e një kursi të tillë, nuk e faktorizon realisht në mënyrë aktive shtetin francez. Franca ka hezituuar të përmendë statusin final për Kosovën duke u mjaftuar me “një status special”, për të siguruar edhe pozicionin politik serb që për Francën llogariten si me rëndësi për stabilitetin e Ballkanit (Couture, 2014: 8).

Franca ka synuar që të veprojë si e pavarur ndaj ndikimit të jashtëm, te rasti i Kosovës, por jo vetë, duke e dëshmuar këtë edhe në rastin e mosndërhyrjes në Afganistan dhe Irak, që dëshmon se ajo dhe SHBA-ja, në qendër të mospajtimeve të tyre e kanë sigurinë ndërkombëtare (Skrpec, 2003: 93).

Gjermania – E sapo dalë nga bashkimi i saj, shteti gjerman, e gjeti veten mes dilemave kryesore se si do të duhej të vepronte në Kosovë, fillimisht si angazhim ushtarak, pasi kishte një peng që i kishte mbetur si pasojë e qëndrimit që ajo kishte në raport me politikën e saj të jashtme sa i takon përdorimit të forcës ushtarake, që nga Lufta e Dytë Botërore.

Qeveria gjermane e kohës, ishte rreshtuar krah aleancës ushtarake të udhëhequr nga SHBA-ja, por prerësit e partive politike që udhëhiqnin koalicionin qeverisës gjerman (Gerhard Schröder dhe Joschka Fischer) vazhdimisht kishin protestuar kundër përdorimit të forcës ushtarake, deri kur u desh që edhe vetë ata që merrnin pjesë në të (Uwe Friedrich, 2000: 2), duke bërë që kjo ngjarje të ishte treguese e kursit të ri politik që do të ndërmernte shteti gjerman, sigurisht pas votimit në parlamentin kombëtar.

Ndërhyrja në Kosovë, do të mund të ishte edhe një mundësi tjetër e lejimit të angazhimit ushtarak të përligjshëm, të cilin veprim qeveria gjermane e kishte cilësuar si strategjik në procesin e konsolidimit në politikën e jashtme dhe të përdorimit të ushtrisë, si mekanizma të menaxhimit dhe zgjedhjeve të konfliktit (Hamilton & Morina, 2014: 14).

Gjermania, fillimisht ishte e angazhuar në kuadër të Grupit të Kontaktit, prandaj qëndrimi i saj ishte me peshë të madhe politike, sepse ky mekanizëm kishte mundësinë që të përcaktonte kornizat e statusit të ardhshëm politik të Kosovës (Perritt, 2005: 8).

Gjermania, sa i takon statusit politik të Kosovës, sidomos pas “Trazirave të Marsit” 2004, kishte dhënë disa indikacione se si e shihte zgjidhjen e statusin politik. Këto ide politike silleshin mes opsionit të protektoratit evropian mbi Kosovë (të propozuar nga opozita), ndjekjen e politikës së standardeve para statusit dhe në fund, një jo për pavarësinë si zgjidhje e menjëhershme, kjo e fundit nuk është thënë zyrtarisht, por sido që të jetë të dyja tregojnë se pavarësia e plotë në periudhën afatshkurtër nuk ishte opsion për Gjermaninë (Toshev & Cheikhameguyaz, 2005: 295-296).

Italia - Shteti italian, nga shtetet e Grupit të Kontaktit, kishte afërsinë gjeografike me shtetet e Ballkanit, prandaj siguria e saj varej edhe nga stabiliteti i tyre. Italia ishte e interesuar që të shihte paqen dhe qëndrueshmërinë politike të Ballkanit, si mundësi e ruajtjes së stabilitetit të saj (MPJ- Itali).

Italia, ndaj Kosovës, duhej të aplikonte një politikë e cila u gjet mes dy dilemave themelore; e para si normë e lejimit të ndërhyrjes humanitare dhe e dyta, norma që e përshkruan çdo ndërhyrje pa autorizim nga KS-OKB, si të ndaluar, prandaj mes qëndrimeve pro e kundër, vlen të përmendet qëndrimi që kishte mbajtur Masmo D’Alema, i cili këtë

veprim politik e shihte si reagim në favor të aleancës, prestigjit dhe interesit kombëtar (Verbeek & Giacomello, 2011: 167).¹²

Në një analizë të veprimit të shteteve të Grupit të Kontaktit, studiuesit e cilësojnë si *model i integruar*, i cili përfshin një ballafaqim mes *teorive të veprimit kolektiv, bilancit të neorealizmit të kërcënimit, opinionit publik dhe strukturave institucionale të qeverisë* (Auerswald, 2004: 631). Te rasti i Kosovës, shtetet kanë ndërmarrë veprime, ose jo të ndërvarrura nga veprimet politike të anëtarëve të grupit, jo vetëm ndaj rastit, por edhe si reagim ndaj veprimeve politike mes anëtarëve viza-vi, njëri-tjetrit. Duke qenë pjesë e Grupit të Kontaktit, ka nënkuptuar se Italia duhet të sillet me prestigj, e qartë në objektiva dhe e arsyeshme në veprim, me ç'rast zgjedh të arsyetohet se Italia ka obligime nga Aleancës së NATO-s dhe parimeve të humanitetit” (Crocì, 2000: 42).

Shtetet e Bashkuara të Amerikës - Shteti i Kosovës ishte parë si mundësi e vetme e krijimit të paqes në Ballkan, por edhe si një e drejtë për popullin e Kosovës, që kishte përjetuar dhunë sistematike nga aparatura shtetërore serbe, që e kishte detyruar NATO-n të ndërhynte edhe ushtarakisht, vijon argumentimi që shteti amerikan bënte në momentin e njohjes. Por njohja nga Shtetet e Bashkuara u pa si momenti më i rëndësishëm që po i ndodhte Kosovës në historinë e saj, pra njohja (nga SHBA-ja) ishte parë si po aq e rëndësishme sa edhe shpallja e pavarësisë (Hamilton, 2008).

Njohja e shtetit të Kosovës, do të kishte pasoja për zhvillimet ndërkombëtare, prandaj edhe qëndrimi i shtetit amerikan ishte i qartë, i deklaruar në momentin e konfirmimit të njohjes. Për ta, shteti i Kosovës nuk lidhet me një ngjarje, nuk është shembull i zakonshëm, por një shumësi faktesh që lidhen me shpërbërjen e Jugosllavisë, e spastrimit etik e krimeve kundër civilëve, por edhe një vend i cili doli nga një administrim ndërkombëtar, duke e bërë Kosovën të pakrahasueshme me rastet e tjera, deklaronte sekretarja amerikane e shtetit Condoleezza Rice, duke shtuar se Shtetet e Bashkuara do të jenë përkrahësi i ngushtë i saj (US – Department of State Archive: 2008). Deklarimet e tilla nga sekretarja amerikane u panë edhe si tregues se si do të vijonte procesi i njohjes së pavarësisë, pasi ky shtet:

¹² Davidson, J. W. (2011). Italy at War: Explaining the Italian Contribution to the Kosovo War (1999). Italy's Foreign Policy in the Twenty-first Century: The New Assertiveness of An Aspiring Middle Power, 153-173.

“...ka pasur një histori të gjatë përfshirjeje në Kosovë, që daton që nga konfliktet në Ballkan gjatë viteve 1990 dhe që kur Kosova shpalli pavarësinë e saj, të cilën Shtetet e Bashkuara e kanë njohur (Morelli, 2018: 2).

Rusia - Ka dashur që rastin e Kosovës ta përdorë për disa elemente kryesore strategjike, fillimisht për të përcaktuar zhvillimin e ngjarjeve politike shumë larg zonës së saj, e dyta të rishfaqet politikisht si fuqi diplomatike dhe të provojë fillimisht të delegjitimojë ndërhyrjen si shkelje brutale e së drejtës ndërkombëtare (Yesson, 1999: 11).

Shumica e liderëve politikë perëndimorë, duke kujtuar ndikimin që ka (mund të ketë) Rusia, kanë dashur që përmes afrimit të saj në struktura politike globale të vendimmarrjes të shmangin ballafaqimin me të. Kjo vlen sidomos te Kosova, e cila u përdor si rast i mirë i këndelljes diplomatike ruse, ndërsa me t’u konsoliduar ajo, gati dhjetë vite pas shembjes së Bashkimit Sovjetik tregoi hapur se të gjitha veprimet politike që do të ndodhnin në periudhën pasuese do të varen nga qëndrimi i saj, sidomos në KS-OKB.

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s mbi caqet serbe u pa me zemërim të madh politik e qytetar në Rusi, duke i bërë presion mbi presidentin rus të kohës, Boris Yelcin, për të ndërmarrë hapa konkretë për ndaljen e këtyre veprimeve që ishin të parat në historinë e NATO-s, duke i shtyrë rusët të besojnë se ndërrimi i qasjes doktrinare ushtarake të Aleancës së Atlantikut do të jetë rrezik për vetë Rusinë, e cila do ta pasojë një ditë atë që po ndodhë në Serbi (sot) (Cross, 2001: 2).

Qëndrimi rus ndaj Kosovës ishte i qartë, ajo dëshironte dhe këmbëngulte se çdo zgjidhje politike e statusit të Kosovës, duhet të jetë në pajtim me qëndrimin serb, duhet të jetë në pajtim me Rezolutën 1244, dhe se dhënia e pavarësisë si zgjidhje politike do të thoshte intensifikim i spastrimit të qytetarëve serbë nga Kosova, duke paralajmëruar se do të përdorej vota në KS-OKB (Antonenko, 2007: 5-6). Rusia dha impaktin e saj të ri në procesin vijues në Kosovë, raportin Kosovë – Serbi, por edhe të të gjithë perëndimit.

Rusia kishte pësuar fiasko në rastin e Kosovës, duke mos qenë në gjendje të përcaktonte asnjë nga linjat e saj të interesave strategjikë, që duket se ka qenë një lexim i mirë i situatës kur ajo ftohet, ndërsa kundërshtimet e saj nuk duhet të shihen si pengesë, pasi ato vinin nga ngurtësia e paaftësia. Dinamika politike e situatës në Kosovë pas luftës së saj ndryshonte në raport me atë paraprake, prandaj Rusia do të përdorte tash ngadalësimin,

pengimin si strategji e cila do ta faktorizonte më pas në procesin vijues (Levitin, 2010: 130-131).

Grupi i Kontaktit, siç thuhet edhe me lart kanë dashur të krijojnë zgjidhje politike, ose ta përdorin atë për të kushtëzuar fillimisht procesin (sidomos Rusia e cila ka dashur që përmes dialogut ose të sfidojë diplomacinë perëndimore përgjithësisht), prandaj është dashur që procesi të kornizohet si një udhërrëfyes, por çka vërehet në proces është fakti se si është përcaktuar statusi final, i cili që në vendosjen e parimeve ka qenë i negociuar.

Shtetet e GK-së që në fillim ishin të ndara, me SHBA-në e BM-në, që kishin deklaruar paraprakisht se Kosova duhet të jetë shtet, me Francën që mbante qëndrimin se zgjidhja duhet të jetë një “status special”, Gjermania konsideronte se nuk duhet të jetë pavarësia e shpejtë si zgjidhje e fundit, në anën tjetër, Rusia, siç edhe pritej, shihte se zgjidhja duhet të jetë e negociuar, çka i shtyri shtetet e tjera të konsiderojnë se ajo dëshiron një proces pafund, sa kohë që dihej se çfarë qëndrimesh po mbanin palët në proces, elaboron studiuesi Stefan Lehne (2009: 3-4) duke vijuar argumentimin, që GK-ja paraqiti disa objektiva, që bien në rrafshin e kriterëve politike që do të gëzonte entiteti politik, statusi i të cilit po vendosej, për të entiteti i ri politik duhet të karakterizohet me kriteret si:

“...demokracia, multietniciteti, decentralizimi, përputhshmëria me perspektivën e BE-së, prania e vazhdueshme ndërkombëtare ... mospërdorimi i forcës, dialogu gjithëpërfshirës” (Lehne, 2009: 3-4).

Kriteret e paraqitura me lart janë përshirë të gjitha në Pakon e Ahtisaarit, por ato nuk prodhuan zgjidhje, Rusia kishte penguar secilin hap që do të shpinte në përfundim të procesit. Rusia mbante anën e Serbisë, ajo e përdorte KS të OKB-së për të bllokuar procesin, duke kundërshtuar secilën ide të anëtarëve të tjerë të GK-së, madje që nga fillimi kur u përcaktuan propozimet e kornizimit të dialogut, pastaj edhe te paketa e statusit final, ku përfshiheshin parimet udhëzuese, vlerat politike e demokratike, pozitën e pakicave dhe grupeve etnike, trashëgiminë kulturore e fetare, qëndrueshmërinë sociale dhe atë të rajonit (Weller, 2008: 25).

dh) Pakoja e Ahtisaarit – Kompromisi për njohje

Që në fillim dihej se Negociatat e Vjenës nuk do të prodhonin një zgjidhje të pranueshme për palët, sa kohë që ato mbanin qëndrime të ndryshme politike dhe nuk lëviznin

nga ato, pothuajse asnjëherë, veçanërisht Serbia, duke ofruar projekte e ide, të cilat nuk mund të zbatoheshin, pavarësisht kornizimit të opsioneve që ishin bërë nga Grupi i Kontaktit, paraprakisht.

Plani i Ahtisaarit nuk mund të pranohej, ky ishte qëndrimi rus, ky propozim nuk do të votohej në KS-OKB, dhe si i tillë nuk mund t'i imponohej palëve, prandaj me kërkesën e Francës u ideua një shtyrje gjashtë muajshe, për përfundimin e negociatave, për të pritur një mundësi të re të gjetjes së një zgjidhjeje politike për statusin e ri të Kosovës.

Kjo shtyrje u provua të kapitalizohej nga Serbia, e cila duke e ditur atë që ofronte pakojë si zgjidhje, provonte ta kundërshtonte atë duke ofruar një shkallë të re fleksibiliteti në qëndrimet e saj politike në raport me ato që e mbanin atë në fillim, ndërsa në planin e brendshëm, bënin ndryshime kushtetuese të cilat do të mund të përdroreshin më pas, gjatë proceseve vijuese (Weller, 2008: 1223).

Sa i takon gjithë procesit politik të negociatave për statusin, si proces ka qenë tepër elitare, duke pasur si prioritet shtetësinë, territorin ose kufijtë, si nga kornizimi paraprak, qasja e liderëve, shmangia e komunikimit nga poshtë-lart dhe kjo vërehet te të dyja palët, si te shqiptarët ashtu edhe te serbët, duke nënkuptuar se si proces nuk do t'i përfronte ata, pra qytetarët, aq me tepër kur nuk do të pranohej nga së paku njëra prej palëve (Kostovicova, 2008: 644).

“U bë e qartë se Serbia nuk do ta shuante kundërshtimin e saj ndaj pavarësisë së Kosovës. Rusia, duke parë mundësitë për të avancuar agjendën e saj gjeopolitike, filloi të distancohej nga anëtarët e tjerë të Grupit të Kontaktit. Ndërsa kundërshtimi rus ndaj Planit të Ahtisaarit u intensifikua dhe mundësia e një vetoje ruse në Këshillin e Sigurimit u bë më e madhe...” (Perritt, 2010: 172).

Kosova, duke qenë se nuk kishte shumë opsione e pa Pakon e Ahtisarit si një zgjidhje e cila sido që të jetë do të çonte te pavarësia dhe se mohimi i saj, parimisht do të nënkuptonte përmbysjen e procesit, ndërsa shpallja e pavarësisë pa marrë obligime nga procesi ndërkombëtar i statusit, do të nënkuptonte shmangie nga gatishmëria e krijimit të shtetit ku të gjithë ishin të përfaqësuar, dilemë kjo e kamotshme.

Serbia nuk e pranoi pakon, por përfitoi nga ajo, pasi komunat me shumicë serbe, me pranimin e Pakos së Ahtisaarit nga Kosova do të thoshte edhe krijimi i këtyre komunave, Kështu Serbia e Rusia filluan të shfaqin projektin e tyre të ri tash të minimimit të statusit politik të Kosovës, përmes:

- Ndryshimeve kushtetuese në Serbi;
- Refuzim kategorik për Pakon e Ahtisaarit;
- Pranim në heshtje i komunave me shumicë serbe...;¹³
- Pengim i votimit të Pakos së Ahtisarit në KS-OKB; dhe
- Përmbysje e gjithë procesit politik të statusit të Kosovës.¹⁴

Pakoja e Ahtisaarit paraqiste një propozim të atillë që i garantonte serbëve lokalë të Kosovës, vetëqeverisje të shkallës së gjerë duke i ofruar atyre kushte të mjaftueshme politike për të marrë pjesë në proceset e gjithmbarshme në vend (Sallova, 2017), kjo deri diku ndodhi, sidomos për serbët në jugun e Kosovës, të cilët morën pjesë në zgjedhje e u bënë pjesë e institucioneve të Kosovës, duke u akomoduar në realitetin e ri, por kishte edhe bindje se serbët e veriut nuk do të bashkëpunonin me institucionet e Kosovës (Deda, 2010: 89), por serbët që bashkëpunojnë me shqiptarët jetojnë nën kërcënim (Hoogenboom, 2011: 6).

Ndarjet etnike në Kosovë kanë reflektuar edhe në ndarjen e përgjithshme të Ballkanit, të cilat janë parë si mundësi, por edhe shtytje për ndarje të mëtejme në baza etnike në rajon. Kjo ndarje ka reflektuar edhe në ndarjen e madhe gjeopolitike që ka ndodhur në nivelin global. Shtetet që përkrahin Kosovën gjenden përballë shteteve që përkrahin Serbinë, prandaj kjo jep të kuptohet se te rasti i Kosovës është konfrontim gjeopolitik ndërkombëtar (Richter, 2012: 263).

Ky konfrontim nuk ishte i ri, sa kohë që i gjithë procesi politik ka kaluar mes debateve të mëdha akademike e ballafaqimesh teorike, qysh nga represioni serb, ndërhyrja e NATO-s, administrimi ndërkombëtar e shpallja e shtetit të Kosovës (Hilpold, 2012: 1), prandaj pritshmërinë për pranimin e Pakos së Ahtisaarit nuk mund ta cilësojmë si jorealiste, pasi vendosja e kufijve ka qenë burim konflikti dhe mirëmbajtja e tyre ose jo është thelbësore për sigurinë dhe rivendosjen e paqes (Bothe, 2012: 181).

¹³ Komunat me shumicë serbe ishin kompromisi kryesor që bëri Kosova në procesin negociues.

¹⁴ Weller, M. (2008). Kosovo's Final Status. *International Affairs* (Royal Institute of International Affairs 1944-), 84(6), 1223–1243. <http://www.jstor.org/stable/25144990>.

Rusia kishte provuar në çdo formë të pengonte kapërcimin e rastit të Kosovës nëpër KS të OKB-së, duke ofruar modele, ose alternativa të cilat dilnin jashtë realitetit kohor të procesit politik që po ndodhte atëkohë, si rishikimi i arritjeve të Kosovës konform Rezolutës 1244 e deri te shfaqja e shqetësimit lidhur me kthimin e ngadaltë të serbëve të Kosovës dhe jetesa e tyre e zyrtë (ICG, 2007: 4-5).

Shtetet e Bashkuara këmbëngulnin se shtyrjet e mëtejme të afatit të statusit do të prodhonin status-quo të re, por jo edhe mundësinë e gjetjes së zgjidhjeve, sepse nuk ka më mundësi për të prodhuar zgjidhje sa kohë që ka këto qëndrime, prandaj ajo që është paraqitur është një zgjidhje e imponuar (ICG, 2007: 6).

Serbia do të përdorte dialogun për të ruajtur status-quo-n, zgjidhjet që do të ofroreshin, në parim nuk do të paraqisnin objektivat serbe, kështu, procesi do të varet nga ndikimi i jashtëm të cilën sferë e mbulonte Rusia, e cila kërkonte me këmbëngulje një zgjidhje kompromisi. As konsumimi i 120 ditëve të tjera nuk prodhoi zgjidhje, Pakoja e Ahtisaarit, nuk do të votohej në Këshillin e Sigurimit, prandaj Kosova vetë do të merrte atë obligim dhe kështu statusin e saj politik e zgjidhte mbi një kompromis të cilin ajo e mori si obligim ndërkombëtar (Güner, 2021: 91).

Mesi i vitit 2007, tregohet si momenti vendimtar kur u dëshmuar se GK dhe KS i OKB-së, për shkak të qëndrimit rus nuk do të mund të prodhonin zgjidhje lidhur me propozimin e Ahtisaarit. Kjo i shtyri edhe më shumë autoritetet e Kosovës që të ideojnë shkëputjen e tyre, si përfundim i procesit politik (Ker-Lindsay, 2015: 1).

Vlen të përmendet se kishin filluar deklarime publike të shteteve kryesore si SHBA-ja, përmes presidentit Bush, në Tiranë, për mbështetje publike për pavarësinë e Kosovës, ku kishte thënë: *“Në të njëjtën kohë, më herët se sa vonë, duhet të thuash mjaft, Kosova është e pavarur”* (Zakaria & Tzortzi/ Reuters, 2007), prandaj Serbisë nuk i kishte mbetur tjetër pos të identifikonte skenarët e bllokimit, ose të pengimit të njohjeve të pavarësisë së Kosovës, e cila do të deklarohet shumë shpejt (Ker-Lindsay, 2015: 1), pavarësisht një shtyrjeje prej gjashtë muajsh, e kërkuar befasisht nga presidenti i Francës, kërkesë e cila u pranua nga G8 (Dempsey / New Your Times, 2007).

Mos paqartësive se si do të zhvillohej procesi vijues dhe duke parë se të gjitha format e tjera të deklarimit të shtetit të Kosovës ishin mbyllur, Kuvendi i Kosovës, mbledhet me 17 shkurt 2008, (Borgan, 2008: 2) në një seancë të jashtëzakonshme kur do të shqyrtohej një pikë e rendit të ditës, Shpallja e Pavarësisë së Kosovës.

Në deklaratën e pavarësisë së lexuar para Deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ndër të tjera thuhet:

Pika 1.

“Ne, udhëheqësit e popullit tonë të zgjedhur në mënyrë demokratike, me anë të kësaj deklarate e shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo deklaratë pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në përputhje të plotë me rekomandimet e të dërguarit të posaçëm të OKB-së Martti Ahtisaari dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës” (Kuvendi i Kosovës, 2008).

E Drejta Ndërkombëtare kur trajton shtetin, e cilëson atë si shumën e individëve që jetojnë përbrenda një territori ndaj të cilit ka efektshmëri të kontrollimit dhe janë organizuar politikisht nën një sistem politik sovran dhe shprehin gatishmëri për të marrë obligime ndërkombëtare,¹⁵ prandaj shkrimi i deklaratës në këtë mënyrë paraqet edhe plotësimin e kritereve të para të shtetësisë.

Pika 2.

“Ne e shpallim Kosovën republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e mosdiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe do të krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse” (Kuvendi i Kosovës, 2008).

Studiuesit e së drejtës ndërkombëtare kur trajtojnë krijimin e shtetit, pos kritereve themelore të shtetësisë, duhet të jenë të plotësuar me patjetër, por vendosin theksin te ajo se çfarë shteti po krijohet, duke u fokusuar në tiparet, vlerat dhe shkallën e demokracisë që

¹⁵ Dugard, J. (2021). "Chapter 5 What Is a State in International Law? How Is This to Be Determined?". In *Furthering the Frontiers of International Law: Sovereignty, Human Rights, Sustainable Development*. Leiden, The Netherlands: Brill | Nijhoff. doi: https://doi.org/10.1163/9789004459892_006. Shih edhe Gruda, Z. (2013). *E Drejta Ndërkombëtare Publike*. Prishtinë, ose Panayi, P. (2018). 'The state of a State - The ineffective application of the Montevideo criteria.

ajo përfaqëson, pozitën e pakicave dhe përfaqësimin e tyre në jetën politike dhe institucionale, proceset demokratizuese dhe shkallën e decentralizimit.¹⁶

Pika 3.

“Ne i pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përfshira në Planin e Ahtisaarit dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do t'i zbatojmë plotësisht ato detyrime, duke përfshirë miratimin me përparësi të legjislacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht ato që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”

Kosova, duke mos pasur zgjidhje tjetër, ka pranuar Pakon e Ahtisaarit si zgjidhje kompromisi, duke besuar se e njëjta është standardi më i lartë i qeverisjes dhe vlerave demokratike, duke e vënë jo pak në sfidim sistemin politik të saj, pasi serbët shpesh do të dëshmonen si keqpërdorues të të drejtave të tyre të garantuara me kushtetutë, për më shumë shih.¹⁷

Pika 4

“Ne do të miratojmë sa më shpejt që të jetë e mundur një Kushtetutë që ruan angazhimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, veçanërisht siç përcaktohet nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta do të inkorporojë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe do të miratohet përmes një procesi demokratik dhe konsultativ”.

¹⁶ Grant, T. D. (1999). The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution. United Kingdom: Praeger. Lauterpacht, H. (2012). Recognition in International Law. United Kingdom: Cambridge University Press. Weller, M. (2008). Kosovo's Final Status. International Affairs (Royal Institute of International Affairs 1944-), 84(6), 1223–1243. <http://www.jstor.org/stable/25144990>

¹⁷ Kostovicova, D. (2008) Legitimacy and international administration: The Ahtisaari settlement for Kosovo from a human security perspective. International Peacekeeping, 15 (5). pp. 631-647. ISSN 1353-3312. <https://doi.org/10.1080/13533310802396160>.

Pavarësia ofron perspektiva të arsyeshme për arritjen e qëllimeve themelore si të ndërhyrjes ndërkombëtare të vitit 1999, ashtu edhe të synimeve të OKB-së, kur ajo vuri në lëvizje procesin e Ahtisaarit.¹⁸



Figura 5. Momenti i Deklarimit të Pavarësisë së Kosovës

Burimi: Interneti

Reagimi serb ishte i pritshëm, ata përmes presidentit Tadic, dënuan aktin e shpalljes së pavarësisë, duke e cilësuar si të papranueshme, jo vetëm për Serbinë, por edhe për rendin dhe të drejtën ndërkombëtare, duke i listuar këto arsyetime në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurimit:

- Shpallja e pavarësisë është shkelje e Rezolutës 1244;
- Nuk është e drejtë që Serbia të penalizohet për shkak të Millosheviqit;
- Kosova nuk ka krijuar kushte për serbët, ata janë dëbuar masivisht nga Kosova;
- Njohja e Kosovës paraqet shkelje të Kartës së OKB-së dhe një precedent i rrezikshëm etj. (Tadic, 2008/ S/PV.5839).

Sipas Presidentit Tadic,

- **Serbia:** *“Republika e Serbisë nuk do të pranojë shkeljen e sovranitetit dhe integritetit territorial të saj. Qeveria e Serbisë dhe Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë e kanë*

¹⁸ Perritt, Jr., H. (2009). Kosovo's Future. In *The Road to Independence for Kosovo: A Chronicle of the Ahtisaari Plan* (pp. 221-254). Cambridge: Cambridge University Press. <https://doi.org/10.1017/CBO9780511635410.018>.

shpallur të pavlefshëm vendimin e autoriteteve të Prishtinës. Po kështu ne po marrim të gjitha masat diplomatike dhe politike për të parandaluar shkëputjen e një pjese të territorit tonë. Si një anëtare e përgjegjshme e bashkësisë ndërkombëtare e angazhuar për zgjidhjen paqësore dhe të negociuar të mosmarrëveshjeve, Republika e Serbisë nuk do të përdorë forcën. Asnjë krizë nuk është zgjidhur kurrë me sukses me forcë. Vetëm jetët njerëzore shkatërrohen me dhunë” (Tadic, 2008/ S/PV.5839).

Në mbledhjen e KS – OKB-së, shtetet listuan argumentet e tyre, pro dhe kundër:

- **Rusia**, përmes ambasadorit Churkin, tregoi për pozicionin politik që ka në raport me njohjen. Për Federatën Ruse, shpallja e shtetit të Kosovës është joligjore, prandaj njohja do të krijojë një precedent të rrezikshëm i cili nuk duhet të lejohet. Për Rusinë, *“Shpallja e njëanshme e pavarësisë dhe njohja e saj janë të papajtueshme me dispozitat e Aktit Përfundimtar të Helsinkit, i cili specifikon qartë parimet e paprekshmërisë së kufijve dhe integritetit territorial të shteteve. Dispozitat lejojnë ndryshime në kufijtë shtetërorë vetëm në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me mjete paqësore dhe me marrëveshje”* (Churkin, 2008/S/PV.5839).
- **SHBA** – përmes ambasadorit Khalilzad, njoftoi KS – OKB-në se Amerika e ka njohur Kosovën, që në ditën kur po mbahej mbledhja. Në arsyetimin e tyre, SHBA-ja tregoi se Kosova është rast unik, del nga shpërbërja e Jugosllavisë, del si produkt i spastrimit etnik të shqiptarëve nga shteti serb, i pasuar nga administrimi ndërkombëtar e deri te negociatat për statusin, të gjitha këto procese të kaluara përmes KS-OKB-së. Për SHBA-në, *“Shpallja e pavarësisë së Kosovës është një përgjigje logjike, legjitime dhe ligjore ndaj situatës në fjalë... Njohja e sovranitetit të Kosovës nga një numër i konsiderueshëm i qeverive të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të rajoneve të tjera në ditën e parë që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës ka siguruar që ky fakt të jetë i pakthyeshëm. Përpjekjet tona kolektive tani duhet të përqendrohen në punën konstruktive me Kosovën dhe Serbinë për t'i ndihmuar ata të hapin një faqe të re* (Khalilzad, 2008/S/PV.5839).
- **Kina** – Përmes ambasadorit Wang Guangya, paraqiti një qëndrim negativ ndaj statusit, duke u thirrur në qëndrimin se Rezoluta 1244 duhet të respektohet, duke kërkuar zgjidhje kompromisi e ulje tensionesh. *“Kina gjithmonë qëndron për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve përmes mjeteve politike dhe diplomatike dhe mbështet një zgjidhje të negociuar dhe të duhur të çështjes së statusit të Kosovës. Kina*

kundërshton veprimin e njëanshëm dhe kundërshton zgjidhjet e imponuara nga presioni. Kina gjithmonë ka pohuar se mënyra më e mirë për të zgjidhur çështjen e statusit të Kosovës është që të dy palët e interesuara të arrijnë një zgjidhje të pranueshme reciprokisht përmes negociatave. Ky duhet të jetë qëllimi i përbashkët i të gjitha palëve të interesuara” (Wang Guangya, 2008/S/PV.5839).

- **Britania e Madhe** – përmes ambasadorit Sir John Sawers, mbajti një qëndrim argumentues në favor të shtetit të Kosovës, duke numëruar të gjitha faktet e procesit politik që kishte kaluar vendi, duke kujtuar se pikërisht KS i OKB-së, ka miratuar Rezolutën 1244, për të larguar sovranitetin efektiv të Serbisë mbi Kosovën, për shkak të dhunës sistematike që ajo kishte ushtuar ndaj shqiptarëve. *“Brenda dy viteve nga miratimi i rezolutës, në Beograd erdhi në pushtet një qeveri e re, demokratike. Ajo qeveri dhe pasardhësit e saj kanë luftuar me trashëgiminë e krimeve të luftës së Millosheviqit. Ata kanë të drejtë të argumentojnë se nuk duhet të dënohen për ato krime. Por në të njëjtën mënyrë, ata kanë për detyrë të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga Millosheviqi dhe duhet të pranojnë se trashëgimia e shtypjes dhe dhunës së Millosheviqit e ka bërë të pamundur kthimin e Kosovës në kontroll nga Beogradi. Kur, në mes të procesit të statusit përfundimtar, Qeveria e Serbisë ndryshoi kushtetutën e saj për të përjashtuar çdo të ardhme të Kosovës jashtë Serbisë, ajo i dha fund çdo mundësie për një zgjidhje të negociuar” (Sir John Sawers, 2008/S/PV.5839).*
- **Franca** – përmes ambasadorit të saj Ripert, që në hyrje të fjalës tha se Franca e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe ju takon shteteve veç e veç të deklarohen lidhur me njohjen ose jo të kësaj deklarate, duke shtuar se shumë shtete evropiane e kanë bërë këtë ose pritet ta bëjnë. Franca mbajti qëndrimin e qartë duke thënë: *“Tani jemi përballë një realiteti të ri, i cili pa dyshim do të merret parasysh nga Këshilli i Sigurimit dhe Sekretari i Përgjithshëm. Edhe një herë, duhet të kujtojmë se kjo është një situatë unike, pasi shënon rezultatin e një procesi të veçantë historik: shpërbërja e ish-Jugosllavisë gjatë viteve 1990, e ndjekur nga një periudhë e administrimit ndërkombëtar nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Natyra e perspektivës së përbashkët evropiane që i ofrohet Kosovës dhe Serbisë është gjithashtu specifike për situatën në fjalë” (Ripert, 2008/S/PV.5839).*

III.1. Krijimi i shtetit të Kosovës dhe sfidat e para të sigurimit të njohjeve

Shpallja e shtetit të Kosovës e gjeti atë para sfidave të para për të siguruar njohjet. Fillimisht ishte thënë se deklarimi i pavarësisë do të ishte i koordinuar me bashkësinë ndërkombëtare, por koordinimi flet për *njohjen si veprim politik*, sigurisht në mungesë të mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë, prandaj Kosova do të ishte e sfiduar nga pretendimet se kjo shpallje ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Qëndrimi i Rusisë e i Serbisë ishte se nuk mund të ketë ndryshim të territorit të Serbisë pa vullnetin e saj dhe se njohja e dalë nga ky proces nuk është e ligjshme, por ky konstatim nuk është i saktë, pasi ka raste kur shteti ka humbur të drejtën e kontrollimit të territorit të saj për shkak të veprimeve sistematike kundrejt një grupi të caktuar etnik si te rasti i Kosovës, prandaj bashkësia ndërkombëtare ka arritur të pranojë ligjshmërinë e shkëputjes në rrethana të caktuara edhe për rastet e tjera (Borgen, 2008: 4), pavarësisht se ky koncept është ende i pa etabluar si duhet në të drejtën ndërkombëtare dhe shpesh është thënë se varet nga njohja ose jo e Kosovës.

Në fillimin e procesit të njohjeve të shtetit të Kosovës, betejat kryesore politike do të zhvilloheshin në domenin e ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë, pasi serbët/rusë duke pretenduar në Rezolutën 1244, por edhe te precedenti i rrezikshëm që do të mund të përdroreshin në rastet e tjera në botë, provuan të ndalnin ose vendosnin në diskutim ligjshmërinë e shpalljes, prandaj njohja në këtë rast, do të kishte efekte politike sa i takon rendit të ri ndërkombëtar, ndërsa konfirmimi i shtetësisë, do të konfirmonte bazën e shkëputjes si pjesë e të drejtës ndërkombëtare, thotë Daniel Fierstein, i cili argumentimin e vazhdon:

“Njohja e shpalljes së pavarësisë së Kosovës si ligjore do të sillte një masë të konsiderueshme përfundimtare në një situatë të trazuar dhe të pasigurt më parë në Ballkan. Globalisht, pranimi do të sqaronte, në vend që të vazhdonte të mbulonte, një parim legjitim dhe në zhvillim të së drejtës ndërkombëtare”
(Fierstein, 2009: 442).

Shtetet e Bashkuara dhe pjesa më e madhe e Bashkimit Evropian, ishin në favor të njohjes së shtetit të Kosovës, për SHBA-në që nga ndërhyrja humanitare, shteti i Kosovës lidhet me sigurinë kombëtare të saj (Murphy, 2003: 387), kurse lidhur me të, BE-ja kishte

dhënë edhe një opinion ligjor, ku ndër të tjerash thuhet se Rezoluta 1244 ka në frymën e saj statusin politik të Kosovës, ndërsa kjo rezolutë nuk përcakton ose kufizon statusin, duke mos e ndalur atë, pasi pretendimet për mbajtje të status qoa-s janë shkelje e vetë kësaj rezolute (Reynolds, 2008).

Krijimi i shtetit të Kosovës dhe vendosja e kundërshtarëve të saj para një akti të kryer, sikur krijoi edhe një bartje të debatit nga e drejta për shkëputje, në ligjshmërinë e njohjes së shkëputjes, duke bërë që tema të jetë njohja, për çka qëndrimet e evropianëve në këtë kohë duken që më shumë janë të rrafshit të teorisë deklarative, pasi ata, në opinionin e tyre, krijimin e shtetit e shohin si produkt të së drejtës, prandaj njohja e tij duhet të bëhet nga shtetet ekzistuese (Borgen, 2008: 4).

Kosova, në procesin e argumentimit të saj politik, tregon se shteti i saj është produkt i një procesi të gjatë që lidhet me shpërbërjen e Jugosllavisë (Warbrick, 2008: 675), me rrethana politike dhe zhvillime, në njërën anë dhe me pretendimet konkurruese në rajone me përbërës etnikë të ndryshëm, në anën tjetër (Bassiouni, 2017: 1), proces ky me ngjarje e vendime politike të cilat nuk mund të jenë shembuj për rastet e tjera, prandaj këto argumentime i pranuan shtetet e caktuara të cilat ishin të lidhura me rastin e Kosovës, në një ose mënyrë tjetër (Fierstein, 2009: 418/ Reynolds, 2008/Hoxhaj, 2021).

Serbia kishte vendosur që çdo veprim politik të kryer nga Kosova ta shpallte joligjore, aktorët politikë të Kosovës, pjesë e këtij procesi, u akuzuan për tradhti kombëtare, ndërsa ndaj shteteve që njihnin Kosovën, vendosën t'i shkëpusnin raportet diplomatike. Kjo nuk dha efekte, shtetet që kishin vendosur ta njihnin Kosovën e bënë këtë, ndërsa mund të cilësohej si arritje pozitive për Serbinë qëndrimi që u rikonfirmua nga Rusia e Kina, por edhe nga disa vende të Bashkimit Evropian se nuk do ta njihnin Kosovën (Ker-Lindsay, 2015: 3-4).

“Në mes të dy poleve të kundërta të opinionit qëndronin shumica e anëtarëve të OKB-së. Këto do të bëheshin 'shtetet e fushës së betejës'. Në disa raste, rezistenca ndaj njohjes së Kosovës ishte relativisht e fortë, por larg të qenit e pakapërcyeshme. Ndërsa nuk dëshironin të antagonizonin asnjë palë, shumë vende ushqenin shqetësime të thella në lidhje me implikimet e legjitimitetit të një akti të njëanshëm të shkëputjes. Ata mund të tërhiqen, por duhet të binden. Në të kundërt, një numër shtetesh të tjera dukej se ishin më të gatshme për të

njohur, por nuk donin të shiheshin për të nxituar në një vendim për çfarëdo arsye” (Ker-Lindsay, 2015: 3-4).

I gjithë procesi politik i krijimit të shtetit të Kosovës, nga fillesa e saj, deri te shpallja e pavarësisë, ka qenë proces i ndërlikuar, ku janë përfshirë aktorë vendorë e ndërkombëtarë, institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare, po ashtu, që patën qëndrime pro dhe kundër gjatë gjithë procesit. Këto qëndrime janë bartur nga një fazë në fazën tjetër, duke e bërë shtetin e ri, arenën e përplasjeve të fuqive të mëdha, në mënyrë të vazhdueshme. Komuniteti Ndërkombëtar, por edhe qarqet akademike kanë trajtuar jo pak këto dallime në procesin e shtet-krijimit, duke bërë që edhe vetë procesi i njohjeve të jetë po aq i vështirë dhe me këto dallime (Rahmani, 2014: 249).

Kosova dhe aleatët e saj provuan që argumentimin për njohjen e pavarësisë ta lidhin me faktin se Kosova paraqet një rast të pashembullt, *sui generis*, kjo për t’i bindur shtetet që kishin mëdyshje në lidhje me ligjshmërinë e shpalljes së shtetit të Kosovës dhe se njohja e saj nuk do të krijonte efekte për rastet e tjera (Ker-Lindsay, 2015: 3-4), siç pretendonte Rusia e cila dëshironte që përmes ngritjes së disa rasteve në zonën e ndikimit të saj të pengojë njohjen e Kosovës, duke e penguar kështu procesin me të rëndësishëm të diplomacisë perëndimore për kaq vite, veprime të cilat janë vetëm vazhdim i qëndrimit të saj të nisur së paku 25 vite para shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

“Politika ballkanike e Rusisë, duke përfshirë kundërshtimin e saj aktual ndaj pavarësisë së Kosovës, i ka rrënjët në historinë e kohëve të fundit. Lufta e përgjakshme në ish-Jugosllavi ishte testi i parë i diplomacisë post-sovjetike të Rusisë” (Antonenko, 2007: 7).

Mes dallimeve të theksuara që përbënin përkrahësit e shtetit të Kosovës (SHBA, BE) dhe kundërshtarëve të këtij procesi (Rusia, Kina, Afrika e Jugut), një pjesë e mirë e shteteve të botës do të gjendeshin në një pozicion të mesëm, të padeklaruara në lidhje me qëndrimin e tyre për shtetin e Kosovës, duke pritur efektet e saj (Newman & Visoka, 2018: 368).

Serbia, duke pasur përkrahës në disa struktura politike ndërkombëtare si në OKB (Rusinë, Kinën), Këshillin e Evropës (Rusinë, Spanjën, Greqinë, Sllovakinë, Qipron, Rumaninë); BE e NATO (Spanjën, Greqinë, Rumaninë), kishte penguar njohjen si veprim kolektiv, kishte

penguar po ashtu edhe anëtarësimin në këto organizata dhe shumë të tjera në vitet vijuese, Serbia dëshironte të ngadalësonte procesin e njohjeve (Ker-Lindsay, 2015: 1).

Njohja e shtetit të Kosovës mbeti në domenin e angazhimit diplomatik, sidomos ndaj shteteve të padeklaruara, të cilat bëhen objekt i angazhimit të diplomacisë së re dhe në ngritje të shtetit të ri, e cila përkrahej nga shtetet e fuqishme në zonat e tyre të ndikimit (Hoxhaj, 2021), prandaj njohja si proces do të varej nga aftësia e saj për argumentimin politik të shtetit mosnjohëse.

“Diplomacia bën ndryshimin dhe aftësitë e diplomatëve nga shtetet që kërkojnë njohje luajnë një rol të rëndësishëm në fitimin e njohjes. Kjo sugjeron që praktika e njohjes meriton më shumë vëmendje krahas faktorëve sistematikë, pasi mikrodinamika dhe politika e njohjes – shpesh duke reflektuar procese pragmatike mjaft të zakonshme – luajnë një rol të rëndësishëm në shpjegimin se ku dhe pse ndodh njohja” (Newman & Visoka, 2018: 368).

Studiuesit, politikanët por edhe aktorët e tjerë politikë, procesin e njohjeve e lidhin pikërisht me aftësinë bindëse të diplomacisë kosovare, nga mbështetja ndërkombëtare, por edhe nga dinamikat e brendshme të shteteve që mund të njihnin shtetin e Kosovës. Shkollarët Newman dhe Visoka, konsiderojnë se diplomacia kosovare ka qenë vendimtare në mobilizimin e mbështetjes ndërkombëtare për njohjen e saj (2018: 4).

Kreu i diplomacisë kosovare, Enver Hoxhaj, konsideron se diplomacia kosovare ka identifikuar secilin shtet potencial që mund të njohë shtetin e Kosovës, duke përcjellë secilin zhvillim politik brenda strukturave të atyre shteteve dhe duke kërkuar përkrahje nga shtetet aleate me ndikim në ato zona (Hoxhaj, 2021). Ndërsa diplomatja Alma Lama, konsideron se çdo veprim politik i shteteve në një moment të caktuar të zhvillimeve është varur nga realitetet politike të Kosovës, sidomos në raportet me Serbinë, ku çdo arritje ose ngecje ka çuar në ndryshimin ose jo të qëndrimeve për njohje (Lama, 2021/Hoxhaj, 2021).

Argumentet *pro pavarësisë* nga shtetet njohëse:

Njohja e shtetit të Kosovës përmes këtij procesi kaq të komplikuar ka bërë që shtetet të argumentojnë shumë mirë aktin e njohjes së tyre, ndërsa vërehet se shumica nga to do të kenë këto qëndrime:

- **SHBA-ja:**

E ka deklaruar njohjen e pavarësisë së Kosovës me 18 shkurt 2008 (MPJD, 2022, U.S. – Department of State Archive, 2008), të paraqitur nga Sekretarja e Shtetit, Condoleezza Rice, e cila në deklaratën e saj, ndër të tjera thotë:

“Në dritën e konflikteve të viteve 1990, pavarësia është e vetmja mundësi e mundshme për të promovuar stabilitetin në rajon. Shtetet e Bashkuara mbështesin Planin e Ahtisaarit dhe do të punojnë me partnerët e tyre ndërkombëtarë për të ndihmuar në zbatimin e tij” (Rice, 2008/, U.S. – Department of State Archive, 2008).

Presidenti Bush një ditë pas vendimit të SHBA-së për njohje, kishte numëruar argumentet politike pse shteti amerikan e ka marrë këtë vendim duke konsideruar se njohja e Kosovës do t’i kontribuojë paqes (President Bush, 2008/Deborah Charles - Reuters).

Shtetet e Bashkimit Evropian, nuk kishin arritur të tregonin një qëndrim të njehsuar, për shkak të disa shteteve që mbanin qëndrime politike të ndryshme dhe disa pretendime të brendshme, sidomos vlen të përmendet Spanja, prandaj ky dallim ndikoi edhe në zhvillimin e politikave të BE-së karshi shtetit të ri, duke i ngushtuar asaj planin e veprimit, por edhe duke e ndryshuar perceptimin ndaj Kosovës, me ç’rast ajo njohjen si tërësi e zëvendëson me investime (Lefteratos, 2022: 15).

Shtetet e Evropës, mbajtën qëndrime individuale si:

- **Mbretëria e Bashkuar:**

E ka deklaruar njohjen që ditën e parë të shtetit të ri, më 18.02.2008. Për MB-në, ishte shumë e rëndësishme që Bashkimi Evropian të tregohet unik, sa i takon njohjes së Kosovës, dhe jo si ishte në fillimet e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe njohjeve të shteteve që dolën nga ajo. Deklarimin se MB do të njohë Kosovën e ka bërë Sekretari i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar, David Miliband, i cili në prononcimin e tij tha:

"Plani është ta bëjmë këtë mbrëmje dhe më pas do të vendosen marrëdhëniet diplomatike... dhe gjatë ditëve dhe javëve në vijim do të vendosen të gjitha pikat e përfaqësimit të plotë diplomatik" (BBC, 2008).

Miliband, po ashtu tregoi se MB-ja ka kërkuar nga BE-ja të deklarohet njëzëri sa i takon problemit të Kosovës, duke bërë që njohja e vendit të ri të jetë kolektive, por duket që qëndrimi i Spanjës dhe i disa vendeve të tjera ka bërë që njohjet nga shtetet e BE-së të jenë individuale.

- **Franca**

Kishte qenë njëra nga shtetet kryesore gjatë gjithë procesit, duke treguar pozicionim jo shumë favorizues, sidomos ndaj përmendjes së “pavarësisë” si zgjidhje finale. Siç thuhet më lart, ajo kishte përmendur një status special, por kur Kosova deklaroi shtetin, ajo nuk ka hezituuar ta njoh atë, madje që në ditën e parë. Ishte presidenti francez Nicolas Sarkozy, ai i cili kishte nisur letrat kredenciale të njohjes së shtetit të Kosovës, te presidenti Fatmir Sejdiu, ku ndër të tjera thuhet:

“Kam nderin t’ju informoj se Franca, në pajtim të plotë me deklaratën e Bashkimit Evropian dhe duke tërhequr pasojat e rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 17 shkurt 2008, tani e njeh Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur” (Nicolas Sarkozy, Le Monde, AFP dhe Reuters).

- **Gjermania**

Ministria e Punëve të Jashtme Gjermane (2022), kur tregon për raportet diplomatike me Kosovën, ajo niset nga fakti se shteti gjerman ishte nga të parët që kishte njohur Kosovën, duke treguar qeveria dhe populli gjerman, kujtojnë qindra mijëra kosovarë të larguar nga Kosova, pas dhunës serbe, po ashtu kujton kohën kur shteti gjerman ishte angazhuar ushtarakisht e ekonomikisht në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës (Federal Foreign Office).

“Gjermania, e sheh pavarësinë si fundin e një procesi të gjatë dhe të vështirë të shpërbërjes të ish-Jugosllavisë”.

Qeveria gjermane kishte njohur Kosovën si shtet, më 20 shkurt 2008, ndërsa letrat kredenciale i kishte nisur presidenti federal Horst Koehler, drejtuar presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu, por menjëherë shteti serb kishte tërhequr nga Berlioni (Vjena), ambasadorin e tyre, si shenjë proteste për vendimin e marrë (DW, Reuters).

- **Italia**

Italia kishte mbajtur Mbledhje të Qeverisë, sikurse Gjermania, për të shqyrtuar kërkesën e Kosovës për njohjen e pavarësisë. Debati paraprakisht ishte mbajtur edhe në Senat, atje kur Massimo D'Alema, tregoi për qëndrimin e Italisë në raport me njohjen e shtetit të Kosovës. Sipas tij Italia e sheh të interesit kombëtar njohjen e Kosovës, një qëndrim të tillë e kishte mbajtur edhe në vitin 1999 kur kishte mbështetur angazhimin italian në kuadër të operacioneve të NATO-s,

“D'Alema është “autorizuar” nga Këshilli i Ministrave që t'i përgjigjet pozitivisht letrës me të cilën autoritetet kosovare kërkonin njohjen e shtetit të tyre si të pavarur. Italia do ta njohë pavarësinë e Kosovës “në kuadër të mbikëqyrjes ndërkombëtare” dhe Ministria e Punëve të Jashtme do të hyjë në marrëdhënie normale diplomatike” (Nigro, V/ La Repubblica.it, 2008).

- **Turqia**

Shteti turk e ka njohur Kosovën në ditën e parë të shtetësisë së saj, duke qenë ndër të parat shtete që është deklaruar pro njohjes. Në argumentimin që Turqia e bën për njohjen thuhet se janë vlerat kulturore, lidhjet historike e njerëzore ato që e bëjnë Kosovën të dallueshme në perspektivën turke. Në deklaratën e paraqitur pas vendimit për njohje, thuhet:

“Turqia i kushton rëndësi dominimit të një mirëkuptimi të qëndrueshëm të paqes në Ballkan, i cili ka përjetuar vuajtje të mëdha në vitet e fundit, dhe shpreson se pavarësia e Kosovës do të përbëjë gjithashtu një rast për përforcimin e atmosferës së stabilitetit dhe besimit midis vendeve të rajonit” (Çavuşoğlu, 2008/ Turkish MFA).

III.2. Njohja e shtetit të Kosovës si gjeopolitikë

Gjeopolitika ka ndikuar përherë në secilin veprim politik që kanë ndërmarrë aktorët, në mënyrë të vazhdueshme, ndoshta edhe prej kohëve të vjetra, pasi si e tillë ajo ka ndërlidhur një mori faktorësh, sidomos ndërveprimin që kanë gjeografia, historia dhe strategjitë, të cilat kanë prodhuar aso veprimesh politike që kanë pasur ndikim deri te siguria kombëtare (Sloan, 2017: 1). Veprimet politike të shteteve, kur flitet për gjeopolitikën, kanë prekur zona të caktuara gjeografike, historia e të cilave ka prodhuar tensione mes faktorëve në terren dhe të cilat kanë pasur edhe ndikim në rendin ndërkombëtar, si pjesë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Çdo veprim që një shtet ose shumë shtete kanë bërë, ka shtyrë edhe shtetin/shtetet e tjera të reagojnë konform konizmave gjeostrategjike, madje edhe njohja shihet si pjesë e këtyre veprimeve.

Njohja e shtetit ka ngjallur në mënyrë të vazhdueshme dallime të theksuara mes shteteve të fuqishme, të cilat kanë pasur një rol në rendin ndërkombëtar, ndërsa krijimi i këtij rendi, që studiuesit e cilësojnë si multipolar, ka ndikuar edhe në formësimin e njohjes së shtetit, pasi ngjarjet politike që kanë shtyrë entitetet politike të shpallin shtetin dhe të kërkojnë njohjen ka bërë që *fuqive dominuese t'i krijohet baza për kontestim normativ dhe gjeopolitik me rivalët e tyre* (Newman & Visoka, 2021: 1), gjithmonë duke u nisur nga fakti se njohja e këtyre entiteteve do të përdorej politikisht qoftë si kundër balancë, ose si përligjje të veprimeve politike nga këta rivalë.

Ndërtimi i raportit të ndërvarësisë mes gjeopolitikës dhe njohjes së shtetit, duhet të nisë nga prizmi deduktiv i analizës, që i kushton më shumë vëmendje fillimisht trajtimit të veprimtarisë që ndodhet brenda kontestit “gjeopolitikë”, ku përfshihen interesa e zona të caktuara kontrolli, të cilat Colin Flint (2021: 1), i liston brenda tri konteksteve të ndërlidhura; konkretisht, *gjeostrukturore, gjeostrategjike dhe gjeofizike*, ndërsa argumenton faktin se ky aktivitet *përkufizohet si procesi i kontrollit të njësive gjeografike; veçanërisht, rajonet, rrjetet dhe vendet e caktuara nga fuqitë dominuese*.

Vërehet se përdorimi i njohjes si veprim politik e strategji e shtetit, ka një zbatim të madh në disa nivele, të cilat kanë ardhur në shprehje edhe si produkt i një dallimi të theksuar mes teorive të njohjes në njërën anë, por edhe të vetë funksionimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, në anën tjetër.

“Njohja ndërkombëtare është aktualisht jo vetëm një përkufizim i padiskutuar, karakteristikë e një shteti, por në të njëjtën kohë ajo po shfaqet me intensitet në rritje si një instrument i rëndësishëm gjeopolitik për ndjekjen e interesave të politikës së jashtme të fuqive globale dhe rajonale” (Landovský & Riegl, 2013: 10).

Njohja e shtetit shfaqet e rëndësishme në këto raste, nga të dy palët, fillimisht nga entiteti politik që e ndjek arritjen e njohjes si mundësi të fuqizimit të subjektivitetit, por nga shtetet e etabluara në sistemin ndërkombëtar, shihet edhe si mundësi e mirë e përdorimit politik e strategjik për interesa kombëtare. Kësisoj, Landovský dhe Riegl (2013: 10), konstatojnë se duke qenë se njohja si veprim politik vë në shprehje raportin konkurrues mes shteteve, ajo ka marrë një dimension të dukshëm konstitutiv.

Politika e jashtme e shteteve, si tërësia e mekanizmave dhe metodave që aplikon shteti, parasheh edhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren për të rritur sigurinë kombëtare, të cilat ndërlidhen me rrethanat gjeostrategjike e gjeopolitike në rajone të caktuara, të parapara si zona të influencës së interesave kombëtarë, *ose si planifikimi i politikës së sigurisë së një kombi në bazë të faktorëve gjeografikë* (Huzen, 2019: 9).

Kjo situatë është shfrytëzuar ndjeshëm nga fuqitë rajonale e globale, duke bërë që edhe njohja e shteteve të jetë më e arritshme, duke treguar për implikimin që ka rendi ndërkombëtar në njohjen e shtetit. Nisur nga kjo, prishja e sistemit dypolar, ka nxjerrë në pah shumë raste të entiteteve politike që shpallin shtetin, sidomos në kontinentin evropian, pasi shembja e Bashkimit Sovjetik por edhe Jugosllavisë, krijoi jo pak tensione të caktuara ndëretnike (në të shumtën e rasteve), që u pasuan me deklarime të pavarësive nga shumë entitete politike, të cilat disa u njohën e disa të tjera jo, duke u kthyer në instrumentin e kontrollimit dhe të ndikimit në jo pak vende. Studiuesit përmendin disa entitete politike, sidomos në rajonet rreth Ruisë, të cilat cilësohen më shumë si mekanizma politike për të përcaktuar ndikimin gjeostrategjik ndaj Evropës, sesa një përpjekje serioze për të krijuar e njohur shtete të reja.

Studimet e deritanishme tregojnë se fuqitë politike globale kanë reaguar ndryshe ndaj situatave të cilat janë parë si të (pa)krahueshme njëra me tjetrën. Njohja e Kosovës nga SHBA-ja dhe pjesa më e madhe e shteteve të BE-së, është përcjellë me njohjen e Osetisë Jugore dhe Abkhazisë nga Rusia, që Mikulas Fabry i sheh si veprim reagues ndaj njohjes, më

shumë se akt i vullnetshëm që nga fillimi, ndërsa sipas tij, Osetisa Jugore dhe Abkhazisa, nuk do të ishin njohur si shtete, po të mos njihej Kosova nga SHBA-ja (Fabry, 2012: 661).

Konstatimet e Mikulas Fabry, deri diku janë të qëndrueshme, por qasja ruse nuk është treguar e kujdesshme ndaj përdorimit të normës së shkëputjes së njëanshme që Fabry e përmend, pasi në vitin 2014, Rusia ka aneksuar Krimenë, ndërsa në vitin 2022, ka shtyrë grupet e caktuara separatiste në rajonet ukrainase Donbas dhe Luhansk, për t'u shkëputur nga Ukraina, duke e sulmuar ushtarakisht atë.

Studiuesja Rama Sampath Kumar (2008: 24) konsideron se përpjekjet e entiteteve politike që të shpallin shtetin e tyre, i ka shtyrë fuqitë e mëdha që të kërkojnë avantazhe gjeopolitike dhe të ndërhyjnë në këto rajone. Të këtij mendimi janë studiuesit çekë, Martin Riegl dhe Bohumil Doboš (2018: 59), të cilët trajtojnë këtë problematikë, duke u nisur nga fakti se vetë Rusia si faktor kryesor në atë zonë synon që duke u nisur nga premisa të qarta politike, nuk mohon sovranitetin e shteteve respektive (përfshirë Ukrainën më vonë), por fokusohet në aplikimin utilitar dhe selektiv të teorive normative të shkëputjes.

Shpërbërja e Jugosllavisë dhe në veçanti mënyra e çlirimit të Kosovës, ishte parë si një transformim gradual i rendit ndërkombëtar, i bazuar në ruajtjen e doktrinëve shtrënguese që parandalonin çdo veprim të entitetit politik jashtë kornizave ekzistuese të së drejtës. Ky moment, u përdor politikisht nga entitetet e caktuara, por në veçanti u përdor nga shtetet e fuqishme të cilat nxisin reagimin e grupeve të caktuara separatiste në rajone të cilat konsiderohen si zona të caktuara të interesave gjeostrategjike e gjeostrukturore. Rusia ka shkuar aq larg sa ka ndërmarrë këto veprime të cilat sistematikisht kanë prishur rendin ndërkombëtar, kanë krijuar tensione politike mes fuqive të mëdha, ndërsa sipas Brad R. Roth:

“Krizat e Ukrainës ndihmojnë për të nxjerrë në pah rreziqet e fshehura të një jurisprudence në zhvillim që do të lejonte konsiderata të papranueshme më parë – qofshin ato etnike, historike, kushtetuese apo “demokratike” – komprometojnë normën e paprekshmërisë territoriale” (Roth, 2015: 384).

Zhvillimet politike në Evropë, sidomos shpërbërja e Jugosllavisë dhe ajo e Bashkimit Sovjetik, kishte krijuar rrethana të reja strategjike për shtetet e BE-së, por edhe sot, ndryshimet politike që po ndodhin brenda këtyre kontesteve, nuk është se nuk e kanë efektin e tyre, sidomos ndaj procesit të njohjeve. Në këtë mes, rasti i Kosovës, është parë si një test i

madh i ndryshimeve dhe efekteve që ai t'i sjellë, sidomos me implikimin e fuqive në rajon, me transformimin e aktorëve gjeostrategjikë, sidomos me rikthimin e Rusisë tash në rolin e një superfuqie (Abazi, 2008a: 67), rol të cilin ajo e kishte humbur vite më parë.

Pos kësaj, studiuesit Cedric Ryngaert dhe Sven Sobrie konsiderojnë se me shpërbërjen e Jugosllavisë, u krijuan shtete përmes aplikimit të disa fakteve ose normave që më shumë i përkasin moralit se si duhet të veprohet ndaj këtyre entiteteve politike të shpallura shtete, pasi krijimi i shteteve dhe nevoja për njohjen e tyre, ka krijuar momente të favorshme për fuqitë rajonale ose globale që të influencohen në rajone të caktuara, duke e ndërtuar njëfarë sistemi shumëpolarë edhe sa i takon njohjeve (Ryngaert & Sobrie 2011: 467).

Krijimi i shtetit të Kosovës është parë si mekanizmi paqësues i Ballkanit, i qetësimit të raporteve shqiptare (kosovare) – serbe dhe si veprimi përmes të cilit do të evropianizohet i gjithë rajoni. Problemi i mosnjohjes së Kosovës ka rrënuar të gjitha këto paradigma, prandaj është qenësore të kuptohet se mbajtja e tensioneve në Ballkan, si produkt i mosnjohjes së Kosovës, do të shihet edhe si mundësi reale e ndërhyrjes në të, duke minuar të gjitha projektet, sidomos ato evropianizuese, prandaj situata do të sillet në mes një rrethi vicioz ndërmjet stagnimit dhe destabilitetit të përtërirë për Kosovën, Serbinë dhe rajonin, ose lëvizjen përpara drejt Bashkimit Evropian, si opsioni tjetër, thotë studiuesi Alexandros Yannis (2009: 161).

Krijimi dhe njohja e Kosovës nga shtetet kryesore perëndimore, kishte bërë që Rusia ta shihte këtë si moment të mirë të globalizimit të problemeve lokale, duke identifikuar vendet me potencial krizë dhe që kanë trashëgimi të dhunës, për çka ka nxitur faktorët lokalë të cilët do të përdorin qasjen e lidershit vendor ndaj pakicave, si nxitje të reagimeve (Tuathail, 2013: 670).

Studiuesi Gearóid Ó Tuathail, kur trajton ndikimin që ka pasuar njohja e Kosovës të sjellja ruse, thotë se Rusia konsideron se nuk mund të ketë standarde të dyfishta, duke ndërtuar paralele me Osetinë Jugore, Abkazinë ose Transilvaninë, të cilat gjatë procesit të krijimit të shtetit të Kosovës, krijuan lidhje me grupet parlamentare ruse të cilat do të promovojnë ndarjen e tyre si të rasti i Ballkanit (Tuathail, 2013: 683).

Shtetet që janë fuqi rajonale, sikur Rusia, synojnë që përmes identifikimit dhe përkrahjes së partnerëve lokalë, të zgjerojnë ndikimin e tyre, duke minuar sidomos sigurinë e këtyre vendeve, me qëndrueshmëri të brishtë, përmes elementeve gjeostrukturore, si

strukturat etnike, grupet para politike, influencues politikë, por edhe ato gjeostrategjike, që lidhen sidomos me zonat që prekin interesat jetike të pozicionimeve politike e ushtarake.



Figura 6. Territoret “problemore” të dhe rreth Rusisë - John O’Loughlin, 2007 University of Colorado

Për Rusinë problemi kryesor i Kosovës nuk ishte njohja, por ndryshimi i realitetit politik i cili erdhi si rrjedhojë e përdorimit të forcës, të cilën shteti rus e shihte si pikën e tij më të ulët, ndërsa njohja si produkt i saj do të nënkuptonte transformimin rrënjësor të rendit politik, edhe global.

“Qeveria ruse ka dhënë paralajmërime të shpeshta se njohja e një shpalljeje të njëanshme të pavarësisë (UDI) nga Kosova ishte e papranueshme për Moskën. Qeveria e Putinut madje diferencoi se si do të aplikohet Kosova në konfliktet e stërzgjatura në ish-Bashkimin Sovjetik që kishin krijuar shtete de facto. Nagorno-Karabakh, një konflikt në të cilin Rusia ishte zyrtarisht një ndërmjetës ndërkombëtar dhe gjithashtu u përpoq të balancoje interesat e saj të shumtë midis Armenisë dhe Azerbajxhanit, nuk u shfaq si një objektiv në paralajmërimet mbi Kosovën” (Fawn & Nalbandov, 2012: 71).

Nga ajo çfarë thonë Rick Fawn dhe Robert Nalbandov (2012: 57-89), por edhe duke u bazuar në elaboratet e tjera, kuptohet se Rusia ka dashur që gjeopolitikisht ta përdorë rastin e Kosovës në disa rrafshe:

- Global – si ballafaqim frontal me perëndimin dhe politikat e saj;¹⁹
- Rajonal – si rikthim i fuqishëm në ish-zonat e ndikimit;²⁰
- Zgjerim territorial si rrjedhojë e shkëputjes së rajoneve të caktuara;²¹
- Menaxhimi i (de)stabilitetit të rajonit.²²

Rusia e ka të qartë sistemin e saj doktrinar, pasi në sjelljen e saj dallohen dy elemente me rëndësi, e para (neo)realizimi, që shprehet te disa raste ku ka ndërhyrë drejtpërdrejt, ose ku është treguar e rëndësishme për atë zonë, thotë studiuesi Babak Rezvani, i cili analizon veprimin rus në zonën e tij të ndikimit, duke thënë fillimisht ndikimi rus në këto vende i ka transformuar elitat politike gjeorgjiane e ukrainase, pikërisht për shkak të ndikimit rus të Krimesë, Abkasisë e Osetisë, të cilat Federata Ruse ka dashur t’i përdorë si zona që i lidh me Detin e Zi, Detin Mesdhe ose qasjen konstruktive, te rasti i Nagorno – Karabakut, ku qëndron si lehtësues bisedimesh mes Armenisë dhe Azerbajxhanit (Rezvani, 2020: 889).

Studiuesja Barbara Pisciotta konsideron se Rusia dëshiron që përmes veprimeve sistematike politike e ushtarake, të zgjedhojë ndikimi i saj, si në territor, pozicione gjeografike dhe resurse, të gjitha si një rivalitet me NATO-n dhe BE-në dhe objektivat e tyre (Pisciotta, 2020: 87–106).


Veprimet ruse lidhur me fuqizimin e saj në rajon nuk janë ndaluar, ajo ka ndikuar edhe te Ukraina sidomos, duke e aneksuar Krimenë, e cila gjeostrategjikisht paraqet një pikë qenësore për shtetin rus, për kontrollim të zonës dhe burimeve të saj, duke e rishfaqur atë që Rusia kishte dashur përherë të arrinte, rikthimin në zonat që dikur i kishte Bashkimi Sovjetik (shih diagramin vijues të shteteve që e njohin ose jo Kosovën dhe që kufizohen me Rusinë ose i përkasin tokës së ish-Bashkimit Sovjetik, **Diagrami 1**).

¹⁹ Konsolidimi i Rusisë dhe angazhimi i Shteteve të Bashkuara në rajone të tjera, sidomos në Lindjen e Mesme dhe Azinë Qendrore, ka krijuar njëfarë epërsie për Rusinë e cila e pa këtë moment të volitshëm për të çuar përpara agjendën e saj politike. Kosova dhe bllokimi i saj në mënyrë sistematike, i ofroi këtë avantazh.

²⁰ Rusia ka dashur që të rikthejë fokusin sidomos në rajonet kur dikur kanë qenë pjesë e Bashkimit Sovjetik, sidomos te republikat rreth saj, por ka pritur secilin rast që i është dhënë në Ballkan.

²¹ Duke e përdorur rastin e Kosovës si “pretekst” për ndërhyrje në shumë zona rreth saj, sidomos ku ka shumicë ruse, ose me orientim rus.

²² Në disa rajone të tjera, Rusia nuk i ka shkëputur, ose nuk i ka shtyrë drejt shkëputjes, por i ka mbajtur nën tension palët, sidomos te rajoni i Nagorno-Karabakut, i cili është zonë e kontestuar mes Armenisë e Azerbajxhanit.



Diagrami 1. Gjeografia e njohjes

Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës

Rusia e ka përmendur vazhdimisht Kosovën, në secilin rast që i është dhënë, duke e cilësuar atë burimin e një precedenti të rrezikshëm për rastet e tjera në botë, në veçanti në rajonin e saj, ku për shkak të së kaluarës, shumë grupe etnike të ndryshme nga shtetet ku janë ato territore aktualisht, synojnë ndryshimin e statusit. Rusia i ka njohur ato ndryshime, pos që ka ndikuar edhe përcaktuar në të gjitha fazat e zhvillimeve, por nuk e njeh Kosovën, të cilën e ka penguar në KS-OKB në çdo rast. Rusia synon që përmes mosnjohjes së Kosovës të përcaktojë proceset dhe integrimet evropiane në Ballkan, përmes Serbisë, mban të hapur kontestin me Kosovën, në nivelin lokal.

Rusia nuk pranon që në botë të jetë njëpolare, prandaj ka ndërmarrë veprime konkrete dhe me objektiva të qarta për të parandaluar një situatë të tillë, e cila gjenezën e kishte në periudhën e rënies së madhe të ndikimit rus, pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, ndërsa ndërhyrjet ushtarake në Kosovë, Afganistan, Irak e Libi më vonë, nga SHBA-ja, tregonte se Rusia kishte nevojë për rivalitet kokë më kokë me të, për të ndryshuar kështu rrjedhën drejt rendit ndërkombëtar njëpolar, konstaton Valur Ingimundarson, i cili në studimin që i bëri përdorimit të rastit të njohjes së Kosovës nga Rusia, vijon të argumentojë:

“Interpretimi i Ruisë nuk vlen vetëm për vetë përdorimin e forcës, por edhe për njohjen e shtetit të territoreve të kontestuara, si Abkhazia dhe Osetia e Jugut në Gjeorgji në 2008 dhe Donetsk dhe Luhansk në Ukrainë në vitin 2022. Në mënyrë të ngjashme, përpara se të aneksonte Krimenë në vitin 2014—dhe pas

organizimit të një referendumi—Rusia e kishte njohur tashmë atë si një vend të pavarur, duke përdorur shembullin e Kosovës si burim legjitimimi”
(Ingimundarson, 2022: 5-7).

Rusia ka përdoruar elitat politike të grupeve të caktuara etnike në rajonet e destabilizuara, të cilat i ka mbështetur në përpjekjet e tyre për ndryshimin e realiteteve politike të atyre vendeve, fillimisht në krijimin e kohezionit kombëtar të tyre, diferencimit me shumicën dhe mbajtjes nën tension të vazhdueshëm. Kështu ka vepruar edhe Serbia ndaj Kosovës.

Partnerët lokalë, sikur Serbia për Rusinë, nuk kanë kapacitete të mjaftueshme ushtarake për të nisur konflikte të armatosura, thotë Janusz Bugajski, nga Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (2008: 3), por kanë mjaftueshëm mundësi për të destabilizuar rajonin, përmes tensioneve të vazhdueshme të grupeve etnike në disa shtete të rajonit, prandaj është e nevojshme një prani e shtuar e NATO-s, po ashtu një angazhim i BE-së dhe SHBA-së, kjo për t'i mbajtur përherë nën tryzni të gjithë këto struktura.

“Veprimet e Rusisë ndjekin një model të caktuar: promovimin e paqëndrueshmërisë përtej kufijve të saj, me qëllim që të pushtojë burimet perëndimore dhe të NATO-s në zonat që Perëndimi i konsideron një prioritet të ulët brenda qëllimeve të tij të përgjithshme strategjike. Ballkani është një zonë e përshtatshme për prodhimin e krizës nga Rusia, e cila ka përdorur metoda të shumta të formuluar në kuzhinën e Kremlinit për të mbajtur NATO-n dhe Perëndimin të lidhur strategjikisht” (Rajic & Hoare, 2022).

Edhe diplomati i njohur amerikan, Richard Holbrooke, në një shkrim në gazetën Washington Post (2007; 1-2), gati një vit para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, njohjen e shtetit të ri (të Kosovës) e kishte parë nga një vështrim i qartë gjeostrategjik. Duke qenë i përfshirë direkt në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, Holbrooke, konstaton se mos përfshirja e SHBA-së, në mënyrë të drejtpërdrejtë në Ballkan, sidomos pas sulmeve të 11 shtatorit 2001, i kanë krijuar mjaftueshëm hapësirë Rusisë, e cila *kërkon të rimarrë terrenin e humbur në dekadën pas rënies së Bashkimit Sovjetik*. Në analizën që ai i bën situatës, konsideron se SHBA-ja, duhet të bartë mesazhin e qartë ndaj Federatës Ruse, në lidhje me njohjen e pavarësisë së Kosovës, duke shtuar:

“Ky mesazh duhet të jetë i thjeshtë: nëse Rusia bllokon planin e Ahtisaarit, kaosi që do të pasojë do të jetë përgjegjësi e Moskës dhe do të ndikojë në aspekte të tjera të marrëdhënieve të Rusisë me Perëndimin” (Holbrooke, 2007: 2).

Dallimet e mëdha që krijoi shpallja e pavarësisë së Kosovës, pamundësia për të pranuar dhe votuar në KS të OKB-së, Pakon e Ahtisaarit, pos si mosrespektim i vendimit në të cilin vetë Rusia ishte e përfshirë, fillimisht me Rezolutën 1244, përmes së cilës Kosova vendoset nën administrimin ndërkombëtar, duke i dhënë fund krimeve të kryera nga shteti serb, pastaj angazhimi rus edhe në Bisedimet e Vjenës, që prodhoi pakon statusore, jep të kuptohet se as Serbia dhe as Rusia, nuk kanë qenë të interesuara asnjëherë për të prodhuar status politik për Kosovën, cilido qoftë ai që do të avanconte entitetin politik, ndërsa që të dyja, i kanë përdoruar ato (rezolutën, standardet, negociatat) për zgjatje të vazhdueshme të statusit të Kosovës, dhe për të tensionuar Ballkanin, ku Serbia, duke i përdoruar serbët e Kosovës, imponohet dhe përcakton sigurinë, statusin dhe të ardhmen e Kosovës, ndërsa Rusia, pakënaqësinë serbe e ka parë si mundësi e faktorizimit në Ballkan e Evropë, por jo vetëm kaq, ajo këtë rast e ka përdoruar edhe për të ngritur raste të tjera, ashtu siç edhe studiuesi Boris Nikitin, shkruan:

“...ndikimi i pavarësisë së Kosovës në nivelin e brendshëm, rajonal dhe ndërkombëtar duhet të shqyrtohet për të kuptuar zhvillimet e ardhshme rreth Kosovës, si dhe për të reflektuar se çfarë mësimesh mund të mësohen nga përvoja, veçanërisht në dritën e statusit aktual të rajoneve si Abkhazia, Transnistria, Tajvani, Ontario dhe shumë pjesë të tjera të botës...” (Nikitin, 2010: 1).

Sido që të jetë, arritja e pavarësisë së Kosovës rishfaqti dy elemente, fillimisht se strukturat e Luftës së Ftohtë janë shpërbërë dhe se ka një peizazh të ri gjeopolitik në rajon, por edhe se serbët vazhduan të mbështesin qasjen që Rusia ka në rajon, një raport i vjetër marrëdhënieje, që shërbehet si mundësi e faktorizimit reciprok, ku rusët përmes saj synojnë të faktorizohen si supremaci, ndërsa serbët të ruajnë ndikimin nga jashtë (Abazi, 2008: 2-3).

“Rusia ishte në gjendje të ruante ndikimin e saj mbizotërues në 'hapësirën post-sovjetike' si një ndërmjetës fuqie në territore të panjohura ose shtete të

pavarura si Gjeorgjia, Moldavia, Armenia dhe Azerbajxhani. Në mënyrë të ngjashme, Rusia donte të kultivonte marrëdhëniet e saj intime historike me Serbinë përmes mbështetjes së saj për çështjen e Kosovës” (Ingimundarson, 2022: 7).




Figura 7. Shtetësia në teori dhe praktikë²³

Studiuesit kanë sjellë konceptin “gjeopolitika imagjinare”, që paraqet raportin shumë shtresor ndaj realitetit politik të krijuar, ku si ilustrim, për Krimenë, dikush konsideron se ajo është pjesë e Rusisë, ndërsa në anën tjetër, shtrohet pyetja se si do të vizatohej harta e Serbisë (Wydra, 2020: 317), ose si presidenti francez, Nicholas Sarkozy, që kishte treguar mbështetjen për pavarësinë e Kosovës, dy ditë para shpalljes së pavarësisë së saj, duke thënë “Duhet ta ndryshoni hartën e Evropës, ku duhet të jetë dhe Kosova” (Evropa e Lirë, 2008). Pra, shteti i Kosovës, në pikëpamjen gjeostrategjike franceze është shtet i pavarur dhe i cili do të ndryshojë realitetin politik të Ballkanit. Edhe për SHBA-të, pozita gjeostrategjike e Kosovës është me shumë peshë, pasi ajo gjendet në qendër mes Evropës Lindore dhe asaj Perëndimore (Morelli, 2018).

²³ Coggins, B. (2014). Statehood in Theory and Practice. In Power Politics and State Formation in the Twentieth Century: The Dynamics of Recognition (pp. 14–43). chapter, Cambridge: Cambridge University Press. <http://doi.org/10.1017/CBO9781107239050.002>

III.3. Faktorët gjeostrukturorë dhe ndikimi në njohjen e shtetit

Ky nënkapitull trajton pozitën e serbëve lokalë në Kosovë dhe ndikimin që ata kanë pasur në raportet në mes saj dhe Serbisë, ndikim që vërehet në të gjitha fazat e zhvillimeve politike, si para statusit, gjatë negociatave për statusin, por edhe në procesin e gjetjes së një zgjidhjeje të pranueshme për palët, që varej nga procesi i *Bisedimeve të Brukselit*, por edhe pas tij, në procesin e njohjeve.

Serbët e Kosovës, nuk paraqesin thjesht një grup etik, por në shumë raste shihen edhe si një pykë që është përdoruar dyanshëm nga palët për të arritur objektivat e tyre politike, si në kohën e *“Trazirave të Marsit”*, kur krijohet dhe plasohet ideja se Kosova nuk *“pranon pakicën serbe”*, më pas në *Negociatat e Vjenës*, kur Kosova ofron garanci kushtetuese për një shkallë të lartë të vetëqeverisjes për ta, përmes decentralizimit i cili është bërë në baza etnike dhe i cili është produkt i këtyre negociatave, ndërkaq sfida mbetet krijimi i *një strukture të re politike*, e njohur si *Asociacioni i Komunave me Shumicë të Caktuar Etnike*, por i cili ka hasur në rezistencë të pala kosovare për implementimin e saj, pasi si i tillë ka rezultuar jo kushtetues.

“Trazirat e Marsit” 2004, kishin rrënuar pothuajse idenë se një shoqëri e dalë nga konflikti po ndërtohej mbi premisa shumetnike, ndërsa decentralizimi u pa si mundësi e kthimit të tyre në sistemin politik dhe jetë institucionale përgjithësisht. Procesin e decentralizimit në Kosovë, përveç si një nga parimet themelore të një sistemi demokratik dhe si parakusht themelor për qeverisje efektive që lidh qytetarin me pushtetin, është dhe mbetet njëra nga sfidat kryesore të Republikës së Kosovës, pasi realizimi i tij kërkon ndërmarrjen e veprimeve politike që kanë afektuar edhe rendin kushtetues në Kosovë.

Sistemi Politik i Kosovës, i dalë kryekëput nga Pakoja e Ahtiraarit, parasheh një shkallë të gjerë të të drejtave politike për pakicat, e në veçanti për pakicën serbe, e cila në periudha të ndryshme, shihet edhe si e instrumentalizuar nga Beogradi, i cili përdor një mori formash e mekanizmash politikë e institucionalë, në arritjen e këtyre objektivave.

Duke aplikuar një bazë teorike të qëndrueshme, në këtë nënkapitull sillen *parimet, modelet dhe sfidat* që ka shoqëria kosovare e pas konfliktit në krijimin e parakushteve për qëndrueshmëri politike duke i identifikuar pengesat gjeostrukturorë, si ato *psikologjike, strukturale e politike*, ndërsa identifikohen *faktorët dhe mekanizmat politikë e strukturalë* që kanë ndikim në përafrimin e tyre potencial, pasi Kosova ka provuar që përmes decentralizimit,

i cili është parë në të njëjtën kohë edhe si faktor përmes të cilit do të ndodhte transformimi gradual i konfliktit, për shkak se, komunat do të kenë nevojë për bashkëpunim ndër rajonal, në kufijtë administrativë ose në plane të përbashkëta që nuk mund të realizohen ndryshe, e që prekin direkt jetën e qytetarëve, më ç'rast, edhe komunitetet jo shumicë marrin pjesë në vendimmarrje, për shkak të shkallës së lartë të vetëqeverisjes, të garantuara më kushtetutë dhe akte të tjera ligjore.

Por, meqenëse në Kosovë, komunat me shumicë serbe, kanë një kompaktësi të lartë të përbërjes etnike, ka bërë që decentralizimi të mos e luajë rolin e transformuesit të konfliktit, por ta polarizojë edhe më tej shoqërinë kosovare, edhe ashtu të polarizuar nga lufta. Decentralizmi me karakter etnik në Kosovë ka qenë parakusht i mirë i shtrimit të ndikimit serb në Kosovë, ndërsa përdorimi i serbëve lokalë u pa në dy rrafshë politik e juridik, politik përmes Listës Serbe e juridik përmes Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Këto struktura dalin të jenë mekanizmat gjeostrukturorë që ka përdoruar Serbia.

Është e njohur se në periudhën e tanishme ta pakta janë konfliktet klasike mes shteteve, ndërsa shumica prej tyre, janë mes përbërësve të shtetit. Konflikti i Kosovës me Serbinë i ka që të dyja karakteristikat, fillimisht është *konflikt mes përbërësve të shtetit të dikurshëm*, nga ku Kosova doli fillimisht si administrim ndërkombëtar, e pastaj si shtet i pavarur, por shtet i cili nuk njihet nga Serbia, e cila përmes serbëve lokalë, ka gjetur rrugën për të penguar atë në shumë dimensionë politike, e duke provuar që t'i paraqesë ata si pjesë të një konflikti të vazhdueshëm. Konfliktet e tilla kanë implikime të ndryshme të cilat duhet të identifikohen e trajtohen.

- *Natyra e konfliktit si faktor gjeostrukturor*

Konflikti në të gjitha fazat e tij si nga shfaqja, mënyra e përhapjes, përsëritja dhe ashpërsia e tij në kohën e tanishme, shihet si vazhdimësi e ngjarjeve paraprake, që studiuesit i cilësojnë si *hija e zgjatur e parahistorisë* (Arbatli et al., 2015). Kur është folur për luftën, ka pasur trajtime nga më të ndryshmet, por shumica e konflikteve, thonë shkollarët, nisen nga fakti pse shtetet fillojnë luftën, ndërsa pak ka të atillë që vlerësojnë se lufta duhet trajtohet *si një rezultat që duhet shpjeguar* (Ramsay, 2008). Konflikti, pra nuk është fundi, por duhet të shihet si fillimi i procesit përmes të cilit synohet të nxirret një rezultat, prandaj në disa raste, vërehen transformime të formave të konfliktit, pasi sigurisht ende nuk është arritur rezultati i kërkuar nga palët ndërluftuese, ose së paku nga njëra prej tyre. Prandaj, përdorimi i ngjarjeve

që prodhojnë *modelet, strukturat* dhe që ndikojnë në transformimin gradual të konfliktit, mbesin sfidat dhe synimet që dalin përpara (Azar, 1980).

Konfliktet kanë qenë tepër të shprehura në mënyrë të vazhdueshme, sidomos nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, por vërehet se ka pasur rënie kah viti 2000, sidomos konfliktet e llojit *ndëretnik* (Cederman & Pengl, 2019). Por konfliktet ndëretnike vazhdojnë të ekzistojnë edhe me tej, prandaj, elementet e para që duhet të shtrohen në analizë janë ato *kulturore e fetare* (Bercovitch & Foulkes, 2012).

Autorë të tjerë si Philip Verwimp, Patricia Justino e Tilman Brück (2009), konsiderojnë se konfliktin nuk mund ta trajtojmë si duhet, nëse nuk marrim për bazë nivelet e tij, ndërsa theksojnë faktin se konflikti parimisht është pakënaqësia që shprehin individët e caktuar dhe ndërveprimet e tyre ndaj mjedisit politik, prandaj priren ta shohin konfliktin nga niveli *mikro*. Ndërsa, Christopher Blattman and Edward Miguel, nisen nga fakti se për të elaboruar shkaqet, sjelljen dhe pasojat e konfliktit, duhet të elaborohen elementet *makro*.

Ndërsa, për ta njohur problematikën e konfliktit, duhet të matet edhe *shkalla e demokratizimit* të vendit, përkatësisht sistemi politik. I këtij mendimi është Alex Braithwaite, i cili duke u thirrur në vlerësimet e Bueno de Mesquita et al. (2003), i cili thekson faktin se shoqëritë e demokratizuara janë më të ashpra ndaj konfliktit, për shkak se ato kanë kostot ekonomike, buxhetore, por edhe në jetët e njerëzve, madje nisur nga kjo ata edhe ndryshojnë përmes votës liderët politikë me prirje tjetër, prandaj ky qëndrim ka efekte edhe në vendimarrje.

Kësisoj, Braithwaite (2010), konsideron se liderët nuk hyjnë në konflikte të cilat ata edhe mund t'i humbin. *Pabarazitë horizontale midis grupeve etnike të rëndësishme politikisht, thotë Cederman et. al. (2011), mund të nxisin konflikte etnonacionaliste.*

“Rasti i Kosovës zbulon pasionin dhe urrejtjen që etnia mund të rritet nëse manipulohet nga liderët politikë etnonacionalistë. Në Kosovë, lidhja emocionale me tokën e dy grupeve etnike e përjashtonte njëri-tjetrin. Millosheviq luajti një rol të rëndësishëm në konfliktin etnik që pasoi, duke iu drejtuar ndjenjave të thella patriotike të popullit serb, duke u bërë “zëri” i tij dhe duke ushqyer ndjenjat nacionaliste kur bënte deklarata si “nacionalizmi serb është një gjarpër thellë në gjirin e popullit serb” (Sotiropoulou, 2002: 5).

Te konfliktet etnike, janë me rëndësi, sidomos narrativja për tjetrin, shumica prej të cilave janë konstruktive socio-psikologjike, por që prekin edhe individin, sikundër edhe grupin, dhe ndikojnë në krijimin e ndasisë, të cilat Daniel Bar-Tal, Neta Oren dhe Rafi Nets-Zehngut i listojnë, si: *justifikimi dhe kërcënimet e konfliktit, delegjitimimi i kundërshtarit, glorifikimi dhe viktimizimi brenda grupit, nevoja e grupit për patriotizëm dhe unitet, dhe aspirata e saj për paqe* (Bar-Tal et al., 2014).

Bazuar në perspektivën historike, vërehet se pozita e serbëve në Kosovë, në një plan gjysmëciklik do të dukej kështu, nisur me “Trazirat e Marsit” 2004, vijohet nga decentralizimi mbi bazën etnike, kulmon ose jo me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa cikli potencialisht mund të rikthehet në fillimin e tij, “Trazirat e reja”, në mungesë të një zgjidhjeje të pranueshme për palët.

Natyra e konfliktit në ish-Jugosllavi ka prodhuar jo pak problem edhe në procesin e rikonsolidimit të shoqërive dhe shteteve, pasi u përdorën taktika të ndryshme ushtarake e paraushtarake, në dëm të grupit tjetër etnik, qëllimi kryesor i së cilës ishte spastrimi etik, ose ndryshimi demografik. Gjatë konfliktit, grupet etnike ishin në shënjestër për t'u eliminuar përmes taktikave ushtarake dhe kampeve të përqendrimit, thotë studiuesi Naimark Norman (2001: 2), ndërsa sipas tij, termi "spastrim etnik" lidhet me veprimet që një grup etnik merrte kundrejt grupit tjetër, që në vitin 1992.

Dallimet etnike dhe strukturat etnike kanë qenë fare të dukshme në të gjithë periudhën e konfliktit, si gjatë, por edhe pas tij. Micheal Brown (2001: 12), i kushton vëmendje sidomos strukturës etnike të krijuar në periudhën e pas konfliktit, marrë parasysh faktin se konfliktet në Jugosllavi, ndër të tjerash e kanë pasur këtë karakteristikë dhe kanë definuar edhe procesin e krijimit të paqes.

Strukturat etnike në periudhën e pastkonfliktit paraqesin ndër të tjerash edhe jetësimin e teorisë së Benedict Andersonit, në lidhje me *komunitetin e imagjinuar* (2006), pasi deri në luftë, në Jugosllavi u provua të adaptohej një model ndryshe i kombit e i nacionalizmit, modeli i *Vëllazërimit dhe Bashkimit*, i cili ishte investim shumëvjeçar dhe ishte parë si i vetmi model i mbajtjes afër të shoqërive jugosllave me një diversitet kaq të theksuar religjioz e kulturor, duke i eliminuar figurat nacionaliste, simbolet dhe duke i zëvendësuar ato me ‘Vëllazërinë dhe Bashkimin’ dhe kultin e personalitetit të Titos.

Në Jugosllavinë e Titos, urrejtjet etnike dukeshin sikur të ishin nën sipërfaqe, duke u shfaqur në mënyra të çuditshme dhe shpesh kontradiktore (Macdonald, 2002: 183). Lufta e

rrënoi modelin e qytetarisë jugosllave duke mos lënë as gjurmët më të vogla të ringritjes së saj.

Ted Robert Gurr (2000: 5), kur flet për identitetet etnike, ai konsideron se ato nuk janë diçka e re, por i përkasin periudhës primordialiste, dhe si të tilla bazohen në vlera, besime dhe përvoja të përbashkëta. Identitetet etnike janë më të gatshme për t'i mbështetur lëvizjet e caktuara shoqërore, prandaj edhe kanë një qëndrueshmëri më të thekuar se lëvizjet e tjera me karakter material ose politik, prandaj edhe kanë një kohëzgjatje më të theksuar dhe e cila është më e qëndrueshme në arritjen e objektivave.

Lufta e karakterit ndëretnik në Jugosllavi, ndër shumë arsye është edhe për shkak të dallimeve të dukshme gjeostrukturore, të llojeve të ndryshme, qoftë e karakterit etnik, kulturor, fetar, ekonomik e të tjera. Prandaj brenda saj është vërejtur se ka pasur në mënyrë të vazhdueshme një përpjekje për dominim. Kjo ka bërë që shumë studiues të identifikojnë ndikimin që ka pasur dominimi i bazuar në strukturën etnike, nga ku pastaj ka reflektuar edhe modeli i krijimit të paqes në periudhën e paskonfliktit.

Alvin Rabushka and Kenneth Shepsle (1971: 461-476) në kuadër të ndikimit strukturor, identifikojnë katër lloje të dominimit etnik, si *konfigurimi konkurrues*, në të cilin shfaqen dy ose tri grupe numerikisht përafërsisht të balancuara; *konfigurimi dominues nga shumica*, në të cilën një grup është kryesisht dominant si politikisht ashtu edhe demografikisht; *konfigurimi dominues nga pakica*, në të cilin një pakicë e vogël dominon politikën; *konfigurimi i fragmentuar*, që përfshin një shumëllojshmëri të grupimeve fetare, fisnore ose gjuhësore në një territor të përbashkët politik.

Horoëitz, Lijphart, Tsebelis, Stepan, Kaufman e të tjerë, e lidhin decentralizimin me mekanizmin që do të përdoret në zbutjen e tensioneve ndëretnike, duke krijuar një kohezion shoqëror, i cili vihet në shprehje kur ai është i suksesshëm, por duke përjashtuar në mënyrë kategorike shkëputjen e ndonjë pjese të caktuar territoriale, më ç'rast autoritetet qendrore do të ishin institucionet e vetme që do të kontrollojnë interesat kombëtarë, politikën e jashtme si dhe ato të sigurisë, në procesin e ndërtimit dhe të konsolidimit të shtetit.

E veçanta e problematikës së Kosovës është se asnjëra nga to nuk e përshkruajnë mirë situatën, për faktin se, shumica e komunave me shumicë serbe, janë vetëm nominalisht "me shumicë", pasi aty dominojnë serbët dhe ka homogjenitet etnik, prandaj ky homogjenitet etnik e sfidon shumë mundësinë e shtensionimit ndëretnik në Kosovë, duke prodhuar një

model të ri, atë të *konfigurimit të ndërvvarshëm*, ku shumica etnike, është pakicë në disa komuna ose regjione.

Markus Böckenförde (2011) ka listuar dy qëllime kryesore që synohen të arrihen përmes decentralizimit. Sipas tij efektshmëria politike në funksionimin e shtetit varet nga pjesëmarrja e periferisë në veprimtarinë politike, duke u nisur nga parimi i subsidiaritetit, përkatësisht bartjes së përgjegjësisë nga qendra drejt periferisë, pasi në këtë mënyrë rritet efektshmëria, pjesëmarrja në jetën politike e ekonomike por edhe në llogaridhënie, duke ofruar qasje në shërbimet publike dhe duke inkurajuar në këtë mënyrë pjesëmarrje më të gjerë në vendimmarrje. Ndërsa pika e dytë, më shumë është e karakterit politik dhe krijimit të paqes së qëndrueshme, duke i përfshirë në vendimmarrje edhe palët që përfaqësojnë pakicat e caktuara brenda sistemit politik, për t'i siguruar ata se shteti është në shërbim të të gjithëve, nga ku prodhohet edhe modeli i sistemit konsociativ.

Ideja e decentralizimit qëndron në faktin e krijimit të dy parakushteve themelore të vendimmarrjes, e para është në nivelin lokal dhe e dyta e nivelit qendror. Përmes nivelit lokal, pakicat e cekura, ndiejnë se ata janë bartësit e sovranitetit, marrin pjesë në vendimmarrje, përcaktojnë ndarjen e resurseve, paraqesin planifikimin dhe funksionimin e sistemeve të ndryshme, qoftë arsimore, shëndetësore ose planifikimin urban, ndërsa përmes pjesëmarrjes në vendimmarrjen e nivelit qendror, pakicat krijojnë lidhshmëri me shtetin si qendër, rritet pranueshmëria ndaj tij dhe po ashtu edhe besimi, marrë parasysh faktin se në të shumtën e rasteve, sidomos në Ballkan, shteti është bartësi kryesor i përndjekjes së pakicave.

III.4. Gjeostruktura dhe procesi i njohjes

Procesi i krijimit të shtetit të Kosovës kishte shumë të panjohura. Përfundimi luftës dhe nevoja për miratimin e një rezolute nga ana e OKB-së, e ktheu edhe një herë fatin e Kosovës dhe të ardhmes së saj politike, në një arenë të përplasjeve të fuqive të mëdha. Rezoluta 1244, e KS të OKB-së, nuk parashihte modelin se si do të zgjidhej statusi përfundimtar i Kosovës, por sido që të jetë, përmes UNMIK-ut, u mundësua krijimi i jetës institucionale, institucione që më pas do të ishin përgjegjëse për nxjerrjen e një statusi të ri politik.

Në rrethana jo shumë të njohura deri më tash, me 17 mars 2004, ndodhën ato që njihen si *"Trazirat e Marsit"*, trazira këto që patën një epilog tragjik dhe nisën si pasojë e

vrasjes së tre fëmijëve në lumin Ibër, ata paraprakisht ishin ndjekur nga serbët e veriut të Mitrovicës. Në raportin e ICG-së për Evropë (2004), lidhur me “Trazirat e Marsit” dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e mëpasshëm tregohet se këto trazira shkatërruan progresin më shumë se katër vjeçar të Kosovës, ndërsa trazirat si të tilla më shumë i cilëson si spontane, ndërsa ndikimi i Beogradit në tensionimin e Kosovës lidhet me padurueshmërinë e shqiptarëve ndaj institucioneve ndërkombëtare dhe qëllimeve të tyre në Kosovë. Cilësimi i trazirave si spontane pa i identifikuar shtytësit kryesorë të tyre, flet ndër të tjerash për paqëndrueshmërinë e situatës së krijuar ndër vite, e cila me gjasë do të plaste në cilindo rast tjetër, por epilogu i tyre ishte tragjik për Kosovën dhe për të ardhmen e saj shumetnike.

“Më 17 mars, 2004, themelet jostabile të një progresi gradual të arritur për katër vite e gjysmë u shkatërruan” (Weller, 2009: 312).

Vrasja e një të riu serb të Kosovës dhe mbytja e dy fëmijëve shqiptarë - megjithëse në dukje spontane në fillim, ishte marrë shpejt në kontroll nga elementë të organizuar me interes për të përzënë serbët e Kosovës nga provinca dhe për të kërcënuar praninë ndërkombëtare atje, thuhet në raportin e KS të OKB-së, duke vijuar se trazirat pasuan dy ditë dhunë, duke rezultuar në 19 vdekje, 954 civilë të plagosur dhe 730 shtëpi, afër ose që u përkasin pakicave të Kosovës, të djegura ose të dëmtuara.²⁴

Ishte e qartë se lënia anash e statusit për një kohë, do të ishte fatal për gjithë procesin e deritanishëm, ndërkaq “Trazirat e Marsit” dhanë indikacione të qarta, si paqëndrueshmëria, nevoja për siguri për minoritetet dhe gjetja e shpejtë e një statusi i cili do të përfshinte një shkallë të gjerë të vetëqeverisjes për pakicat. Mungesa e progresit rreth statusit final si dhe mungesa e ndonjë indikacioni lidhur me atë se sa mund të zgjasë mandati i UNMIK-ut ishin faktorë që ndikuan në shtimin e ndjenjës së frustrimit (ICG, 2004: 2).

Humbja e legjitimitetit politik të misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut, u pa edhe si mundësi e diferencimit të shoqërisë shqiptare ndaj gjithë bashkësisë ndërkombëtare prandaj minimi i proceseve ishte qenësore për efektet ndërkombëtare që kishte Kosova dhe stabiliteti i saj. Raportet dhe mediumet ndërkombëtare nuk reshtën së shkruari në lidhje me këtë

²⁴ Security Council, March violence in Kosovo ‘huge setback’ to stabilization, reconciliation, under-secretary-general for peacekeeping tells security council, 4942nd Meeting, <https://press.un.org/en/2004/sc8056.doc.htm>. 13/04/2004.

ngjarje dhe me pasojat e saj për rrënimin e tregimit të suksesshëm të Kosovës si shoqëri multietnike.²⁵

Edhe pse zyrtarisht nuk ka një raport që tregon me saktësi se kush qëndron prapa organizmit eventual të këtyre trazirave, nëse ato nuk kanë qenë spontane, reagimi i zyrtarëve serbë, tregon se ata nëse nuk e kanë organizuar gjithë skenarin, ata e kanë pritur një të tillë, përmes të cilit kanë plasuar idenë e decentralizimit në baza etnike, si parakushti i domosdoshëm për sigurinë e serbëve të Kosovës.

Kjo dëshmohet në një takim që kryeministri serb, Kushtunica, kishte me një diplomat britanik, ku ndër të tjera thuhej: “Abuzimet e të drejtave të njeriut kundër serbëve në Kosovë ishin një dukuri e përditshme dhe se e vetmja mënyrë për të stabilizuar situatën ishte përmes ‘decentralizimit dhe garancive institucionale’ për serbët dhe pakicat e tjera joshqiptare” (Traynor, 2004).

“Trazirat e Marsit” sikur trazuan rrugën që do të ndiqte Kosova drejt të ardhmes së saj politike, ndërkaq Serbia në anën tjetër menjëherë ndërmori të gjithë hapat për të paraqitur këtë rast si:

- Një dëshmi se Kosova nuk ka të ardhme, duke synuar të arrijë dy qëllime;
 - e para, se Kosova nuk është tregim i suksesit për një shoqëri multietnike, duke minuar krejt investimin ndërkombëtar aty; dhe
 - e dyta, duke përcaktuar se si do të rrjedhë edhe procesi dhe më saktë se cila do të ishte pozita e serbëve në Kosovë, ajo filloi ta rriste rezistencën në dy sfera:
 - të brendshme, përmes serbëve lokalë; dhe
 - të jashtme, përmes angazhimit diplomatik, siç bën edhe tash.

Trazirat ndikuan në një mobilitet të serbëve lokalë, ata në mungesë të ndonjë alternative tjetër u grupuan në lokalitete me shumicë serbe dhe i forcuan strukturat e tyre të njohura si paralele, duke rritur në këtë mënyrë rezistencën ndaj çdo shtate tejet të (pa)prishme.

“Duke e mbajtur Kosovën si një çështje grindjeje, Rusia dëshiron të ngrejë një pykë brenda BE-së dhe ta lidhin Serbinë më ngushtë me Moskën. Shtytja serbe për krijimin e Unionit të Komunave Serbe brenda Kosovës, si precedenti i

²⁵ BBC: Kosovo clashes 'ethnic cleansing', CBS: Serbia Kosovo Clashes.

rrezikshëm i shkëmbimeve territoriale, ka për qëllim të krijojë destabilitet të qëndrueshëm dhe të vërë në pikëpyetje parimet e sovranitetit dhe multietnicitetit në shoqëri” (Rajic & Hoare, 2022).

Pamundësia për të shtrirë autoritetin në të gjithë territorin, me 25 korrik 2011, qeveria e Kosovës kishte ndërmarrë një aksion të gjerë policor, më qëllim të vendosjes së autoritetit dhe marrjes nën kontroll të pikave kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak, të demoluara disa ditë pas shpalljes së pavarësisë. Prania e policisë në një numër kaq të madh krijoi rezistencë te serbët e asaj pjese, të cilët shpejt u organizuan dhe ndërprenë aksionin e policisë, bllokuan rrugët dhe vendosën barrikada, të cilat qëndruan me vite atje.

Pos KFOR-it, të vetmet institucione që operonin ishin strukturat paralele, pavarësisht se si të tilla nuk lejoheshin as nga Marrëveshja e Kumanovës, e cila përcaktonte institucionet e sigurisë në Kosovë. Këto struktura përmes mekanizmave të ndryshëm, kryesisht të dhunës e të shantazhit, kanë ndikuar në sjelljen e serbëve të atjeshëm, por janë përgjegjës edhe për spastrimin etnik të veriut të Kosovës.

Që nga viti 1999, në veri të Kosovës kanë funksionuar strukturat paralele të sigurisë. Ndikimi dhe veprimtaria e tyre është intensifikuar edhe më shumë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Organizimi dhe financimi i shërbimeve të sigurisë është direkt i lidhur me Qeverinë e Republikës së Serbisë.²⁶

Serbia për të pamundësuar qasjes e autoriteteve të Kosovës në atë pjesë, kishte strukturë të përbërë nga tri dikastere, MPB-ja që kishte 500 pjesëtarë, Mbrojtja Civile 254 dhe Shërbimin sekret serb, dega në Kosovë (Krasniqi/Koha Ditore, 2012: 3). Pos kësaj, serbët kishin krijuar edhe sistemin paralel të tyre, edhe në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë.

Situata e krijuar dhe pamundësia për të shtrirë autoritetin e Kosovës atje, çoi në nevojën për të zhvilluar bisedime mes Kosovës dhe Serbisë, bisedime të cilat në fillim ishin të karakterit teknik e më vonë avancuan në atë politik, të njohura si Bisedimet e Brukselit

Bisedimet e Brukselit sollën një rezultat i cili krijoi një situatë të re antagonistë në raportet Kosovë – Serbi, edhe pse ajo ishte pjesë e marrëveshjes. Krijimi i një asociacioni të komunave me shumicë serbe, u pa më sy kritikë nga palë të ndryshme, të involvuar në proces

²⁶ Raport i Zyrës së koordinorit për Veri, “Mbi strukturat paralele të Serbisë në veri”, Maj 2011, 41-51.

edhe pse komunat sipas ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës, kanë të drejtë të bashkëpunojnë në të mirë të zhvillimit të politikave.

Parimet themelore të bashkëpunimit ndër komunal janë që komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë dhe të krijojnë partneritet me komunat e tjera të Kosovës, brenda fushave të tyre të kompetencave, për të kryer funksione që janë në interesin e tyre dhe për të realizuar qëllime dhe interesa të përbashkët në fushën e shërbimeve publike komunale dhe zhvillimit lokal.²⁷ Bashkëpunimi ndër komunal gjithashtu ishte parashikuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisaarit) dhe është i garantuar në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.²⁸

Në Kosovë, u shfaq një rezistencë e jashtëzakonshme në lidhje me krijimin e këtij Asociacioni, edhe për faktin se si i tillë u vlerësua si antikushtetues. Partitë opozitare, thirrën protesta në mënyrë të vazhdueshme, madje bllokuan edhe punën e kuvendit, duke përdorur gazin lotsjellës. Gjithë ky antagonizëm vazhdon edhe sot e kësaj dite, kur disa qeveri kanë rënë shkak i kësaj rezistence. Por krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe, duket se është i pashmangshëm, për faktin se bashkësia ndërkombëtare pa dallim ka insistuar në themelimin e tij.

²⁷ Këshilli i Evropës, Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale (Strasbourg 1985), Art. 4.4.

²⁸ Ligji për bashkëpunim ndërkomunal, neni. 4.3.

KAPITULLI IV

PROCESI I NJOHJEVE, POLITIKA E JASHTME DHE DIPLOMACIA

Shtetet në marrëdhëniet ndërkombëtare synojnë që përmes politikës së jashtme të mund të forcojnë pozitën e tyre në ato marrëdhënie. Teorikisht, politika e jashtme e shteteve synimin e ka në ruajtjen e marrëdhënieve me shtetet e tjera, përmes formave të caktuara, ku qëllimi kryesor është në ruajtjen e sigurisë, përmes mbrojtjes së interesave politikë, ushtarakë e ekonomikë (Reka et al., 2016: 220).

Shtetet nuk reshtin së kërkuari strategjitë më të duhura lobuese për arritjen e objektivave politike, pasi sigurisht grupet lobuese nëpër botë, kanë një praktikë të theksuar të angazhimit të tyre politik, arritjet e të cilëve kapërcejnë edhe diplomatët më të suksesshëm (Newhouse, 2009: 73).

Para se të trajtohet procesi lobues, si pjesë e politikës së jashtme, është me rëndësi të trajtohet fillimisht koncepti politika e jashtme, diplomacia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Autorët konsiderojnë se shtetet aplikojnë strategji specifike, që ka kuptimin e veprimit të qartë politik në raport me strukturat e tjera ndërkombëtare, si shtetet, organizatat, kompanitë multinacionale, me qëllim të promovimit të vlerave dhe attributeve, përmes së cilave synojnë të ndikojnë te vendimmarrësit në favor të vendit respektiv (Imeri, 2021).

Politika e jashtme e shteteve ushtrohet nga diplomacia, si shuma e veprime që shteti ndërmerr ndaj shtetit, ose organizatës tjetër, këto veprime cilësohen si strategjike (Goldstein, 2003: 165). Veprimet politike të ndërmarra nga shteti dhe diplomacia e saj kanë një synim, ruajtjen e interesit kombëtar. Ky term përdoret gjerësisht në literaturën e politologjisë dhe i referohet veprimeve politike të ndërmarra nga shtetet që kur ato janë krijuar dhe përshkruajnë aspiratat dhe qëllimet që kanë shtetet sovraane në marrëdhëniet mes vete (Nuechterlein, 1976: 246).

Politika e jashtme e shteteve varet edhe nga kapaciteti që ato kanë, sidomos potenciali i tyre ekonomik, territori, ose edhe faktorë të tjerë, të cilët determinojnë sjelljen dhe kursin e këtyre shteteve në MN, ndërsa provojnë që përmes mekanizmave të diplomacisë multilaterale të kompensojnë pikat e tyre të dobëta, por nuk përjashtohet fakti se me një qasje të duhur politike, mund të kapërcehen të gjitha pengesat (Thorhallsson & Steinsson, 2017).

Në procesin e zbërthimit të koncepteve politike, si politikë e jashtme, marrëdhënie ndërkombëtare e diplomaci, të shpeshta janë rastet kur njëra e zëvendëson tjetrën, së paku praktikisht, por gabimisht në aspektin e politologjisë, thotë studiuesi Ernest Petric (2003, 34-37).

- **Politika e jashtme**

Është njëra nga konceptet më të përdorura të shkencës politike, nga autorë si Kenneth N. Waltz, Hans J. Morgenthau, Ole Holsti, Marc Lanteigne, David Reed, Richard N Haass, John J Mearsheimer, Stephen M Walt, Jeffrey Sachs, Robert Jervis etj

Studiuesi i njohur Kenneth N. Waltz, në veprën e tij të njohur “Teoria e Politikës Ndërkombëtare”, konsideron se politika e jashtme flet për veprimet politike që kryhen nga niveli kombëtar, pra veprimet e shtetit, qofshin real politika, balancimi i fuqisë etj. (1979: 72). Politika e jashtme konsiderohet si shuma e veprime politike që ndërmerr kreu i shtetit, në planin e veprimit të jashtëm (shemb.), dhe varen nga qëndrimet politike personale që mban ai lider politik (Holsti, 2013: 35).

Studiuesi tjetër Hans Morgenthau, që konsiderohet si përfaqësuesi i shkollës realiste të studimit të MN-së, e lidh teorinë e tij me një aks të pashkëputshëm veprimi *fuqi – shtet*. Sipas tij, fuqia mund të përfshijë ndonjë gjë që krijon dhe mban kontrollin e njeriut mbi njeriun, ndërsa ushtrimi i pushtetit buron brenda subjekteve intelektualisht të prekshme ku më i rëndësishmi sipas tij është shteti, sepse sipas Morgenthau “kombet-shtete” janë si pikë përfundimtare e referencës së politikës së jashtme bashkëkohore (Thompson & Clinton, 2006: 11).

- **Politika e jashtme në shërbim të njohjes**

Marrëdhëniet ndërkombëtare, politika e jashtme, shtetet, diplomacia e rendet ndërkombëtare, si sisteme e nënsisteme reciproke, tregojnë se politika gjerësisht shihet si veprimtari fluide, ku veprimet dhe arritjet e tyre janë pjesë e një tërësie aktorësh dhe faktorësh nga më të ndryshmit, nga më të papërcaktueshmit, që ndikojnë edhe te krijimi i shtetit, njohja ose jo e tij, por edhe te zhvillimet pasuese.

Meqë krijimi dhe njohja e shtetit ka efekte në rendin dhe të drejtën ndërkombëtare, ka bërë që edhe disa entitete politike të synojnë që të avancojnë në krijimin e shteteve të tyre duke e parë shembullin dhe duke e ndjekur modelin e Kosovës, por njohja e gjerë dhe kaq e

shpejtë e republikës së re, tregoi se ky nuk ishte shembulli që duhet të ndiqet, thotë studiuesja Nina Caspersen, e cila argumentimin e vijon:

“Gjatë Luftës së Ftohtë, kriteret për njohjen e shtetit ishin mjaft të qarta dhe praktika aktuale shtetërore ishte relativisht e qëndrueshme. Megjithatë, shpërbërja e Jugosllavisë çoi në pasiguri më të madhe: e drejta për vetëvendosje u zgjerua përtej kontekstit kolonial dhe u shtuan kushte shtesë, si demokracia dhe të drejtat e njeriut. Megjithatë, këto nuk u zbatuan vazhdimisht dhe u duk se politika ishte bërë më e rëndësishme se e drejta ndërkombëtare” (Caspersen, 2015: 393).

Krijimi i shtetit të Kosovës krijoi jo pak pritje se do të mund të ndiqej si shembull edhe nga entitetet e tjera, pavarësisht se këto shtete që e njohën Kosovën deklaroheshin se ky shtet është unik si çështje dhe si i tillë, është shuma e ngjarjeve politike pararendëse.

Kjo sido që të jetë nuk ishte ndonjë farë argumenti që do t'i ndalte entitetet të mos deklarohen shtete, por ishte më rëndësi faktori pasues, *ai i sigurimit të njohjeve*, pasi kështu këto entitete politike të deklaruar si shtete do të forcojnë pozicionin e tyre ndërkombëtar, nëse do të njihen, duke e rrumbullakuar shtetësinë e tyre, duke i dhënë rëndësi të madhe njohjes dhe faktorëve/strategjive që shpien në sigurimin e saj. Aftësia diplomatike dhe njohja e marrëdhënieve ndërkombëtare, si aftësi të shteteve e liderëve politikë të tyre, është jetike në këto raste, pasi ato sigurojnë ekzistencën e shtetit.

Shumica e argumenteve të mësipërme flasin për standardet dhe kornizimet teorike të politikës së jashtme, por pak nga to, pranohen gjerësisht si të efektshme edhe në rastin e njohjes së një shteti, aq më pak të Kosovës. Këtë mendim e kanë shkollarët Newman dhe Visoka, të cilët vënë në dukje se faktorët sistematikë, institucionet normative dhe preferencat e fuqive të mëdha kanë ndikim në njohje, por nuk janë të mjaftueshme për të përshkruar rastet komplekse të njohjes, si ajo e Kosovës, ku faktorët si *aftësitë diplomatike, koha dhe madje rastësia* dalin si pjesë e gjithë procesit (Newman & Visoka, 2018: 367).

Ky konstatim i përmendur, qëndron në linjë me argumentimin tjetër, që ka të bëjë me sistemin ndërkombëtar, i cili ka ndikuar edhe në njohje. Duke pasur një rend të tillë të cilësuar si multipolar dhe në tranzicion, është krijuar njëfarë shtate amorfe, ku dalin në shprehje edhe faktorët e sipërpërmendur, të cilët sido që të jetë, kanë fragmentuar edhe më tej raportin me

njohjen dhe praktikën e saj (Newman & Visoka, 2021: 1). Te rasti i Kosovës, autorët përmendin faktin se shumë shtete, të varura nga kjo qarje e sistemit, janë gjetur si në mes, duke vonuar njohjen, ose duke e pritur se si do të rrjedhë vetë procesi (Newman & Visoka, 2018: 2).

Kosova kishte ndërtuar strukturën e politikës së jashtme relativisht vonë, natyrisht paralelisht me shtetin, por lidhjet diplomatike, komunikimet dhe lobimi ishin më të vjetra se kaq, ato datojnë që nga periudha e para çlirimit, por edhe gjatë periudhës së krijimit të shtetit të Kosovës, ndërsa studiuesit i kanë kushtuar vëmendje strukturimit të politikës së jashtme, si funksionim, por edhe ndarje kompetencash, shkallën e bashkëveprimit e deri te arritjet e tyre në procesin e njohjeve të Kosovës.

“Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nisur nga nevoja për krijimin e mekanizmave për jetësimin e politikave të jashtme të shtetit, ka precizuar në një numër nenesh, bazën për krijimin e institucioneve përgjegjëse relevante. Këto nene janë të shpërndara në kuadër të kompetencave të institucioneve të ndryshme, të presidentit, kryeministrit (qeverisë) dhe kuvendit, si organe të brendshme të politikës së jashtme” (Imeri, 2022).

- Presidenti dhe roli në politikën e jashtme:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, te roli që ka presidenti i Kosovës, tregon disa nivele ku ai ka mundësi të përfshihet në politikën e jashtme, si pjesë e prerogativave kushtetuese, funksione të cilat dalin edhe si pjesë e ndarjeve të pushtetit dhe bashkëveprimit mes tyre.

Neni 4, i cili flet për Formën e Qeverisjes dhe Ndarjen e Pushtetit, thotë: *“Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë”* (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 4).

Presidenti i Republikës së Kosovës ka përgjegjësi të nënshkruajë marrëveshjet ndërkombëtare, si pjesë e obligimeve ndërkombëtare që ka marrë shteti në raport me shtetet e tjera. Kushtetuta e Kosovës e ngarkon presidentin, me të drejtën për të ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare, konform Nenit 18, *për të drejtat dhe liritë themelore; anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe marrjen përsipër të*

detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 18).

Kushtetuta e Kosovës, kur flet për presidentin, një vëmendje i kushton edhe angazhimit të tij të jashtëm, siç shihet në Nenin 83, ku thuhet: *“Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës”* (Kushtetuta e Kosovës), ndërsa në nenin vijues (84), flitet për kompetencat e presidentit, dhe në disa nene precizohet në veçanti angazhimi i jashtëm i tij, si në Nenin 84, (pika 1), *ku thuhet: (Presidenti) përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë; (pika 7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë; (pika 10) udhëheq politikën e jashtme të vendit; (pika 11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës; (pika 24) vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me kryeministrin; (pika 25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e qeverisë* (Kushtetuta e Kosovës, Neni 84).

- **Qeveria dhe roli i saj në politikën e jashtme**

Në Kosovë, qeveria luan rolin kryesor në politikën e jashtme, këto kompetenca janë pjesë e enumeracionit taksativ të kushtetutës dhe janë të shpërndara te qeveria dhe kryeministri. Neni 93, i Kushtetutës së Kosovës flet për kompetencat e qeverisë në fushëveprimin e politikës së jashtme, dhe thotë se *qeveria ka këto kompetenca: propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit* (pika 1); dhe (qeveria) *i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misioneve diplomatike të Kosovës* (pika 8) (Kushtetuta e Kosovës, Neni 93). Ndërsa sa i takon kompetencave lidhje me politikën e jashtme, Nenit 94, pika 1, thotë (kryeministri) *përfaqëson dhe udhëheq qeverinë; pika 2, (kryeministri) siguron që të gjitha ministratë të veprojnë në pajtim me politikat qeveritare; dhe pika 9, (kryeministri) këshillohet me presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit* (Kushtetuta e Kosovës, Neni 94).

- **Kuvendi i Kosovës dhe roli i tij në politikën e jashtme**

Kuvendi i Kosovës ka shumë pak kompetenca sa i takon angazhimit të tij në procesin e politikëbërjes së jashtme të Kosovës, gjithsesi edhe ato pak kompetenca janë të ushtruara direkt nga institucionet e tjera. Kushtetuta e Kosovës në Nenin 65, ku flitet për kompetencat e kuvendit, thotë: *miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme* (pika 1), *ratifikon traktatet ndërkombëtare* (pika 4) *dhe mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë* (pika 12) (Kushtetuta e Kosovës, Neni 65).




Figura 8. Shpërndarja e kompetencave nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës te organet e brendshme të politikës së jashtme

Burimi: Dorajet Imeri²⁹

IV.1. Sfidat e para të Kosovës për sigurimin e njohjeve

Shteti i Kosovës ndonëse i deklaruar më 2008, e kishte të sigurt se njohja e saj nuk mund të kalonte përmes KS-OKB-së, ku Rusia kishte deklaruar se nuk do të lejonte miratimin e Pakos së Ahtisaarit,³⁰ duke e minuar gjithë procesin, prandaj shpallja e shtetit duhej të bëhej nga institucionet e Kosovës të cilat ishin pajtuar me partnerët ndërkombëtarë për zhvillimin

²⁹ Imeri, D. (2021). "The role of parliamentary diplomacy in Kosovo's foreign policy 2008-2021" in the process of publication in the new issue of the Scientific Journal "Bulletin of the Faculty of Philosophy" KDU 94(=18) (05).

³⁰ Rusia kishte paralajmëruar aplikimin e të drejtës së votës, në rast se kërkohet një votim lidhur me statusin e ri politik të Kosovës, pa pajtimin e Serbisë dhe Rezolutës 1244.

e mëtejme të procesit, këto shtete kishin paralajmëruar se do të njihnin Kosovën që para shpalljes së saj.

Dështimi për të çuar përpara agjendën e Kosovës në OKB, e bëri entitetin politik kosovar të detyruar të ndiqte rrugën e tij për të shpallur shtetin. Në deklaratën e shpalljes së pavarësisë (Kuvendi i Kosovës, 2008), kërkohet që shtetet të njohin pavarësinë e Kosovës, të deklaruar në Kuvendin e Republikës, *kjo bëri që të përcaktohet një dinamikë tjetër e njohjeve*.

Kosova, kështu, kthehet në një anë të re të ballafaqimit me Serbinë, tash për sigurimin e njohjeve, pasi çdo njohje kishte shumë rëndësi për entitetin politik të deklaruar shtet, për të krijuar një masë kritike të vendeve që e njihnin pavarësinë e Kosovës, të cilat do të jenë të nevojshme për t'i mundësuar asaj zhvillim në proceset vijuese (Reynolds, 2008).

Shtetet e fuqishme botërore, duke e parë zhvillimin e procesit, u deklaruan paraprakisht për qëndrimin që do të mbanin në raport me statusin e ardhshëm politik të Kosovës, madje shumica nga to ishin angazhuar politikisht për përmbylljen e tij. Shtetet e Bashkuara e kishin bërë të qartë se do të njihnin shtetin e ri, që në vitin 2007, madje pos njohjes, qëndrimi i presidentit Bush ndaj Kosovës, ka qenë më shumë sesa deklarimi i njohjes, ai thotë se republika e re do të jetë shtet, duke treguar se SHBA-ja nuk mjaftohet vetëm me pranimin e deklarimit të pavarësisë, por edhe të mirëmbajtjes së saj, duke dëshmuar se do ta ndihmojë edhe në procesin e mëpasshëm, atë të sigurimit të njohjeve, ndërsa fjalimi i mbajtur në Tiranë, pak para shpalljes së pavarësisë, shihet si historik, ku ndër të tjerash, kishte thënë:


“Presidenti Bush: Në një moment kohor, herët a vonë, ju duhet të thoni mjaft, Kosova është e pavarur” (Zakaria & Tzortzi/ Reuters, 2008).

Njohja e Kosovës nga vendet perëndimore, sikur krijoi njëfarë ndasie me pjesën tjetër të botës, sa i takon njohjes së pavarësisë së shtetit të ri, pasi procesi politik i saj krijoi së paku tri grupime shtetesh, ato që do të mbështesnin njohjen, ato që ishin deklaruar kundër njohjes së saj që në fillim dhe grupin e tretë e përbënin shtetet që për arsye të caktuar nuk nxituan të deklaronin njohjen, duke u bërë pikërisht ato, caku i lobimit vijues për sigurimin ose jo të njohjes.

“Shumëllojshmëria e reagimeve të shteteve të treta ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës gjen bazën në boshllëqet e së drejtës ndërkombëtare që lejojnë

politikën të luajë në praktikën e njohjes së shtetit” (Poghosyan & Berg, 2021: 605).

Njohjet e para për shtetin e Kosovës (shih dinamikën e njohjeve brenda muajit të parë në diagramin vijues, **Diagrami 2**) erdhën nga shtetet që e njihnin problemin e saj (Hoxhaj, 2021), pasi procesi politik që kishte kaluar, ka krijuar shumë ngjarje paraprake, të ndodhura, sidomos gjatë viteve të 90-ta të shek. XX, madje ky argumentim është paraqitur te disa deklarime, si ajo e SHBA-së dhe e Gjermanisë.³¹



Diagrami 2. Njohjet e pavarësisë së Kosovës në muajin e parë të shtetësisë


Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës

Shtetet e para që e njohën Kosovën vinin nga kontinenti evropian dhe ai amerikan dhe nga shtetet ku ndikimi i fuqive të mëdha reflektonte edhe te vendimet që do të merrnin ato (shih diagramin e bashkëngjitur me të dhënat konkrete të shteteve që e njohin Kosovën, **Diagrami 3**). Këtu duhet të përmenden shtetet si SHBA-ja, Franca, MB-ja, Gjermania, Turqia, si vende me ndikim përcaktues për zhvillimet politike globale, por edhe në procesin e njohjeve të pavarësisë.

Procesi politik i njohjeve të pavarësisë, u var edhe një herë nga ata që e kishin mbështetur Kosovën, sepse shtetet e vogla synimin e kanë që ta merrnin mbështetjen e

³¹ SHBA-ja dhe Gjermania në argumentimet e tyre për njohje thonë se ky veprim është si kulmim i ngjarjeve historike nëpër të cilat ka kaluar Kosova.

fuqive të mëdha, pasi në krah të tyre, edhe mund të sigurojnë njohjet, ose e kundërta, shtetet që pengojnë procesin e njohjeve synojnë që përmes lidhjeve politike tradicionale me shtetet e fuqishme, ose disa nga to të pengojnë njohjet.



Diagrami 3. Trendi i njohjeve të pavarësisë

Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës

Studiuesit e paraqesin kështu këtë ndarje mes shteteve që e kanë përkrahur, ose kundërshtuar Kosovën në procesin e njohjeve, ku vendet që janë pjesë e sferës së ndikimit amerikan, me lidhje politike e ushtarake, e kanë njohur Kosovën ose kanë gjasa të bëjnë këtë, ndryshe nga ato, vendet që gjenden në zonën e ndikimit rus, sigurisht kanë pak gjasa për të bërë një veprim të tillë, ose e vonojnë atë (Siroky et al., 2021: 1049).

Pavarësisht se shpallja e pavarësisë u mbështet nga SHBA-ja dhe shumica e vendeve evropiane e perëndimore, ky akt u kundërshtua ashpër nga Serbia, ajo filloi një ofensivë të re diplomatike, duke i kërcënuar shtetet që njihnin pavarësinë e Kosovës me shkëputje të raporteve diplomatike, ose sanksione të tjera. Ajo kishte nisur ta aplikonte *Doktrinën Hellstain*, një praktikë e ushtruar nga Gjermania Federale, e cila i shkëputte raportet

diplomatie me të gjitha shtetet që e njihnin Gjermaninë Demokratike, si shtetin e dytë gjerman (Fawcett, 1968: 522).³²

Sido që të jetë, procesi i njohjeve të Kosovës ka kaluar në disa faza të cilat kanë qenë reflektim i proceseve paralele politike, të cilat janë paraqitur si të orkestruara nga Serbia e Rusia që kanë dashur të ndikojnë në bllokimin ose ngadalësimin e gjithë procesit, deri në përmbysje të përgjithshme të tij (shih, **Figura 9**).




Figura 9. Prosesi i njohjeve dhe ngjarjet përcaktuese

Si pasojë e aplikimit të kësaj doktrine dhe me qëllim të destabilizimit të rajonit, shteti serb, i gjetur para një akti të kryer, edhe pse të pritshëm, shprehu papajtueshmërinë e tij me aktin e deklarimit, kësisoj, shumica e ambasadave të huaja të akredituara në Beograd, u mbyllën, protestat ishin të shumta e të shpeshta, ndërsa Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në diskutimin për Kosovën, në mbledhjen e mbajtur menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, nuk nxori asnjë rezolutë, por rikonfirmoi ndarjen e madhe që kishte ndodhur mesh fuqive të mëdha lidhur me statusin e Kosovës (BBC, 2008).

Këto veprime të Serbisë, studiuesi Bebler, qartë i trajton si strategjia për ngadalësimin e njohjeve:

³² Praktikrat e tilla, edhe pse fillimisht janë qasje doktrina shtetërore, përmbajta, forma dhe objektivat merren si modele për shtetet e tjera. Prandaj shtetet herë pas here kanë miratuar, me shprehje formale, doktrina për të shpallur interesin ose synimin politik e strategjik, duke i kthyer në praktika shtetërore, thotë studiuesi Thomas D. Grant. (2014), kjo praktikë ishte ringjallur nga Serbia më 2008.

“Objektivi i saj (i Serbisë) imediat politik ishte zbutja e opinionit publik serb, fitimi i kohës dhe ngadalësimi i procesit të njohjes ndërkombëtare të Kosovës”
(Bebler, 2015: 162).

Procesi i njohjeve të Kosovës si kulmimi i krijimit të shtetit të ri, po i jepte fund një procesi të gjatë e historik të shpërbërjes së Jugosllavisë, proces që kishte pasur disa zhvillime të jashtëzakonshme brenda saj, duke filluar me ndërhyrjen humanitare e administrimi ndërkombëtar, duke çuar në krijimin e një shteti që konsiderohet si një *shtet në tranzicion*, pavarësisht pretendimeve të tij, pasi të shumta janë pengesat që i bëhen sidomos ndaj moslejimit të hyrjes në Kombet e Bashkuara, konstatonte James Gow, në vitin 2009, kur Rusia ishte e zëshme në procesin e saj të pengimit me njohje dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare (Gow, 2009: 239).

Kosova, në procesin e saj të njohjeve, u gjet e ballafaquar përsëri me sfida të vjetra, strukturore fillimisht, por edhe jostrukturore më pas. Shtetet nëpër botë, duke pasur raste të ngjashme në territoret e tyre, ose afër tyre, nuk nxituan të njihnin shtetin e ri, duke pritur se si do të rrjedhin gjërat. Mosnjohja e tyre e shpejtë, i dha mundësinë kundërshtarëve të shtetit të Kosovës të reagonin individualisht ndaj tyre, përmes formave më jokonvencionale të mundshme (Pacolli për REL/ Bislimi, 2020).

Rusia ishte e interesuar që të pengonte njohjen e shtetit të Kosovës, për arsyt e veta strategjike, madje qëndrimi i saj i parë ishte se nuk do të lejonte asnjëherë njohjen e shteteve që dalin nga shpëputja e pavullnetshme me shtetin amë, ndërsa me njohjen që i bëri Osetisë Jugore e Abkazisë, sikur shënoi përmbyse të paradigmës së politikës së saj të jashtme, kurse në anën tjetër nuk e njeh Kosovën, pavarësisht që e konsideron të së njëjtës natyrë me entitetet politike që i njohu, thotë studiuesi Kavus Abushov (2021: 401), i cili vë në dritë faktin se Rusia më pak ka vepruar duke e përdoruar rastin e njohjes së Kosovës nga perëndimi, se sa ka vepruar për shkak të daljes së situatës jashtë kontrollit, duke qenë se ai veprim do të pasonte aneksimin e Krimesë (2021: 401).

Serbia, duke e penguar njohjen e Kosovës, ka vepruar duke i pasur të qarta objektivat dhe synimet e saj, sidomos ndaj vendeve të grupit të tretë, ndaj të cilave shteti serb kishte pasur të kultivuara raportet politike, në veçanti me *“Lëvizjen e Shteteve të Painkuadruara”*, lidhjet historike me të cilat i dha njëfarë avantazhi Serbisë në lobimin për mosnjohje (Persiskopi, 2016).

Rusia në anë tjetër e ka përdorur njohjen e Kosovës nga perëndimi, për t'i krijuar avantazhe vetes në njohjen e entitetet politike rreth zonës së saj të ndikimit, por këto entitete nuk u njohën nga shtetet e tjera, pasi shtetet veprojnë drejt njohjes kur i shohin entitetet politike si të ligjshme, duke qenë se shpesh këto entitete thirren në norma e simbole rezonante, sidomos te vendet që shkëputen njëanshëm (Seymour, 2017: 817), por efektet politike të njohjes nga Rusia, ishte i madh sidomos në krijimin e dilemave të reja te shtetet potencialisht njohëse ndaj pavarësisë së Kosovës.

SHBA-ja dhe shtetet e tjera që e kishin mbështetur dhe njohur Kosovën, kishin konstatuar se këto raste janë unike dhe se te to ka pasur dhunë sistematike të ushtruar kundrejt një grupi etnik, prandaj që në fillim është cilësuar si një shkëputje e karakterit korrigjues, për të ruajtur rendin ndërkombëtar nga reagimet e njëjta, me efekte destabilizuese (Roseberry, 2013: 857). Por meqë shtetet njohjen e shohin si qëndrim politik, në mungesë të ndonjë përkufizimi tjetër gjithëpërfshirës, tregohet se Rusia ka dashur të përdorë politikisht situatën.


Serbia ka synuar përherë të kontekstualizojë njohjen e pavarësisë së Kosovës, fillimisht duke e dërguar rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila kishte efekte në ripërcaktimin strategjik të Kosovës, sa i takon arritjeve të njohjeve dhe ruajtjes së ligjshmërisë së shpalljes së saj, duke i shtyrë institucionet e Kosovës të angazhonin ekspertë vendorë e të huaj (Konushevc, REL/ 11 tetor, 2008).

IV.2. Njohjet për Kosovën nga momenti i deklarimit deri në vendimin e GJND-së

Që në momentin e deklarimit të shtetit nga Kuvendi i Kosovës (shih njohjet e Kosovës për vitin e parë, **Diagrami 4**), Serbia ka përdoruar instrumente politike e juridike për të penguar procesin e njohjeve të Kosovës, fillimisht duke i djegur disa nga ambasadat e akredituara në Beograd, me ç'rast ka dashur të dramatizojë situatën, si një kurs shumë radikal, i cili synonte të mirëmbante nacionalistët serbë, por edhe për të ngritur sado pak pritshmëri se njohjet mund të vonohen, ndërsa më vonë kishin dërguar rastin e Kosovës në GJND për të parë ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së saj.

Serbia kishte identifikuar shtetet të cilat kishin raste të ngjashme brenda territoreve të tyre, shtetet me raporte politike të mira, të kultivuara që nga koha e Jugosllavisë, por edhe shtetet e fuqishme për të penguar njohjen e Kosovës. Një shembull i tillë janë disa shtete

evropiane, Rusia, por edhe shtetet që bënin pjesë të “Lëvizja e Shteteve të Painkuadruara”, me të cilat Serbia u mor intensivisht (REL, 2009), por edhe Kosova kishte planifikuar po ashtu disa veprime për të siguruar njohjet nga shtetet, sidomos ato të rajonit dhe ato që hezitonin në fillim (REL, 22 mars 2008).



Diagrami 4. Njohjet e pavarësisë së Kosovës në vitin e parë të shtetësisë

Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës

Njohja e shtetit të Kosovës kishte një dinamikë “mbresëlënëse” në fillim, pasi ajo u njoh nga shumica dërrmuese e vendeve të BE-së dhe shtetet me të fuqishme të botës, duke krijuar një masë kritike për procesin e njohjeve, më pas. Shtetet që e njohën Kosovë, intensifikuan ardhjet e tyre në Kosovë, në vizita diplomatike si shtetin më të ri, duke treguar për përkushtimin e tyre për të mbështetur njohjen e saj nga shtetet e treta. Për diplomatët e huaj të shteteve që e kishin njohur Kosovën, ishte e rëndësishme që ajo të vijonte, pasi ato do t’i duheshin shtetit të ri për të siguruar mbështetje për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare (Konushevci/REL, 8 korrik 2008). Pengimi i njohjeve, kështu shfaqet me dy efekte negative, pamundësim i lidhje diplomatike, si produkt i njohjes dhe i atyre multilaterale, si produkt i anëtarësimit në ON.

- Shtetet e Ballkanit

Kosovës i duhej të fokusohet në sigurimin e njohjeve fillimisht te shtetet e rajonit, të cilat u përmbyllën brenda vitit të parë të shtetësisë (shih, **Figura 10**). Shqipëria e kishte njohur Kosovën që ditën e parë të shtetësisë, me 18.02.2008, ndërsa kishte deklaruar se që ditën e

nesërme nga njohja do të vendoste themelimin e marrëdhënieve diplomatike me shtetin e ri (Reuters, 18.02.2008).

Shteti i parë nga ish-Jugosllavia që e kishte njohur Kosovën, ishte Sllovenia, ajo edhe ashtu ishte shteti i parë i njohur në procesin e shpërbërjes së RSFJ-së, ndërsa njohja që po i bënte Kosovës, ishte me rëndësi të madhe, pasi shteti slloven po kryesonte presidencën e Bashkimit Evropian. Sllovenët, deklarimin e njohjes së Kosovës e lidhin si veprim që është në linjë me qëndrimet e politikës së jashtme evropiane (Reuters, 05.03 2008).

Reagimi ndaj Sllovenisë, nga ana e Serbisë ishte i zakonshëm, si veprimet që ndërmerreshin ndaj shteteve të tjera, ndërsa frika ishte se njohja mund të kishte konsekuenca ekonomike (Reuters, 05.03 2008), për shkak të lidhjeve të vjetra e tradicionale, por kjo nuk ishte pengesë që Sllovenia të mos vijonte me procesin e njohjes, duke iu dhënë edhe shteteve të tjera shembullin se Serbia është e pafuqishme në bllokimin e njohjeve, prandaj si veprim duhej të ndiqej nga shtetet e tjera.

Kroacia, Hungaria e Bullgaria e njohën Kosovën një muaj pasi Kosova e shpalli pavarësinë e saj (Reuters, New Yourk Times, WoA, 19.03.2008). Këto njohje ishin të sinkronizuara, pasi me të tria këto shtete kufizohet Serbia, prandaj për shkak të ndonjë veprimi *“të papritur”* nga kjo e fundit, njohja ishte deklaruar që në ditën e njëjtë. Në deklaratën e përbashkët të këtyre shteteve thuhej:

“Shpallja e pavarësisë së Kosovës erdhi pas dështimit të të gjitha përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për të gjetur një zgjidhje të negociuar mes Beogradit dhe Prishtinës për statusin e Kosovës. Në këto rrethana ndryshimi i status quo-s së paqëndrueshme ishte i pashmangshëm. Kosova është një rast sui generis që lind nga rrethanat unike të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë si dhe nga periudha e vazhdueshme e administrimit ndërkombëtar” (Governments of Republic of Croatia, 19.03.2008).

Njohja nga vendet e dala nga Jugosllavia ishte me shumë rëndësi për Kosovën, për shkak të pranimit të epilogut të njëjtë me to, si pjesë e shpërbërjes së ish-shtetit jugosllav. Pas njohjes së Kosovës nga Sllovenia dhe Kroacia, shtetet që pritej të njihnin Kosovën ishin Mali i Zi dhe Maqedonia, ndërsa pos Serbisë, Kosovën nuk pritej ta njohte Bosnja e

Hercegovina, sigurisht për shkak të natyrës së saj të vendimmarrjes dhe ndikimit të serbëve atje.

Maqedonia dhe Mali i Zi e njohën Kosovën për një ditë më 9 tetor 2008, madje njohjet e tyre konsiderohet me rëndësi të jashtëzakonshme, pasi ato erdhën vetëm një ditë pasi Serbisë iu pranua kërkesa në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, që rasti i shpalljes së pavarësisë të trajtohet nga Gjykata Ndërkombëtare, e cila natyrshëm do të kishte efekt në pengimin e njohjeve, ndërsa njohja nga to përmbysi pikërisht këto pretendime (Kole Casule/REL, 09.10.2008).

Njohja e tyre u komentua shumë, pasi dukeshin si produkt i një shtytje të madhe që vinte nga faktorët e jashtëm, i fuqive të mëdha, të cilat varësisht nga qëndrimi që do të mbanin vendet ballkanike ndaj Kosovës, do të kenë të hapur ose jo procesin integruar, njohja u “përsëritet” nga SHBA-ja e cila po ashtu paralajmëroi se do të ketë njohje të reja muajt e ardhshëm, duke treguar se procesi i njohjeve nuk do të ndalej, pavarësisht obstrukcioneve politike e pengesave strukturore që do përdorte Serbia, ndërsa rusët (përmes Aleksandër Konuzin, ambasador rus në Serbi) i denoncuan këto njohje si veprim nën tension, duke shtuar:

"Ato shtete (Mali i Zi dhe Maqedonia) po shantazhohen nga disa shtete të cilat kërcënojnë të krijojnë probleme për integrimin e tyre evropian" (Kole Casule/REL, 09.10.2008).



Figura 10. Shtetet e Ballkanit dhe Hungaria³³

Burimi: Bazuar në hartën e World Atlas

Njohjet që kishte ardhur nga Maqedonia dhe Mali i Zi, u cilësuan po ashtu shumë lart edhe nga vrojtuesit e tjerë të marrëdhënieve ndërkombëtare, si Ivo Banac, nga Universiteti Yale, i cili në lidhje me këto dy njohje tregonte se rasti i Kosovës nuk ka më kthim mbrapa,

³³ Harta është e përpunuar


dhe se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka një rol vetëm të karakterit akademik (Vidishiçi/REL, 14.10.2008).

Çështja e njohjeve është trajtuar me kujdes të shtuar sidomos për shkakun se ajo u pa e lidhur me faktin se Kosova do të vihej para një sfide të re, GJND-së, që u pa si e kapërcyeshme nga studiuesit dhe aktorët politikë, të cilët konsideruan se nuk ka asnjë dyshim se do të mbyllej në favor të Kosovës, për shkak të argumenteve historike (Konushevci/REL, 17 dhe 18.10.2008), ndërsa rasti ishte marrë me shumë seriozitet, pasi u angazhuan ekspertët më të mirë ndërkombëtarë (Konushevci/REL, 15.10.2008).

Procesi i njohjeve zhvillohej sipas një dinamike të shthurur, të varur nga arritjet e caktuara në raportet mes palëve, të cilat nuk kanë ngurruar të zhvillojnë një betejë edhe për “karakteristikat” e shteteve të cilat e kanë njohur shtetin e ri ballkanik. Kosova konsideron se njihet nga shumica e shteteve të botës, ndërsa Serbia, ka matje tjetër të shteteve që nuk e njohin Kosovën, për të pjesa me e madhe e botës nuk e njeh Kosovën, duke llogaritur në gjeografi e demografi, me ç’rast aludon në Rusinë si shtetin më të madh me territor, po ashtu edhe Kinën, Indinë e Brazilin, ndër shtetet me numrin më të madh të banorëve në botë, nuk e njohin Kosovën (Palokaj/Koha, 15.02.2017) (Shih, *Diagrami 5*).

Është interesant të thuhet se Kosova ka fituar njohjen nga SHBA-ja, partnerët e saj dhe shtetet që kanë ndikim në to, por nuk njihet nga asnjë nga shtetet e grupit BRIC dhe Afrika e Jugut, që përfaqësojnë disa shtete prapa të cilave janë shumë vende të cilat nuk e njohin po ashtu Kosovën, dhe secila prej tyre është dashur të jetë adresa reale e lobimit për njohje (Gashi, 2022).

Kosova që në fillim kishte identifikuar grupe të mëdha shtetesh me të cilat duhej të punohej për të siguruar njohjen, si vendet islamike, vendet arabe (Konushevci/REL, 18.10.2008), shtetet e painkuadruara, por edhe vendet e Amerikës Jugore, vendet frankofone, ose vendet ku ndikimi i vendeve ish-kolonialiste vazhdon akoma të jetë i madh, si rasti i ndikimit portugez (Gashi, 2022), ndërsa ka bashkëpunuar me vendet si Turqia, Franca e Mbretëria e Bashkuar për të siguruar njohje (Gashi, 2022; Hoxha, 2021; Kullashi, 2022).



Diagrami 5. Numri i shteteve që e njohin shtetin e Kosovës në vitin 2008 dhe 2009-2021

Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës

Edhe qeveria “e pavarësisë” i kishte parë vendet e Afrikës si potencialin më të madh të njohjeve (Zymberaj, 2022), pas tyre edhe vendet islame ose arabe (Hoxhaj, 2021: Gashi, 2021), por edhe vendet ameriko-latine (Gashi, 2022), por pavarësisht piketimit të shteteve që do të mund të njihnin Kosovën, që në muajin e parë pas shpalljes së pavarësisë, u shfaq skepticizmi ndaj punës së institucioneve të Kosovës sa i takon platformave lobuese, duke konsideruar se njohjet ishin më shumë kontribut i SHBA-ve, sesa i institucioneve të Kosovës, që nuk po identifikojnë platformat, strukturat dhe individët e duhur për lobim (Lutolli, 13.06.2008).

Kosova, si një vend me diplomaci “foshnjore”, nuk kishte kapacitetet e duhura, përvojat dhe lidhjet e mjaftueshme për të lobuar për njohje, prandaj në atë kohë ishte ideuar që të kontraktuhej një kompani e cila do t’i kryente këto punë, ndërsa si shembull ishte ndjekur edhe më pas, kur ishte kontraktuar një kompani e huaj për të punuar në përmirësimin e imazhit të Kosovës (BIRN, 25.09.2008).

Kosova, sido që të jetë kishte bërë dy veprime domethënëse, kishte themeluar Ministrinë e Punëve të Jashtme, si mekanizmin kryesor të politikës së jashtme, siç thuhet *me qëllim të rregullimit, thellimit dhe ushtrimit të marrëdhënieve me shtetet dhe organizatat e tjera, subjekt i së drejtës ndërkombëtare* (Democracy Plus, 2020: 6), por edhe gradualisht, pas shumë debatesh e polemikash, kishte nisur krijimin e misionëve të para diplomatike, ndërsa

vlen të përmendet fakti se opozita e kohës kërkonte të përfshihej në procesin lobus (Gashi/REL, 18.06.2008),

Punimi vëren se procesi i njohjeve ka qenë tërësisht politik, prandaj ndikimi i faktorëve politikë ka qenë evident gjatë rrjedhës dhe dinamikave të njohjes, duke nisur nga rajonizimi, ndikimi mbështetës dhe frenues i fuqive dhe shteteve me ndikim në zona, ngjarjet politike globale, e më pak angazhimi politik vendor, i cili gjendet ndërkohë në paqëndrueshmëri politike, efektet e të cilit vërehen edhe në proces.

“Lobimi i institucioneve tona ka qenë i një niveli shumë të ulët, edhe pse kjo ka qenë si prioritet për ambasadat tona ose për përfaqësuesit tanë jashtë vendit, të cilët, përkundër vullnetit të mirë, asnjëherë nuk arritën të konsolidohen dhe asnjëherë nuk arritën të përçojnë zërin e tyre fuqishëm” (Hoti/REL 25 dhjetor, 2009).

IV.3. Pengesat strukturore dhe jostrukturore në procesin e njohjeve

Vendimi për të trajtuar rastin e Kosovës në “gjykatë” natyrisht se kishte efekte negative në njohje, edhe pse Kosova deklaronte se kjo ishte vetëm një përpjekje e kotë dhe e radhës nga Serbia e cila synonte ta përdorte në ngadalësim të njohjeve, ose edhe të bllokimit të Kosovës në procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare (Sejdiu/REL, 08.10.2008).

Vlen të përmendet se edhe te trajtimi i kërkesës së Serbisë në Asamblenë e OKB-së, kishte një ndarje të thellë mes shteteve që kundërshtuan nismën, atyre që abstenuan dhe atyre që e përkrahën. Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe e Shqipëria, e kundërshtuan ashpër këtë nismë, që sipas tyre kjo nismë ishte më shumë veprim politik sesa juridik (REL, 08.10.2008).

"Arsyeja është se kërkesa e Serbisë është bërë më shumë për arsye politike, sesa juridike ... rezoluta është disenjuar që të ngadalësojë shfaqjen e Kosovës si një komb i pavarur, i njohur në masë të madhe ndërkombëtarisht, në institucionet ndërkombëtare të botës, ku edhe ajo do të luante rolin e vet" (Ker-Lindsay, 2015).




Figura 11. Vizualizimi i procesit dhe i dinamikës së njohjeve të shtetit të Kosovës në raport me vendimin e GJND-së


Burimi: Dorajet Imeri

Ishte e kuptueshme se Serbia donte të rivendoste në diskutim rastin e Kosovës duke e cilësuar atë si të papërfunduar dhe duke i shtyrë shtetet skeptike të vonojnë njohjen, pavarësisht se vendimi i GJND-së ishte vetëm këshillëdhënës. Studiuesit e politikës dhe analistët në Kosovë e kishin parë me shqetësim vendimin e OKB-së për të përkrahur kërkesën e Serbisë, që rasti të dërgohet në GJND, pasi efekti do të ishte prolongimi i njohjeve, pengimi i tyre dhe dobësimi i pozicionit të Kosovës për anëtarësim në mekanizma ndërkombëtarë (Beqaj, Gashi/ REL, 23.10.2008).

Në vlerësimin që i bëhet procesit të njohjeve të Kosovës del se gjatë votimit në OKB, ishin krijuar katër grupe shtetesh të cilat votuan kundër, për, abstenuan, ose nuk morën fare pjesë në votim për t'u deklaruar se janë apo jo që rasti i Kosovës të trajtohet në GJND.

Shtetet që votuan kundër ishin Shqipëria, SHBA-ja dhe katër shtete të tjera, të gjitha e kishin njohur Kosovën paraprakisht, por kishte edhe shumë shtete të cilat e kishin njohur Kosovën, por kishin votuar "për" që rasti të trajtohet në gjykatë, shumë të tjera që kishin abstenuar ishin shtetet njohëse të Kosovës, kryesisht nga Evropa, por kishte edhe shtete të tjera që nuk kishin marrë pjesë fare në votim. Tabela e mëposhtme është derivat i votimit të

shteteve lidhur me rastin e qëndrimin se si të trajtohet rasti i Kosovës (GA/10764, 08.10.2008).



Diagrami 6. Pozicionimi i shteteve lidhur me vendimin e OKB-së për dërgimin e rastit të Kosovës në GjND


Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës

Trajtimi i Kosovës në GjND, ishte lexuar qartë si një fitore diplomatike e Serbisë ndaj procesit politik të njohjeve të shtetit të ri. Këtë vlerësim e kishte Marc Weller, një studiues i njohur i çështjes së Kosovës, i cili argumentonte faktin se Serbia nuk është e interesuar për të parë *a priori* ligjshmërinë e shpalljes së shtetit, por krijimin e dyshimeve në aktin e njohjes dhe vonimin e saj (Peci, REL, 08.04.2009), duke vijuar:

"Ky edhe ka qenë qëllimi pse gjykatës i është kërkuar një mendim këshillëdhënës, pasi një numër i konsiderueshëm i shteteve kanë thënë se ne nuk mund të përcaktohem i do ta njohim Kosovën si shtet, derisa të dëgjojmë mendimin e gjykatës. Kështu që fushata për njohjen e Kosovës nga një numër i konsiderueshëm është vonuar për gati një vit e gjysmë si pasojë e kësaj dhe kjo në një mënyrë ka qenë një hap i suksesshëm i Qeverisë në Beograd" (Weller/Peci, REL, 08.04.2009).

Efekti i trajtimit të rastit të Kosovës në GjND, është i dukshëm, pasi nga 117 shtet që e njohin sot (nëntor 2022) Kosovën si shtet, 48 e kishin njohur para vendimit të OKB-së që rasti të trajtohet në GjND, shih diagramin e poshtëshënuar (**Diagrami 7**) (MJPD, 2022), ndërsa

edhe skena politike e Kosovës, ishte e ndarë sa i takon sfidimit të njohjeve nga vonimi dhe trajtimi që po bënte gjykata ndaj rastit të Kosovës (Konushevci/REL, 14.08.2009).



Diagrami 7. Njohjet e para dhe njohjet në 13 vitet vijuese

Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës

Gjatë kësaj kohe, si Kosova, ashtu edhe Serbia kanë mbajtur një dozë të theksuar të optimizmit, i cili në rastin më të mirë duket si një pozicionim taktik, sesa një pikëpamje e matshme, ndërsa shqetësimi kryesor të Kosova ishte se çka do të rrjedhë pas vendimit, duke e ditur se qëndrimi serb me gjasë nuk do të ndryshonte. Sigurisht, vërehet se Kosova ishte orientuar shumë të vendimi i gjykatës, ndërsa i kishte kushtuar sidomos në procesin lobues, që dukej si jofunksional, ose i mirëmbajtur nga SHBA-ja, si aleate e Kosovës (Matoshi për REL/Konushevci, 18.09.2009).

“Strategjia e Jeremiqit përfshinte diplomaci të gjerë dypalëshe me qëllim që të pengonte njohjen e Kosovës. Përderisa shumë vende nuk e njohën Kosovën në fillim, kjo më së shumti ishte pasojë e skepticizmit për ligjshmërinë e saj ose për arsye të brendshme, sesa për shkak të diplomacisë serbe. Në fakt, disa shtete që u ballafaquan si nga Serbia ashtu edhe nga Kosova pas vitit 2008, me siguri nuk e njohën Kosovën nga inercia” (Bieber, 2015: 295).

Institucionet e Kosovës, linin dykuptimësi sa i takon ndikimit të GJND-së në procesin e njohjeve, fillimisht pohonin se nuk ka ndikim, ndërsa pas përmbylljes së procesit dhe pritjes së vendimit, shpreheshin se do të ketë ndikim në njohje, pasi ka shtete që janë duke e pritur këtë vendim (Gashi/REL, 02.12.2009). Me afrimin e kohës kur gjykata do të vendoste për

rastin e Kosovës, ishin rritur vlerësimet se Serbia pas saj, pavarësisht vendimit të gjykatës, do të fillojë në rikontestim të statusit politik të Kosovës, duke kërkuar, forma ose modalitete të tjera, për negociim, ndërsa Kosova, do të provojë që të përdorë vendimin, për të filluar një fazë të re të njohjes (Bislimi, Konushevc/REL, 02.12.2009).

“Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë do t’i ndihmojë edhe shtetet që hezitojnë tash për tash që ta njohin vullnetin legjitim të qytetarëve të Kosovës, të institucioneve të Kosovës, që të ndodhin njohje edhe më të shpejta, edhe më të shumta” (Thaçi për REL, Gashi, 10.12.2009).

Kosova priste të kishte njohje edhe gjatë procesit të marrjes së vendimit të GJND-së, por evidente ishte fakti i mungesës së strategjive lobuese, krijimit të strukturës diplomatike e deri te mungesa e përvojës, ndërsa zyrtarët e MPJ-së, kishin konstatuar se Kosova nuk mund të ketë strategji uniforme, për shkak të dallueshmërisë së madhe të shteteve, çka kishte hasur në reagime të politikanëve opozitarë, të cilët konsideronin se Kosova duhet të identifikojë personat adekuatë që do të merreshin me lobimin për njohje (Gashi/REL, 18.02.2010).

Vendimi i GJND-së, ndonëse u cilësua kapital për Kosovën, ishte e sigurt se Serbia përsëri nuk do të njihte shtetin e ri, as pas këtij vendimi, ndërsa gradualisht u shtuan zërat se Kosova dhe Serbia, duhet të fillojnë bisedimet si një formë e mirë e përmbylljes së gjërave “të hapura” që kanë mes vete, Serbia i kishte si mundësi bisedimet për përafrim me BE-në, ndërsa Kosova për të shtrirë legjitimitetin e saj në gjithë territorin, sidomos në veriun e vendit (Peci/REL, 04.03.2010), ndërsa vlen të përmendet se edhe zyrtarisht Kosova e kishte pranuar se procesi i GJND-së, e kishte vonuar vijimin e procesit të njohjeve (Konushevc, 13.04.2010).

“Ndërsa opinioni këshillimor i GJND-së ishte më i paqartë nga sa e panë palët, ai i ofroi BE-së një mundësi për t’i bërë presion Serbisë që të angazhohej në dialog nëse donte të vazhdonte me integrimin në BE dhe i linte qeverisë serbe me pak strategji alternative. Mendimi këshillues, pra, pa dashje i hapi rrugën ndërmjetësimi të BE-së ndërmjet Serbisë dhe Kosovës” (Bieber, 2015: 297).


Gjatë kohës sa pritej vendimi, gradualisht doli në skenë politike si diskutim fillimi i negociatave teknike, mes Kosovës dhe Serbisë, të cilën politikë serbët e shihnin si të nevojshme dhe të domosdoshme, por edhe të pavarur nga vendimi i GJND-së. Kjo mund të

shihet edhe si një tregues i qartë i qasjes që Serbia donte të aplikonte ndaj Kosovës dhe në veçanti ndaj njohjes së saj (Bislimi/REL, 17.05.2010).

- Bisedimet politike si pengesë e njohjeve

Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, pavarësisht se u cilësua si kapital, Serbia dëshironte të shmangte efektin që do të kishte pranimi i saj nga OKB-ja, prandaj ishte me rëndësi gjetja e një shmangieje, duke intensifikuar thirrjet për fillimin e negociatave për gjërat që kishin mbetur të hapura mes Kosovës, të cilat sipas pikëpamjes së tyre janë bisedime të cilat kishin mbetur në gjysmë, pas veprimit të njëanshëm të Prishtinës (Goebel, n & Lowen, M./DW, 21/07/2010).

Politika e jashtme e Kosovës pas marrjes së vendimit të GJND-së, provoi të ndërtonte një argument më shumë në procesin lobues, duke intensifikuar lobimet te shtetet që kishin dhënë indikacione se mund të njihnin Kosovën. Duke qenë se vendimi ishte i shkruar qartë dhe nuk lejonte dykuptimësi, Kosova kishte mundësi të siguronte disa njohje, ose të fillonte një valë e re njohjesh (Peci/REL, 20.06.2010), ndërsa procesi i njohjeve kishte marrë gradualisht rënien, për të mos pasur ngritje deri te viti 2011-12, kur brenda dy vitesh sigurohen 24 njohje (shih, **Diagrami 8**).



Diagrami 8. Pasqyra totale e njohjeve të pavarësisë 2008-2021


Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës

Serbia, dëshironte të krijonte një strategji të re penguese për njohjen, ndoshta fillimi i bisedimeve do të ishte ndoshta mënyra për të penguar arritjen e njohjeve të reja, ishte evidente, intensiteti i njohjeve kishte shënuar rënie. Një aspekt i rëndësishëm që shumë pak

vërehet, sidomos në periudhën e fundit (para shpalljes së vendimit të GjND-së) është se vendimi sido që të jetë pati ndikim në krijimin e bindjes se çështja e Kosovës si status politik është i zgjidhur, ndërsa vërehet se tensionet ishin ulur, kurse bisedimet si mundësi e gjetjes së zgjidhjeve politike për çështjet e tjera, u pa si e dobishme (Tatjana, 2015: 240).

“Pas vendimit të vitit Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me aktin e shpalljes së pavarësisë nga ana e Kosovës, në vitin 2010, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën e cila kërkonte fillimin e dialogut Kosovë-Serbi, nën ndërmjetësimin e BE-së” (KDI, 2020: 7).

Procesi i njohjeve kishte shënuar njëfarë këndellje kah viti 2011 dhe viti 2012 (shih diagramin vijues, **Diagrami 9**), kur u arritën disa njohje edhe si rezultat i lobimit të shteteve të fuqishme, nëpër zonat e tyre të ndikimit, por pengu kryesor me të cilat po ballafaqohej Kosova ishte se gradualisht po shfaqej koncepti i normalizimit të raporteve, proces i cili nuk parashihte njohjen, ndërsa ajo do të mund të vinte si pjesë e integritimeve politike në Bashkimin Evropian (Shala/KlanK, 21.12.2020).



Diagrami 9. Njohjet e pavarësisë në pesë vitet e para të shtetësisë

Burimi: Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës

Shtrimi i çështjes lidhur me opinionin këshillëdhënës, ishte cilësuar si i ngushtë në fillim, por Serbia kishte vepruar strategjikisht, sigurisht duke e ditur se si do të ishte fundi i vendimit të gjykatës. Serbia nuk kërkonte të vendoste në diskutim shtetin e Kosovës, por

“kontestimin” e kishte sa për të vonuar procesin e njohjeve, që duket si strategji e mirë arritur, prandaj veprimi politik e kishte shndërruar në shqetësim juridik, ndërsa më vonë pas vendimit kishte vepruar politikisht në atë mënyrë që rrethanat juridike të kthehen në ato politike, pra pakënaqësinë që e pati me vendimin e GjND-së dëshironte ta kthente në një situatë të favorshme, fundi i së cilës nuk do të mund të dihej (Bancroft, 2010: 2-6).

Kosova dhe Serbia, pas një numri të caktuar takimesh, arritën një marrëveshje, e njohur si “Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë”, duke qenë kështu marrëveshja e parë mes dy vendeve, marrëveshje e cila u ratifikua në Kuvendin e Kosovës, por jo edhe në Serbi, pasi për ta, kjo nuk ishte marrëveshje ndërkombëtare, ndërsa BE-ja e pa si arritje historike, por e cila edhe u interpretua sipas pikëvështrimeve të tyre, duke pasur një shkallë të lartë të dykuptimësisë (KDI, 2020: 7-10).

Marrëveshja e viti 2015, e arritur mes Kosovës dhe Serbisë, më vonë u cilësua si jo kushtetuese për Kosovën, duke shënuar pikën më të ulët të raporteve mes dy shteteve, të cilat vazhduan, Serbia e ka parë si dështim të përpjekjeve të saj për dobësimin e pozitës politike të Kosovës.

Qëndrimi serb sa i takon njohjes së Kosovës ka pasur një ndryshim të vazhdueshëm, të varur nga temat që janë ngritur kohë pas kohe, ajo i shihte negociatat për të forcuar pozicionin politik të serbëve të Kosovës në institucione dhe për të krijuar siguri për ta, por pa e njohur Kosovën, madje marrëveshja (2013) është pranuar sepse nuk e parasheh njohjen, ndërsa ka intensifikuar raportet ekonomike e politike, duke krijuar njëfarë ndërvarësie, thotë ish-ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë dhe Malit të Zi, Vuk Drashković, i cili shton se Beogradi është pajtuar dhe e ka pranuar marrëveshjen, vetëm sepse ajo nuk nënkupton njohjen e Kosovës dhe ka dhënë mundësinë për marrëdhënie intensive ekonomike dhe politike me Prishtinën, duke krijuar një ndërvarësi (Siegertszt, 2015: 29).

“Në pamje të parë, ekipi negociator nga Prishtina mund të duket se ka qenë në një pozicion më të përshtatshëm se sa homologët e tyre serbë. Me Shtetet e Bashkuara që mbështesin fuqishëm shtetësinë e Kosovës, dhe një shumicë e madhe e shteteve të BE-së që bëjnë presion për integrim të mëtejshëm, është e lehtë të parashikohet një lëvizje e qëndrueshme dhe e pashmangshme drejt anëtarësimi dhe njohjes. Megjithatë, pasi politikanët në Kosovë u është dashur

të mësojnë rrugën e vështirë, edhe shkëmbimi më i vogël me fqinjin e tyre verior shkakton rrëmuje brenda vendit. Mediat dhe aktorët vendas janë vazhdimisht të vëmendshëm për lëshime ndaj Beogradit që do të rrezikonin shtetësinë dhe funksionalitetin e Kosovës” (Elmehed, 2016: 23).

Serbia ishte e interesuar të përdorte dialogun për të paraqitur si të pa mbyllur rastin e Kosovës, duke filluar një lobim të ri, me argumentet se negociatat po vijnë, duke i ftuar shtetet të mos nguten me vendimin për njohje deri në një epilog të ri, që do të dilte nga dakordimi mes palëve (Gashi, D. 2022).

Serbia po ashtu prej atëherë kishte filluar një fushatë të re lobuese për çnjohje, e cila kryesisht kishte aplikuar edhe forma tepër jokonvencionale, shantazhuese, e korruptuese (Zymberaj, 2022), ndërsa ajo i ka vazhduar këto veprime edhe në vitet vijuese, duke identifikuar së paku 30 shtete të cilave iu është paraqitur kërkesa për çnjohje (Ahmeti, 2022).

Serbia dëshironte që stagnimet eventuale, sidomos pezullimi i miratimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, t'i kthente në një ofensivë diplomatike, me synime të qarta, pengimin e arritjes së njohjeve të tjera dhe në disa raste edhe fushatën për çnjohje (Konushevc/REL, 31.08.2019). Sido që të jetë, nuk mund të thuhet se këto veprime kanë ndodhur vetëm për shkak të fushatës serbe, por edhe për shkak të moskultivimit të marrëdhënieve me shtetet që e kanë njohur Kosovën, thotë studiuesi Gëzim Visoka (Konushevc/REL, 31.08.2019).

Serbia e ka përdoruar sidomos dialogun për të shtyrë shtetet që të çnjohin Kosovën, duke pretenduar se kushtet mbi të cilat ato e kanë njohur shtetin e ri nuk ekzistojnë më (Visoka për REL/Konushevc, 13.11.2019), pos kësaj, në kuadrin e çnjohjeve, si pjesë e aktiviteteve lobuese ishte e përfshirë edhe Rusia, e cila thuhet se ka hequr vizat për shtetet që e çnjohin Kosovën, ose ka lidhur edhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare, të karakterit ushtarak e diplomatik (Gjurgjeviq/REL, 25.07.2019).

“Çnjohjet e Kosovës nga vendet e treta kishin nisur në vitin 2018 si pasojë e fushatës agresive kundërlobuese të Serbisë dhe nga ajo kohë diku rreth 15 shtete kanë marrë pozicion të ri, duke deklaruar se kanë tërhequr njohjen për pavarësinë e Kosovës ose e kanë ngrirë atë” (S'bunker/Berisha, 02.09.2021).

Politika e jashtme e Kosovës u duk si të ishte në pauzë, kohë pas kohe, ndërsa mendimi ishte se ndoshta Kosova duhet gradualisht të shtrijë fokusin e saj kryesor te vendet e BE-së që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, si pjesë e një strategjie e cila do të mund të përmbylej paralelisht me marrëveshjen me Serbinë dhe me pranim në OKB (Hysenaj/REL 13.05.2021).

Në mungesë të strategjive të qarta politike, Kosova gradualisht dhe në mënyrë më intensive, fokusin kryesor të saj në procesin e njohjeve e ktheu te njohja nga pesë vendet kryesore të Bashkimit Evropian, të cilat e kundërshtojnë ashpër, ose nuk e njohin, por komunikojnë.

IV.4. Sfidat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare

Procesi i njohjeve të një shteti, është tepër domethënës për secilin entitet politik që synon njohjen e gjerë, prandaj janë këto institucione që mundësojnë ndërveprimin e shteteve në arritjen e objektivave të tyre (Abbott & Snidal, 1998: 3). Shtetet nëpër forumet shumëpalëshe, synimin kryesor e kanë që të rrisin bashkëpunimin dhe prezencën, duke u përfshirë në iniciativa të tilla, qëllimi i së cilës është sidomos forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar (Emini & Marleku, 2016: 172).

Kosova ka një relacion shumë pozitiv me organizatat, pasi ato kanë qenë të përfshira në mënyrë direkte në gjithë procesin politik, sidomos në rikonsolidimin e shoqërisë, ngritjes së institucioneve dhe kapaciteteve të tjera, por edhe në krijimin e shtetit të Kosovës, por mos anëtarësimi i saj në shumë nga to (Istrefi, 2018: 255), është si pasojë e mosnjohjes nga shtetet, ndërsa statutet e këtyre organizatave mund të kërkojnë shprehimisht që shteti aplikues të jetë pjesë e OKB-së, ose edhe e organizatave të tjera.

“Kosova ka bërë një përparim domethënës në procesin e shtetndërtimit, falë mbështetjes së dhënë nga aktorët ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe shtetet dhe organizatat ndërkombëtare” (Emini & Marleku, 2016: 172).

Sido që të jetë, sfida kryesore që ka Kosova në procesin e saj të konsolidimit të jashtëm, e ka pranimin në organizatat ndërkombëtare, pasi ato, shihen si përligje të shtetësisë, kompletim i saj, pavarësisht nëse shteti i caktuar është apo nuk është i njohur nga të gjithë anëtarët e saj, madje pranimi në OKB, është edhe kusht për pranim në organizata dhe në veçanti rastet e dala nga shprehjet (Ker-Lindsay, 2012: 130).

Tri organizatat kryesore botërore nuk e njohin shtetin e Kosovës, prandaj edhe nuk është pjesë e tyre. Dallimi mes shteteve kryesore që ndikojnë në pranimin e anëtarëve të rinj i kanë kushtuar shumë shtetit të ri, për t'u anëtarësuar në këto organizata, si OBK e OSBE ku ballafaqimi është mes SHBA-së e Rusisë, ashtu edhe në BE, duke bërë që raporti i tyre me Kosovën të jetë “neutral”, ose njëfarë konfirmimi i status quo-s (Eckhard & Dijkstra, 2017: 105).

Shteti, njohja dhe subjektiviteti janë tri elemente me shumë rëndësi, kyçe për analizën politike të rolit që ka njohja në forcimin e subjektivitetit të shtetit dhe rëndësinë që ka pranimi në organizata si mundësi e forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar, si alternativë e njohjes, pavarësisht se pranimi në organizata nuk e zëvendëson njohjen, por e arrin qëllimin e saj (Mehmeti, 2017: 370).

Kosova, kishte pak përvojë në anëtarësim në organizata ndërkombëtare, por kryesisht këto veprime kanë qenë të rezervuara për UNMIK-un, si kompetenca, prandaj bashkëpunimi me vendet fqinje, për siguri e tregti, ishin vetëm disa nga pak angazhime që kishte Kosova në sferën e bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare (Marleku, 2012: 87).

Për Kosovën, ka qenë tepër me rëndësi dhe vazhdon të jetë edhe më tej, pranimi në organizata ndërkombëtare, ky është një konstatim i qëndrueshëm në lidhje me synimet që ka entiteti politik për t'u konsoliduar si shtet, por anëtarësimi është proces tepër kompleks.

“Anëtarësimi në secilën prej tyre e kërkon një mund të madh: përmbushje të kriterëve, fushatë intensive lobimi, koordinim të ngushtë me aleatë dhe në fund, në rastin më të mirë, bëhet anëtarësimi. Deri më tani, Kosova është anëtare e disa organizatave të rëndësishme, si: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata Botërore e Doganave, Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA) etj.” (Abrashi/sbunder, 2022).

Në periudhën e pas shpalljes së pavarësisë, Kosova nuk ka reshtur së përmenduri faktin se integrimi në organizata ndërkombëtare, është me rëndësi për Kosovën, por asnjëherë, nuk u përmend gjerësisht dhe me saktësi se çfarë se si shteti i ri e sheh me prioritet, real apo jo, ndërsa ishte evidente që atëherë e deri më sot, që mosnjohja nga shtetet e caktuara patën ndikim negativ në procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare (Peci/REL, 0403.2009).

Kosova është anëtare në disa organizata të nivelit global, duke filluar nga institucionet financiare si: FMN, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim; organizata sportive si: Federata Botërore e Futbollit, Federata Evropiane e Futbollit, Komiteti Olimpik; organizata të bashkëpunimit tregtar dhe doganor, si: Organizata Botërore e Doganave dhe Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA) (Krasniqi – Veseli/REL, 17.06.2020).

Gjithsesi, fati i pranimet në organizata ndërkombëtare ishte i lidhur nga njohjet dhe nga bisedimet politike me Serbinë, me të cilën pas arritjes së Marrëveshjes së Brukselit, i mundësohej Kosovës që të merrte pjesë në forumet rajonale, por pa simbolet e shtetit dhe me fusnotë.

PËRFUNDIMET

- Rrjedha historike

Krijimi i shtetit është procesi më kompleks në marrëdhëniet ndërkombëtare, ai duke prekur territoret, sovranitetin, rendin dhe të drejtën ndërkombëtare, është kthyer në konceptin dominues në shkenca politike, por edhe aktori/subjekti kryesor i marrëdhënieve e i së drejtës ndërkombëtare.

Krijimi i shtetit, vjen si rrjedhojë e ngjarjeve politike të një kontesti historik të caktuar, i cili vjen si rrjedhojë e një numri faktorësh të jashtëm si rendi dhe drejta ndërkombëtare, por edhe të brendshëm, nga shkalla e decentralizimit, veprimet qendër-periferi, shkallës së legjitimitetit politik të qeverisë, kompaktësisë etnike e shumë faktorë të tjerë, të cilët kthehen në argumente politike pro dhe kundër njohjes së shtetit.

Procesi historik i kërimit të sigurimit të njohjes së pavarësisë së Kosovës, paraqet një proces tepër dinamik me përpjekje të vazhdueshme, por pa ndonjë rezultat konkret, sidomos në nismën e jetësimit të shtetit të Kosovës. Sigurisht se kjo mos arritje, nuk e ka zmbursur kërkesën e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur e të njohur ndërkombëtarisht.

Fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë, krijoi shumë ngjarje ndaj të cilave Kosova provoi të krijonte reagime politike, ndërsa fakti se vetë fillimi i shpërbërjes së ish-federatës pikërisht në Kosovë, tregonte ndër të tjerash për rolin dhe pozitën që ajo ka në planet dinamike të udhëheqjes së re serbe të kohës, e cila shpejt do të merrte nën kontroll gjithë aparaturën shtetërore, sidomos ushtrinë dhe qeverinë.

Krijimi i një shteti (të madh) ku serbët janë të sigurt, ose kthyer në versionin nacionalist, Serbia e Madhe, duhet të niste me suprimimin e autonomisë së Kosovës, liritë politike të së cilës janë vënë në shfrytëzim kundrejt pakicës serbe në Kosovë. Serbia ndërmori shumë masa, të tilla që prekën komplet jetën politike, sociale, ekonomike, arsimore e shëndetësore në vend. Masat u vijuan me largimin nga puna e mijëra punëtorëve të cilët në këto kushte detyroheshin të largoheshin nga Kosova.

Kjo prodhoi reagim te elita intelektuale e Kosovës, të cilët ndryshimet politike në Jugosllavi, provuan t'i përcillnin edhe me ndryshime politike në Kosovë, shpallja e Republikës së Kosovës, e më vonë mbajtja e referendumit për shtetin e pavarur të Kosovës, të përcjellja

me ndryshime kushtetuese respektive, bëri që Kosova të krijonte një reagim të natyrshëm, edhe pse jo efektiv.

Kosova, në mungesë të një alternative tjetër më të efektshme, ndoqi një qasje të rezistencës civile jo të dhunshme që kulmoi me krijimin e një sistemi paralel të funksionimit të shtetit të Kosovës, të shpallur por jo të njohur. Kjo bëri që konflikti të shmangej së paku për momentin, ndërsa gjatë kësaj kohe, Kosova kishte nisur një fushatë lobimi për sigurimin e njohjes. Komisioni i Arbitrazhit të Badinterit, ishte mundësia e parë, por kriteret që kishte përcaktuar ajo, nuk e lejuan Kosovën, të siguronte njohje. Pavarësisht kësaj Kosova ndoqi rrugëtimin drejt njohjes, duke pritur që të krijohet një moment i përshtatshëm, edhe pse pritshmëritë dalin të jenë shumë ambicioze.

Intensifikimi i luftës në Bosnje e Hercegovinë bëri që fokusi ndërkombëtar të mos ishte te Kosova, e cila priste rastin tjetër, tash në Konferencën e Dejtonit, e cila i dha fund luftës në Jugosllavi, ndërsa ky përjashtim i Kosovës me gjithë përpjekjet që të sigurohet pjesëmarrja që do të rezultonte me njohje, doli e pasaktë.

Deri tash, Kosova humbi disa raste për t'u njohur si shtet, pra ajo nuk u njoh si shtet, si rezultat i parimit të vetëvendosjes, as si produkt i konferencave ndërkombëtare, as i ligjit të brendshëm. Kjo i dha shumë favore Serbisë e cila pas zgjidhjes së problemit me Bosnje e Hercegovinën, ku me marrëveshjen e Dejtonit krijohet Republika Srbska, synonte që idenë e krijimit të një shteti ku jetojnë serbët, ta arrinte duke aplikuar masa represive kundër një grupi të caktuar etnik, si shqiptarët në Kosovë, dhunimi masiv i të drejtave të tyre, do të ngrinin vëmendjen ndërkombëtare për Kosovën, duke filluar të jepte sinjalet e para të mundësisë për krijimin e shtetit të Kosovës, njohja e së cilës do të vinte bazuar në parimin e shkëputjes së suksesshme përmirësuese, për të cilat do të flitet në vijim.

Intensifikimi i krimeve dhe fillimi i luftës, natyrisht se do të kishte edhe reagime ndërkombëtare, të cilat shihen edhe si të vonuara dhe se si të tilla kanë mundur të ndodhnin më herët. Pamundësia për të prodhuar një marrëveshje shtyri bashkësinë ndërkombëtare, në veçanti SHBA-të dhe partnerët e NATO-s, të fillojnë një fushatë bombardimi, si një veprim përmes së cilit kërkohet që Serbia t'i ndalonte veprimet kriminale në Kosovë, për të vendosur më pas Kosovën nën administrimin ndërkombëtar.

Kjo situatë e re e krijuar në Kosovë, u përcoll me paparashikueshmëri se si do të rridhte procesi, cili do të ishte statusi i ardhshëm politik dhe cilët do të ishin hapat që duhet të

ndërmerren për të gjetur zgjidhjen politike, që për Kosovën nuk mund të ishte asgjë më pak se sa pavarësia.

Qëndrimi serb ishte i qartë, ata nuk do të pranonin asnjë zgjidhje politike e cila do të nënkuptonte njohjen e Kosovës si shtet, ndërsa në anën tjetër, as misioni i UNMIK-ut, nuk kishte një strategji dalëse, ngaqë as Rezoluta 1244 nuk parashihte diçka të tillë. Kjo krijoi tensione të larta politike e cila u reflektua edhe te një trazirë e madhe ndëretnike në marsin e vitit 2004, e cila rishfaqti papajtueshmërinë e madhe mes qytetarëve dhe dallimin e madh ndëretnik.

Sido që të jetë, kjo trazirë kishte krijuar mundësinë dhe nevojën për reagim, ngase situata mund të dilte jashtë kontrollit, prandaj gjetja e zgjidhjes politike të statusit, do të duhej të ishte si plan i parë me të cilin bashkësia ndërkombëtare dhe në veçanti Grupi i Kontaktit, duhej të merrej. Ky grup përcaktoi kornizat e statusit, të cilat duhej të ndiqeshin gjatë negociatave, pasi ato të ishin filluar, e të cilat u varën nga standardet paraprake të përcaktuara.

Negociatat mes Kosovës dhe Serbisë, parimisht dhe paraprakisht ishte e ditur se do të dështojnë, sepse palët mbanin qëndrime tërësisht të ndryshme, si pozicione strategjike, natyra e të cilave u reflektua edhe në proceset e pas statusit. Këto qëndrime kaq të ndryshme ndikuan edhe në polarizimin e faktorëve të jashtëm të cilët, u rreshtuan krah palëve duke e thelluar edhe më shumë mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje politike që do të prodhonte njohje.

- Baza teorike

E Drejta Ndërkombëtare është e ndarë sa i takon njohjes, shkollat e saj kryesore të njohura si teoria konstitutive dhe teoria deklarative, kanë krijuar një hendek të madh mes tyre, rrjedhimisht, edhe pamundësi për të dhënë shpjegimin e duhur për rastet. Njohja ka karakter konstitutiv, pra themelon shtetin, ose njohja është konstatim i një fakti, pasi kriteret janë përmbushur, janë dilemat themelore. Duke qenë se as njëra e as tjetra, nuk janë komplementare në trajtimin e tyre, njohja është kthyer në një veprim të qartë politik. Kjo vërehet edhe te rasti i Kosovës, ku shtetet e caktuara e njohin dhe më pak se gjysma tjetër jo, duke reflektuar ndarjen mes teorive, gjeopolitikave dhe rendit ndërkombëtar.

Punimi konstaton se te rasti i Kosovës, shteti i deklaruar në vitin 2008, pretendon se është çështje fakti, ka përmbushur kriteret themelore të shtetësisë, por ka vijuar edhe me

adaptimin e vlerave të tjera, politike, si demokracinë, lirinë, garantimin e pjesëmarrjes së minoriteteve në jetën politike e institucionale, ka shprehur gjithë gatishmërinë për të marrë obligimet ndërkombëtare.

E veçanta e punimit është se ndikimi që ka rendi ndërkombëtar është shumë i madh, pasi vetë ngjarja është produkt i shpërbërjes së Jugosllavisë, e cila po ashtu ishte reflektim i një procesi edhe më të madh global. Pozicioni i ndikimit politik i shteteve të fuqishme atëkohë, u përdor si një revanshizëm në procesin e njohjeve.

- Njohja dhe anëtarësimi në organizata

E gjetur para dilemave themelore, se si të prodhonte zgjidhje, Kosova nuk ka pasur mundësi tjetër, pos të shpallte pavarësinë e saj si shprehje e vullnetit politik të qytetarëve të saj. Punimi konstaton se Serbia ka dashur që përmes faktorit rus të pengojë çdo mundësi të njohjes së shtetit të Kosovës, përmes instancave ndërkombëtare, aq më pak OKB-së. Kjo do t'i kishte disa efekte negative, e zhvlerësonte tejte shumë procesin paraprak dhe investimet në të, e pengonte Kosovën që në fillimin e saj, ndikonte në dinamikën e njohjes dhe në proceset pasuese që rridhnin nga ajo.

Kosova, u kthye në një përplasje të re me Serbinë, tash për sigurimin e njohjeve, ndërsa SHBA-ja dhe Rusia, po sfidonin njëra-tjetrën për zonat e ndikimit, rendin ndërkombëtar dhe revanshizmin për të kaluarën jo të largët, konstaton ky punim. Rusia kishte identifikuar Serbinë si faktorin lokal që do të sabotonte projektet perëndimore, duke i garantuar asaj përkrahje sa i takon mosnjohjes së Kosovës.

Rusia e kishte përdoruar rastin e Kosovës për të ndërtuar strategjitë e reja për t'u rikthyer në zonat që dikur i zotëronte Bashkimi Sovjetik, ku Oseta Jugore dhe Abkasia, ishin të parat që do të njiheshin si shtete, ndërsa u vijua me aneksimin e Krimesë, si kundërbalancë e njohjes së Kosovës, duke dëshmuar për efektet gjeostrukture që krijoi njohja e shtetit të Kosovës.

Shtetet mbetën të ndara, në lidhje me njohjen e Kosovës, u krijuan tri grupe, ato që e njihnin rastin e Kosovës dhe e njohën shtetin e saj, shtetet që hezituan të bënin njohjen së paku jo në fillimin e procesit dhe shtetet që e kundërshtuan atë, si: Rusia, Spanja, Rumania, Kina e Brazili. Kjo ndasi krijoi efekte edhe te dinamika e njohjeve, e cila sipas këtij punimi del të jetë një proces me rënie konstante, e cila pikën më të lartë e ka pasur fillimin e saj, ndërsa rënia ka arritur pikën më të ulët kur brenda vitit (2018-2019), nuk ka asnjë njohje.

Punimi konstaton se deri te kjo gjendje ka ardhur si rrjedhojë e disa arsyeve, si:

- Konsumimit të procesit;
- Fushatave agresive serbe e ruse;
- Pengesave strukturore, si GJND-ja, Bisedimet Teknike e Politike;
- Mungesa e strategjive lobuese;
- Ndërrimi i qeverive dhe mungesa e kohezionit politik nacional.

Si rrjedhojë e këtyre sfidimeve, Kosova e pa pranimin në organizata ndërkombëtare si alternativën e njohjes, por fushatat lobuese të Serbisë, nuk ishin vetëm për pengimin e njohjeve, por edhe për pranimin në mekanizmat ndërkombëtarë, si: NATO, BE, OKB, KiE etj. Edhe në këto situata Serbia përmes lobimit dhe sidomos për shkak të dallimeve që kishin anëtarët brenda tyre, bëri që Kosova të mos anëtarësohet në këto organizata.

E ardhmja e njohjeve dhe e anëtarësimit të Kosovës në organizata, u var nga procesi i dialogut, i cili shihet edhe si njëfarë procesi prolongues përmes së cilit Serbia e ka dobësuar pozitën politike të Kosovës, e ka ngushtuar ndikimin e saj të jashtëm dhe e ka minuar të ardhmen e saj. Dinamikat e fundit janë shpresëdhënëse se një dobësim i pozicionit rus mund të ndikojë sidomos në avancimin e Kosovës në organizata, si ajo e Këshillit të Evropës, ndërsa pranimi nga Serbia, duket si i paarritur as pas 14 vitesh nga shpallja e shtetit, ose 11 nga fillimi i procesit negociues.

Bazuar në të, punimi konstaton se hipotezat janë shumë të qëndrueshme, duke u testuar si të bazueshme.

Hipoteza I

- I. Njohjet e pavarësisë së Kosovës në fazën e saj fillestare janë produkt i ndikimit të diplomacisë perëndimore, më saktë shteteve të Kuintit.*

Punimi konstaton se njohja e shtetit të Kosovës u var direkt nga ndikimi i shteteve kryesore, si pro njohjes, ashtu edhe kundër saj. Angazhimi i tyre ishte direkt, si pjesë e agjendës së politikës së jashtme.

- II. Procesi i njohjeve të pavarësisë së Kosovës është penguar strategjikisht dhe sistematikisht nga Serbia, përmes Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Bisedimeve*

të Brukselit dhe Gjykatës Speciale, me synim ndalimin e rrjedhës së njohjeve dhe dobësimin e pozitës politike ndërkombëtare deri në delegjtimim të tërësishëm.

Punimi vjen në përfundim se Serbia nuk ka pasur asnjëherë synime të njohë pavarësinë e Kosovës, madje sipas sjelljeve të tanishme është vështirë e arritshme edhe në fazat vijuese. Kjo ka krijuar ato që ne i kemi quajtur pengesat strukturore në njohje, duke prodhuar një veprim të karakterit spiral, akt juridik – veprim politik – akt juridik.

III. Kosova nuk pati një strategji lobuese të qartë dhe të efektshme për t'i kompletuar njohjet.

Duke qenë e varur nga ndikimi i madh perëndimor dhe në mungesë të strukturës shtetërore e trupave institucionale, Kosova nuk ka pasur strategji të qartë lobuese, ajo ka vepruar sipas të njëjtit standard, ndaj secilit rast, duke prodhuar shpesh edhe kundërefekt.

IV. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare ka ndikim më të madh në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës se sa njohjet individuale nga shtetet.

Kjo hipotezë nuk është vërtetuar, sepse njohjet nuk mund të zëvendësohen nga pranimi në mekanizma ndërkombëtarë, aq më tepër kur vetë ky pranim varet nga vullneti politik i atyre shteteve.

V. Anëtarësimi i Kosovës në OKB, në NATO dhe BE është parë si procesi më i rëndësishëm përmes së cilës synohet të përmbillet subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës, procesi i cili varet nga Bisedimet e Brukselit, në mes Kosovës dhe Serbisë.

Pranimi në OKB, në kushtet e tanishme është vështirë e arritshme, hulumtimi vë në pah se Kosova mund të anëtarësohet në NATO e KiE, por mosnjohja nga pesë vendet e BE-së, katër nga të cilat janë në NATO, e pengojnë gjithë procesin. Prandaj, njohja prej tyre është gjëja më e rëndësishme me të cilën duhet të merret Kosova në procesin e saj të kompletimit të njohjeve dhe anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

BURIMET DHE LITERATURA

Dokumentet arkivore

Arkivi elektronik i OKB-së

Arkivi Elektronik i Kongresit Amerikan

Arkivi Elektronik i Departamentit Amerikan të Shtetit

Arkivi Elektronik i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Librat

Abushov, K. et al (ed). (2014). Self-Determination and Secession in International Law. United Kingdom: OUP Oxford.

Anderson, D., & Australia. (1995). The collapse of Yugoslavia: Background and summary. Canberra: Dept. of the Parliamentary Library.

Bajrami, A. (2011). Sistemi Politik i Kosovës. Prishtinë.

Bassiouni, M. C. (2017). Background on the Conflict in the Former Yugoslavia. In Investigating War Crimes in the Former Yugoslavia War 1992–1994: The United Nations Commission of Experts Established Pursuant to Security Council Resolution 780 (1992).

Berridge, V. (2018). Why policy needs history (and historians), Health Economics, Policy and Law, Cambridge University Press.

Brownlie, I. (2012). Principles of Public International Law. Oxford, OUP. 8th ed.

Buja, R. (2016). Kosovo – from Dayton to Rambouillet. ILIRIA International Review.

Calic, M.J. (2019). A history of Yugoslavia. West Lafayette, Indiana Purdue University Press.

Carley, P. (1996). Self-determination: Sovereignty, Territorial Integrity, and the Right to Secession. United States, U.S. Institute of Peace.

Clark, H. (2000). Civil Resistance in Kosovo. London: Pluto Press.

Crawford, J. (2007). The creation of States in International Law. Oxford: Clarendon Press, 2007.

Crawford, J. (2010). The Creation of States in International Law. The Creation of States in International Law.

- Flint, C. (2021). *Introduction to Geopolitics* (4th ed.). Routledge.
- Garton, T. (1993). In Europe's Name. Germany and the Divided Continent, New York: Random House.
- Goldstein, J. (2013). Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Tiranë. Ditura
- Grant, T. D. (1999). The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution. United Kingdom: Praeger.
- Grant, T. D. (2014). Doctrines (Monroe, Hallstein, Brezhnev, Stimson), Max Planck Encyclopedia of Public International Law.
- Grbin, C. A. (2004) The role of Britain in Yugoslavia and its successor states: 1991-1995. PhD thesis.
- Gruda, Z. (2013). *E Drejta Ndërkombëtare Publike*. Prishtinë. Dukagjini.
- Hill, Ch., Smith, K. E. (2002). European Foreign Policy: Key Documents, UK, London: Routledge.
- Holbrooke, R. (2011). To End a War: The Conflict in Yugoslavia--America's Inside Story--Negotiating with Milosevic. United Kingdom: Random House Publishing Group.
- Isakovic, I. (1999). Diplomacy and the Conflict in Kosovo — Notes on Threats and Fears, International Studies Association, Washington.
- Jones, C. (2015). France and the Dissolution of Yugoslavia (Doctoral dissertation, University of East Anglia).
- Judah, T. (2008), Kosovo: What Everyone Needs to Know, Oxford: Oxford University Press.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovë – Kuvendi i Kosovës, 2008.
- Kocs, S. A. (2016). International Order: A Political History. Lynne Rienner Publishers
- Lawson, George (2016). The rise of modern international order. In: Baylis, John, Smith, Steve and Owens, Patricia, (eds.) The Globalization of World Politics: An Introduction to International Relations. Oxford University Press, Oxford, UK
- Malcolm, N. (1998). Kosovo: a short history. New York: New York University Press
- Morgenthau, H. J. (2006). *Politics Among Nations*. 7th. Edited by Kenneth W. Thompson, & W. David Clinton. New York. McGraw-Hill.
- Nicholson, R. (2019). Statehood and the State-like in International Law. Oxford University Press, USA.
- Panayi, P. (2018). 'The state of a State - The ineffective application of the Montevideo criteria.
- Perritt, H. H. (2010). The Road to Independence for Kosovo: A Chronicle of the Ahtisaari Plan. United Kingdom: Cambridge University Press.

- Pesic, V. (1996). *Serbian Nationalism and the Origins of the Yugoslav Crisis*. United States: U.S. Institute of Peace.
- Petric, E. (2003). *Politika e jashtme – Bazat e teorisë dhe praktikës*. Prishtinë: Kolegji Universitar “Victory”,
- Portmann, R. (2010). *Legal Personality in International Law*. (n.p.): Cambridge University Press.
- Radin, A., Astrid Stuth, C., Priebe, M., Mazarr, M. J. (2016). *Understanding the Current International Order: [Building a Sustainable International Order Series]*. United States: RAND Corporation.
- Reka, B. (2003). *UNMIK as an International Governance in Post-war Kosova: NATO's Intervention, UN Administration and Kosovar Aspirations*. North Macedonia: Logos-A.
- Reka, B. et al., (2016). *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*”. Shkup; Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare.
- Rennack, D./ CPC (1996). *Economic Sanctions and the Former Yugoslavia: Current Status and Policy Considerations Through*.
- Vickers, M. (1998) *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo*. Columbia University Press.
- Visoka, G., et al. (2020). *Routledge handbook of State Recognition*.
- Waltz, K. N. (1979). *Theory of International Politics*. Addison-Wesley Pub. Co.
- Weisbrode, K. (2016). “Diplomacy in Foreign Policy”, Oxford Research Encyclopedia of Politics. Routledge,
- Weller, M. (2008). *Negotiating the Final Status of Kosovo*, Paris, Institute for Security Studies.
- Wheatley, S. (2014). *Modelling Democratic Secession in International Law*. Steven Wheatley, ‘Modelling Democratic Secession in International Law’ in Stephen Tierney (ed.), *Nationalism and Globalisation: New Settings, New Challenges* (Oxford: Hart, Forthcoming).
- Williams, P., et al. (2003). *Achieving a Final Status Settlement for Kosovo*. Center for strategic & international studies.
- Sloan, G. (2017). *Geopolitics, Geography and Strategic History* (1st ed.). Routledge.
<https://doi.org/10.4324/9780203489482>

Burimet e tjera – revistat

- Abazi, E. (2008). A New Power Play in the Balkans: Kosovo's Independence. *Insight Turkey*, 10(2), 67–79. <http://www.jstor.org/stable/26328675>.
- Abazi, E. (2012). Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm. *Studime Historike*, Institute of History, Tirana, 66 (3-4), pp.187-216.
- Abbott, K. W., & Snidal, D. (1998). Why States Act through Formal International Organizations. *The Journal of Conflict Resolution*, 42(1), 3–32. <http://www.jstor.org/stable/174551>.
- Abushov, K. (2021). Explaining Foreign Policy Deviations: The Strategic Rationale of Russia's Recognition of Abkhazia's and South Ossetia's Independence. *Formerly Global Review of Ethnopolitics*. Volume 21(4). 401-422. <https://doi.org/10.1080/17449057.2021.1882117>.
- Ahmed, (2020). "The theoretical significance of foreign policy in international relations- an analyses", *Journal of Critical Reviews*, ISSN- 2394-5125 Vol 7(2), DOI: <http://dx.doi.org/10.31838/jcr.07.02.144>.
- Almqvist, J. (2009). The Politics of Recognition, Kosovo and International Law, Real Instituto Elcano, Working Paper 14/2009. <https://media.realinstitutoelcano.org/wp-content/uploads/2021/11/wp-14-almqvist-kosovo-international-law.pdf>.
- Antonenko, A. (2007). Russia and the Deadlock over Kosovo. *Russia/NIS Center. Russie.Nei.Visions*, No. 21.
- Arbatli, C. et al. (2019). Diversity and Conflict, *Bravo Working Paper*. <https://ssrn.com/abstract=3527039> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.3527039>.
- Auerswald, D. P. (2004). Explaining Wars of Choice: An Integrated Decision Model of NATO Policy in Kosovo. *International Studies Quarterly*, 48(3), 631–662. <http://www.jstor.org/stable/3693526>.
- Azar, E. E. (1980). The Conflict and Peace Data Bank (COPDAB) Project. *The Journal of Conflict Resolution*, 24(1), 143–152. <http://www.jstor.org/stable/173937>.
- Balcer, A. (2003). Kosovo – the question of final status, *CES Studies*.
- Baldwin, T. (2009). Recognition: personal and political. *Politics, Philosophy & Economics*, 8(3), 311–328. <https://doi.org/10.1177/1470594X09105391>.
- Bartelson, J. (2013). Three concepts of recognition. *International Theory*, 5(1), 107-129. <https://doi.org/10.1017/S175297191300002X>.

- Bauder, H. & Mueller, R (2021). Westphalian Vs. Indigenous Sovereignty: Challenging Colonial Territorial Governance, Geopolitics, <https://doi.org/10.1080/14650045.2021.1920577>.
- Bebler, A. (2015). The Serbia-Kosovo conflict. In A. Bebler (Ed.), "Frozen conflicts" in Europe (1st ed., pp. 151–170). Verlag Barbara Budrich. <http://www.jstor.org/stable/j.ctvdf0bmg.18>.
- Bercovitch, J., & Foulkes, J. (2012). Cross-cultural effects in conflict management: Examining the nature and relationship between culture and international mediation. *International Journal of Cross Cultural Management*, 12(1), 25–47. <https://doi.org/10.1177/1470595811413105>.
- Bieber, F. (2015). The Serbia-Kosovo Agreements: An eu Success Story? *Centre for Southeast European Studies, University of Graz, Review of Central and East European Law*. 40. 285-319.
- Blaufarb, R. (2007). The Western Question: The Geopolitics of Latin American Independence. *The American Historical Review*, 112(3), 742–763. <http://www.jstor.org/stable/40006669>.
- Böckenförde, M. (2011). A Practical Guide to Constitution Building: Decentralized Forms of Government, International IDEA's publication A Practical Guide to Constitution.
- Bolton, G. & Visoka, G. (2010). Recognizing Kosovo's independence: Remedial secession or earned sovereignty? St Antony's College University of Oxford.
- Bolton, G. (2013). International responses to the secession attempts of Kosovo, Abkhazia and South Ossetia 1989–2009. 109-138. <https://doi.org/10.1017/CBO9781139248952.008>.
- Borgen, Ch, (2008). Kosovo's Declaration of Independence: Self-Determination, Secession and Recognition, *American Society of International Law: Asil Insight*, <http://www.asil.org/insights/2008/02/insights080229.html>.
- Bothe, M. (2012). "Drawing Borders as a Means to Restore and Maintain Peace: From Palestine to Kosovo and Back". In *Kosovo and International Law*. Leiden, The Netherlands: Brill | Nijhoff. doi: https://doi.org/10.1163/9789004221291_009.
- Braithwaite, A. (2010). Resisting infection: How state capacity conditions conflict contagion. *Journal of Peace Research*, 47(3), 311–319. <https://doi.org/10.1177/0022343310362164>.

- Brown, Michael et al. (2001) eds. *Nationalism and ethnic conflict*. MIT Press.
- Caplan, R. (1998). International Diplomacy and the Crisis in Kosovo. *International Affairs* (Royal Institute of International Affairs 1944-), 74(4), 745–761. <http://www.jstor.org/stable/2625368>.
- Carson, C. (2013). The Dayton Accords and the Escalating Tensions in Kosovo. *Berkeley Undergraduate Journal*, 26(1). <http://dx.doi.org/10.5070/B3261016222>.
- Caspersen, N. (2015). The Pursuit of International Recognition After Kosovo, *Global Governance: A Review of Multilateralism and International Organizations*, 21(3), 393-412. <https://doi.org/10.1163/19426720-02103004>.
- Cederman, L. et al. (2011). Horizontal Inequalities and Ethnonationalist Civil War: A Global Comparison. *The American Political Science Review*, 105(3), 478–495. <http://www.jstor.org/stable/41480853>.
- Cederman, L. and Pengl, Y. (2019). *Global Conflict Trends and their Consequences*, ETH Zürich
- Coggins, B. (2014). Statehood in Theory and Practice. In *Power Politics and State Formation in the Twentieth Century: The Dynamics of Recognition* (pp. 14–43). chapter, Cambridge: Cambridge University Press. <http://doi.org/10.1017/CBO9781107239050.002>
- Craven, C. R. M. (1996). The European Community Arbitration Commission on Yugoslavia, *School of Oriental and African Studies*. <http://bybil.oxfordjournals.org>.
- Crawford, B. (1996). Explaining Defection from International Cooperation: Germany's Unilateral Recognition of Croatia. *World Politics*, 48(4), 482–521.
- Croci, O. (2000). Forced Ally? Italy and 'Operation Allied Force', *Italian Politics*, 15(1), 33-50. <https://www.berghahnjournals.com/view/journals/italian-politics/15/1/ip150105.xml>.
- Cross, Sh. (2001). *Russia and NATO Toward the 21st Century: Conflicts and Peacekeeping in Bosnia-Herzegovina and Kosovo* NATO-EAPC Research Fellowship Award Final Report NATO/Academic Affairs 1999-2001.
- DAC, (2012). "Guidelines and Reference Series International Support to Post-Conflict Transition: Rethinking Policy, Changing Practice". France: OECD Publishing, 28-29. <https://doi.org/10.1787/19900988>.

- Davidson, J. W. (2011). Italy at War: Explaining the Italian Contribution to the Kosovo War (1999). Italy's Foreign Policy in the Twenty-first Century: The New Assertiveness of An Aspiring Middle Power, 153-173.
- Davidson, J. W. (2011). Italy at War: Explaining the Italian Contribution to the Kosovo War (1999). Italy's Foreign Policy in the Twenty-first Century: The New Assertiveness of An Aspiring Middle Power, 153-173.
- Deda, I. (2010). The View from Kosovo: Challenges to Peace-building and State building. The Quarterly Journal.
- Devin, Guillaume. & Toernquist-Chesnier, Marie. 'Burst Diplomacy - The Diplomacies of Foreign Policy: Actors and Methods''. Brazilian Political Science Review Online 2009.
- Dixon, P. (2003). Victory by spin? Britain, the US and the propaganda war over Kosovo, Civil Wars, 6:4, 83-106, <http://doi.org/10.1080/13698240308402556>.
- Drnovsek, J. (2000). Riding the Tiger: The Dissolution of Yugoslavia. World Policy Journal, 17(1), 57-63. <http://www.istor.org/stable/40209677>.
- Duclos, N. (2020). Joining the Kosovo Liberation Army: A continuist, process-based analysis. *Violence: An International Journal*, 1(1), 21-39. <https://doi.org/10.1177/2633002420904263>.
- Dugard, J. (2021). "Chapter 5 What Is a State in International Law? How Is This to Be Determined?". In *Furthering the Frontiers of International Law: Sovereignty, Human Rights, Sustainable Development*. Leiden, The Netherlands: Brill | Nijhoff. doi: https://doi.org/10.1163/9789004459892_006.
- Shih edhe Gruda, Z. (2013). E Drejta Ndërkombëtare Publike. Prishtinë, ose Panayi, P. (2018). 'The state of a State - The ineffective application of the Montevideo criteria.
- Dugard, J. (2013). *The Secession of States and Their Recognition in the Wake of Kosovo*. Netherlands: Brill.
- Eckert, AE. (2002). *Constructing states: the role of the international*, Princeton University, <https://jpia.princeton.edu/sites/jpia/files/2002-2.pdf>.
- Eckhard, S. & Dijkstra, H. (2017). Contested Implementation: The Unilateral Influence of Member States on Peacebuilding Policy in Kosovo. *Erschienen in: Global Policy*; 8, S5. - S. 102-112 <https://dx.doi.org/10.1111/1758-5899.12455>.

- Efevwerhan, D.I., (2012). Kosovo's Chances of UN Membership: A Prognosis, Goettingen Journal of International Law 4 (2012) 1, 93-130, doi: 10.3249/1868-1581-4-1-efevwerhan. https://www.gojil.eu/issues/41/41_article_efevwerhan.pdf.
- Elmehed, M (2016). Disambiguating the Brussels agreement. A study of ambiguity in the Serbia-Kosovo normalisation process. Lund University.
- Emini, A & Marleku, A. (2016). The Prospects of Membership in International Organizations: The Case of Kosovo. Acta Universitatis Danubius. Relationes Internationales. 9(2). 172-181.
- Fabry, M. (2012) The contemporary practice of state recognition: Kosovo, South Ossetia, Abkhazia, and their aftermath, Nationalities Papers, 40:5, 661-676, <https://doi.org/10.1080/00905992.2012.705266>.
- Fawcett, J. (1968). Die Nichtanerkennung im Modernen Völkerrecht: Probleme staatlicher Willensäußerung, *International Affairs*, Volume 44(3). <https://doi.org/10.2307/2615046>.
- Fawn, R. & Nalbandov, R. (2012) The difficulties of knowing the start of war in the information age: Russia, Georgia and the War over South Ossetia, August 2008, European Security, 21:1, 57-89, <https://doi.org/10.1080/09662839.2012.656601>.
- Fierstein, D. (2009). "Kosovo's declaration of independence: an incident analysis of legality, policy and future implications". University School of Law. *Boston University International Law Journal*, 417-442.
- François, F. (2016). The State between Fact and Law: The Role of Recognition and the Conditions Under Which it is Granted in the Creation of New States. Polish Yearbook of International Law, Vol. 36, 51-81, <https://ssrn.com/abstract=3025607>.
- Garding, S. (2021). Kosovo: Background and U.S. Policy, Congressional Research Service, R46175, <https://crsreports.congress.gov>.
- Gashi, K., & Musliu, V. (2017). Mediation through recontextualization: The European Union and the dialogue between Kosovo and Serbia. *European Foreign Affairs Review*, 22(4).
- Geci, Sh. (2008). Kosovo's Final Status Negotiation Process: A Way Out or Cul-de Sac, A dissertation presented to the Faculty of Arts in the University of Malta for the degree of Master in Contemporary Diplomacy.

- Gow, J. (2009). Kosovo – The Final Frontier? From Transitional Administration to Transitional Statehood. *Journal of Intervention and Statebuilding*. Volume 3 (2). 239-257 <https://doi.org/10.1080/17502970902830034>.
- Grant, T. D. (1999). *The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution*. United Kingdom: Praeger.
- Lauterpacht, H. (2012). *Recognition in International Law*. United Kingdom: Cambridge University Press.
- Weller, M. (2008). Kosovo's Final Status. *International Affairs (Royal Institute of International Affairs 1944-)*, 84(6), 1223–1243. <http://www.jstor.org/stable/25144990>.
- Greenwood, Ch. (2002). Humanitarian intervention: the case of Kosovo. *Finnish yearbook of international law*. Helsinki, Finland: Kluwer Law, 141-175.
- Gromes, Th, (2019). A humanitarian milestone? NATO's 1999 intervention in Kosovo and trends in military responses to mass violence, PRIF report 2/2019, 4.
- Güner, O. (2021). A Legitimacy Question in The European Union: The Kosovo Non-Recognition Quagmire, *Avrasya Etüdleri*, YIL: 27 / SAYI: 59.
- Gurr, T. R. (1993). Why Minorities Rebel: A Global Analysis of Communal Mobilization and Conflict Since 1945. *International Political Science Review / Revue Internationale de Science Politique*, 14(2), 161–201. <http://www.jstor.org/stable/1601151>.
- Gustafsson, K. (2016). Recognising recognition through thick and thin: Insights from Sino-Japanese relations. *Cooperation and Conflict*, 51(3), 255–271. <https://doi.org/10.1177/0010836715610594>.
- Guzina, D. (2000) "The Self-Destruction of Yugoslavia," *Canadian Review of Studies in Nationalism* 27, no. 1/2. 21-32.
- Hamilton, A. & Morina, E. (2014), *Germany's Foreign Policy towards Kosovo. A Policy Perspective*. Group for Legal and Political Studies.
- Hilpold, P. (2012). "The Kosovo Opinion of 22 July 2010: Historical, Political and Legal Pre-Requisites". In *Kosovo and International Law*. Leiden, The Netherlands: Brill | Nijhoff. doi: https://doi.org/10.1163/9789004221291_002.
- Hirvonen, O., & Laitinen, A. (2016). Recognition and democracy – An introduction. *Thesis Eleven*, 134(1), 3–12. <https://doi.org/10.1177/0725513616646022>.
- Holsti, O. (2013). *Making American Foreign Policy*. United Kingdom: Taylor & Francis.
- Hoogenboom, J. (2011). *The EU as a Peacebuilder in Kosovo*. Civil Society Dialogue Network.

- Howlett, M., & Rayner, J. (2006). Understanding the historical turn in the policy sciences: A critique of stochastic, narrative, path dependency and process-sequencing models of policy-making over time. *Policy Sciences*, 39(1), 1–18. <https://doi.org/10.1007/S11077-005-9004-1>.
- Hudson, K. A. (2009). *Justice, Intervention, and Force in International Relations: Reassessing Just War Theory in the 21st Century*. (n.p.): Taylor & Francis.
- Hürner, R. G. (1997). Kosovo after the Dayton Agreement. *Studia Diplomatica*, 50(1), 71–77. <http://www.jstor.org/stable/44840039>.
- Huzen, Kent. (2019). *Framework for understanding: geopolitics and foreign policy*.
- ICG. (2007). Kosovo: No Good Alternatives to the Ahtisaari Plan. Crisis Group Europe Report N°182.
- Imeri, D. (2021). "The role of parliamentary diplomacy in Kosovo's foreign policy 2008-2021". *Bulletin of the Faculty of Philosophy. KDU 94(=18) (05)*.
- Ingimundarson, V. (2022). 'Kosovo Precedent': Russia's justification of military interventions and territorial revisions in Georgia and Ukraine. LSE IDEAS Strategic.
- Istrefi, K. (2018). Kosovo's Quest for Council of Europe Membership, *Review of Central and East European Law*, 43(3), 255-273. doi: <https://doi.org/10.1163/15730352-04303002>.
- Kelsen, H. (1941). Recognition in International Law: Theoretical Observations. *The American Journal of International Law*, 35(4), 605–617. <https://doi.org/10.2307/2192561>.
- Keohane, D. (2000). The debate on British policy in the Kosovo conflict: An assessment, *Contemporary Security Policy*, 21:3, 78-94, <http://doi.org/1080/13523260008404269>.
- Ker-Lindsay, J. (2012). The Role of International Organizations', *The Foreign Policy of Counter Secession: Preventing the Recognition of Contested States*. 130–157. <https://doi.org/10.1093/acprof:oso/9780199698394.003.0007>.
- Ker-Lindsay, J. (2015) Explaining Serbia's decision to go to the ICJ. In: Milanovic, Marko and Wood, Michael, (eds.) *The Law and Politics of the Kosovo Advisory Opinion*. Oxford University Press, Oxford, UK. ISBN 9780198717515. <http://eprints.lse.ac.uk/51624/>.
- Ker-Lindsay, J. (2015). Britain, 'Brexit' and the Balkans, *The RUSI Journal*, 160:5, 24-29, <http://doi.org/10.1080/03071847.2015.1102539>.
- Kingsbury, B. (1998) Sovereignty and Inequality. *European Journal of International Law*, Vol. 9, 599-625, <https://ssrn.com/abstract=803695>.

- Kleibrink, A. (2008). Federalism in the Balkans – Doomed to fail?. *L'Europe en Formation*, 349-350, 71-79. <https://doi.org/10.3917/eufor.349.0071>.
- Kostovicova, D. (2008) Legitimacy and international administration: The Ahtisaari settlement for Kosovo from a human security perspective. *International Peacekeeping*, 15 (5). pp. 631-647. ISSN 1353-3312. <https://doi.org/10.1080/13533310802396160>.
- Kostovicova, D. (2008) Legitimacy and international administration: The Ahtisaari settlement for Kosovo from a human security perspective. *International Peacekeeping*, 15 (5). pp. 631-647. ISSN 1353-3312. <https://doi.org/10.1080/13533310802396160>.
- Kostovicova, D. (2008). Legitimacy and international administration: the Ahtisaari settlement for Kosovo from a human security perspective. *International Peacekeeping*, 15 (5). 631-647. <https://doi.org/10.1080/13533310802396160>.
- Krasner, S. (2001). Abiding Sovereignty. *International Political Science Review/Revue Internationale de SciencePolitique*, 22 (3), 229–251.
- Kyris, G. (2022). State recognition and dynamic sovereignty. *European Journal of International Relations*, 28(2), 287–311. <https://doi.org/10.1177/13540661221077441>
- Latawski, P., & Smith, M. A. (2018). " Introduction". In *The Kosovo crisis and the evolution of post-Cold War European security*. Manchester, England: Manchester University Press.
- Laurinavičiūtė L. & Biekša, L., (2015). *International Comparative Jurisprudence*, Volume 1(1). 66-75, <https://doi.org/10.1016/j.icj.2015.10.008>.
- Lefteratos, A. (2022): Contested statehood, complex sovereignty and the European Union's role in Kosovo, *European Security*, <https://doi.org/10.1080/09662839.2022.2138350>.
- Lehne, S. (2009). *Resolving Kosovo's Status*. (Policy Paper/Österreichisches Institut für Internationale Politik). Wien: Österreichisches Institut für Internationale Politik (oiip). <https://nbn-resolving.org/urn:nbn:de:0168-ssoar-58272-2>.
- Levitin, O. (2010). Inside Moscow's Kosovo muddle. *Global Politics and Strategy*. Volume 42, 2000 - Issue 1. 130-140. <https://doi.org/10.1093/survival/42.1.130>.
- Macdonald, D. B. (2002). *Balkan Holocausts?: Serbian and Croatian victim centred propaganda and the war in Yugoslavia*. Manchester University Press. <http://www.jstor.org/stable/j.ctt155jbrm>
- Macleod, A. (1997). French Policy toward the War in the Former Yugoslavia: A Bid for International Leadership. *International Journal*, 52(2), 243–264. <https://doi.org/10.2307/40203199>.

- Marleku, A. (2012). Small States Foreign Policy: the Case of Kosovo. *Alternatives Turkish journal of international relations*. Vol. 11, No. 3, 80-97. www.alternativesjournal.net.
- Marolov, D. (2012). The Policy of the USA and EU towards the Disintegration of Yugoslavia, *International Journal of Social Science Tomorrow*. Vol. 1 No. 2, ISSN: 2277-6168, www.ijsst.com.
- Marsavelski, A, et al. (2018), Did nonviolent resistance fail in Kosovo?, Oxford University Press on behalf of the Centre for Crime and Justice Studies (ISTD), 58, 218–236.
- Mason, W. (2006). Kosovo: Unraveling the Knot. *World Policy Journal*, 23(3), 87–98. <http://www.jstor.org/stable/40210036>.
- Mazi, C.C., "Power and Foreign Policy: A Theoretical Approach". *International Journal of Research and Innovation in Social Science (IJRISS)* |Volume III, Issue VIII, August 2019|ISSN 2454-6186, 600, www.rsisinternational.org.
- McCurley, J. (1979). The Historian's Role in the Making of Public Policy. *Social Science History*, 3(2), 202–207. <https://doi.org/10.2307/1171201>.
- Meester, D. (2011). The International Court of Justice's Kosovo Case: Assessing the Current State of International Legal Opinion on Remedial Secession. *Canadian Yearbook of International Law/Annuaire Canadien De Droit International*, 48, 215-254. <https://doi.org/10.1017/S0069005800010122>.
- Mehmeti, E. (2017). Quest for Statehood: Kosovo's Plea to Join International Organizations. *European Journal of Social Sciences. Education and Research*. Vol.11 Nr. 2. 370 – 378.
- Mélandri, P. (2000). Les États-Unis et le Kosovo. Les risques d'un leadership à bon marché. In: *Vingtième Siècle, revue d'histoire*, n°67,. pp. 3-19; doi : <https://doi.org/10.3406/xxs.2000.4591>.
- Michael E. Smith, M. E. (1995). The Limits of Leadership: Germany and the EMS/Yugoslavian Crises, University of California. http://aei.pitt.edu/7018/1/smith_michael_e.pdf.
- Mir, F. (2015). Introduction. *The American Historical Review*, 120(3), 844–851. <https://www.jstor.org/stable/26577259>.
- Morelli, V. (2018). Kosovo: Background and U.S. Relations, Congressional Research Service, 7-5700, www.crs.gov, R44979.
- Morrison, F. (1961). "Recognition in International Law: A Functional Reappraisal." *The University of Chicago Law Review*, vol. 34, no. 4, University of Chicago Law Review, 1967, pp. 857–83, <https://doi.org/10.2307/1598995>.

- Muhammad, Muzaffar. et al, "Pakistan's Foreign Policy: Initial Perspectives and Stages". Global Regional Review I, no.I, 2016.
- Muharremi, R. (2014). Conflicting Rules of Recognition: UN Security Council Resolution 1244 or the Constitution of the Republic of Kosovo. *German Law Journal*, 15(4), 719–733. <http://doi.org/10.1017/S207183220001909X>.
- Murphy, A. & Stăncescu, V. (2017). State formation and recognition in international law. *Juridical Tribune*. 7. 6-14.
- Murphy, S. D. (2003). Use of Force and Arms Control. In *United States Practice in International Law* (Vol. 1, pp. 387–460). chapter, Cambridge: Cambridge University Press. <http://doi.org/10.1017/CBO9780511493799.012>.
- Mustafa, Z. (1971). The Principle of Self-Determination in International Law. *The International Lawyer*, 5(3), 479–487. <http://www.jstor.org/stable/40704674>.
- Newhouse, J. (2009). Diplomacy, Inc.: The Influence of Lobbies on U.S. Foreign Policy. *Foreign Affairs*, 88(3), 73–92. <http://www.jstor.org/stable/20699564>.
- Newman, E & Visoka, G (2018). The Foreign Policy of State Recognition: Kosovo's Diplomatic Strategy to Join International Society. *Foreign Policy Analysis*, 14 (3). pp. 367-387. <https://doi.org/10.1093/fpa/orw042>.
- Newman, E. & Visoka, G. (2021) The Geopolitics of State Recognition in a Transitional International Order, *Geopolitics*. <https://doi.org/10.1080/14650045.2021.1912018>.
- Nezaj, N. Xh. (2015): The development of Kosovo and its relationship with the EU, Discussion Paper, No. 4/15, Europa-Kolleg Hamburg, Institute for European Integration, Hamburg.
- Nigro, Di V., (2008). L'Italia riconosce il Kosovo, Belgrado ritira l'ambasciatore
- Nikitin, B. S. (2010). "Kosovo's Road to Independence." *Inquiries Journal/Student Pulse*, 2(09). Retrieved from <http://www.inquiriesjournal.com/a?id=291>.
- Nuechterlein, D. E. (1976). National interests and foreign policy: A conceptual framework for analysis and decision-making. *British Journal of International Studies*, 2(3), 246–266. <http://doi.org/10.1017/S0260210500116729>.
- Okosa, Ch. (2018). Statehood Theory: Current Scholarship on the Various Theories of Statehood in International Law (2018). *Nile University Law Journal* Vol. 1 No. 1, <https://ssrn.com/abstract=4157829>.

- Papic, T. (2015). "Political Aftermath of the ICJ AO on Kosovo" (October 31, 2013); M. Milanović, M. (2015). "The Law and Politics of Kosovo Advisory Opinion", Oxford University Press, 240-267.
- Patton, S. (2019). "The Peace of Westphalia and its Effects on International Relations, Diplomacy and Foreign Policy," *The Histories*: Vol. 10 : Iss. 1 , Article 5
- Pellet, A. (1992). The Opinions of the Badinter Arbitration Committee A Second Breath for the Self-Determination of Peoples, *European Journal of International Law*, Volume 3, Issue 1, 178–185, <https://doi.org/10.1093/oxfordjournals.ejil.a035802>.
- Perritt Jr., H. (2005). Final Status for Kosovo, 80 *Chi.-Kent L. Rev.* 3. <https://scholarship.kentlaw.iit.edu/cklawreview/vol80/iss1/2>.
- Perritt, Jr., H. (2009). Kosovo's Future. In *The Road to Independence for Kosovo: A Chronicle of the Ahtisaari Plan* (pp. 221-254). Cambridge: Cambridge University Press. <https://doi.org/10.1017/CBO9780511635410.018>.
- Perritt, Jr., H. (2009). Kosovo's Future. In *The Road to Independence for Kosovo: A Chronicle of the Ahtisaari Plan* (pp. 221-254). Cambridge: Cambridge University Press. <https://doi.org/10.1017/CBO9780511635410.018>.
- Phillips, D. L. (1996). Comprehensive Peace in the Balkans: The Kosovo Question. *Human Rights Quarterly*, 18(4), 821–832. <http://www.jstor.org/stable/762594>.
- Pippan, C. & Karl, W. (2008). Self-determination, secession and recognition: International law aspects of Kosovo's independence (Parts I and II). *Europäisches Journal für Minderheitenfragen*. 1. <https://doi.org/10.1007/s12241-008-0030-z>.
- Pisciotta, B. (2020). Russian revisionism in the Putin era: an overview of post-communist military interventions in Georgia, Ukraine, and Syria. *Italian Political Science Review/Rivista Italiana Di Scienza Politica*, 50(1), 87–106. <http://doi.org/10.1017/ipo.2019.18>.
- Poghosyan, S. & Berg, E. (2021). When There Is a State? The Politics of Recognition and Kosovo. *Diplomacy & Statecraft*, Volume 32 (3). 605-626 <https://doi.org/10.1080/09592296.2021.1961492>.
- Poirier, C. R. (1998). *The Breakup of Yugoslavia and the War in Bosnia*, USA: Greenwood Press.
- Pomerance, M. (1998). The Badinter Commission: The Use and Misuse of the International Court of Justice's Jurisprudence, *Michigan Journal of International Law*. 20 (1). <https://repository.law.umich.edu/mjil/vol20/iss1/2>.

- Price, P. The Impact of Constitutive Recognition on the Right to Self-Determination: An Analysis of United States Recognition Practices Utilizing the Chinese Question as a Guide, 14 Val. U. L. Rev. 123 (1979). <https://scholar.valpo.edu/vulr/vol14/iss1/6>.
- Qeriqi, B. (2020). The Beginning of the Breakup of Yugoslavia – Kosovo as starting point. *Kroatologija*, 11 (2), 81-105. <https://hrcak.srce.hr/251541>.
- Rabushka, A., & Shepsle, K. A. (1971). Political Entrepreneurship and Patterns of Democratic Instability in Plural Societies. *Race*, 12(4), 461–476. <https://doi.org/10.1177/030639687101200407>.
- Radeljic, B. (2010). Europe 1989-2009: Rethinking the Break-up of Yugoslavia. *European Studies*, 9(1), 115-127.
- Rajic, D. & Attila Hoare, M. (2022). Serbia and Russia and the Coming Balkan Storm. *The Foreign Service Journal*.
- Ramet, S. P., Simkus, A., & Listhaug, O. (eds.). (2015). Civic and uncivic values in Kosovo: History, politics, and value transformation (NED-New edition, 1). Central European University Press. <http://www.jstor.org/stable/10.7829/j.ctt13wzttq>.
- Ramsay, K. W. (2008). Settling It on the Field: Battlefield Events and War Termination. *The Journal of Conflict Resolution*, 52(6), 850–879. <http://www.jstor.org/stable/27638643>.
- Reynolds, P. (2008). BBC. Legal furore over Kosovo recognition. <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/7244538.stm>.
- Rezvani, B. (2020) Russian foreign policy and geopolitics in the Post-Soviet space and the Middle East: Tajikistan, Georgia, Ukraine and Syria, *Middle Eastern Studies*, 56:6, 878-899, <https://doi.org/10.1080/00263206.2020.1775590>.
- Richmond, O. (2002). States of sovereignty, sovereign states, and ethnic claims for international status. *Review of International Studies*, 28(2), 381-402. <https://doi.org/10.1017/S0260210502003819>.
- Richter, S. (2012). "The Political Future of Kosovo after the ICJ Opinion: Status Question (Un)Resolved?". In *Kosovo and International Law*. Leiden, The Netherlands: Brill | Nijhoff. doi: https://doi.org/10.1163/9789004221291_014.
- Riegl, M. Doboš B. (2018). Geopolitics of Secession: Post-Soviet De Facto States and Russian Geopolitical Strategy, *Central European Journal of International and Security Studies* 12, no. 1: 59–89.

- Rogel, C. (2003). Kosovo: Where It All Began. *International Journal of Politics, Culture, and Society*, 17(1), 167–182. <http://www.jstor.org/stable/20020202>.
- Roseberry, P. (2013). Mass Violence and the Recognition of Kosovo: Suffering and Recognition. *Europe-Asia Studies* Volume 65, (5): Special Issue: Self-Determination After Kosovo. 857-873. <https://doi.org/10.1080/09668136.2013.792449>.
- Roth, B. (2015). The Virtues of Bright Lines: Self-Determination, Secession, and External Intervention. *German Law Journal*, 16(3), 384-415.
- Rusinow, D. (1991). Yugoslavia: Balkan Breakup? *Foreign Policy*, 83, 143–159. <https://doi.org/10.2307/1148723>.
- Russell, P. (2009). The exclusion of Kosovo from the Dayton negotiations. *Journal of Genocide Research*, 11(4), 487–511. <https://doi.org/10.1080/14623520903309537>.
- Ryngaert, C., & Sobrie, S. (2011). Recognition of States: International Law or Realpolitik? The Practice of Recognition in the Wake of Kosovo, South Ossetia, and Abkhazia. *Leiden Journal of International Law*, 24(2), 467-490. <http://doi.org/10.1017/S0922156511000100>.
- Rahmani, B. (2014). Kosova/o and the challenges of recognition. *European Scientific Journal*. /SPECIAL/ edition vol.2 ISSN: 1857 – 7881 (Print) e - ISSN 1857- 7431.
- Salla, M. (1995). Kosovo, Non-violence and the Break-up of Yugoslavia. *Security Dialogue*, 26(4), 427–438. <http://www.jstor.org/stable/26296545>.
- Sallova, D. (2017). Ethnic decentralization in Kosovo. *THESIS*, Vol. 6, no. 2, 2017. 97-111.
- Sathyamurthy, T. V. "New States and International Order: The East African States." *Economic and Political Weekly*, vol. 6, no. 51, *Economic and Political Weekly*, 1971, pp. 2523–27, <http://www.jstor.org/stable/4382886>.
- Schieder, T. (1978). The Role of Historical Consciousness in Political Action. *History and Theory*, 17(4), 1–18. <https://doi.org/10.2307/2504707>.
- Sell, L. (2003). *Slobodan Milosevic and the Destruction of Yugoslavia*. United Kingdom: Duke University Press.
- Seymour, LJM. (2017). Legitimacy and the Politics of Recognition in Kosovo. *Small Wars & Insurgencies*. Volume 28, (4-5): Rebels & Legitimacy. 817-838. <https://doi.org/10.1080/09592318.2017.1322335>.
- Siboe N.N. (2020) The Criteria for Self-determination and Recognition as a Sovereign State: Case of Kosovo. *Open Science Journal* 5(3).

- Siegertszt, S. (2015) Kosovo and Serbia: an agreement to normalize relations. *Revista de Ciências Militares*, III (1), pg. 13-37. <http://www.iesm.pt/cisdi/index.php/publicacoes/revista-de-ciencias-militares/edicoes>.
- Siroky, D. S., Popovic, M., & Mirilovic, N. (2021). Unilateral secession, international recognition, and great power contestation. *Journal of Peace Research*, 58(5), 1049–1067. <https://doi.org/10.1177/0022343320963382>.
- Skrpec, D. (2003). The European and American Reactions to Kosovo: The Policy Divide Revisited in the Iraq War. *SAIS Review*, 23, 111 - 93.
- Smith, J. (2008). The NATO-Russia Relationship: Defining Moment or Déjà vu?. *Politique étrangère*, I, 759-773. <https://doi.org/10.3917/pe.084.0759>, dhe Megan Slack, "Kosovo a frustration for Russia," *LA Times*, February 14, 2008.
- Sotiropoulou, A. (2002). The role of ethnicity in ethnic conflicts: The case of Yugoslavia MA in Contemporary European Studies, Euromaster, University of Bath.
- Sotiropoulou, A. The role of ethnicity in ethnic conflicts: The case of Yugoslavia, MA in Contemporary European Studies, Euromaster, University of Bath.
- Steel, C. (2015) "Introduction: The Legacy of the Republican Roman Senate". *Classical Receptions Journal*, Volume 7, Issue 1, <https://doi.org/10.1093/crj/clu011>.
- Tannam, E. (2013). The EU's Response to the International Court of Justice's Judgment on Kosovo's Declaration of Independence. *Europe-Asia Studies*, 65(5), 946–964. <http://www.jstor.org/stable/23438650>.
- Taylor, C (1994) The politics of recognition. In: Gutmann, A (ed.) *Multiculturalism: Examining the Politics of Recognition*. Princeton: Princeton University Press, 25–74
- Tilly C. (2001) Historical Analysis of Political Processes. In: Turner J.H. (eds) *Handbook of Sociological Theory. Handbooks of Sociology and Social Research*. Springer, Boston, MA. https://doi.org/10.1007/0-387-36274-6_26.
- Toshev, A. & Cheikhameguyaz, G. (2005). The European Union and the Final Status for Kosovo, 80 *Chi.- Kent L. Rev.* 273. <https://scholarship.kentlaw.iit.edu/cklawreview/vol80/iss1/12>.
- Tuathail, G. (2013). Russia's Kosovo: A Critical Geopolitics of the August 2008 War over South Ossetia. *Eurasian Geography and Economics*, Volume 49, 2008 - Issue 6. 670-705. <https://doi.org/10.2747/1539-7216.49.6.670>.

- Thomas, R.G.C., & Friman, H.R. (Eds.). (1996). *The South Slav Conflict: History, Religion, Ethnicity, and Nationalism* (1st ed.). Routledge. <https://doi.org/10.4324/9781003249917>. Shih kapitullin, Germany and the Breakup of Yugoslavia e përgatitur nga Wolfgang F. Schloer.
- Thorhallsson, B. & Steinsson, S. (2017). *Small State Foreign Policy. Oxford Research Encyclopedia of Politics*.
- Uwe Friedrich, W. (2000). *The legacy of Kosovo: German politics and policies in the Balkans*. American Institute for Contemporary German Studies. The Johns Hopkins University. <http://www.aicgs.org>.
- van Heuven, M. H. A. (1993). Testing the New Germany: The Case of Yugoslavia. *German Politics & Society*, 29, 52–63. <http://www.jstor.org/stable/23735271>.
- Verbeek, B. & Giacomello, G. (2011). *Italy's Foreign Policy in the Twenty-first Century: The New Assertiveness of an Aspiring Middle Power*. United States, Lexington Books,
- Davidson, J. W. (2011). *Italy at War: Explaining the Italian Contribution to the Kosovo War (1999)*. *Italy's Foreign Policy in the Twenty-first Century: The New Assertiveness of An Aspiring Middle Power*, 153-173.
- Vidmar, J. (2010). Remedial Secession in International Law: Theory and (Lack of) Practice. *St Antony's International Review*, 6(1), 37–56. <http://www.jstor.org/stable/26227069>.
- Vidmar, J. (2011). The Kosovo Advisory Opinion Scrutinized. *Leiden Journal of International Law*, 24(2), 355-383. <https://doi.org/10.1017/S0922156511000057>.
- Vidmar, J. (2012). EXPLAINING THE LEGAL EFFECTS OF RECOGNITION. *The International and Comparative Law Quarterly*, 61(2), 361–387. <http://www.jstor.org/stable/23279896>.
- Vidmar, J. (2021). International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence, 42 *Vanderbilt Law Review* 779, <https://scholarship.law.vanderbilt.edu/vjtl/vol42/iss3/2>.
- Warbrick, C. (2008). Kosovo: The Declaration of Independence. *The International and Comparative Law Quarterly*, 57(3), 675–690. <http://www.jstor.org/stable/20488236>.
- Weisglas, Frans W. & de Boerb, Gonnie. "Parliamentary Diplomacy". *The Hague Journal of Diplomacy*, 2:1.
- Weller, M. (1999). The Rambouillet Conference on Kosovo. *International Affairs (Royal Institute of International Affairs 1944-)*, 75(2), 211–251. <http://www.jstor.org/stable/2623341>.

- Weller, M. (2008). Kosovo's Final Status. *International Affairs* (Royal Institute of International Affairs 1944-), 84(6), 1223–1243. <http://www.jstor.org/stable/25144990>.
- Weller, M. (2008). The Vienna Negotiations on the Final Status for Kosovo. *International Affairs* (Royal Institute of International Affairs 1944-), 84(4), 659–681. <http://www.jstor.org/stable/25144870>.
- Woehrel, S. (1999: 5). Kosovo: Historical Background to the Current Conflict. CRS Report for Congress. <https://sgp.fas.org/crs/row/RS20213.pdf>.
- Wood, P. Ch. (1994). France and the post-cold war order: The case of Yugoslavia, *European Security*, 3:1, 129-152, <https://doi.org/10.1080/09662839408407156>.
- Worster, W. T. (2009). Law, Politics, and the Conception of the State in State Recognition Theory, *Boston University International Law Journal*, Vol. 27, No. 1.
- Yağci, S. (2019). Internal and external reasons of the breakup of the Yugoslavia, 2(4): 245-258, <https://doi.org/10.32953/abad.535965>.
- Yannis, A. (2004). The UN as Government in Kosovo. *Global Governance*, 10(1), 67–81. <http://www.jstor.org/stable/27800510>.
- Yannis, A. (2009). A The politics and geopolitics of the status of Kosovo: the circle is never round, *Southeast European and Black Sea Studies*, 9:1-2, 161-170. <http://doi.org/10.1080/14683850902723470>.
- Yesson, E. (1999). NATO and Russia in Kosovo. *Perspectives*, 13, 11–19. <http://www.jstor.org/stable/23615938>.
- Żakowska, M. (2016). Strategic challenges for Serbia's integration with the European Union. *Security and Defence Quarterly*, 11(2), 3-29. <https://doi.org/10.5604/01.3001.0010.5631>.
- Zejnullahi, V. (2014). Balkan Conflict, the Disintegration of Yugoslavia and the ICTY. *Mediterranean Journal of Social Sciences*. 5. 10.5901/mjss.2014.v5n19p264. shih edhe Lisen Bashkurti, Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Gerr, Tiranë, 2006.
- Zoran, Z. (2000). French Foreign Policy Elites and the Crises in the Former Yugoslavia, *Perspectives on Political Science*, 29:1, 17-22, <https://doi.org/10.1080/10457090009600692>.

Zhang, L. (2008). Analyzing the Causes of the Dissolution of the Former Yugoslav Federation from the Perspective of Ethnicity Relations, vol. 1, no. 2.
<https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1058020.pdf>.

Burime të tejra – Intervista

Alma Lama

Drilon Gashi

Enver Hoxhaj

Ibrahim Gashi

Jetlir Zymberaj

Kreshnik Ahmeti

Safet Merovci

Shemsi Krasniqi

Visar Ymeri

Burime nga Interneti

Arkivi elektorin i RTK-së

Arkivi elektorik i REL (Radio Evropa e Lirë)

Arkivi elektronik i RTV 21

Arkivi elektronik i KTV-së

Telegrafi

BBC

CNN

New York Time

AP

DW